

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

KONFERENCA E AMBASADORËVE NË LONDËR DHE SHQIPTARËT

Konferencë shkencore

13 tetor 2023



PRISHTINË
2024

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

ACADEMY OF SCIENCES OF ALBANIA

THE CONFERENCE OF AMBASSADORS IN LONDON AND THE ALBANIANS

Scientific Conference

13 October 2023

Prepared for publication by: Frashër Demaj

Organizing Committee:

Frashër Demaj, Chair, Jusuf Bajraktari, secretary, Hivzi Islami, member,
Justina Shiroka-Pula, member, Marenglen Verli, member, Beqir Meta, member,
Ksenofon Krisafi, member, Arben Cici, member

Editor: Correspondent member Gjyljeta Mushkolaj, Secretary of the Section of Social Sciences



PRISHTINA
2024

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

KONFERENCA E AMBASADORËVE NË LONDËR DHE SHQIPTARËT

Konferencë shkencore

13 tetor 2023

Përgatiti për botim: Frashër Demaj

Këshilli organizues:

Frashër Demaj, kryetar, Jusuf Bajraktari, sekretar, Hivzi Islami, anëtar,
Justina Shiroka-Pula, anëtare, Marenglen Verli, anëtar, Beqir Meta, anëtar,
Ksenofon Krisafi, anëtar, Arben Cici, anëtar

Redaktor: Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore



PRISHTINË
2024

Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

Frashër Demaj PARATHËNIE.....	7
Beqir Meta NDIKIMI I VENDIMEVE TË KONFERENCËS SË AMBASADORËVE NË LONDËR NË PROCESIN E NDËRTIMIT TË SHTETIT SHQIPTAR	13
Jusuf Bajraktari REZISTENCA E SHQIPTARËVE TË KOSOVËS NDAJ VENDIMEVE TË KONFERENCËS SË LONDRËS.....	25
Ksenofon Krisafi KUSH E (ZH)BËRI SHQIPËRINË, VLORA APO LONDRA, SHQIPTARËT NË 1912 APO EUROPA NË 1913?	35
Frashër Demaj KONTRIBUTI I “KOMITETIT SHQIPTAR TË LONDRËS” NË SENSIBILIZIMIN E ÇËSHTJES SHQIPTARE GJATË VITEVE 1912-1913.....	81
Arsim Bajrami ASPEKTE JURIDIKE DHE KUSHTETUESE TË NDARJES DHE ANEKSIMIT TË KOSOVËS NGA KONFERENCA E LONDRËS DERI TE PAVARËSIA E KOSOVËS	105
Paskal Milo FATI HISTORIK I VENDIMEVE TË KONFERENCËS SË AMBASADORËVE NË LONDËR PËR KOMBIN SHQIPTAR	141

Marenglen Verli

INTERESAT E FUQIVE EVROPIANE DHE PERCEPTIMI I
TYRE PËR SHQIPTARËT – PRELUDI I VENDIMEVE TË
KONFERENCËS SË LONDRËS 155

Ibrahim Gashi

NDIKIMET E KONSTELACIONIT NË RAPORTET E FUQIVE
TË MËDHA NË EPILOGUN E KONFERENCËS SË
AMBASADORËVE NË LONDËR 1912-1913 163

Arben Cici

SHQIPTARËT, NGA SHKËPUTJA PREJ SOVRANITETIT TË
SULLTANIT DREJT COPËTIMIT ETNIKO-TERRITORIAL,
BRENDA TREKËNDËSHIT ROMË-LONDËR-VJENË 175

Arbër Hadri

POLITIKA E SHBA-së NDAJ FORMËSIMIT TË SHTETIT
SHQIPTAR: NGA KONFERENCA E LONDRËS DERI TE
NJOHJA (1912-1922) 197

PARATHËNIE

Marrëveshjet politike për koalicion të përbashkët ushtarak në mes të aleatëve ballkanikë (Serbi, Bullgari, Mal i Zi dhe Greqi) u pasuan me nënshkrimin e marrëveshjeve konkrete për ndarjen e territoreve pas fitores së aleatëve në luftë kundër Perandorisë Osmane.

Më 13 mars 1912 u përfundua marrëveshja serbo – bullgare sipas të cilës Bullgaria i njihte Serbisë jo vetëm tokat me popullsi serbe, por edhe aneksimin e tokave shqiptare në Shqipërinë e Mesme, Veriore dhe Verilindore, kurse Serbia i njihte Bullgarisë tokat në lindje të Rodopit dhe të lumit Struma. Territori midis Bjeshkëve të Sharrit, lumit Struma dhe liqenit të Ohrit, me qytetet kryesore Dibër, Kërçovë, Gostivar, Tetovë, Kumanovë e Shkup e quajt si zonë e diskutueshme dhe si arbitër për zgjidhjen e kësaj çështjeje u caktua cari i Rusisë.

Krahas bisedimeve serbo – bullgare u zhvilluan edhe bisedimet bullgaro – greke, të cilat përfunduan më 29 maj me nënshkrimin e një marrëveshjeje mbrojtëse në rast sulmi nga ana e Perandorisë Osmane. Kjo u pasua me marrëveshje gjentelmene ndërmjet Greqisë dhe Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi dhe Bullgarisë dhe Malit të Zi. Këto marrëveshje u përforcuan me një varg konventash ushtarake të lidhura prej tyre. Përgatitjet e shteteve ballkanike për luftë kundër Perandorisë Osmane, destabilizimin e Ballkanit dhe nisjen e një lufte me përmasa të paparashikueshme.

Lufta Ballkanike shpërtheu më 8 tetor 1912 kur Mali i Zi i shpalli luftë Perandorisë Osmane. Më 17 tetor i shpallën asaj luftë Serbia e Bullgaria dhe një ditë më vonë Greqia. Këtë luftë, Britania e Madhe dhe Franca e quanin “një ndërmarrje kokëkrisurish”.

Fillimi i luftës i gjeti shqiptarët në një situatë shumë të ndërlikuar. Ata ishin po aq të interesuar sa edhe popujt e tjerë të shtypur të Ballkanit për t’u çliruar nga pushtimi osman. Përfaqësuesit e tyre bënë përpjekje për t’u lidhur me fqinjët në luftën e përbashkët kundërosmane, por këto përpjekje dështuan për faj të krerëve të Aleancës Ballkanike. Situata e luftës shkaktoi shqetësime dhe reagimin e Fuqive të Mëdha për shkak të mundësisë së destabilizimit dhe daljes jashtë kontrollit të situatës në Evropën Juglindore.

Brenda në Shqipëri nismën për një veprim politik, që ta nxirrte vendin nga gjendja e vështirë dhe e ndërlikuar e krijuar nga Lufta Ballkanike, e morën shoqëritë atdhetare, Komiteti “Shpëtimi” dhe “Shoqëria e Zezë për Shpëtim” që ishte krijuar në Shkup. Përfaqësuesit e tyre Sali Gjuka, Nexhip Draga, Bedri Pejani, Mithat Frashëri etj., organizuan në Shkup më 14 tetor 1912 një mbledhje, për të cilën ishte edhe miratimi i Hasan Prishtinës e i Bajram Currit, që kishin shkuar në front për organizimin e mbrojtjes së tokave shqiptare.

Ndërkohë në frontet e luftës, ushtritë e aleatëve ballkanikë brenda një kohe të shkurtër e shpartalluan ushtrinë osmane në të gjitha frontet. Trupat bullgare, pasi thyen qëndresën e forcave osmane, të përquendruara në Trakinë Lindore, iu drejtuan Adrianopojës. Forcat e Malit të Zi, të ndara në tri kolona, sulmuan dy në drejtim të Shkodrës dhe njëra në drejtim të Pejës. Brenda tri javësh ato pushtuan Pejën dhe iu drejtuan Shkodrës. Mbreti Nikolla i Malit të Zi u premtonte malësorëve se do të respektonte flamurin shqiptar, në thirrjen drejtuar popullit malazez e ftonte këtë t’u jepte dorën “vëllezërve nën zgjedhë të Malësisë, të cilët prej më shumë se dy vjetësh luftonin për të drejtat e lirinë e tyre dhe për bashkimin me Malin e Zi”.

Edhe mbreti serb Petar, në manifestin që shpalli në fillim të fushatës ushtarake serbe, deklaronte në mënyrë demagogjike se do t’u sillte edhe shqiptarëve lirinë, vëllazërinë dhe barazinë.

Shqiptarët e Kosovës, veçanërisht ata të Llapit dhe të krahinave përreth, qëndruan me vendosmëri në luftimet e Merdarit (14 – 18 tetor 1912) në veri të Podujevës, kundër forcave të Armatës së parë dhe të tretë serbe. Ushtria osmane një ditë para betejës braktisi frontin në disa pika. Luftimet në Merdar ishin të ashpra. Serbët e morën atë pas humbjeve të mëdha.

Pas pushtimit të Prishtinës ushtria serbe filloi veprime të tjera në përmasa të mëdha, të cilat kishin si objektiv të parë pushtimin e Ferizajt, të Kumanovës e të Shkupit, për të vijuar më tej marshimin drejt jugut dhe drejt pjesës perëndimore të Shqipërisë. Beteja më e madhe në Vilajetin e Kosovës ishte ajo e Kumanovës (22 – 24 tetor 1912) ku serbët hodhën ushtrinë e Armatës së parë, të përbërë nga 126 000 veta. Pas pushtimit të Kumanovës, më 26 tetor forcat serbe pushtuan Shkupin. Pas pushtimit të Shkupit, ushtria serbe vazhdoi mësymjen drejt pjesës perëndimore të Vilajetit të Kosovës (drejt Prizrenit, Pejës, Gjakovës etj.), drejt vilajeteve të Manastirit (pushtuan Manastirin), të Shkodrës e të Janinës.

Ndërkohë edhe ushtria greke, pasi theu forcat osmane në Thesali e në Epir, mori Selanikun, rrethoi Janinën, shtiu në dorë Sazanin dhe zbarkoi në Himarë, të cilën e pushtoi bashkë me disa fshatra përreth.

Situata e rëndë në Ballkan i detyroi Fuqitë e Mëdha që të viheshin në lëvizje dhe të ndërmerinin hapa konkretë për organizimin e një konference ndërkombëtare në të cilën do të diskutohej gjendja e krijuar në Ballkan.

Më 17 dhjetor 1912, rreth 19 ditë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, fuqitë e mëdha evropiane: Britania e Madhe, Gjermania, Rusia, Franca, Austro Hungaria dhe Italia, organizuan një konferencë të paqes në nivel ambasadorësh në Londër. Prej të gjitha këtyre shteteve vetëm Britania e Madhe përfaqësohej nga shefi i diplomacisë britanike Sir Eduard Grey. Kurse të tjerët përfaqësoheshin në nivel ambasadorësh.

Palët e përfshira në konflikt kishin të drejtë vetëm të paraqisnin mendimet e tyre, por jo të merrnin pjesë në vendimmarrje në Konferencë. Në këtë grup bënte pjesë edhe Shqipëria.

Shqipëria ishte vendi ku gërshetoheshin interesat e dy grupeve të mëdha dhe që në këtë kohë u bë fusha e ashpërsimit të kontradiktave midis tyre. Krijimi i një shteti të pavarur shqiptar shikohej me simpati nga Aleanca trepalëshe, e cila shpresonte që këtë vend ta tërhiqte në orbitën e saj për shkak të ndikimit që kishte Austro-Hungaria dhe Italia. Edhe diplomacia britanike u shpreh për problemin shqiptar duke konsideruar se “Autonomia e Shqipërisë duhet të jetë e garantuar dhe e kontrolluar ekskluzivisht prej gjashtë Fuqive nën sovranitetin ose suveranitetin e Sulltanit. Një dalje tregtare do t’i rezervohet Serbisë me anën e një skele shqiptare të lirë dhe asnjansë, që do të lidhet nëpërmjet një hekurudhe ndërkombëtare nën kontrollin evropian dhe nën mbrojtjen e një force speciale ndërkombëtare, me liri transiti dhe të drejtën për gjithë mallrat pa përjashtuar municionet e luftës.

Një hap konkret për zgjidhjen e nyjës ballkanike e hodhi Eduard Grey më 21 Nëntor 1912, në takimin që pati me ambasadorin gjerman në Londër, princin Lichnovsky. Në këtë takim, Eduard Grey propozoi tre çështjet thelbësore që Fuqitë e Mëdha duhet t’i diskutonin dhe të arrinin një marrëveshje për ruajtjen e paqes në Ballkan dhe Evropë:

1) Mundësia e krijimit të një shteti shqiptar autonom dhe kufijtë që duhet të ketë; 2) Metodatat dhe konditat e sigurimit të Serbisë në Adriatik; 3) Çështja e ishujve të Egjeut.

Ambasadori Mensdorf u deklarua i vendosur në qëndrimin e Austro-Hungarisë për krijimin e një shteti autonom shqiptar si një zgjidhje e qëndrueshme dhe në përputhje të plotë me lëvizjet politike dhe rrethanat e kohës. Vjena mori në konsideratë edhe kërkesat serbe për një shtegdalje në Adriatik, por duke kundërshtuar me vendosmëri sovranitetin mbi ndonjë port shqiptar apo rrugë që do të lidhej me këtë port. Kurse përfaqësuesi rus Benkendorf mbrojti qëndrimet e Rusisë për shtegdalje të Serbisë në Adriatik nëpërmjet një rruge hekurudhore ndër-kombëtare dhe një porti të neutralizuar.

Konferenca arriti disa marrëveshje qysh në mbledhjen e parë të saj. Dakordimi i parë ishte mbi autonominë e Shqipërisë, marrëveshja e dytë për sigurimin e një daljeje tregtare për në Adriatik për Serbinë dhe së fundi mbi të drejtën e Serbisë që të zgjidhte trasenë e rrugës hekurudhore që do ta lidhte me portin e Durrësit.

Vendimet e Konferencës duhet që t'i nënshtroheshin aprovimit të qeverive përkatëse dhe do të prodhonin efekte politike e juridike vetëm pas aprovimit. Prandaj, marrëveshjet e arritura ambasadorët ua për-collën qeverive respektive, të cilat i aprovuan brenda tre ditëve. Komunikatën zyrtare lidhur me vendimet e Konferencës e shpalli Eduard Grey më 20 dhjetor 1912. Kjo datë konsiderohet si datë kur Fuqitë e Mëdha njohën në parim krijimin e shtetit të pavarur shqiptar.

Në mbarim të mbledhjes së parë u adaptuan gjithashtu dy rezoluta: njëra ftonte qeverinë e Austro-Hungarisë dhe atë të Italisë, si iniciatorë të propozimit për një Shqipëri autonome që të paraqitnin pikëpamjet e tyre për organizimin e shtetit të ardhshëm autonom shqiptar dhe tjetra ftonte qeverinë ruse të paraqiste projektin për daljen e Serbisë në Adriatik.

Kontradiktat e mëdha që dolën në shesh gjatë mbledhjes së parë të Konferencës, sidomos për çështjen e kufijve të shtetit të ri shqiptar, bënë që konferenca të zgjasë punimet e saj dhe të vazhdojë konsultimet për kompromise reciproke. Në këtë mënyrë, projekti austro-hungarez dhe italian mbi organizimin e shtetit të ri shqiptar, si edhe projekti rus për daljen e Serbisë në Adriatik u paraqitën në konferencë më 8 maj 1913, domethënë për më se 5 muaj e gjysmë nga data që u aprovuan rezolutat.

Gjatë kësaj kohe, midis personaliteteve shtetërore të vendeve të interesuara ishin bërë shumë shkëmbime mendimesh mbi organizimin shtetëror të Shqipërisë. Në pikëpamjet që i kishte paraqitur ministri i Jashtëm austro-hungarez, Berhtoldi, kolegut të tij italian, San Xhuliano, mendonte që Shqipëria të kishte në krye një princ, por ky të mos ishte

turk, pasi të krishterët e jugut do të afroheshin me Greqinë dhe katolikët me Malin e Zi. Kurse pikëpamja ruse ishte kundër emërimit të një princi, por për një guvernator të caktuar nga sulltani dhe të varur nga fuqitë e mëdha. Këtë pikëpamje e përkrahte edhe Franca.

Britania e Madhe përmes ministrit të Jashtëm Grey më 14 korrik propozonte zgjidhjen një princi për Shqipërinë për një kohë të caktuar, ndërkaq kontrolli mbi administratën e Shqipërisë t'i besohet një komisioni ndërkombëtar.

Pas debateve, përplasjeve dhe mospajttimeve u gjet rruga e kompromiseve dhe afrimit të pikëpamjeve. Më 29 korrik të vitit 1913, konferenca aprovoi projektin austro-hungarez dhe italian të ndryshuar me këtë përmbajtje:

1. Shqipëria bëhet principatë autonome, sovrane dhe e trashëgueshme, sipas rendit të lindjes së parë, nën garancinë e 6 fuqive të mëdha. Princi do të caktohet nga të 6 fuqitë.

2. Çdo lidhje suzereniteti midis Shqipërisë dhe Perandorisë Osmane përjashtohet.

3. Shqipëria shpallej shtet asnjës, asnjësisia e saj garantohet nga të gjashtë fuqitë e mëdha.

4. Kontrolli mbi shtetin shqiptar do të ushtrohej nga KNK-ja e përbërë nga delegatë të 6 fuqive dhe një delegati shqiptar.

5. Kompetencat e këtij Komisioni do të vazhdojnë 10 vjet dhe në rast nevojë mund të zgjatet.

6. Ky Komision do ta ngarkohet të përpunojë një projekt organizimi të hollësishëm për të gjitha degët e administratës së Shqipërisë. Ai do t'u paraqitet fuqive, në një afat prej 6 muajsh, një raport lidhur me rezultatin e punës së tij, si dhe përfundimet e tij në lidhje me organizimin administrativ dhe financiar të vendit.

7. Princi do të emërohet brenda një afati jo më vonë se 6 muaj. Duke pritur emërimin e tij dhe formimin e qeverisë kombëtare definitive, funksionimi i autoriteteve ekzistuese i vendit, si dhe i xhandarmërisë do të kontrollohet nga Komisioni Ndërkombëtar.

8. Qetësia dhe rendi publik do të sigurohen nga organizata ndërkombëtare e xhandarmërisë. Kjo organizatë do t'u besohet oficerëve të huaj që do të kenë komandën eprore dhe efektive të xhandarmërisë.

9. Këta oficerë do të merren nga ushtria suedeze.

10. Misioni i oficerëve instruktorë të huaj nuk do të cenojë as uniformitetin e shërbimit as përdorimin e oficerëve, nënoficerëve dhe xhandarëve vendës.

Me këtë marrëveshje fuqitë e mëdha vendosën krijimin e një shteti të ri, me organizim të ri, me institucione të reja. Prandaj si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja kjo marrëveshje nuk i solli popullit shqiptar rezultatet e pritura për të cilat kishte luftuar dhe ishte përpjekur në vazhdimësi sidomos nga viti 1878. Por nga ana tjetër duke pasur parasysh rrethanat ballkanike, ndërkombëtare dhe situatën në të cilën gjendej populli shqiptar, kjo ishte ngjarje e rëndësishme që i hapte rrugë zhvillimit të Shqipërisë në çdo pikëpamje përfshirë këtu edhe njohjen ndërkombëtare të shtetit shqiptar.

Frashër Demaj

Beqir Meta

NDIKIMI I VENDIMEVE TË KONFERENCËS SË AMBASADORËVE NË LONDËR NË PROCESIN E NDËRTIMIT TË SHTETIT SHQIPTAR

Abstrakt

Kjo kumtesë rreket të analizojë rolin dhe ndikimin e Konferencës së Londrës në procesin e formimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar gjatë shekullit XX.

Kumtesa shtron për diskutim pyetjen: a ishte Konferenca e Londrës (1913) krijuesja definitive e shtetit shqiptar dhe a pati ai sfida që buronin prej vendimeve të saj? Në këtë kontekst do të argumentohet se vendimi i Londrës nuk rezultoi definitiv dhe i pacenueshëm. Analizohet se në thelbin e paqëndrueshmërisë qëndronte konceptimi i shtetit shqiptar nga Fuqitë e Mëdha jo si një e drejtë natyrale e kombit shqiptar dhe jo si një element afatgjatë dhe stabiliteti në hartën politike ballkanike dhe evropiane, por si një krijesë e përkohshme kompromisi që do t'u shërbente Fuqive vetëm për të shtyrë konfliktin e armatosur midis tyre.

Konceptimi i shtetit shqiptar si një entitet i paqëndrueshëm dhe jo si definitiv ka pasur pasoja negative në afirmimin dhe konsolidimin e këtij shteti gjatë shek. XX. Pikërisht analiza e këtyre pasojave përbën thelbin e kësaj kumtese. Ato ishin:

- Mbajtja e territoreve të shtetit shqiptar të pushtuara pas vendimit të Konferencës;
- Zvarritja e punës së Komisioneve për Caktimin e Kufijve;
- Ballafaqimi i Fuqive për çështjen e kufijve të shtetit të ri;
- Analizohet ndikimi i KNK-së dhe i Fuqive në procesin e themelimit të shtetit, ndikimet pozitive e negative.
- Inkurajimi i fqinjëve nga disa Fuqi të Mëdha për ta sfiduar dhe zhbërë shtetin e ri.
- Presioni i jashtëm që lidhej me vendimin e kësaj Konference ndikoi në forcimin e elementëve dhe tendencave të brendshme shformuese.
- Analizohet shfaqja e paqëndrueshmërisë së vendimeve të Londrës, gjatë dhe në përfundim të dy luftërave botërore.
- Analizohet ndikimi i copëtimit të thellë të territoreve shqiptare në procesin e shtetformimit.

Fjalët çelës: Konferenca, vendimet, fuqitë e mëdha, shqiptarët.

Shpesh historianët, duke dashur t'i referohen shtetit shqiptar, për ta veçuar atë nga nocioni më i gjerë – Shqipëri, e quajnë ndoshta jo me aq saktësi Shqipëria Londineze. Ata kanë parasysh faktin se krijimi i këtij shteti ishte kryekëput produkt i vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1913.

Në këtë kumtesë do të përiqemi të analizojmë pikërisht rolin e kësaj Konference në shtetformimin shqiptar gjatë shekullit XX. Dhe këtë analizë do ta fillojmë pikërisht me këtë pyetje: a ishte Konferenca e Londrës e vitit 1913 krijuesja definitive e shtetit shqiptar? Ne mund të themi me siguri se ajo ishte krijuesja e parë e këtij shteti, pa nënvlef-tësuar këtu aktin e madh të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Kuvendin Kombëtar të Vlorës që shpalli Pavarësinë dhe themeloi shtetin e pavarur shqiptar. Por nga ana tjetër, koha provoi se vendimi ndërkombëtar i Londrës 1913, nuk ishte definitiv dhe as i pacenueshëm. Ndonëse ishte një vendim ndërkombëtar i nënshkruar nga të gjithë Fuqitë e Mëdha evropiane, si dhe i pranuar nga shtetet fqinje, ndonëse pavarësia shqiptare ishte një kompromis midis dy Blloqeve më të mëdha politike të kohës: Antantës dhe Aleancës Trepalëshe, kompromis i cili ishte në vetvete shumë i dhimbshëm për kombin shqiptar, pasi u dha fqinjëve gjysmën e territoreve dhe popullsisë shqiptare, ai ishte i brishtë dhe koha do të provonte se do të sfidohej ashpër pikësëpari nga vetë nënshkruesit e kësaj marrëveshjeje – Fuqitë e Mëdha.

Fatkeqësisht të dy Blloqet kundërshtarë e konceptuan krijimin e shtetit shqiptar jo si një e drejtë e pamohueshme e shqiptarëve, jo si një element afatgjatë dhe stabiliteti në hartën dhe skemën politike ballkanike dhe evropiane, por si një krijesë artificiale dhe të përkohshme që do t'u shërbente atyre vetëm për të shtyrë konfliktin e armatosur evropian i cili po afrohej me shpejtësi. Pikërisht ky konceptim me gjithë implikimet e shumta që solli, do të kishte pasoja të shumta në procesin e ndërtimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar.

Krijimi i shtetit të pavarur shqiptar shërbeu për të formësuar një ekuilibër të ri forcash në Ballkan dhe Adriatik, duke ruajtur përkohësisht interesat imediate të Fuqive të Mëdha dhe vetë sistemin e Koncertit Evropian në momentet kritike para fundit të tij. Faktin që ky kompromis ishte i përkohshëm dhe si rrjedhojë edhe krijesa e tij, shteti i pavarur shqiptar konsiderohej i tillë, e pohonte vetë kryetari i Konferencës, E. Grey, por për më tepër atë e vërtetoi koha që pasoi, pikësëpari Traktati i Fshehtë i Londrës 1915 dhe diskutimet e marrëveshjet që u arritën në Konferencën e Paqes në Paris në vitet 1919-1920. Gjithashtu

duhet përmendur edhe fakti se kur qeveria shqiptare i paraqiti memorandumet e para më 22 dhe 30 nëntor 1920 Lidhjes së Kombeve ku argumentoi ekzistencën e shtetit të pavarur shqiptar qysh më 1913 me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, Komisioni V i LK-së i hodhi poshtë argumentet shqiptare.¹

Konceptimi i shtetit shqiptar si një entitet i paqëndrueshëm dhe jo definitiv ka pasur pasoja të rënda negative për afrimin dhe konsolidimin e tij në gjysmën e parë të shekullit XX. Pasojat kanë qenë afatshkurtra dhe afatgjata.

Po fillojmë më pasojat afatshkurtra që nënkuptojnë periudhën deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore. Pengesat ndërkombëtare për ndërtimin e shtetit të ri u shfaqën qysh në fillim:

Fuqitë toleruan Beogradin, Athinën dhe Cetinën, që të mbanin të pushtuara për një kohë të gjatë disa territore që i ishin njohur shtetit të ri shqiptar.²

Pas arritjes së marrëveshjes për kufijtë në parim në Konferencën e Londrës, kundërshtitë midis Fuqive nuk u shuan dhe shkaktuan zvarritjen e punës së Komisionit të caktimit të kufijve në terren e cila, siç vërente E. Durham, pati një pasojë kriminale, që u dha serbëve kohën e nevojshme për të ndryshuar përbërjen etnike të rajonit, nëpërmjet spastrimit të krahinave prej banorëve autoktonë shqiptarë.³ Qeveria ruse ishte penguesja kryesore e punimeve të këtij Komisioni.⁴ Përcaktimi i kufijve u zvarrit, dhe gjatë gjysmës së dytë të vitit 1913 e gjysmës së parë të vitit 1914 pati një debat të ashpër midis dy blloqeve: Diplomacia austro-hungareze u përpoq të mbronte kufijtë shqiptarë të vendosur në Londër dhe të hidhte poshtë me vendosmëri çdo përpjekje që vinte në dyshim mundësinë e krijimit të një shteti shqiptar të pavarur e të qëndrueshëm, kurse krijimi i këtyre pengesave ishte qëllimi kryesor i kundërshtarëve të saj, në radhë të parë, i Ruisë dhe Francës.⁵ Kuptohet që të gjitha këto ballafaqime ndikonin negativisht në procesin e ngritjes

¹ AQSH, F. 14 (Fan Noli) pa vit, d. 207, fl. 1-7, Proces-verbal i komisionit të LK nr. 13, Gjenevë, 11 dhjetor 1920.

² *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll I, Tiranë 2017, f. 204, 205; Dokumente britanike për çështjen shqiptare, përgatiti M. Shatri, f. 458, F. Bertie për E. Grey, Paris, 25 prill 1913.

³ M. Edith Durham, *Twenty Years of Balkan Tangle*, London, G. Allan & Unwin Ltd, 1920, f. 249.

⁴ HHSSt A.P.A.A në AIH, Vj. 23-31-3170, Telegram i Berchtold-it për ambasadorin austro-hungarez në Berlin, Flotov, 16 tetor 1913.

⁵ HHSSt A.P.A.A në AIH, Vj. 24-22-2213, Letër e Conrad dërguar Berchtold-it, 18 prill 1913.

së shtetit shqiptar qysh në fillimet e tij. Nga ana tjetër, kjo nxiste politikat agresive të fqinjëve. Këto vonesa e pengesa që lidheshin me formatin, natyrën dhe kohën kur u zhvillua Konferenca e Londrës, si dhe shpërthimi i Luftës Botërore ishin faktorë madhorë që penguan stabilizimin e shtetit të ri.

Kur shpërtheu Lufta e Madhe, Komisioni i Kufijve ndërpreu punën më 29 korrik 1914 dhe bilanci i tij ishte jopozitiv. Vetëm një pjesë e vogël e kufirit midis Serbisë e Shqipërisë kishte marrë formë përfundimtare. Popullsia shqiptare do t'i paguante një çmim të shtrenjtë këtij dështimi, duke iu nënshtuar arbitrariteteve të panumërta dhe mizorive të kryera nga trupat serbe, të cilat nuk u tërhoqën nga territoret që Konferenca e Londrës ia kishte caktuar Shqipërisë.

Kjo do të ndikonte edhe në destabilizimin dhe kërcënimin e shtetit shqiptar në vitet 1914 dhe 1920-1921. Caktimi i kufirit në terren do të kryhej shumë vjet më vonë dhe do të përfundonte më 26 korrik 1926, pas peripecish të shumta të shoqëruara me përplasje, konflikte e tensione shumëvjeçare midis Shqipërisë dhe shtetit serbo-kroato-sllloven. Një situatë e ngjashme ishte edhe në Komisionin Jugor, ku Greqia u përpoq ta keqorientojë atë, duke shfrytëzuar mbështetjen këmbëngulëse të delegatëve francezë dhe rusë, që vepruan si protektorë të zellshëm të saj.⁶

Një element tjetër që pati ndikim negativ, ishte fakti se Konferenca e Londrës nuk e njohu Pavarësinë e Shqipërisë të shpallur nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës dhe Qeverinë e Përkohshme të zgjedhur prej tij nuk e konsideroi qeveri kombëtare, por administratë lokale. Veçanërisht Franca dhe Rusia kundërshtuan edhe propozimin austro-italian që Qeveria e Vlorës të shërbente si bërthamë për organizimin e shtetit shqiptar, duke këmbëngulur që ky organizim të bëhej tërësisht prej Fuqive, pa marrë parasysh vullnetin e shqiptarëve të shprehur në Kuvendin e Vlorës.⁷ Ky ishte një atentat ndaj vullnetit të shqiptarëve dhe përpjekjeve për të ndërtuar një shtet natyral kombëtar që do të kishte pasoja në procesin e shtetformimit. Fuqitë e Antantës, arritën të zhvleftësonin autoritetin dhe legjitimitetin e Kuvendit të Vlorës dhe të qeverisë së parë kombëtare shqiptare të dalë prej këtij institucioni përfaqësues mbarëkombëtar. Fuqitë e Antantës kontribuan në minimin e përpjekjeve të qeverisë së Vlorës për krijimin e Bankës Kombëtare, për

⁶ A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, vëll. II, dok. nr. 59, f.392-393; dok. nr. 60, f. 402, etj.; V. Kondis, *Greqia dhe Shqipëria në shekullin e XX...*, f. 153-155.

⁷ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. I (2017), f. 251.

formimin e disa institucioneve me profil kombëtar si për shembull për kombëtarizimin e arsimit dhe në disa drejtime e çështje të tjera. Qeveria e Vlorës u gjend midis dy zjarreve, politikave sabotuese të Antantës dhe presionit të dy Fuqive adriatike, të cilat rivalizonin për supremaci në Shqipëri. Kështu ndërhyrjet e Fuqive të Mëdha ishin një faktor qenësor që ndikuan negativisht në minimin e përpjekjeve të Qeverisë së Vlorës për të hedhur hapa të rëndësishëm në procesin e shtetformimit, si në krijimin e organeve të larta përfaqësuese legjislativë, në ndërtimin e raporteve normale midis tyre, në ndërmarrjen e politikave kombetari-zuese në sfera të ndryshme etj.

Vjena u përpoq të përdorte autoritetin e KNK-së, i cili ishte organizimi kryesor i Konferencës së Ambasadorëve, që të pengonte tendencat e diferencimit të grupeve politike shqiptare në këto momente të para tepër kritike të formimit të shtetit shqiptar. Ndërsa përfaqësuesit e Antantës u përpoqën ta sabotonin dhe kundërshtonin me forcë këtë politikë. Dhe ata patën mjaft sukses në sabotimin e saj.⁸ Kështu KNK-ja nuk pranoi që oficerët holandezë të viheshin nën kontrollin e Qeverisë së Vlorës, por të ishin nën kontrollin e tij; hodhi poshtë kërkesën e qeverisë së Vlorës për të marrë nën kontroll Shkodrën.⁹ KNK-ja ndikoi drejtpërdrejt në dobësimin e autoritetit të qeverisë kombëtare të Vlorës dhe në thellimin e copëzimit politik të vendit, duke pohuar se do të hyn-te në marrëdhënie me “qeveritë” e Vlorës, Durrësit, të Mirditës dhe më tej, edhe me Shkodrën dhe Malësinë, të cilat duhej të krijonin qeveritë e tyre lokale. KNK-ja kundërshtoi zgjedhjen e Preng Bib Dodës nga I. Qemali si nënkryetar i Qeverisë së Vlorës. Lëvizja e I. Qemalit kishte synime unifikuese e stabilizuese. KNK-ja kundërshtoi kategorikisht përpjekjet e Qeverisë së Vlorës për të marrë në administrimin e saj Korçën dhe Gjirokastrën pas zbrazjes së tyre nga trupat greke, pasi Fuqitë e Antantës nuk donin t’i akordonin asaj njohje dhetribute kombëtare. Vargu i këtyre ndërhyrjeve është i gjatë, duke përfshirë edhe ndërhyrjen për anulimin e vendimit të Qeverisë së Vlorës për mbylljen e disa shkollave greke në Vlorë dhe hapjen e shkollave shqipe.¹⁰

⁸ A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, vëll. II, dok. nr. 70, f. 431, Seanca e dytë e KNK, Vlorë 18 tetor 1913.

⁹ P. Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, vëll. I, f. 146; A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, vëll. II, dok. nr. 78, f. 446, Raport i Krajevskit për Ministrinë e Jashtme në Paris mbi bashkëpunimin e tij më I. Qemalin, 3 nëntor 1913.

¹⁰ Qeveria e Përkohshme e Vlorës, dok. Nr. 249, f. 180, Urdhëresë e Ministrisë së Arsimit e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, 13 shtator 1913.

Diskutimet e gjata të Fuqive dhe mosmarrëveshjet midis tyre vonuan caktimin dhe ardhjen e Princ Vidit në fronin shqiptar, dhe kjo ishte një pengesë tjetër në formimin dhe konsolidimin e shtetit të ri. Gjithashtu, skepticizmi i theksuar me të cilin e pritën caktimin e Vidit shumica e Fuqive ndikoi negativisht për shtetin shqiptar. (Skeptikë ishin qeveria gjermane, italiane, etj.)¹¹ Huaja ndërkombëtare e premtuar në Konferencën e Londrës se do t'i jepej shtetit të ri nga Fuqitë, nuk u dha kurrë, dhe ky ishte një minim i shtetit të ri. Nuk vonoi dhe njëra nga Fuqitë e Mëdha që kishte qenë kontribuuese për themelimin e Shqipërisë në Londër, (Italia) komplotoi, duke nxitur çarje brenda qeverisë dhe vendit (rasti i Esat Pashës)¹².

Për brishtësinë dhe sfidat që i vinin vendimit të Londrës 1913 dhe shtetit shqiptar flet edhe fakti se njëra prej këtyre Fuqive, që kishte qenë edhe në pozitën e protektores së këtij shteti, konkretisht Italia, kishte një rol nxitës në kryengritjen antishtetërore të Shqipërisë së Mesme, e cila shembi nga themelet shtetin e ri e të brishtë shqiptar. Ky qëndrim i saj ishte rezultati i rivalitetit me Austro-Hungarinë për dominimin e shtetit të ri.¹³

Në gjykimin e veprimtarisë së Princ Vidit dhe të dështimit të tij, i duhet dhënë vend kryesor rolit që luajtën Italia, Franca, Rusia dhe sateletit e tyre, prishjes së solidaritetit austro-italian për mbështetjen e shtetit shqiptar, etj.¹⁴ Pra arkitektët e Londrës ishin njëkohësisht edhe shkatërrimtarët e saj, duke sabotuar plotësisht shtetin e ri shqiptar.

Vetëm pak muaj pasi u themelua shteti shqiptar, ndodhi një kthesë e madhe në politikën evropiane. U përhap frika e luftës që po bëhej e pashmangshme. Meqenëse ngritja e shtetit shqiptar ishte e lidhur me politikën e mëparshme të paqes së Fuqive të Mëdha, shndërrimi i saj gradual në politikë të luftës, domosdoshmërisht preku shumë thellë të gjithë bazën e këtij shteti. Në këtë mënyrë koha kur përfundoi Konferenca e Ambasadorëve, vetëm një vit para fillimit të Luftës së Madhe, ishte një tjetër faktor që ndikoi negativisht. Politika e Ruisë dhe Fran-

¹¹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. I (2017), f. 281-283.

¹² N. Guy, *Lindja e Shqipërisë ...* f. 103.

¹³ Silvio Ghelli, *Austria Nemica*, Milano: *Studio editoriale Lombardo*, 1916, f. 136; Princ Wied, *Memorandum përmbi Shqipërinë*, Tiranë, Arbëria, 2008, f. 35; DDI, Serie V, vol. I, dok. Nr. 5201, Konsulli Italian në Shkodër, De Facendis për ministrin e Jashtëm San Giuliano, Durrës, 9 shtator 1914.

¹⁴ N. Guy, *Lindja e Shqipërisë ...* f. 100, *British Documents on the Origins of the War (1898-1914)*, vol X (part 1), London 1938, dok. nr. 139.

cës kur lufta po afronte u bë edhe më inkurajuese ndaj fqinjëve armiqësorë të Shqipërisë, si dhe ndaj elementëve egoistë, turbullues, antishtetëror, antikombëtar apo të zhgënjyer brenda saj.¹⁵ Rivalitetet midis Fuqive të Mëdha sundonin në KNK e për pasojë e minuan shtetin e ri.¹⁶

Kështu Athina gëzonte një farë imuniteti në realizimin e makinacioneve të saj, prej të cilit ajo përfitoi plotësisht për të sfiduar fuqishëm shtetin e ri. Madje në pranverën e vitit 1914 edhe qëndrimi i Gjermanisë u bë indiferent. Ky qëndrim lidhej me shqetësimet e saj për grindjet austro-italiane, por edhe me interesat dhe pozicionin e Greqisë në luftën që po afrohej.

Ndërkohë KNK-ja ishte shndërruar në një pushtet paralel të Fuqive të Mëdha, përkrah Vidit duke e minuar autoritetin e tij në disa aspekte, si për shembull: e drejta e KNK-së për të nënshkruar marrëveshje bilaterale në emër të Shqipërisë me subjekte të tjera etj. Kështu, Vidi u pengua nga KNK-ja të dërgonte forca për të shtypur ndërhyrjen greke në jug, të maskuar si lëvizja “vorioepirote” që kishte filluar pak ditë pas ardhjes së tij. Kjo ishte shenja më ogurzezë për shtetin e ri shqiptar. Më tej anëtarët e KNK-së bënë propozime gjatë diskutimeve në Korfuz me krerët “vorioepirote”, të cilat i tejkaluuan garancitë që u kishte dhënë qeveria shqiptare.¹⁷ Protokollin e Korfuzit ishte rezultat i përpjekjeve të Fuqive të Mëdha për të gjetur një zgjidhje kompromisi që do të stabilizonte gjendjen në Shqipërinë e Jugut dhe do të kënaqte Greqinë. Por ai ishte dhe cenim flagrant i vendimit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, nga vetë institucioni i krijuar prej saj, nga KNK-ja. Dispozitat e këtij Protokollin u dhanë territoreve jugore të shtetit autonomisë territoriale dhe legalizuan konceptin e popullsisë “vorioepirote”. Ky do të ishte një element destabilizues, gati konstant, për shtetin shqiptar atëherë, por edhe në dekadat që do pasonin. Madje ky rrezik nuk do të venitej edhe pse Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1921 do ta hidhte poshtë këtë protokoll.

Kur qeveria shqiptare nuk e ratifikoi menjëherë Protokollin e Korfuzit, me shpresën se situata në Shqipërinë e Jugut do të përmirësohej, Fuqitë e Mëdha nënshkruan vendimet të Londrës 1913, ushtruan presion ndaj saj për nënshkrimin dhe për t'i lënë në kompetencë të KNK-së çështjet e mbetura pezull në Korfuz, siç ishte ajo e Himarës.¹⁸

¹⁵ Edith Durham, *Twenty Years ...*, f. 258, 269.

¹⁶ N. Guy, *Lindja e Shqipërisë ...* f. 99.

¹⁷ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit ...*, f. 309.

¹⁸ Dokumente Britanike për Shqipërinë, vëll II, përgatiti Valentina Duka, f. 558-590, Raport i Harry Lamb për E. Grey, Durrës, 26 qershor 1914.

Më 1 korrik 1914 Fuqitë miratuan Protokollin e Korfuzit, duke shkelur vetë vendimet e Konferencës së vitit 1913.¹⁹

Midis majit dhe korrikut 1914, Vidi, në mënyrë të përsëritur, u bëri thirrje Fuqive të Mëdha për ndihmë financiare dhe ushtarake, por kjo nuk erdhi asnjëherë.

Me fillimin e Luftës së Madhe, KNK-ja do të shpërbëhej dhe bashkë me të do të treteshin edhe shpresat e fundit të regjimit të Princ Vidit. Koncepti evropian u shpërbë, ambiciet dhe rivalitetet e armiqve të Shqipërisë ishin jashtë çdo kontrolli. Sapo çështja shqiptare nuk u interesonte më Fuqive si një element ekuilibri i interesave të tyre, i cili ishte vendosur në Konferencën e Londrës, shteti shqiptar i porsalindur u braktis dhe siç shprehej E. Durham “do t’u hidhej ujçërve, për të shpëtuar mëkonjësit e tyre.”²⁰

Por Konferenca e Londrës mori edhe vendime të vlefshme e të qëlluara që, nëse nuk do të vepronin faktorët e lartpërmendur negativë, do të kishin shërbyer pozitivisht në procesin e shtetndërtimit në Shqipëri. Më i rëndësishëm ishte hartimi dhe miratimi i Statutit Organik të Principatës së Shqipërisë nga KNK-ja më 10 prill 1914, i cili bazohej në vendimet kryesore të marra nga Konferenca e Londrës më 29 korrik 1913. Statuti sanksiononte regjimin mbretëror ku kreu i regjimit, sovrani Princ Vidi kishte pushtet të gjerë (ishte kryetar i administratës civile e ushtarake, emëronte Këshillin e Ministrave dhe nxirrte dekrete, duke marrë prerogativa ligjvënëse, shpallte zgjedhjet për Asamblenë Kombëtare dhe e shpërndante atë). Këto përcaktime do të kishin rëndësi themelore për shtetformimin, sepse ndikonin fuqimisht në centralizimin e shtetit të ri, i cili kërcënohej para së gjithash nga tendencat separatiste e decentralizuese. Ky element i statutit pati rëndësi se mbeti një trashëgimi e vlefshme historike e cila, në një formë apo tjetër, u trashëguua dhe u aplikua edhe në tre dekadat e para të jetës së shtetit shqiptar.

Asambleja Kombëtare ishte një organ tjetër centralizues dhe efektiv që u përgjigjej në mënyrë adekuate nevojave të stabilizimit të shtetit të ri, ndonëse ajo nuk kishte cilësi demokratike e inkluzive. Anëtarët e saj zgjidheshin nëpërmjet zgjedhjeve të tërthorta nga tre përfaqësues për çdo prefekturë, anëtarë të saj ishin gjithashtu përfaqësuesit e komuniteteve fetare, komisar i lartë shqiptar në “Bankën Kombëtare të Shqi-

¹⁹ HHS A.P.A.A në AIH, Vj. 24-43-4377, Notë e Fuqive të Mëdha për qeverinë greke, Athinë, 1 korrik 1914.

²⁰ Edith Durham, *Twenty Years ...*, f. 258.

përisë” dhe dhjetë anëtarë të caktuar nga Princi. Një përcaktim me ndikim pozitiv që u trashëguara gjatë gjithë ekzistencës së shtetit shqiptar ishte edhe ai se Shqipëria nuk kishte fe shtetërore, i cili gjithashtu ishte një dispozitë kushtetuese shumë përparimtare për kohën.²¹

Por edhe Statuti nuk u shpëtoi ndikimeve negative për shtetin shqiptar, të cilat lidheshin me interesat e Fuqive. Një element i tillë ishte sanksionimi në nenin 4, i konservimit të sistemit të kapitulacioneve, të trashëguara nga Perandoria Osmane, çka përbënte një pengesë juridike për shtetin e sapokrijuar. Fuqitë nuk morën parasysh kundërshtimin e përfaqësuesit shqiptar në KNK, i cili argumentoi se shteti shqiptar do të adaptonte një legjislacion “i cili do të ishte i frymëzuar plotësisht nga parimet e qytetërimit perëndimor dhe modern”, prandaj sistemi i kapitulacioneve ishte i panevojshëm.²² Përfaqësuesi tjetër shqiptar, Mehdi Frashëri, që zëvendësoi M. Libohovën, i cilësoi kapitulacionet si një cenim të rëndë të pavarësisë dhe sovranitetit të shtetit shqiptar. Më vonë koha provoi se kapitulacionet ishin një burim destabiliteti, pasi çdo shtetas i huaj që u arratis nuk u lejua të gjykohej nga autoritetet vendase.²³

Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913 do të kishin edhe një impakt negativ afatgjatë në procesin e stabilizimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar. Ndër pasojat afatgjata mund të përmendim:

Brishtësia e kompromisit të arritur në Konferencën e Londrës 1913 do ta vinte në pikëpyetje ekzistencën e shtetit shqiptar menjëherë pas saj, por edhe pas shumë vitesh. Ekzistenca e shtetit shqiptar u vu seriozisht në pikëpyetje gjatë dhe pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, për shkakun themelor se Lufta e Madhe i ndryshoi në mënyrë radikale balancat dhe interesat e Fuqive që kishin ekzistuar para saj. Fqinjët u inkurajuan për ta zhbërë këtë krijesë që nuk gëzonte mbrojtje ndërkombëtare dhe shqiptarët u detyruan të bënin përpjekje e sakrificat të mëdha për rikrijimin e shtetit të pavarur dhe riafirmimin e tij ndërkombëtar.

Vitet 1920-1921 ishte periudha më e vështirë dhe njëkohësisht më e dhimbshme e këtij procesi. U desh një konferencë tjetër ambasadorësh

²¹ AMPJ, v. 1914, D.1, Statuti Organik i Shtetit Shqiptar.

²² HHS A.P.A.A në AIH, Vj. 24-5-529, Raport i anëtarit shqiptar në KNK, Myfit Libohova drejtuar ministrit të jashtëm austro-hungarez Berchtold, Vlorë, 3 prill 1914.

²³ Jan Fabius, Gjashtë muaji në Shqipëri, Tiranë Skanderbeg Books, 2011, f. 99-100.

ajo e vitit 1921, e cila më 9 nëntor rikonfirmoi njohjen ndërkombëtare të shtetit të ri, duke i hequr atij pak territore të reja, duke i njohur një privilegj politik Italisë në Shqipëri dhe duke lënë sërish hapur disa çështje kufitare. Kjo do të provonte se vendimet e vitit 1913, jo vetëm që u rishqyrtuan, por edhe u rimodeluan.

Të gjitha këto patën pasoja të ndjeshme në procesin e shtetformimit, i cili njëkohësisht përballej edhe me sfida të brendshme që nuk janë objekt i kësaj analize, por vetëm duhet të theksojmë se cenet në pozitën ndërkombëtare i nxitën dhe i amplifikuan më tej vështirësitë e brendshme në procesin e stabilizimit të shtetit shqiptar. Kështu vepruan këta faktorë në vitet 1920-1921, duke nxitur separatizmin krahinor ose fetar brenda vendit.

Por edhe pas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të 9 nëntorit 1921, fqinjët nuk u pajtuan me ekzistencën e Shqipërisë së pavarur, duke shpresuar në përkohshmërinë e pozitës së saj ndërkombëtare. Kështu veproi Greqia me nxitjen e lëvizjes vorio-epirote në Jug, Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene (Jugosllavia) me nxitjen e separatizmit në fiset katolike të Veriut etj. Ndërsa Italia, e inkurajuar edhe nga vendimet e Konferencës së Ambasadorëve më 1921, u përpoq të siguronte monopolin politik dhe ekonomik mbi shtetin shqiptar në vitet 1922-1924, duke komplotuar kundër tij dhe duke nxitur përçarjet politike, grushtet e shtetit dhe kryengritjet antiqeveritare. Ndërsa më tej, ajo e sfidoi hapur pavarësinë e Shqipërisë në aspektin ekonomik, politik e në fund edhe ushtarak.

Paqëndrueshmëria e vendimeve të dy Konferencave të Ambasadorëve më 1913 dhe 1921 u shfaq edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore e në fund të saj, kur Fuqia më e madhe evropiane, antifashiste, Britania e Madhe dhe pas saj edhe Franca nuk e denoncuan agresionin italian. Kurse në vitin 1942, Londra sërish hodhi hije dyshimi mbi pavarësinë dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë pas luftës, madje në vitin 1945 propozoi diskutimin për herë të tretë të kufijve të saj.

Por pasoja më e rëndë dhe afatgjatë e vendimeve të Konferencës së Londrës në procesin e shtetformimit lidhej me copëtimin e thellë të territoreve shqiptare. Qysh para marrjes së vendimit final për kufijtë, qeveria e Vlorës dhe Kongresi Shqiptar i Triestes (1-4 mars 1913), u argumentuan Fuqive të Mëdha se: “një Shqipëri e reduktuar në rajone pa vlerë ekonomike dhe e privuar nga qytetet e mëdha që mund të bëheshin për kombin shqiptar qendra të mëdha qytetërimi”, do të ishte një shtet “që do ta kishte të pamundur të zhvillohej normalisht dhe, në të njëjtën kohë, do të ishte për vetë Fuqitë burim i vështirësive të

mëdha”.²⁴ Në Shqipërinë politike u përfshinë 28 000 km² ose 36 % e sipërfaqes së viseve shqiptare dhe një popullsi prej 700 000 shqiptarësh e 37 000 pjesëtarësh të pakicave të huaja kombëtare. Në viset shqiptare prej 75-76 mijë km² llogaritej se jetonin 2 milionë banorë.²⁵ Ky ishte copëtimi më i thellë në Ballkan dhe Evropë. Shumë kombe kishin humbur popullsi të tyre, por asnjëri në këto dimensione. Kjo pikësëpari theu balancat natyrale në fuqinë numerike, politike, ushtarake e ekonomike midis kombit shqiptar dhe kombeve të tjera ballkanike. Para copëtimit, shqiptarët nuk kishin diferenca të dukshme numerike me kombet fqinje. Në fund të shekullit XIX, Bullgaria kishte 96 000 km² dhe 3.3 milionë banorë (bullgarë e jobullgarë), Serbia 48 000 km² dhe 2.37 milionë banorë, Greqia 64 600 km² dhe 2.6 milionë banorë (prej tyre së paku 1/3 ishin arvanitë).²⁶ Kjo do të ndikonte fuqishëm negativisht në konsolidimin e shtetit shqiptar, në ç‘balancimin e fuqive të tij me fqinjët, duke i nxitur ata të ndërtonin politika konstante agresive ndaj tij. Ky ndikim do të ishte afatgjatë për gjatë gjithë shekullit XX dhe konsistent.

Shteti i ri humbi pozitën gjeografike që kishin pasur më parë viset shqiptare, si ndërlihdhëse me rajonet ballkanike dhe më gjerë. U ndërpre në të tria korridoret e tij tregtare; brenda Shqipërisë së pavarur mbetën 350 mijë ha tokë bujqësore, kurse jashtë saj mbetën 2 herë më tepër, dhe kjo ishte toka më pjellore; Shqipëria humbi qytetet e saj kryesore si dhe fuqinë ekonomike që gjeneronin ato; u thye tregu i përbashkët kombëtar, Shqipëria humbi shumicën e njërive zejtare –tregtare dhe të ndërmarrjeve industriale, humbi shumicën e pasurive minerale, si dhe pjesën më të vlefshme të tyre. Këto do të kishin pasoja të rënda në procesin e shtetndërtimit dhe konsolidimit të tij. Shteti shqiptar kishte kapacitete të dobëta politike, ekonomike dhe ushtarake, qenia e tij ishte gjithmonë në kufijtë e mbijetesës, ritmet e zhvillimit ekonomik ishin të ulëta dhe jokonkurrese në rajon, atij iu desh të konsumonte shumë energji dhe mjete për të siguruar ekzistencën e vet; shteti shqiptar u izolua ekonomikisht, nuk kishte më mundësitë e mëparshme të akumulimit të kapitalit, të thithjes së teknologjisë, përvojës, etj., të zhvillonte në parametrat normalë të kohës degët prioritare të ekonomisë me rentabilitet; u pakësua ndjeshëm fondi blegtoral, u përball si kurrë më parë me mungesën e drithërave dhe me zinë e bukës.

²⁴ AMAE (Paris) në AIH, F-177, Turquie, Guerres Balkaniques vol. 259. (XXXI), f. 233-235, Telegram i Konsullit të Francës, Trieste, 7 mars 1913.

²⁵ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. I (2017), f. 223.

²⁶ Jakob Gould Schuman, *Luftërat Ballkanike (1912-1913)*, Tiranë: Uegen, 2006, f. 46; *Historia e Shqiptarëve ...*, vëll I, f. 223-224.

Fqinjët, që kishin marrë territore dhe popullsi të konsiderueshme shqiptare, do të përpiqeshin pandërprerë për ta sfiduar, dobësuar, për ta vënë nën kontroll dhe madje për ta asgjësuar shtetin e ri. Njëri prej qelimeve të këtyre politikave mbytëse ishte pikërisht pengimi i këtij shteti për t'u shndërruar në një piemont apo mbështetje sado modeste për mbrojtjen e popullsisë shqiptare nën sundimin e tyre. Ky faktor destabilizues që buronte nga vendimet e Konferencës së Londrës ka vepruar për dekada të tëra dhe ndikoi fuqimisht në dështimin e shumë përpjekjeve të shqiptarëve për ta stabilizuar shtetin e tyre.

Copëtimi i thellë i territoreve shqiptare, veçanërisht aneksimi i viseve shqiptare nga Serbia e Mali i Zi do të krijonte natyrshëm një rrymë politike irredentiste, e cila do të vepronte brenda shtetit të ri kombëtar. Në mjaft raste ajo ndihmoi në konsolidimin e shtetit (mbështetja e Qeverisë së Vlorës, e Vidit dhe roli në Kongresin e Lushnjës). Por në vitet 1920-1924, një segment i fuqishëm i kësaj rryme, pati divergjenca të thella me qeveritë e kohës, kryesisht lidhur me nivelin e mbështetjes dhe mënyrën se si ato duhet të ndihmonin këtë lëvizje irredentiste, duke kërkuar një angazhim më aktiv, politik e ushtarak, veçanërisht kundër politikave shtypëse të mbretërisë SKS ndaj shqiptarëve. Këto divergjenca u nxitën më tej e u shfrytëzuan edhe nga qeveria italiane dhe degjeneruan në një konflikt të ashpër politik, që u karakterizua nga grushte shteti dhe kryengritje antiqeveritare. Ky ballafaqim ishte një faktor me rëndësi për destabilizimin e shtetit shqiptar dhe pengesë serioze për stabilizimin e tij.²⁷

²⁷ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit ...*, vëll II, 2019, f. 194-197; TNA, FO 371/9643, C. 3587/3587/90, Eyres për MacDonald, 9 shkurt 1924; FO 371/8532, Eyres për Curzon, Durrës, 30 janar 1923.

Jusuf Bajraktari

REZISTENCA E SHQIPTARËVE TË KOSOVËS NDAJ VENDIMEVE TË KONFERENCËS SË LONDRËS

Abstrakt

Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër ishin zhgënjyese për shqiptarët, sepse u cenua rëndë tërësia e territoreve etnike të banuara historikisht me popullsi shqiptare. Si shkak-pasojë e këtyre vendimeve, Kosova dhe viset e tjera shqiptare në veri, verilindje dhe në jug u dhanë shteteve ballkanike, si: Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi.

Vendimi për copëtimin e tokave shqiptare nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër është rezultat i gjetjes së rrugës së kompromisit që pajton interesat e fuqive të mëdha dhe aleatëve të tyre ballkanikë. Këto vendime ishin në kundërshtim të hapur me të drejtat legjitime të një populli, sepse fuqitë e mëdha jo vetëm që nuk njohën shtetin e pavarur shqiptar të shpallur më 28 Nëntor 1912 dhe organet e tij legjislative dhe ekzekutive të zgjedhura, por përkundrazi, vendosën krijimin e një shteti të ri, me organizim të ri, me organe të reja dhe pa përfshirje të territoreve kompakte të banuara me shqiptarë. Prandaj qoftë nga forma, qoftë nga përmbajtja këto vendime nuk i sollën popullit shqiptar rezultatet e pritura prej kohësh për të cilat kishte luftuar dhe ishte përpjekur në vazhdimësi për shekuj me radhë, sidomos me kryengritjet 1910-1912.

Në shenjë mospajtimi me vendimet e Konferencës dhe moslejimin e pushtimit të Kosovës nga Serbia, forcat atdhetare shqiptare organizuan rezistencë. Ata përveç kërkesave drejtuar diplomacisë ndërkombëtare, organizuan edhe rezistencë të armatosur. Patriotët si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Idriz Seferi dhe tribunë të tjerë organizuan çeta vullnetarësh për të kundërshtuar me forcën e armëve pushtimin e Kosovës nga Serbia. Rezistenca e popullit të Kosovës u përcoll me masa ndëshkuese dhe terrorizim të bartësve të kësaj rezistence dhe familjeve të tyre nga ana e ushtrisë serbe.

Fjalët çelës: Konferenca e Londrës, rezistenca, territoret shqiptare, shqiptarët e Kosovës.

Akti i shpalljes së Shqipërisë së Pavarur, në Vlorë më 28 Nëntor 1912, është padyshim akti më sublim i përpjekjeve shekullore të shqiptarëve në luftërat dhe kërkesat e tyre për liri e pavarësi. Edhe pse ky akt juridiko-politik ndodhi në rrethana ndërkombëtare mjaft kontradiktore, mbase nuk e zvogëlon vlerën historike të krijimit të një entiteti të ri në Ballkanin e mpleksur me antagonizma politikë, ekonomikë, socialë dhe ushtarakë të blloqeve. Shqipëria u shpall e pavarur në kohën kur ishte

sulmuar në të gjitha anët nga aleatët ballkanikë të cilët pretendonin ndarjen midis tyre të territoreve të sunduara nga Perandoria Osmane.

Rreth 19 ditë pas shpalljes së pavarësisë, më 17 dhjetor 1912, Fuqitë e Mëdha evropiane: Britania e Madhe, Gjermania, Rusia, Franca, Austro-Hungaria dhe Italia organizuan një konferencë të paqes në nivel ambasadorësh në Londër për të trajtuar çështje të rëndësishme që rrodhën nga zhvillimi i ngjarjeve në terren¹. Prej të gjitha këtyre shteteve vetëm Britania e Madhe përfaqësohej nga shefi i diplomacisë Sir Eduard Grey, kurse të tjerët përfaqësoheshin nga ekipe të diplomatëve të udhëhequr nga ambasadorët e shteteve të tyre. Austro-Hungaria si një nga fuqitë më aktive në rajonin e Ballkanit, përfaqësohej nga ambasadori Mensdorf, Gjermania nga ambasadori Lichnowski, Rusia nga ambasadori Bekendorf, Franca nga ambasadori Kambon dhe Italia nga ambasadori Imperial².

Luftërat ballkanike të viteve 1912 – 1913, e kishin thelluar edhe më tej krizën politike dhe ushtarake midis aleatëve të dikurshëm ballkanikë që po grindeshin mes vete për copëtimin e tokave të banuara me shumicë shqiptare që për interesa të tyre i cilësonin si “trashëgimi” osmane që duhet ndarë mes tyre pa e pasur parasysh se shqiptarët që nga vitit 1910 kishin intensifikuar përpjekjet e tyre kryengritëse antiosmane. Mirëpo pavarësisht se shqiptarët luftuan kundër Perandorisë Osmane, ata nuk u ftuan të jenë pjesë e një koalicioni të gjerë antiosman. Arsyet e mospërfshirjes së shqiptarëve në koalicion ishin me motive nacional-shoviniste me qëllim final realizimin e projekteve të hershme për zgjerimin territorial të shteteve të tyre.

Në këto rrethana logjika e pushtimeve dhe konflikteve po kalonte nga ato të përmasave rajonale në hapësira më të gjera, në ato kur prekeleshin interesat e Fuqive të Mëdha evropiane. Prandaj, Fuqitë e Mëdha, duke ndjerë rrezikun që po u kanosej u detyruan të ndërmerrnin masa konkrete që përmes Konferencës së paqes të tejkalonin rreziqet që dukeshin në horizont si pasojë e çështjeve të pazgjidhura kombëtare siç ishte problemi shqiptar, pasojave nga rreziku i shpërbërjes së Perandorisë Osmane, pretendimeve të shteteve ballkanike dhe interesave gjeo-strategjike në Pellgun e Mesdheut dhe në koloni.

¹ Ismail Qemal Vlora, *Kujtime*, Shtëpia Botuese “Grand Prind”, Tiranë 2007, f. 352. Titulli i origjinalit: “*The Memoaris of Ismail Kemal Bey*”, Edited by: Sommerville Story, with a preface by: Wiliam Morton Fulerton, Constable And Company LTD, London 1920.

² Frashër Demaj, *Britania e Madhe dhe çështja shqiptare, 1975-1913*, Prishtinë 2017, f. 311.

Këto dhe arsye të tjera ishin faktorë kryesorë që ideja për Konferencë Ndërkombëtare të Paqes u mbështet fuqimisht nga ministri i Jashtëm britanik Eduard Grej, si njëri nga kreatorët kryesorë të diplomacisë evropiane të asaj kohe.³ Ai e pati mbështetjen e rezervë të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar deri në përfundimin e plotë të seancave të Konferencës. Udhëheqja me kompetencë dhe fokusi politik e publik evropian në kryeqytetin britanik, për muaj me radhë i dhanë Mbretërisë së Bashkuar epitetin e njëres nga fuqitë kryesore pa pajtimin e së cilës nuk mund të zgjidhej asnjë problem i përmasave ndërkombëtare.

Nga 17 dhjetori 1912 e deri më 29 korrik 1913, Konferenca mbajti një varg seancash ku u trajtuan çështja e statusit të shtetit të saposhpallur shqiptarë dhe shtrirja territoriale, kufijtë veriorë, verilindorë, jugorë dhe juglindorë, projektet austro-hungareze dhe ruse, qëndrimet pro dhe kontra të fuqive të tjera më pak të implikuara në çështjet e Ballkanit dhe aspekte të tjera shumëdimensionale si pjesë përbërëse e interesave gjeostrategjike të Fuqive të Mëdha dhe aleatëve të tyre të vegjël. Në Konferencë u paraqiten edhe pretendime shoviniste kryesisht nga Serbia, Mali i Zi dhe Greqia të cilat cenonin tokat shqiptare⁴. Edhe delegacionet shqiptare në Londër brenda mundësive të tyre të limitua u munduan ta sensibilizojnë opinionin politik e diplomatik me kërkesat dhe çështjen e tyre kombëtare.⁵

Fuqitë e Mëdha për shkak të pozicionimeve të tyre të mëhershme u ndanë në dysh. Në njërin anë Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia, kurse përballë tyre Britania e Madhe, Franca dhe Rusia të cilat patën mospajtime të thella në kuadrin e zhvillimeve gjatë punimeve të Konferencës së Ambasadorëve.

Çështja e statusit të shtetit shqiptar, përfshirja territoriale dhe kufijtë që do të përfshinte u bënë temë diskutimi në tre nivele diplomatike brenda dhe në margjinat e Konferencës.

1. Shqiptarët të cilët sapo kishin shpallur shtetin e tyre kombëtar, kërkonin që brenda territoreve të këtij shteti të përfshiheshin të gjitha territoret e banuara me shqiptarë. Kjo nënkuptonte edhe bashkimin e vilajeteve (Vilajetit të Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës) deriatëhershme në një shtet të vetëm kombëtar. Brenda përpjekjeve politike,

³ Po aty, f. 256.

⁴ Frashër Demaj, *Pozita gjeografike, politike dhe popullsia shqiptare në dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtëme të Britanisë së Madhe 1912-1918*, ASHAK, Prishtinë 2021, f. 142.

⁵ Po aty.

Konferencës së Londrës i kishte paraqitur një memorandum edhe qeveria e përkohshme shqiptare.⁶

2. Qeveritë e shteteve aleate të Ballkanit gjithashtu i paraqitën Konferencës pikëpamjet dhe kërkesat e tyre lidhur me ndryshimet territoriale që duhej të bëheshin në Konferencë pas fitores së Aleancës Ballkanike në luftë kundër Perandorisë Osmane. Në këtë kuadër u paraqitën edhe pretendime shoviniste kryesisht nga Serbia, Mali i Zi dhe Greqia të cilat synonin të ndanin mes tyre shumë nga territoret shqiptare⁷.

3. Qëndrimi pro dhe kontra i diplomacisë së Fuqive të Mëdha, përtej kërkesave politike të shqiptarëve dhe aleatëve ballkanikë. Pra, rolin vendimtar dhe vendimmarrjen Fuqitë e Mëdha e kishin rezervuar për vete dhe në përputhje me interesat e tyre gjeostrategjike.⁸

Nga dita e parë e punimeve të Konferencës, për çështjen e shtetit shqiptar dhe shtrirjen territoriale i shfaqen pikëpamjet e tyre Austro-Hungaria dhe Rusia si dy fuqitë më të interesuara për Ballkanin. Austro-Hungaria kishte qëndrim miqësor ndaj kërkesave politike të shqiptarëve dhe bënte përpjekje që sa më shumë territore të përfshiheshin brenda shtetit të ri që po krijoheshin, sepse kjo ishte në përputhje të plotë me interesat mbretërisë dualiste e cila nuk pajtohej me zgjerimin e shteteve sllave në Ballkan dhe ndikimin pansllavist të Rusisë në këtë pjesë të Evropës. Madje qeveria e Austro-Hungarisë e kishte nuhatur politikisht rënien e Perandorisë Osmane që nga fundi i shekullit XIX dhe Shqipëria ishte bërë orientimi kryesor në politikën ballkanike të Mbretërisë Dualiste.⁹ Mendimi politik në Vjenë sa i takon Perandorisë Osmane dhe Ballkanit ishte ndarë në dysh. Në njërin anë qarqet ushtarake që insistonin për ndërhyrjen e Monarkisë me forca ushtarake për të shtënë në dorë bregun lindor të Adriatikut ku do të përfshiheshin edhe Durrësi dhe Vlora. Kurse në anën tjetër politika zyrtare dhe Ministria e Jashtme Austro-Hungareze insistonte të ndërtonte një politikë të kujdesshme të bazuar në parime që brenda vetes përmbante tre elemente kryesore që bazoheshin në

⁶ *Historia e Popullit Shqiptar III*, periudha e Pavarësisë 28 Nëntor 1912-7 prill 1939, Tiranë 2007, f. 21.

⁷ Frashër Demaj, *Pozita gjeografike, politike dhe popullsia shqiptare në dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe 1912-1918...* f. 142.

⁸ Frashër Demaj, "Përplasjet e diplomacisë së Fuqive të Mëdha për përfshirjen e territoreve dhe kufijtë e shtetit shqiptar", kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore "Çështja shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913)", Prishtinë më 26 tetor 2023, f. 2.

⁹ Arben Puto, *Pavarësia Shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*, Tiranë 2012, f. 80.

mosndërrhyrje ushtarake në Perandorinë Osmane, krijimin e një shteti të pavarur shqiptar dhe rindestinim të kufijve të shteteve ballkanike.¹⁰

Përballë Vjenës qëndronte Perandoria Ruse si protektore e interesave pansllaviste në Ballkan, më saktësisht përkrahëse e interesave malazeze dhe serbe për zgjerim në dëm të tokave shqiptare. Diplomacia ruse qëndronte forcërisht pro Serbisë dhe Malit të Zi dhe brenda platformës së saj i bënte kalkulimet politike duke manifestuar fuqinë e saj diplomatike dhe njëkohësisht duke u shfaqur shumë e interesuar për t'i zgjidhur nyjat që i konsideronte peng të punimeve të Konferencës. Për të arsyetuar përkrahjen për Serbinë dhe Malin e Zi, diplomacia ruse thirrej edhe në të drejtën e aleatëve ballkanikë, të cilët kishin dalë fitimtarë kundër Perandorisë Osmane në Luftën e Parë Ballkanike. Qëndrimet diametralisht të kundërta të austriakëve dhe rusëve ndikuan që, kryetari i Konferencës, Eduard Grey të konsideronte me nota pesimizmi zgjidhjen e çështjeve të ndjeshme gjatë punimeve të Konferencës¹¹. Prandaj, sipas tij duhej një ndërhyrje esenciale e Gjermanisë për të zbutur qëndrimin e Austrisë e cila këmbëngulte në deklaratimet e saj.¹²

Problemi i përfshirjes së territoreve dhe kufijtë e Shqipërisë në Konferencën e Londrës nuk u shtruan sipas parimet etnike, historike, dhe vullnetit politik, por sipas interesave të Fuqive të Mëdha dhe aleatëve të tyre të vegjël. Prandaj këto çështje u shndërruan në nyja shpeshherë të pazgjidhur që komplikonin edhe më shumë situatën në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Bazuar në fuqinë e vendimmarrjes dhe vendimeve që u morën përgjatë kohëzgjatjes së Konferencës u pa qartë se shqiptarëve pak u njihej e shumë u merrej nga të drejtat e tyre të patjetërsueshme siç ishte e drejta për të pasur shtet kombëtar në kufijtë etnikë, ashtu siç kjo e drejtë iu kishte njohur pothuajse të gjithë popujve të Ballkanit.¹³ Brishtësinë e shtetit të saposhpallur shqiptar dhe pafuqinë e tij tentonin ta shfrytëzonin maksimalisht Serbia, Greqia dhe Mali i Zi me kërkesat e veta për zgjerim territorial duke kërkuar nga Konferenca që të trajtoheshin si fitimtarë të luftës kundër Perandorisë Osmane.

Konferenca e Ambasadorëve me vendimin përfundimtar të 29 korrikut 1913, njohu Shqipërinë si "Principatë Sovrane", duke përjashtuar çdo lidhje varësie nga Perandoria Osmane. Ndërsa, sa u përket kufijve Konferenca kreu një padrejtësi të madhe historike në dëm të kombit

¹⁰ Po aty, f. 81.

¹¹ Arkivi i Institutit të Historisë- Tiranë, më tej AIHT, A-IV-218.

¹² AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 419, dok. Nr. 52.

¹³ Frashër Demaj, *Britania e Madhe dhe çështja shqiptare...* f. 325.

shqiptar. Ajo nuk përfilli të drejta themelore të shtetit të ri shqiptar. Brenda kufijve të tij u përfshinë më pak se gjysma e trojeve shqiptare, ndërsa jashtë kufijve ngelën Kosova, Maqedonia Perëndimore, Çamëria, Ulqini, Tivari, Plava e Gucia dhe viset e tjera të banuara me shumicë shqiptare. Për këto arsye Konferenca e Londrës konsiderohet e padrejtë karshi kërkesave dhe interesave vitale të kombit shqiptar që në hapat e parë të lindjes së shtetësisë së tij.

Kryetari i Konferencës së Londrës, Eduard Grey, me përfundimin e saj do të shprehej *“Unë e di fare mirë se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të japë shkas për kritika të forta nga kushdo që e njeh vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë lokale. Duhet të mos harrohet se qëllimi kryesor ka qenë që të ruhej marrëveshja midis vetë Fuqive të Mëdha dhe në qoftë se vendimi për Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë e ka bërë punën më të rëndësishme në dobi të paqes në Evropë.”*¹⁴

Grey ishte i vetëdijshëm që Konferenca kishte bërë padrejtësi ndaj shqiptarëve, sepse *“për të drejtën në anën e shqiptarëve”* ishte shprehur shpeshherë kur ishte diskutuar çështja se kujt do të duhej t’i takojnë dhe nga cila etni popullohen qytete si Gjakova, Prizreni, Peja dhe Dibra.¹⁵

Megjithëse Shqipëria nuk kishte të drejtë të merrte pjesë në punimet e Konferencës, një delegacion i kryesuar nga kryeministri i Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemali, kishte vizituar Londrën dhe disa qendra evropiane të vendosjes për të shpjeguar aspiratat e popullit shqiptar para tyre. Isa Boletini, i cili ishte pjesë e këtij delegacioni do t’i deklarojë korrespondentit të një gazete të kohës *“...na shqiptarët s’ marrim përgjegjësi për luftërat që do të bjerë e ardhmja.”* Ai më tutje theksonte *“neve ju thamë qeveritarëve të Romës, të Vjenës, të Parisit dhe të Londrës që populli ynë kurrë nuk mund të durojë të copëtohet. Pas 13 kryengritjesh të përgjakshme, në të cilat derdhëm gjak për lirinë tonë, ndërsa gjysmën më të madhe të kombit duan të u bëjnë therror armiqëve. Kosova, zemra e Shqipërisë po na humbet, viset e Hotit dhe Grudës të cilat luftuan kaq trimërisht për çështjen shqiptare po u jepen Malit të Zi. 34 qytetet shqiptare u lanë në duart e armiqëve tanë...na shqiptarët duam paqë, por duhet të mbrojmë veten në qoftë se e copëtojnë dhe e vrasin popullin tonë.”*¹⁶

¹⁴ Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912 – 2005*, Tiranë, 2006, f. 26.

¹⁵ The National Archives-London, më tej TNA, Albania FO 195/2406.

¹⁶ Arben Puto, *Pavarësia Shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*, Tiranë 1978, f. 293.

Isa ishte shndërruar në njërin nga personazhet më interesante në margjinat e Konferencës dhe në opinionin publik për shkak të veçantive karakteristike dhe këmbënguljes së tij që Kosova të përfshihej brenda kufijve të shtetit shqiptar.¹⁷ Ai pas kthimit nga Londra ishte njëri ndër organizatorët kryesorë të rezistencës kundër vendimeve të Konferencës ndaj shqiptarëve dhe ndër më të shquarit e kundërshtimit të pushtimit të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nga ushtritë serbe dhe malazeze.

Konferenca e Londrës, me gjithë kompromiset e bëra nuk arriti të pengojë thellimin e krizës në Ballkan. Ndarja e Fuqive të Mëdha në dy blloqe politiko-ushtrike kundërthënëse: siç ishin Fuqitë e Boshtit (Austro-Hungaria, Gjermania dhe Italia), si dhe Blloku i Antantës (Britania e Madhe, Franca dhe Rusia) në anën tjetër, pa kaluar as një vit do të konfrontohen në një konflikt të përmasave të Luftës së Parë Botërore. Në anën tjetër, copëtimi i tokave shqiptare si rezultat i vendimeve të Konferencës ishte fatal për shqiptarët, sepse e rënduan edhe më shumë situatën e krijuar nga pushtimet e aleatëve ballkanikë të legjitimuar nga Fuqitë e Mëdha evropiane. Shqiptarët humbën rreth 63 për qind të territoreve, gati 2/3 e popullsisë dhe një vlerë të madhe, gati të pallogaritshme të aseteve ekonomike natyrore dhe të luajtshme. Në territoret e mbetura brenda kufijve të shtetit shqiptar pati probleme të ndryshme duke filluar që nga sigurimi i ushqimeve për popullsinë, ulja e fondit blegtoral dhe kapacitetet bujqësore, mungesë e zhvillimit të perspektivës ekonomike dhe ritme të ngadalta edhe në zhvillimin socio-politik.¹⁸

Periodha kohore prej shtatorit 1913 e deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore do të jetë një kohë e vuajtjeve dhe e përjetimit të masakrave të tmerrshme që bënë ekspeditat ushtarake serbe e malazeze ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, Dukagjin, Plavë e Guci dhe gjithë andej nga Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari, Dibra, Struga dhe Ohri. Ushtria serbe kishte pushtuar territoret nga Mitrovica e Prishtina në veri, deri në Shkup, përjashtuar disa territore të Sanxhakut e viseve perëndimore të Rrafshit të Dukagjinit që i zotëronte Mali i Zi dhe vazhonte më tej në Kumanovë, Manastir, Strugë e deri në Elbasan.¹⁹ Dhuna ndaj shqiptarëve nga tetori 1912 deri në shtator 1913 ndaj trevave veriore, verilindore e lindore ishte e pazakontë dhe sistematike. Terrori,

¹⁷ Më gjerësisht: Bejtullah Destani, Jason Tomes, *Miku më i madh i shqiptarëve Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme, Ditarë dhe Letra 1904-1923*, Prishtinë 2020

¹⁸ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëllimi I, Tiranë 2022, f. 191.

¹⁹ Po aty, f. 384.

masakrat, shkatërrimi i fshatrave dhe vendbanimeve shqiptare me pretekst të çarmatimit dhe përdorimin e “argumenteve” etnike, fetare, kulturore etj. duke i parë shqiptarët si armiq njësoj si Perandorinë Osmane la pasoja të mëdha për popullsinë vendase. Përtej pretekstit, qëllimet ishin krejt politike me synim pushtimin e tokave shqiptare dhe dëbimin e popullsisë për të kolonizuar më vonë territoret me popullsi serbe. Dhuna serbe ndaj shqiptarëve ndodhi pavarësisht nga premtimet të mbretit serb Petar Karagjorgjeviç i cili në proklamatin e 17 Tetorit 1912 ishte zotuar se: “ushtria serbe do të sillte për të gjithë lirinë, vëllazërinë, barazinë, si dhe paqen e përparimin e dëshiruar”.²⁰ Gjendje e padurueshme ishte krijuar edhe në viset e pushtuara nga Mali i Zi, ku ushtria malazeze plaçkiste, dëbonte dhe vriste popullsinë shqiptare. Rastet më të identifikuar të ushtrimit të dhunës dhe terrorit malazez ndaj shqiptarëve ishin edhe konvertimi i dhunshëm, përdhunimet, marrja peng e meshkujve shqiptarë dhe veprime të tjera të pakontrolluara.

Dhuna ndaj shqiptarëve mori një dimension të ri pas Paqes së Bukureshtit të 10 gushtit 1913 kur u vendos definitivisht që Kosova, territoret lindore e veriore shqiptare dhe krahina e Çamërisë do të kalonin brenda kufijve të shteteve të Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë.²¹ Të dhunshme nuk ishin vetëm veprimet ushtarake dhe ato të bandave të pakontrolluara serbo-malazeze. Dhuna ndaj shqiptarëve u legjitimua edhe përmes legjislacionit serb e malazez dhe përmes administratës së instaluar në territoret e okupuara shqiptare.

Përballë kësaj situatë ku shqiptarëve që mbetën jashtë kufijve të Shqipërisë së njohur ndërkombëtarisht u kanosej zhdukja fizike, krerët lokalë të koordinuar me disa nga ideologët e Lëvizjes Kombëtare ishin të detyruar të organizoheshin për t’u mbrojtur nga dhuna dhe terrori serb e malazez që kishte marrë hov në të gjitha krahinat shqiptare.

Kjo gjendje kritike për vetë ekzistencën fizike të popullit shqiptar u bë trishtuese edhe për korrespondentët e vëmendshëm të gazetave të kohës dhe misionarët e ekspeditave vëzhguese evropiane, të cilët interesoreshin prej kohësh për fatin e shqiptarëve që mbetën jashtë kufijve etnikë dhe iu nënshtruan pushtetit të Serbisë dhe Malit të Zi.

Midis atyre që shkruan në mënyrë objektive për këto ngjarje tragjike duke alarmuar botën e qytetëruar, dallohen Miss Durham, Aubrey Herbert, Lav Trocki, Leo Frondlich, Dimitrije Tucoviçi e të tjerë.

²⁰ Marenglen Verli, “Situata në trevat shqiptare lindore të pushtuara dhe qëndresa antiserbe”, Studime Historike nr. 3-4, Tiranë 2004, f. 157-167.

²¹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...* f.386.

Këta me shkrimet e tyre objektive e stigmatizuan dhunën, persekutimin dhe gjakderdhjen e një populli që kërkonte të drejtën e tij për të jetuar i lirë në atdheun e vet. Këto penda shërbyen si modele të shkelqera të solidaritetit njerëzor dhe udhërrëfyes të së vërtetës nëpër të cilën kaloi populli shqiptar në ato kohë të vështira. Personalitete të tilla ndërkombëtare denoncuan fuqishëm në opinionin publik dhe politik në vendet e tyre dhe kontinentin evropian, dhunën dhe terrorin e ushtruar ndaj popullit shqiptar nga ana e pushtetit serb e malazez.

Në planin e brendshëm figurat e shquara të LKSH-së si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Azem Bejta etj. u munduan të organizojnë çeta vullnetarësh për t'u rezistuar pushtuesve serbo-malazezë të Kosovës, në prag të Luftës së Parë Botërore. Angazhimi i tyre vazhdoi edhe gjatë viteve të luftës kur i gjithë aktiviteti i tyre ishte i fokusuar në organizimin e kryengritjeve kundër pushtuesve. Rezistenca e shqiptarëve ndaj pushtuesve ballkanikë u manifestua që nga Merdarja e Llapit e deri te Kryengritja e Dibrës më 1913.

Rryma politike e udhëhequr nga Hasan Prishtina, Bajram Curri dhe Isa Boletini ishin përfaqësuesit më të spikatur të vazhdimit të rezistencës dhe luftës për çlirim dhe bashkim kombëtar të trojeve të ndara nga trangu kombëtar. Ata kërkonin edhe përkrahjen e Qeverisë së Përkohshme të drejtuar nga Ismail Qemali, pavarësisht se ishin të bindur që shteti shqiptar ende nuk kishte arritur të krijonte një konsolidim të mjaftueshëm për t'u implikuar më shumë me territoret që iu kishin shkëputur. Nga ana tjetër qeveria serbe protestonte për shkak të përzierjes së Qeverisë së Vlorës. Legata serbe në Vjenë në fund të shtatorit 1913 kishte dorëzuar në Ministrinë e Jashtme Austro-Hungareze një protestë në të cilën e akuzonte qeverinë shqiptare për përfshirje në kryengritjen antiserbe.²² Në shkresë përmenden edhe emrat e Hasan Prishtinës dhe Isa Boletinit si organizatorët kryesorë të shqiptarëve të armatosur që po e kundërshtonin me armë Serbinë dhe po sillnin armë në mënyrë të organizuar për armatosjen e shqiptarëve dhe rebelimin e tyre.²³

Në periudhën 1912-1914, pra në prag të Luftës së Parë Botërore, shqiptarët patën një periudhë të vështirë në procesin e konsolidimit të shtetit shqiptar, por edhe më e vështirë ishte situata e shqiptarëve në

²² Arben Puto, *Pavarësia Shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914...*f. 365

²³ Po aty.

Kosovë, Çamëri dhe vise të tjera të pushtuara nga ushtria serbe, malazeze dhe greke. Nga ana tjetër edhe Ballkani po vlonte nga pakënaqësitë e popujve, si osmanëve, bullgarëve dhe shqiptarëve të cilët ishin dëmtuar nga vendimet e Konferencës së Ambasadorëve.²⁴ Kurse përfituesit më të mëdhenj nga popujt ballkanikë ishin Serbia, Rumania, Greqia dhe Mali i Zi. Pra dukej se në Ballkan, paqja ishte krejt provizore dhe popujt e pakënaqur do të shfrytëzonin momentin e tyre për revansh. Edhe mosmarrëveshjet në kampin e Fuqive të Mëdha ishin një tregues i qartë se situata e përgjithshme dhe paqja botërore ishte krejt e brishtë.

²⁴ Oliver Jens Schmit, *Ballkani në shekullin XX, një histori post-imperiale*, Prishtinë 2021, f. 69.

Ksenofon Krisafi

KUSH E (ZH)BËRI SHQIPËRINË, VLORA APO LONDRA, SHQIPTARËT NË 1912 APO EUROPA NË 1913?

Abstrakt

Në literaturën historike dhe juridiko-ndërkombëtare, shqiptare dhe të huaj është debatuar rreth çështjes se kush e krijoi Shqipërinë, Lëvizja Kombëtare Shqiptare apo diplomacia e Fuqive të Mëdha? E shprehur më ndryshe e bënë shqiptarët në Vlorë, me vendimin e 28 Nëntorit 1912 apo Europa me vendimin e Konferencës së Londrës, të 29 korrikut 1913?!

Në përgjigjet e dhëna, përplasen dy qëndrime kryesore. I pari është karakteristik sidomos për studiuesit vendas. Nisur nga analiza e realiteteve shqiptare të fillimit të shekullit të kaluar, ata mbrojnë pikëpamjen se pavarësia ishte rezultat i përpjekjeve, luftërave dhe sakrificave shekullore të shqiptarëve për liri dhe pavarësi. I dyti, i përfaqësuar kryesisht nga studiuesit e huaj dhe posaçërisht nga vendet fqinje, pretendon se pavarësia e Shqipërisë ishte dhuratë e aktorëve kryesorë të politikës ndërkombëtare.

Doemos, do të ishte padrejtësi historike të mohohen luftërat, sakrificat dhe kontributi vendimtar i shqiptarëve për arritjen e pavarësisë, të cilët bënë shtetin e tyre të pavarur. Padrejtësi do të ishte edhe nëse mohohet e vërteta që diplomacia e Fuqive të Mëdha europiane, la jashtë kufijve Kosovën, troje të rëndësishme në Maqedoni, Mal të Zi dhe Greqi. Padrejtësi do të ishte edhe nëse kalohej në heshtje imponimi ndaj shtetit të ri i regjimit të kapitulacioneve, për qëllimet e vetë Fuqive etj. Nisur nga kjo politikë ambasadori amerikan i asaj kohe, Xhorxh Fred Uilliams, thotë se “Shtetet e Europës ... prenë copa me rëndësi nga toka shqiptare dhe ua dhanë fqinjëve në veri, në jug dhe në lindje, duke shkaktuar kështu ngatërresa dhe luftëra të përditshme në mes të këtyre shteteve. Copën që mbeti nga gërhëra e tyre e quajtën shteti i pavarur i Shqipërisë”. Por edhe glorifikimi ekstrem i rolit të shqiptarëve dhe shpërfillja e plotë e veprimtarisë së Fuqive të Mëdha do të çonte në qëndrime metafizike, jorealiste. Faktori vendas nuk veproi dhe nuk mund të vepronte në *vacuum*. Historia dëshmon se ndikoi pozitivisht, për aq sa ishte e mundur, mbështetja nga segmentët proshqiptarë të faktorit ndërkombëtar. Fjala vjen Austro-Hungaria dhe Italia, nisur nga interesat e tyre, ndërmorën nisma për përkrahjen e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe mbështetën edhe disa prej eksponentëve kryesorë të saj për shpalljen e pavarësisë.

Për një periudhë të caktuar historike, faktori i brendshëm dhe ai i jashtëm, interferuan te njëri-tjetri, vepruan bashkërisht dhe si rezultat sollën daljen e Shqipërisë si subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe njohjen e saj nga aktorët kryesorë të skenës europiane, që u realizua pikërisht nga vendimi i 29 korrikut 1913, i Konferencës së Ambasadorëve të Londrës. Ai sanksionoi njohjen e shtetit shqiptar, i cili ishte krijuar dhe zyrtarizuar nga vendimi i Kuvendit të Vlorës, i 28 nëntorit 1912. E ardhmja e tij politike do të vihej në pikëpyetje të shumta pa njohjen nga ndërkombëtarët. Nga ana tjetër ata

dhanë kontributin e vet për strukturimin e organizimit politiko-administrativ të Principatës shqiptare, duke caktuar kreun e shtetit, hartuar ligjin themeltar dhe legjislacionin e vendit, si dhe duke ndërmarrë veprime të tjera, veprimtari këto që u ndërpre në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore.

Fjalët çelës: Vlora, Konferenca e Londrës, shteti shqiptar, Ismail Qemali, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, Italia, Austro-Hungaria

Në literaturën historike dhe juridiko-ndërkombëtare, shqiptare dhe të huaj, është debatuar gjatë rreth çështjes se kush e krijoi Shqipërinë, shqiptarët nëpërmjet Lëvizjes së tyre Kombëtare apo diplomacia e Fuqive të Mëdha?! E shprehur më ndryshe, e bënë shqiptarët në Vlorë, me vendimin e 28 nëntorit 1912 apo Europa në Londër, me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, të 29 korrikut 1913?!

Për ta kuptuar dhe trajtuar më mirë thelbin e pyetjes me të cilën nis studimi në vijim, mund të shërbente një vështrim i shkurtër historik mbi rrugëtimin e shqiptarëve drejt shtetit të tyre të pavarur, faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikuan, ngjarjet që ndodhën dhe rezultatet që u arritën.

Pavarësia, ideal i hershëm i shqiptarëve

Akti i shpalljes së pavarësisë, i 28 Nëntorit 1912, duhet të gjykohe në kontekstin e historisë së përpjekjeve dhe luftërave çlirimtare që i paraprinë. Shumë breza, luftëtarë të pushkës e të penës, u bënë shembull për ata që ideuan dhe organizuan Kuvendin e Vlorës, ku nënshkruan dokumentin e pavarësisë.

Pavarësia e Shqipërisë ka përfaqësuar një ideal të hershëm të atyre që banonin në territoret e saj, që flisnin gjuhën shqipe, që kishin të njëjtën përkatësi etnike, konstitucion shpirtëror, kulturor etj. Ngrehinat politiko-administrative me tipare shtetërore kanë ekzistuar në trojet iliro-shqiptare që kur shoqëria u organizua politikisht. Ilirët më parë dhe shqiptarët më pas, sikurse edhe popujt e tjerë, kanë pasur struktura politiko-administrative me funksionet e shtetit. Për të mos zbritur thellë në histori, mund të kujtohet se të tilla pati në periudhën e principatave feudale shqiptare, ndër të cilat historiografët ndalen posaçërisht te shteti i Arbërit, shteti i Skënderbeut, te pashallëqet e mëdha të Janinës dhe të Shkodrës. Projekti i pavarësisë u konkretizua në trajta embrionale veça-

nërisht në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në programin e Rilindjes dhe të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare pavarësia ishte një ndër alternativat më optimale të zgjidhjes së çështjes shqiptare, madje më e avancuara dhe më e dëshiruara.

Për realizimin e idealit kombëtar rilindësit luftuan edhe me arsenalin e fuqishëm të ideve të iluminizmit dhe të Rilindjes evropiane, të cilat i përdorën për të argumentuar të drejtën natyrore të popullit shqiptar për ekzistencë të pavarur, për ta frymëzuar dhe mobilizuar atë në luftën për çlirimin kombëtar. Iu drejtuan historisë për të vërtetuar lashtësinë e shqiptarëve në trojet e veta, individualitetin e tyre kombëtar. Evokuan luftërat kundër sundimit të huaj, kontributin në çështjen e përbashkët të çlirimit të popujve ballkanikë dhe evropianë, gjallëruan kujtimet historike që populli i kishte ruajtur në këngët e legjendat e tij, vunë në dukje traditat, rëndësinë e bashkësisë gjuhësore, territoriale, shpirtërore, luftuan për ta kthyer vetëdijen popullore në ndërgjegje kombëtare dhe shqiptarizmin e shpallën parim themelor të Rilindjes.¹

Te akti i 28 Nëntorit 1912 shqiptarët panë shpërblimin për gjakun e derdhur, për vuajtjet e sakrificat e bëra për të arritur atë ditë. Prandaj, Pavarësia, Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe Rilindja konsiderohen një e tërë dhe e pandarë...²

Platformat e rilindësve për pavarësinë

Janë të shumtë ata që kanë punuar për pavarësinë, janë të pafundme përpjekjet për realizimin e saj. Një prej tyre ishte rilindësi i madh Sami Frashëri, i cili pikëpamjet dhe vizionin e shqiptarëve rreth të ardhmes së tyre politike, i ka shprehur me shumë qartësi. Përvojën e tij të vyer dhe të grupit rilindës, i cili projektoi dhe udhëhoqi procesin e krijimit të Shqipërisë së shkëputur nga Turqia, e paraqiti në vitin 1899, në veprën *Shqipëria, ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet*,³ që konsiderohet si manifesti politik e ideologjik i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ai piketonte rrugën në të cilën duhej ecur në të ardhmen sipas doktrinave më të përparuara politike, filozofike, sociologjike e juridike mbi shtetin dhe të drejtën. Me këtë libër, Sami Frashëri synonte të ndërgjegjësonte

¹ Kristo Frashëri, - *Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë: 28 Nëntor 1912*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 121.

² Kristo Frashëri, - Po aty.

³ Sami Frashëri, - *Shqipëria, ç'ka qenë, ç'është e çdo të bëhet*, *Librashqip.AL*, Tiranë, 2022,

shqiptarët dhe të huajt për lashtësinë dhe vlerat e Shqipërisë. Ai ua tregoi atyre rrezikun që u vinte nga fqinjët lakmitarë. “Kombet që kanë rrethuar Shqipërinë, duan ta copëtojnë e ta ndajnë në mes tyre”.⁴ Samiu e vlerëson si rrezik të madh edhe përçarjen dhe grindjet si rrjedhojë e përçarjes fetare dhe padijes. “Shpëtimi a humbja e Shqipërisë është në dorë të shqiptarëve”, të cilët “duhet t’i marrin ato që duan me pahir, t’i kërkojnë me fjalë, por të kenë edhe pushkën plot...”⁵. Në këtë manifest, Sami Frashëri parashtron të argumentuar platformën për ndërtimin e një shteti modern të pavarur, të përparuar dhe jo një sulltanati.⁶

Po ashtu edhe vëllai i tij, Abdyl Frashëri, udhëheqës dhe ideolog i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, shkruante se “do të vijë dita kur Europa do të bindet se shqiptarët i shërbejnë çështjes së njerëzimit dhe të qytetërimit më mirë se çdo popull tjetër i Lindjes... Shqipëria meriton pavarësinë më tepër se asnjë kombësi tjetër e Ballkanit”.⁷

Ismail Qemali drejt Vlorës

Në krye të veprimtarive me karakter politik, juridiko-ndërkombëtar dhe diplomatik doli Ismail Qemali. Pasi u bind se nuk kishte asnjë shans alternativa e ngritjes dhe e zhvillimit brenda kuadrit të Perandorisë Osmane, së bashku me bashkëpunëtorë nga të gjitha trevat shqiptare, përpunoi platformën e realizimit të objektivit të pavarësisë. U takua ose komunikoi me personalitete nga më influentët, brenda e jashtë Shqipërisë, me disa gjatë rrugës nga Stambolli për në atdhe në muajin nëntor 1912, ku ndaloi në Bukuresht, Budapest⁸

⁴ Po aty.

⁵ Po aty, f. 69.

⁶ Po aty, f. 70.

⁷ Prof. Dr. Alfred Frashëri, *Shqipëria që të përparojë*, Gazeta DITA, 11 Korrik, 2013.

⁸ Në Budapest u takua me kontin Hadik, nënsekretar shteti për politikën e jashtme si dhe me Berchtoldin, i cili ishte konsultuar paraprakisht me italianët dhe me gjermanët dhe, siç thuhet, kishte marrë pëlqimin e tyre për *pavarësinë* (korsivi i autorit) e Shqipërisë, jo të autonomisë, çka ia bëri të ditur Ismail Qemalit. Blendi Fevziu, *100 vjet, Një ekskursion në politikën e shtetit shqiptar nga 1912-2012*, KLAN-UET/PRESS, Tiranë, 2012, f. 9-10. Ky episod, i ardhur nëpërmjet rrëfimeve të At Zef Pllumit (At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2006, f. 410) dokumentohet edhe nga burime të tjera. Ilir Ikonomi p.sh. flet për takimin, si dhe për mesazhet themelore që Berchtold-i duhet t’i ketë përcjellë Ismail Qemalit. (Ilir Ikonomi, - *Pavarësia*, vep. cit. f. 130-136). Ndoshta edhe me porosi të Berchtold-it, takimi mund të jetë mbajtur konfidencial. Por, mund të ketë pasur rrjedhje informacioni. Në një intervistë të Ismail

dhe Vjenë⁹. Nga një pjesë mori përkrahje për pranimin e pavarësisë, çka e bëri të shpresonte për njohjen ndërkombëtare.

Më 12 nëntor 1912 ai kishte pasur takim në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Në *Raportin ditor* të ministrisë, thuhet, ndër të tjera, se “personaliteti shqiptar Ismail Qemal beu nga Vlora erdhi sot këtu për të na i shpjeguar aspiratat e njohura të shqiptarëve dhe për t’iu lutur qeverisë sonë që t’i përkrahë ato. Ai u përpoq të marrë vesh si e përfytyron qeveria jonë punën e organizimit të nesërm të Shqipërisë autonome dhe se ç’mendojmë ne këtu për qëllimin e tij që të mbliidhet një kuvend i parësisë shqiptare për të formuluar aspiratat e shqiptarëve dhe për t’ua komunikuar Fuqive të Mëdha, gjithashtu për ta shtyrë qeverinë turke, që administrata e saj ushtarake e civile në Shqipëri të punojë krah për krah me krerët e lëvizjes kombëtare. Duke u vënë gishtin shkrimeve të shtypit tonë gjysmëzyrtar, i thamë Ismail Qemal beut se qeveria jonë sot e mot ushqen simpatinë më të madhe për zhvillimin kombëtar të popullit shqiptar dhe dëshiron që Shqipëria të dalë prej ngatërresave të sotme të Ballkanit si një shtet më vete e kompakt, që të përfshijë domosdo brenda

Qemalit dhënë Maurice Pernot, për gazetën franceze, *Journal des débats*, pohohet e kundërta. Gazetari thotë shprehimisht se “me gjithë kërkesat këmbëngulëse, ai (Ismail Qemali) nuk mundi të pritej nga Konti Berchtold, por miqtë shpejtuan ta vënë në kontakt me disa funksionarë të lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme.” (*Journal des débats*, Vjenë, 21 nëntor 1912, citohet sipas I. Ikonomi, *Udhëtimi i paharruar i Ismail Qemalit*, UET/PRESS, Tiranë, 2012, f. 263.) Një telegram i ambasadorit italian në Vjenë, Avarna, i nisur nga Budapesti, më 19 nëntor 1912, në drejtim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, flet për takimin e Ismail Qemalit me ministrin Berchtold, në një version disi më të ndryshëm. Thotë se ambasadori kishte biseduar një ditë më parë me Bertcholdin, i cili i kishte pohuar se nuk donte ta takonte Ismail Qemalin, sepse nuk e dinte përse ai kërkonte të bisedonte me të. “Por duke qenë se ditët e fundit ishte ndodhur në një pritje te Konti Hadik, nënsekretari i shtetit në kabinetin e kaluar hungarez, i prezantoi Ismail Qemal Beun, i cili përfitoi nga rasti që t’i kërkonte të interesohet për fatet e Shqipërisë. Bertcholdi i kishte rrëfyer se nuk mund të impenjohej në këtë drejtim sikundër i kërkohet, pasi Shqipëria ishte ende nën sovranitetin e Sulltanit, prandaj nuk kishte të drejtë të ndërhynte në çështje që kishin të bënin me atë rajon.” Bertcholdi e kishte informuar Avarnën edhe se një kërkesë e njëjtë nga ana e Ismail Qemal Beut i qe bërë edhe Kontit Szapary, i cili i ishte përgjigjur në mënyrë evazive.” Sipas *Dokumente diplomatike italiane për historinë e shqiptarëve, 1912, vëll. II*, Erarba Çiraku, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Kristalina, Tiranë, 2022, f. 261.

⁹ Në Vjenë kontaktoi me drejtues të lartë të Perandorisë si dhe me miq e të njohur, me ndikim në politikën austro-hungarzeze. *Vorberitungen zur Bildung einer provisorischen Regierung in Albanian*, në *Neue Freie Presse*, 11 nëntor 1912, f. Citohet sipas Ilir Ikonomi, *Pavarësia*, vep.cit, UET/PRESS, Tiranë, 2012, f. 100.

tij të gjithë shqiptarët dhe të jetë në një nivel me popujt e tjerë ballkanikë (korsivi i autorit).”¹⁰

I bindur se, pavarësisht vështirësive, gjithçka shkonte në të mirë të pavarësisë, nisi të fliste pa rezerva për atë çka kishte ndërmend të bënte me mbërritjen në atdhe. Ia pohoi edhe një gazetari të *Il piccolo*, në Trieste, më 20 nëntor 1912, pak para nisjes për në Durrës, duke i thënë se pavarësia e Shqipërisë është një zgjidhje e domosdoshme e mbi të gjitha e drejtë dhe e aftë të thjeshtojë konfigurimin e ardhshëm të Gadishullit Ballkanik. Këtë mendim e kanë të gjitha fuqitë europiane e sidomos Anglia.”¹¹

Në intervistën për *Neue Freie Presse* Ismail Qemali konfirmonte: “Që Shqipëria të jetë një shtet i pavarur, thotë ai, këtë e kërkon jo vetëm interesi i shqiptarëve, por edhe interesi i përgjithshëm i Europës. Europa nuk do t’i gëzojë dot frytet e lirisë nëse Shqipëria copëtohet. Ne duhet të trajtohem si një shtet i Ballkanit. Nëse rajonet e pushtuara do të duhet të shkëputen krejt nga Turqia, po ashtu duhet që edhe Shqipëria të bëhet e pavarur”.¹² “Të gjithë shqiptarët, katolikë, ortodoksë ose myslimanë janë të bashkuar për të mbrojtur të drejtat e kombit dhe për të ruajtur pavarësinë e Shqipërisë (korsivi i autorit).”¹³

Një raport i datës 20 nëntor 1912, i drejtorit të policisë së Triestes, Markus, që njofton nisjen e Ismail Qemalit për në Durrës me anijen *Linz*, shkruan se, i përcjellë prej 14 krerëve shqiptarë, “menjëherë pas mbërritjes së tij atje, që ka probabilitet të ndodhë sot në mbrëmje, ka për të proklamuar pavarësinë e Shqipërisë dhe do të vendosë një qeveri provizore... Ka probabilitet që I. Qemal beu, në këtë rast të ketë qenë pak i kujdesshëm,...sepse mund t’i ndodhë rreziku që të ndalohet prej grekëve për të zbritur në Durrës, respektivisht të trajtohet si rob lufte, pasi ka ditë që ata kanë bllokuar Sarandën dhe Vlorën...”¹⁴

Vjena dhe Roma llobojnë për pavarësinë e Shqipërisë

Në javën e fundit të tetorit 1912 Berchtoldi ishte takuar në Firence me ministrin e punëve të jashtme të Italisë, Antonio di San Giuliano, ku

¹⁰ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi VI, Marenglen Verli, Ledia Dushku, Botimet Albanologjike, Tiranë 2012, f.155,156.

¹¹ Citohet nga Ilir Ikonomi, vep.cit. f.268.

¹² Citohet nga Ilir Ikonomi, vep. cit. f. 96.

¹³ Intervistë e Ismail Qemalit dhënë Maurice Pernot, gazetar i *Journal des débats*, Vjenë, 21 nëntor 1912, citohet sipas I. Ikonomi, vep. cit. f. 264 - 265.

¹⁴ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi VI, Marenglen Verli, Ledia Dushku, Botimet Albanologjike, Tiranë 2012, f. 257 - 259.

biseduan edhe rreth të ardhmes politike të Shqipërisë dhe kufijve të saj. Në një dokument që pasqyron diskutimet e zhvilluara në Vjenë, në Ballhausplatz, thuhet ndër të tjera se “për Austrinë do të ishte i deshirueshëm krijimi i një Shqipërie autonome ose i një Shqipërie të pavarur, kur sovraniteti i Turqisë mbi të të kishte marrë fund plotësisht.”¹⁵ Aty konkludohet se “një Shqipëri autonome, qoftë edhe me një sipërfaqe minimale dhe me jetëgjatësi problematike, tani për tani do të ishte për ne zgjidhja relativisht më e pëlqyeshme, sepse ajo e shtyn konfliktin me Italinë dhe na e mban derën të hapur për të ardhmen.”¹⁶

Vjena dhe Roma jo vetëm që ishin në favor të pavarësisë së Shqipërisë, por kishin nisur edhe një “fushatë lobimi” në kryeqytetet e vendeve të tjerë. Në këtë periudhë qeveritë austriake dhe italiane i njoftuan zyrtarisht Cetinës dhe Beogradit mendimin e tyre për *autonominë* e Shqipërisë.¹⁷

Qeveria austriake, më 30 tetor 1912, iu drejtua gjithashtu edhe Gjermanisë që “të solidarizohej për “interesin jetësor” të monarkisë në zhvillimin e lirë të Shqipërisë, në mënyrë që në brigjet lindore të Adriatikut të mos instalohej asnjë fuqi e madhe e huaj.”¹⁸ Është një tjetër dëshmi e hapur e një prej arsyeve të mbështetjes së Austro-Hungarisë për Shqipërinë, “interesi jetësor” i saj mbi trevat shqiptare. Zbulohet gjithashtu edhe se Austro-Hungaria dhe Italia ishin afishuar pro shqiptarëve, krahas një faktori ndërkombëtar që ishte kundër ose preferonte të mos shprehej për pavarësinë e saj. Gjermania, që e trajtonte çështjen në një aspekt më të gjerë dhe më global, nuk shprehej qartë për qëndrimin e vet ndaj përpjekjeve të shqiptarëve për krijimin e shtetit. Madje pati një rast kur doli haptas kundër. Në një telegram që Perandori Vilhelmi i Dytë i dërgonte më 9 nëntor 1912, ministrit të Punëve të Jashtme, Alfred Von Kiderlen-Waechter, i thoshte se “unë i kam folur me detaje Kancelarit të Rajhut në të njëjtën linjë me udhëzimet që po ju jap juve

¹⁵ *Aufzeichnung über eine im Ministerium des Äußern abgehaltene Konferenz*, pa datë (mes 25 dhe 30 tetorit 1912), në Bittner, Pribram, Srbik und Übersberger, Österreich-Ungarns Aussenpolitik von der bosnischen Krise 1908 bis zum Kriegsausbruch 1914, vëll. 4, Österreich-Ungarns Aussenpolitik, Wien, 1930; Nr. 4170, f. 698-699. Citohet nga Ilir Ikononi, vep.cit. f.50-53.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Revista *Leka*, 1937, *Numer kujtimuer i XXV vjetorit të pavarësis komtare*, Vj.IX., numrat VIII-XII, Bleni I, *Trilidhja per autonomin e Shqipnis*, f. 416. Citohet sipas Romeo Gurakuqi, *Shqipëria, 1911-1914*, UET/PRESS, Tiranë, 2012, f. 446-447.

¹⁸ Blendi Fevziu, *100 vjet, Një eksursion në politikën e shtetit shqiptar nga 1912-2012*, KLAN & UET/PRESS Tiranë, 2012, f.14.

dhe kam theksuar se në asnjë rrethanë nuk mund të marshoj kundër Parisit dhe Moskës për shkak të Shqipërisë”.¹⁹

Gjermania nuk donte që, për hatër të Shqipërisë, të rrezikonte ose të cenonte interesa madhore të politikës së saj që kishin të bënin me marrëdhëniet strategjike me Francën dhe Rusinë. Si Parisi ashtu edhe Moska kishin afishuar me kohë pozicionimin e tyre përkrah shteteve sllave të Ballkanit.

Ismail Qemali ishte interesuar drejtpërsëdrejti për të mësuar edhe qëndrimin britanik ndaj objektivit të tij. Për këtë qëllim gjatë qëndrimit në Vjenë, më 10 nëntor pati një takim me përfaqësuesin britanik F. Cartwright. E njoftoi se “pas disa ditësh do të shkonte në Vlorë për të marrë pjesë në një mbledhje të krerëve shqiptarë, të cilët kishin ndërmend të hartonin një *përkujtesë* për dëshirat e tyre që t’u dërgohej Fuqive.” I tha gjithashtu se “shqiptarët ishin të vendosur që ta mbanin vendin, domethënë rajonin në të cilin përgjithësisht flitet gjuha e tyre, që të mos rrëmbehet nga ndonjë shtet i Ballkanit. Ata do të luftojnë deri në vdekje që të mos e lejojnë vendin e tyre të copëtohet”.²⁰

Cartwright-i i shkruante shefit të vet, Eduard Greit, se Ismail Qemali i kishte thënë që “pasojat e pashmangshme të rregullimeve të reja në Ballkan do të ishin që Bullgaria do të orvatej dhe do të kërkonte të zotëronte mbi shtetet e tjera, kështu që, pa kaluar shumë kohë, Ballkani do të ndahej në dy grupe, të përbëra nga Bullgaria, Serbia, Mali i Zi nga njëra anë dhe Rumania, Shqipëria e Greqia, nga ana tjetër.”²¹ Këtë peizazh politik të Ballkanit Ismail Qemali e konsideronte në interes të barspeshës së forcave në Lindjen e Afërt dhe një arsye të mundshme “përse Austria është kaq e vendosur ta ruajë *pavarësinë* e Shqipërisë.”²²

Njoftimi i mësipërm është mjaft interesant, sepse zbulohen disa çështje që duket se nuk janë thënë gjithmonë kaq qartë.

Së pari, sipas Cartwright-it, Ismail Qemali nuk i ka thënë drejtpërsëdrejti se mbledhja e krerëve shqiptarë do të shpallte pavarësinë e Shqipërisë, por do të përgatiste dhe miratonte një Përkujtesë për Fuqitë e Mëdha. Megjithatë, Cartwright-i e kishte kuptuar se fjala ishte për

¹⁹ Citohet nga David Fromkin, *Europe's last summer: who started the Great War in 1914?* Knopf Doubleday Publishing Group, 2007, f. 89.

²⁰ F.O. 47788/42842/12/44., Tel. Nr.133, Vjenë, 10 nëntor 1912. BD,V,IX,P, II, London, 1934, d.nr.173, pp.130, Citohet sipas *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, 1912-1013*, Përgatitur nga Muhamet Shatri, Botimet *Toena*, Tiranë, 2012, f. 96.

²¹ Po aty.

²² Po aty.

krijimin e një Shqipërie të pavarur, për sa kohë që e pyeti se cila do të ishte “politika e jashtme e ardhshme e një Shqipërie të pavarur”?²³

Së dyti, Ismail Qemali ia bëri të qartë përfaqësuesit britanik se shqiptarët nuk do të lejonin copëtimin e vendit të tyre. Çdo përpjekjeje për ndarjen e Shqipërisë, ata do t’i përgjigjeshin me trazira dhe kryengritje, që mund të detyronin Austrinë dhe Italinë për të ndërhyrë.

Së treti, ai mendonte se zhvillimet e asaj kohe në Ballkan mund të çonin në grupimin e shteteve të tij në dy blloqe.

Nga sa u tha më lart del se Vjena dhe Roma kanë luajtur rol të pamohueshëm për pavarësinë e Shqipërisë. Në favor të këtij mendimi ka edhe fakte të tjera. P.sh. në një shkrim të botuar në numrin e 31 gushtit 1913, të gazetës *New York Times*²⁴, i cili paraqet interes, sepse tregon “në kohë reale” mendimin e Fuqive të Mëdha, për zhvillimet shqiptare që çuan në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, riafirmon mendimin se “Austria, me ndihmën e Italisë dhe miratimin hezitues të Gjermanisë, iu imponua Evropës me detyrën që të organizonte Shqipërinë si një mbretëri të re.”²⁵

Lëvizja Kombëtare Shqiptare e kishte dalluar, e vlerësonte dhe e merrte në konsideratë nuancën e qartë të politikës shqiptare të Ballplatz-it. Filip Noga, në shtatorin e 1913, shprehej se “shqiptarët i janë mirënjohës Europës për atë pak gjë që ka bërë për ta dhe shpresojnë se ajo do të riparojë dëmin që i ka shkaktuar Shqipërisë gjatë demarkacionit.” Ai veçonte rolin e Austro-Hungarisë veçanërisht për mënyrën se si ajo e mbrojti Shqipërinë dhe kontribuoi në çlirimin e saj. Ai thoshte se “perandori Franz-Jozef te ne thërritet “xhaxha” dhe “çlirues i Shqipërisë”.”²⁶

Perandori Franc Jozefi, duke folur për pavarësinë e Shqipërisë ka thënë se “duke u marrë vesh plotësisht me qeverinë aleate të Italisë i treguam Konferencës së Ambasadorëve mendimin tonë për krijimin e

²³ Po aty.

²⁴ *New York Times*, 1913 August 31, *The Kingdom of Albania*, Citohet nga *Pse e krijoi Austria Mbretërinë e Shqipërisë, sot në pritje të një Princi dhe me kryeqytet Elbasanin*, - Bota.al 16/11/2019.

²⁵ Po aty.

²⁶ Deklaratë e Filip Nogës, delegatit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës, dhënë gazetës “*Neue Frei Presse*”, për përcaktimin e kufijve të Shqipërisë nga Fuqitë e Mëdha, sidomos në zonën jugore, botuar edhe nga gazeta në gjuhën frënge *La Jeune Turquie*, në faqen n° 2, të numrit të saj të së mërkurës, së 10 shtatorit 1913. Sipas Aurenc Bebja, Francë - 28 tetor 2017.

një principate shqiptare të lirë e të pavarur dhe mundëm të kemi mbështetjen e qeverive të tjera në këtë çështje që kishim nisur”.²⁷ Ndërkaq Franc Ferdinandi, trashëgimtari i fronit austro-hungarez, i kishte deklaruar Syrja Vlorës se “sipas një marrëveshjeje midis Monarkisë dhe Italisë, Shqipëria duhet të mbetet një shtet i pavarur për të ruajtur baraspeshën ballkanike dhe për të penguar hegjemoninë e pakufizuar të sllavëve, duhet të gëzojë dashamirësinë dhe kujdesin e veçantë të pjesëve gjermane dhe hungareze të Monarkisë.” Ministri i Jashtëm austriak Berchtold-i shprehet se “Ne kemi si qëllim vetëm krijimin e një Shqipërie të pavarur, formimi i së cilës nga ana tjetër qe parashikuar nëpërmjet një pune diplomatike të mëparshme sidomos në marrëveshje me aleaten tjetër Italinë.” Konti Jul Andrassy, ish-ministër i Jashtëm i Habsburgëve, shprehet se “Austro-Hungaria nuk ka pasur qëllim të pushtojë Shqipërinë, por ajo ka dashur vetëm që Shqipërinë të mos e ketë një shtet ballkanas armik i Austro-Hungarisë (Serbia) ose një konkurrent që lakmon të sundojë Adriatikun (Italia). Ky është shkaku pse Astro-Hungaria kërkon një Shqipëri të pavarur.”²⁸

Shpallja e pavarësisë

Për itinerarin e udhëtimit të tij historik nga Stambolli në Bukuresht, Vjenë, Budapest, Trieste e Durrës janë shkruar libra, studime, artikuj publicistikë, madje janë bërë edhe filma etj. Një gazetar i *Daily Telegraph*, dëshmitar okular, që kishte parë me sytë e vet, skenën e nisjes së Ismail Qemalit dhe eskortës së tij drejt Vlorës, sjell një rrëfim të gjatë. Ai thotë se “Ishte një karvan jashtëzakonisht piktoresk që po linte qytetin. Në ballë të tyre marshonin dy xhandarë të armatosur, ndërkohë që një mori simpatizantësh i shoqëruan në këmbë delegatët, sikur të donin t’i shpejtonin në rrugën e tyre. Nga dritaret dhe ballkonet, Durrësi e ndoqi me sy karvanin e vogël, i cili u zhduk pak nga pak në mjegullën e mëngjesit.”²⁹

Pas mbërritjes në Vlorë dhe përfundimit të përgatitjeve të nevojshme, Ismail Qemali me bashkëpunëtorët dhe delegatët e ardhur nga të gjitha krahinat shqiptare, u mblodhën në shtëpinë e kushëritit të vet, nga

²⁷ Elena Kocaqi, - *Si e krijoi Austro-Hungaria shtetin shqiptar*, Emal, Tiranë 2012.

²⁸ Referencat e mësipërme, janë marrë nga portali *Një Komb*, December 20, 2019 dhe janë shkëputur nga libri *Si e krijoi Austro-Hungaria shtetin shqiptar*, i autores Elena Kocaqi, botim i Emal, Tiranë 2012.

²⁹ Sipas “Si lindi Shqipëria?” Gazetari Ilir Ikonomi sjell shkrimin e gazetës amerikane në nëntor të vitit 1912, Historia Shqiptare, November 29, 2023

familja Vlora, ku “rreth tryezës, në krye nga ana e hyrjes, ishin vendosur tre frone, në mes të cilëve ndejti Ismail Qemali, në krahun e djathtë Myfti Vehbi Dibra, në të majtë Dom Nikolla Kacorri, në ballin e tryezës së gjatë, karshi Ismail Qemalit kishte zënë vend Bab Dud Karabunara, në krahun e djathtë të tij Abdi Toptani, në të majtën Jani Minga dhe në të dy anët zumë vendet neve delegatët e tjerë...”³⁰ Pas një heshtjeje shpirtërore u ngre në këmbë Ismail Qemali dhe filloi me fjalë të shkurtra. “Zotërinj! Si inisiator i kësaj mbledhjeje historike iu falenderoj Juve dhe popullin kreshnik shqiptar që iu zgjodhi, duke çuar në vend ftesën time, barra që na është ngarkuar është e shënjtë po shumë e rëndë. Ju e dini që të gjithë situatën dhe e çmoni delikatesën e minutave që po kalon kombi dhe atdheu jonë i dashur. Jeni të ftuar e të mbledhur këtu të gjithë që të jepni vendimin historik për fatet e kombit dhe të Shqipërisë...” Ismail Qemali vijon: “Masat e para që duhet të merren janë këto: 1. Të bëhet Shqipëria më vehte nën një qeveri të përkohshme. 2. Të zgjidhet një pleqësi për ndihmë e kontroll të qeverisë. 3. Të dërgohet një komision në Europë për të mbrojtur çështjen shqiptare përpara mbretërive të mëdha.” Të gjithë delegatët me një zë aprovojnë fjalën e Ismail Qemalit dhe vendosin që: “Shqipëria të bëhet që sot më vehte, e lirë, e mosvarur nën një qeveri të përkohshme.”³¹ Vendosën gjithashtu që të njoftoheshin pa humbur kohë Fuqitë e Mëdha dhe shtetet ndërluftuese (ballkanike).³²

Kjo ngjarje, si dhe gjithçka që ndodhi në ato kohë dhe në vijim, dëshmohet edhe nga një dokumentacion voluminoz, autentik arkivor, që gjendet jo vetëm në Tiranë, por edhe në Romë, Vjenë, Paris, Berlin, Londër, Moskë etj, si dhe në Athinë, Beograd, Cetinjë, Sofje, Bukuresht etj. Aty janë depozituar me mijëra akte të korrespondencës diplomatike, shkëmbyer ndërmjet instancave të tyre përfaqësuese dhe kryeqyteteve përkatëse.³³

Në një prej tyre, që dërgohej nga konsulli austro-hungarez në Vlorë, Lejhanec, flitet për falenderimet e një turmë njerëzish, e cila në pasditën e 28 Nëntorit 1912, entuziazmuar nga shpallja e pavarësisë,

³⁰ Vihet re kujdesi i veçantë për të respektuar me rigozitetet përbërjen krahinore dhe fetare të popullsisë së vendit.

³¹ Vasfi Baruti, - *Kuvendi i Vlorës, pasdite e 28 Nëntorit 1912, Ismail Qemali në dokumentin e panjohur të firmëtarit M. Ferid Vokopola*, Nga Gazeta *Telegraf* - 30 Nëntor, 2023.

³² Po aty.

³³ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi VI, Marenglen Verli, Ledia Dushku, Botimet Albanologjike, Tiranë 2012, f. 257 – 259, si dhe AIHT, Vj. 22-8-859, Raport i Lejhanecit për Berchtoldin, 29 nëntor 1912.

përshkoi rrugët e qytetit të Vlorës, “qëndroi përpara konsullatës së (Austro-Hungarisë) dhe shpërtheu në brohoritje të stuhishme duke thirrur “Rroftë Shqipëria! Rroftë Austria!”³⁴ Konsulli Lejhanec i falënderoi nga dritarja dhe thirri “Rroftë Shqipëria!”³⁵

Ai jep edhe të dhëna të tjera me interes për çështjen në fjalë. Thotë p.sh. se Ismail Qemal beu, ditën e mbërritjes së tij, i kishte bërë vizitë konsullatës së këtushme perandorake dhe mbretërore (të Austro-Hungarisë) dhe konsullatës italiane, por nuk i kishte rezervuar deri më sot të njëjtat konsiderata nënkonsullit rus të nderit, zotit Çika, një shqiptar ortodoks vendas, të cilin e njeh privatisht. Deri më sot midis tyre nuk ka ndodhur as dhe një komunikim.³⁶ Thotë gjithashtu se sipas ftesës së Ismail Qemal beut, mbrëmjen e datës 28 të këtij muaji, unë dhe kolegu im italian shkuam në banesën e tij, në shtëpinë e tregtarit të madh Hasan Sharra. Aty na përshkroi zhvillimin e bisedimeve në Kuvendin Kombëtar si dhe rezultatin provizor të tyre. *Na u lut për të vënë në dijeni qeveritë tona dhe për të kërkuar përkrahjen dashamirëse të tyre, për shtetin e ri shqiptar.* Me këtë rast përmendi dhe shqetësimin e tij për përparimin e trupave serbe, në drejtim të Tiranës, të Durrësit, të Elbasanit, pa marrë parasysh njoftimin për proklamimin e Pavarësisë së Shqipërisë...³⁷

Në sinkron me njoftimin e konsullit austro-hungarez ishte edhe ai që përcillej po nga Vlora, nga konsulli i Italisë De Facendis. Në Raportin e 28 Nëntorit 1912, për ministrin e Punëve të Jashtme, San Giuliano, njoftonte shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe ngritjen e flamurit shqiptar në Vlorë. Thoshte ndër të tjera se “delegatët shqiptarë të mbledhur në një asamble në shtëpinë e Vlorajve, me president Ismail Qemal Beun kanë shpallur pavarësinë e Shqipërisë dhe kanë ngritur flamurin shqiptar. Ky veprim është pritur me entuziazëm nga popullsia, e cila ka formuar një kortë të madh, duke kënduar himnin kombëtar dhe ka bërë një demonstrim të gjatë përpara konsullatave të Italisë dhe të Austrisë.”³⁸

Nga telegrami i konsullit austro-hungarez Lejhanec, për ministrin e Jashtëm, Leopold Berchtold-in, rezulton: *Së pari*, se ata që e shpallën

³⁴ Po aty.

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty.

³⁸ *Dokumente diplomatike italiane për historinë e shqiptarëve, 1912, vëll. II*, Erarba Çiraku, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, *Kristalina*, Tiranë, 2022, f. 279. Në Raportin e datës 19 nëntor 1912, që ambasadori Italian në Vjenë i drejtonte ministrit të Punëve të Jashtme San Giuliano, hidhet dritë mbi takimin e Ismail Qemalit me ministrin Berchtold.

pavarësinë ishin të vetdijshëm për rolin e disa prej Fuqive të Mëdha në përkrahjen dhe inkurajimin e mëtejshëm të veprimtarisë shtetformuese të shqiptarëve. Prandaj njerëzit e mbledhur poshtë ballkonit të “shtëpisë së pavarësisë”, sapo morën lajmin e madh marshuan drejt konsullatave të Austro-Hungarisë dhe të Italisë, për t’iu shprehur mirënjohje dhe falënderime për përkrahjen, si dhe për t’iu kërkuar mbështetje për njohjen e pavarësisë. *Së dyti*, ftesa dhe pritja që u bëri konsujve të Austro-Hungarisë dhe Italisë në rezidencën e vet I. Qemali, ishte sërish një gjest, por edhe një vlerësim e kërkesë e tërthortë për njohje. *Së treti*, vizita e tyre në shtëpinë ku banonte Ismail Qemali, ishte shenjë tjetër e përkrahjes së shteteve të tyre ndaj shtetit shqiptar. Janë po ashtu përkrahje, mbështetje, inkurajim edhe përshëndetjet nga dritaret e rezidencave të veta ndaj turmës, shoqëruar me gjeste dhe me fjalët “Rroftë Shqipëria”, të ndjekura në ditët në vijim nga vizita, bisedime dhe konsultime të konsujve në selinë e qeverisë dhe të funksionarëve shqiptarë në selitë e konsullatave etj.

Ngritja e shtetit shqiptar

Qeveria e Përkohshme e Vlorës, nën drejtimin e diplomatit të shquar Ismail Qemali, bëri gati të pamundurën për ngritjen e shtetit shqiptar. Këtë e ka thënë ai vetë, i cili është shprehur se “në një vend me kufij ende të papërcaktuar, kur statusi politik i premtuar nga Evropa pritej të realizohej dhe kur vazhdonte një propagandë e tërbuar për të ngjallur trazira, qeveria ime ia doli mbanë t’i sjellë stabilitet shtetit dhe t’i sigurojë një administratë normale”.³⁹ Vështirësitë me të cilat ai u ndesh ishin të shumta, por ndër më kryesoret mund të renditen: *Së pari*, gjendja e përgjithshme ekonomike, politike, sociale, ushtarake, ndërkombëtare tepër e rënduar. *Së dyti*, kundërshtimi i Portës së Lartë, për të mos e lejuar shkëputjen e Shqipërisë prej saj. *Së treti*, qëndrimi i Fuqive të Mëdha, i karakterizuar nga një konglomerat pozicionesh, disa armiqësore, disa refraktare, disa me simpati dhe përkrahje të kalkuluar, *Së katërti*, armiqësia ndaj saj dhe të ardhmes politike e të gjithë fqinjëve, e shprehur deri edhe me qëndrime të institucionalizuara, të konkorduar dhe të sanksionuara në një sistem aleancash ofensive dhe traktatesh dy e shumëpalëshe që çuan në shpërthimin dhe zhvillimin e luftërave turko-ballkanike. Rezultati i tyre më i parë e më i dukshëm ishte pushtimi i territoreve shqiptare, shoqëruar me masakra, vrasje, spastrim etnik, gjenocid si dhe me rrënimë, shkatërrime.

³⁹ Citohet sipas Arben Puto, - Për 100-vjetorin e Principatës së Vidit, Gazeta Shqiptarja.com, 11 Mars 2014.

Dhe, sikur të mos mjaftonin gjithë këto, ishin edhe Esat Pashët & Co, që, vetëm për interesat e tyre egoiste dhe shteteve në shërbim të të cilëve vepronin, ishin të gatshëm të sakrifikonin të ardhmen e shqiptarëve.

Përpjekjet për sigurimin e njohjes ndërkombëtare

Në marrëdhëniet ndërkombëtare, ndër veprimet më të para të politikës së jashtme, të shteteve të krijuar rishtas është çështja e sigurimit të njohjes. Kjo u shtrua menjëherë edhe për Shqipërinë e 1912. Ismail Qemali, në krye të shtetit shqiptar për një periudhë prej rreth një viti e gjysmë, bëri të gjitha përpjekjet për sigurimin e njohjes së shtetit dhe qeverisë shqiptare. Për shkak të vështirësive të jashtëzakonshme në të cilat vepronte diplomacia shqiptare e asaj kohe, mosnjohjes *de jure* nga Europa, Shqipëria e kohës së Ismail Qemalit, nuk pati shërbim diplomatik të akredituar jashtë. Prandaj u gjykua me vend që fillimisht të caktohej një “ambasador jo rezident, shëtitës”. Ai ishte Rassih (Rasip) Dinon, i biri i Abedin Pashë Dino, ish-Ministër i Jashtëm i Perandorisë osmane dhe një ndër themeluesit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i cili ishte akredituar në Austri, Itali, Londër etj. Që më 28 nëntor 1912 iu drejtoi aktorëve kryesorë të skenës botërore,⁴⁰ si dhe Turqisë dhe fqinjëve⁴¹ me kërkesën për njohjen ndërkombëtare të shtetit. Megjithëse

⁴⁰ Kërkesa iu dërgua më 28 dhe 29 nëntor 1912, nëpërmjet njoftimesh me përmbajtje pothuajse të njëjta Fuqive të Mëdha. Në telegramin drejtuar MPJ të Italisë, Austro-Hungarisë, Francës, Gjermanisë, Ruisë dhe Britanisë së Madhe, thuhej ndër të tjera se: Kuvendi Kombëtar, i përbërë nga delegatë të të gjitha viseve të Shqipërisë, pa dallim feje, të mbledhur sot në qytetin e Vlorës, tashti sa shpalli Pavarësinë politike të Shqipërisë dhe formoi një Qeveri të Përkohshme, të ngarkuar për t'u dalë zot të drejtave të qenies së popullit shqiptar, të kanosur me shfarosje prej ushtrive serbe, e të çlirojë truallin kombëtar të shkelur prej ushtrive të shteteve aleate (bëhej fjalë për pjesëtarët e aleancës ballkanike për luftë kundër Turqisë). Duke i njoftuar Shkëlqësisë Suaj çfarë është bërë, kam nderin që t'i lutem Qeverisë së Madhërisë së Tij, mbretit të Britanisë së Madhe (Italisë, Austro-Hungarisë, Francës, Gjermanisë, Ruisë), që të ketë mirësinë ta njohë këtë ndryshim të jetës politike të kombit shqiptar. Shqiptarët duke hyrë përsëri në familjen e popujve të Evropës Lindore, në të cilën mburren se janë më të moçmit e duke mos ndjekur veçse një qëllim të vetëm: për të jetuar në paqe me gjithë shtetet ballkanike e për t'u bërë një element ekuilibri, janë të bindur se Qeveria e Madhërisë së Tij, ashtu si edhe gjithë bota e qytetëruar do t'i presë me sy të mirë, duke mbrojtur qënien e tyre kombëtare nga çdo agresion. *The Memoirs of Ismail Kemal Bey*, ed. By S. Story, London, 1920, p. 373.

⁴¹ Në telegramin drejtuar Ministrave të Punëve të Jashtme në Cetinjë, Beograd, Sofie, Athinë thuhej: “Po nxitoj t'i njoftoj Shkëlqësisë suaj një ngjarje me rëndësi të jashtëzakonshme për jetën kombëtare të shqiptarëve. Delegatët e gjithë viseve

shpresonte se mund të kishte përgjigje pozitive, u bë e qartë se diplomacia europiane nuk kishte rënë ende në emërues të përbashkët për qëndrimin që do të mbante ndaj Shqipërisë. Situatat po komplikoheshin dhe njohja do të vonohej. Nuk erdhi asnjë përgjigje pozitive për njohje as nga fqinjët dhe as nga Fuqitë e Mëdha, me gjithë njëloj premtimi që i ishte bërë Ismail Qemalit nga disa prej tyre.

Pothuajse të gjithë anëtarët e Koncertit European, vetë Turqia, si dhe fqinjët e Shqipërisë, ishin të vetëdijshme se Shqipëria e pas 28 nëntorit 1912, nuk ishte ajo e një dite më parë. Një varg ngjarjesh e kishin bërë të qartë se Turqia po largohej përfundimisht nga Ballkani dhe se shqiptarët po krijonin shtetin e vet kombëtar. Veprimet që po ndërmerreshin veçanërisht nga fqinjët synonin që nëse nuk do të arrinin ta pengonin, ta vononin ose ta relativizonin.

Nëse mohohet pas 28 nëntorit 1912, në 4 vilajetet shqiptare të Perandorisë Osmane nuk kishte lindur Shqipëria e pavarur, për konsekuencë logjike duhet pranuar që në territorin e saj vazhdonte të ekzistonte Turqia. Por juridikisht⁴² dhe praktikisht⁴³ ajo nuk ishte më aty. Në pjesë të ndryshme të vendit kishin mbetur reparte të ushtrive osmane, të çmobilizuara, kontigjente nëpunësish të administratës tërësisht të dekurajuar, në pritje për t'u larguar. Shkurt, në Shqipëri nuk kishte më Turqi. Ndodheshin ende konsullatat e huaja, që ishin akredituar prej kohësh pranë Portës së Lartë, e cila tashmë nuk kishte më juridiksionin e nevojshëm në territoret shqiptare. Në këtë optikë në raportin Turqi – shtetet e tjera, konsullatat ishin pa mbështetjen e duhur juridiko-ndërkombëtare dhe rrjedhimisht, pa funksion. Sepse që të ekzistojë një marrëdhënie duhen minimalisht dy palë, ndërkohë që në rastin në fjalë,

të Shqipërisë, të mbledhur sot pa dallim feje në Kuvendin Kombëtar në qytetin e Vlorës, kanë shpallur Pavarësinë e Shqipërisë dhe kanë formuar një qeveri të përkohshme. Shqiptarët janë të gëzuar që po munden të hyjnë *përsëri* në familjen e popujve të lirë të Lindjes e duke mos pasur tjetër qëllim, veçse të jetojnë në paqe me gjithë shtetet fqinje, shpresojnë: - se ndryshimi i jetës politike dhe formimi i Qeverisë së Përkohshme do të njihet prej Qeverisë së Tij Mbretërore; - se çdo veprim armiqësor nga ana e ushtrive të tij brenda në truallin kombëtar të tyre do të pushojë së vepruari dhe - se gjithë viset thjesht shqiptare të pushtuara, prej sot do të lirohen përsëri.” Citohet nga Teuta Hoxha, *Ismail Qemali: Përmbledhje dokumentesh (1888-1919)*, (Tiranë: 8 Nëntori, 2002), f. 262-264. - Kryetari i Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemali. Arkivi i Institutit të Historisë Tiranë (AIHT).

⁴² Më 30 maj 1913 në Londër u nënshkrua Traktati i Paqes ndërmjet Perandorisë Osmane dhe aleatëve ballkanikë, nëpërmjet të cilit ajo hiqte dorë nga trashëgimitë e saj në Ballkan.

⁴³ Shqipëria ishte ndarë prej saj që në 28 nëntor 1912.

nga pikëpamja formale, kishte vetëm një. Aty ku ishin konsullatat nuk kishte më Perandori Osmane, kishte Shqipëri, një shtet tjetër, gjithsesi subjekt i së drejtës ndërkombëtare edhe pse i panjohur ndërkombëtarisht. Rrjedhimisht konsullatat e ndodhura në territorin e saj nuk mund të ishin më të akredituara në Perandorinë Osmane. Ato kishin mbetur tashmë konsullata, organe të marrëdhënies me jashtë të Fuqive të Mëdha, që fizikisht ishin vendosur në shtetin e porsakrijuar shqiptar, formalisht të paakredituara. Nuk u mbyllën, nuk u tërhoqën, qëndruan, funksionuan, vepruan dhe vazhduan të përmbushnin misionin e vet klasik, interesimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit dhe shtetasve të tyre në territoret shqiptare, funksion që nuk mund të realizohej kurrsesi pa hyrë në marrëdhënie me institucionet shtetërore shqiptare.

Përveç sa më sipër, një varg episodesh e veprimesh që bashkësia ndërkombëtare ndërmori në raportet me Qeverinë e Vlorës, dëshmojnë se ka vend të mendohet dhe të thuhet se, në fillimet e veta, shtetit shqiptar iu akordua një njohje jo e plotë, jopërfundimtare, që përkon me njohjen *de facto*, si fazë e parë drejt njohjes *de jure*.

Njohje de facto?

Nga analiza e veprimtarisë shtetërore të ndërmarrë në Shqipërinë e asaj kohe, dhe veçanërisht nga marrëdhëniet me botën e jashtme, mund të thuhet se pas 28 nëntorit 1912, Shqipëria kishte marrë një nga llojet e njohjes të përcaktuara nga e drejta ndërkombëtare. Nuk pretendohet të ishte njohja de jure, realisht forma më e avancuar, më e plotë, më e qëndrueshme dhe e përhershme e njohjes ndërkombëtare, që ka si apogje vendosjen e marrëdhënies diplomatike dhe/ose konsullore si dhe shkëmbimin e përfaqësive dhe përfaqësuesve diplomatikë dhe/ose konsullorë. Atë Shqipëria e 1912, as edhe ajo gjysmës së parë të 1913, nuk e kishte siguruar. Por, kishte fituar sidoqoftë një formë sui generis të njohjes de facto, e cila është njohje e përciptë, e pjesshme, jo e plotë dhe jo e përhershme, që synon të përballojë dhe eventualisht të zgjidhë çështje të karakterit emergjent që shfaqen ndërmjet të dyja palëve.

Fuqitë e Mëdha të kohës hynë në marrëdhënie të shumta, të paformalizuara në një akt të shkruar e të firmosur, me qeverinë e Vlorës dhe strukturat e tjera të saj, përfshirë vetë kryeministrin Ismail Qemali. Nuk e deklaruan shprehimisht njohjen për arsye të ndryshme si p.sh. kontradiktat ndërmjet tyre, interesat gjeostrategjike, politike,

ekonomike, ushtarake, simpatitë dhe antipatitë ndaj fqinjëve të Shqipërisë etj. Por nuk mund të vihet në dyshim ekzistenca dhe zhvillimi “normal” i marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera.

Një ndër veprimet ishte fjala vjen telegrami i konsullit austro-hungarez në Vlorë, Lejhanec, i 22 dhjetorit 1912, dërguar eprorëve në Ministrinë e Punëve të Jashtme ku bën me dije takimin me kryetarin dhe anëtarët e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe transmeton falënderimet e tyre për mbështetjen austro-hungareze.⁴⁴ Po ashtu telegrami i ministrit të Jashtëm austro-hungarez, Berchtolhd, drejtuar nënkonsullit austriak në Durrës dhe ambasadorit Merey në Romë ku jepen udhëzime për bashkëpunimin e Vjenës dhe Romës për mbështetjen e qeverisë së Vlorës⁴⁵.

Në gazetën e Romës, *Tribuna*, të datës 11 dhjetor 1912, me titull “*Shqipëria neutrale me garancinë e fuqive*” gjenden elemente, të cilët përforcojnë mendimin e lartpërmendur që politika e Fuqive të Mëdha ndaj shtetit shqiptar, mbështetej në njohjen *de facto*. Aty lexohet, ndër të tjera se “Qeveria e përkohshme e themeluar në Shqipëri ia bëri të ditur zyrtarisht Europës faktin e kryer duke ua vënë në dukje fuqive se një Shqipëri autonome apo e pavarur mund të bëhet një element ekuilibri në Ballkan. Njëherësh ka shprehur shpresën që Europa ta presë këtë fakt me dashamirësi dhe ta mbrojë shtetin e ri të krijuar kundër sulmeve të mundshme apo kërcënimeve dhe përpjekjeve për ta copëtuar.”⁴⁶ Më tej qartësohet synimi për të shkuar drejt njohjes, kur shkruhet se “Qeveria italiane dhe ajo austriake... i kanë pritur dëshirat e shqiptarëve në mënyre të favorshme... dy qeveritë arritën të vendosnin se garancia më e mirë në këtë drejtim mund të gjendej në neutralitetin e Shqipërisë, të zbatuar sipas shembujve ekzistuese të shteteve të tjera të neutralizuara në Europë... neutraliteti i Shqipërisë të vendoset mundësisht nën garancinë e gjithë fuqive të mëdha... zgjidhja e çështjes shqiptare e paraqitur prej tyre ka për ne avantazhet e mëdha vijuese: 1. Na siguron kundër çdo pushtimi të Vlorës ose të porteve të rëndësishme shqiptare nga ana e një fuqie apo e një shteti detar apo i një të tilli... që vetë ose nëpërmjet një kombinimi të çfarëdoshëm mund të sjellë një element turbullimi në ekuilibrin e Adriatikut... Vlora dhe portet e tjera shqiptare që sundojnë kanalën e Otrantos”, kanë rëndësi të madhe për ne. 2. “Neutraliteti i Shqipërisë vendos një kusht barazie të plotë midis

⁴⁴ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912), vëllimi VII*, përgatitur nga Marenglen Verli, Ledia Dushku, Botimet Albanologjike, Tiranë 2014, f.

⁴⁵ Po aty, f. 38-39.

⁴⁶ Po aty, f. 45.

nesh dhe Austrisë në atë territor, i cili do të qëndrojë kështu i hapur për garën ekonomike e tregtare të të dy vendeve dhe për ndikimet e qytërimeve të tyre përkatëse... 3. Një avantazh i fundit, por jo më i vogël, duhet parë nga fakti se Shqipëria përveç se e neutralizuar, do ta ketë neutralitet të saj nën garancinë e të gjitha fuqive... garancia që Europa e bashkuar do t'i japë asnjësisë së Shqipërisë do të sillte si pasojë që ne të shpëtojmë nga çdo shqetësim, në këtë drejtim".⁴⁷

Për të folur pa rezerva për ekzistencën e njohjes qoftë edhe asaj *de facto* ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera do të duhet që të ishin ndërmarrë disa procedura administrative e diplomatike dhe të ishin përmbushur disa formalitete. Nuk rezulton që ato të jenë kryer. Por doktrina dhe praktika e të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare, pranon që vendosja e marrëdhënieve ndërmjet palëve të tyre, realizohet nëpërmjet disa formave, me shkrim, me gojë dhe me veprime konkludente, me veprime direkte, të shprehura, në heshtje ose të nënkuptuara. Fuqitë europiane në atë kohë në marrëdhëniet me Shqipërinë, proceduan nëpërmjet njohjes *de facto*, të nënkuptuar, të akorduar në heshtje dhe me veprime konkludente. U ndërmor si hap i ndërmjetëm nga nevoja e njohjes në thellësi e gjerësi të realiteteve shqiptare. E "vërtetojnë" një varg veprimtarish, si takime, vizita, biseda, si dhe një korrespondencë voluminoze dhe intensive ndërmjet konsullatave të huaja në Vlorë dhe organeve të shtetit shqiptar ku janë trajtuar çështje të rëndësishme si ato që kanë të bëjnë me statusin e ardhshëm të Shqipërisë, posaçërisht propozimi për ta ngarkuar pavarësinë e saj me neutralitetin dhe kapitulationet.⁴⁸

Kjo formë e njohjes *de facto* u përdor e diktuar nga disa rrethana të cilat duhet t'i përballonin të dyja palët. Fuqitë e Mëdha dhe vendet fqinje kishin çështje të ndryshme për të trajtuar dhe zgjidhur me Qeverinë e Përkohshme të Vlorës dhe autoritetet e tjera shtetërore që vepronin në territorin e shtetit shqiptar. Të tilla ishin domosdoshmëria për t'u kujdesur dhe për të mbrojtur interesat e shtetit ose të shtetasve të tyre

⁴⁷ Po aty, f. 46 - 47.

⁴⁸ Për synim e Vjenës për ta parë Shqipërinë shtet të pavarur, dëshmon ndër të tjera edhe telegrami i 23 dhjetorit 1912, i ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, kontit Berchtold, për ambasadorin e vet në Itali, Meréy, ku ndër të tjera thuhet se ... Ndaj ambasadorit italian, unë mbrojta pikëpamjen time, të ditur dhe prej Shkëlqesisë Suaj. Megjithëse, *pavarësia absolute e Shqipërisë m'u duk e dëshirueshme për arsye të ndryshme, prapëseprapë unë mund të pajtohesha së fundmi edhe me një autonomi të plotë të krijesës së re shtetërore*. AIH, Vj. 22-10-1010, Po aty, f. 97, 103, 104.

që eventualisht ndodheshin në Shqipëri, për të gjetur zgjidhje të shpejta, praktike të problemeve që mund të kishin lindur etj.

Ato ishin përfshirë gjithashtu në një proces, i cili nuk mund të kishte vijim normal drejt njohjes *de jure*, pa krijuar bindjen për kapacitetet e duhura politike, juridike, ekonomike, sociale etj. të shtetit shqiptar, për garancitë që ekzistonin nëse ai do të ishte në gjendje të ekzistonte ose jo duke respektuar parimet dhe normat themelore të së drejtës ndërkombëtare etj. Vetëm duke vepruar në kushtet e njohjes *de facto*, ato do të kishin garancinë e nevojshme juridike për të sqaruar dhe qartësuar dyshimet që mund të kishin rreth qëndrueshmërisë së shtetit, aftësive dhe mundësive të tij për përballimin e përgjegjësive juridiko-ndërkombëtare dhe disponimit të elementëve të domosdoshëm për të vepruar si shtet i mirëfilltë.

Ka edhe një motiv tjetër që i shtohet pikëpamjes së ekzistencës së njohjes *de facto*. Përfaqësuesit konsullorë që vepronin në Vlorë mund të vepronin normalisht vetëm nëse do të kishin mbrojtjen e posaçme, të domosdoshme për kryerjen normale të funksioneve të tyre konsullore. Kjo mbrojtje, sipas normave të së drejtës ndërkombëtare të asaj kohe, sigurohej nëpërmjet akordimit të privilegjeve dhe imuniteteve konsullore, të cilat garantohen nga autoritetet kompetente të shtetit, në territorin e të cilit konsujt ndodhen dhe veprojnë. Ata ndodheshin dhe vepronin në territorin e shtetit shqiptar, në krye të të cilit ishin organet e tij, Kuvendi, Senati, Qeveria e Përkohshme, policia, xhandarmëria, prokuroria, gjykatat etj. Kuptohet se në rast se do të kërkohej kjo mbrojtje nga ndonjë prej përfaqësuesve konsullorë që ndodheshin dhe vepronin në Shqipëri, ajo do t'iu jepej vetëm nga organet shqiptare. Nuk mund të imagjinohet që ata do të prisnin që të mbroheshin nga organet e Perandorisë Osmane ku ishin akredituar.

Të gjitha këto në një interpretim të përgjithshëm të çojnë në konkluzionin se shteti shqiptar i 1912-ës kishte një lloj njohje *de facto* nga disa prej shteteve të tjera.

Vendimi i 17 dhjetorit 1912

Pavarësisht se Fuqitë e Mëdha nuk i kthyen përgjigje zyrtare I. Qemalit, çështjen shqiptare në tërësinë e vet, zhvillimet që e shoqëruan dhe skenarët që mund të vërtetoheshin në gadishullin ballkanik, ato i trajtuan posaçërisht në një nga forumet më të rëndësishme diplomatike

të Fuqive të Mëdha, në Konferencën e Londrës, 1912-1913. Nën kryesinë e Edward Grey-t, ministrit të Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, ajo bashkoi ambasadorët e Fuqive të Mëdha që ishin akredituar në Londër, për të diskutuar rreth zhvillimeve në luftërat turko-ballkanike, nën këndvështrimin e interesave rajonale të Fuqive të Mëdha, nënshkruese të Traktatit të Berlinit të vitit 1878.⁴⁹

Pol Kambon (Paul Cambon), ambasadori i Francës, një ndër pjesëmarrësit e Konferencës, qëllimin dhe misionin e saj e shpjegon në këtë mënyrë: “pas marrëveshjes së paqes ndërmjet Turqisë dhe Italisë, lindi nevoja që të zgjidhet kontradikta midis katër fuqive ndërluftuese, Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Bullgarisë dhe Turqisë, si ish-perandori, dhe e tërë kjo iu besua trupit diplomatik në Londër, dhe kjo mblehje filloi më datën 16 (në fakt në 17) dhjetor 1912”.⁵⁰

Prandaj edhe përpjekjet e qeverisë shqiptare u fokusuan te Konferenca e Londrës. Punimet e saj u vlerësuan me seriozitetin e merituar dhe u ndoqën me vëmendje. Madje I.Qemali donte të shkonte në Londër në gjysmën e dytë të dhjetorit në krye të një delegacioni zyrtar. Grekët, që e mbanin të bllokuar bregdetin, nuk e lejuan të dilte, çka e detyroi ta formonte me shqiptarë jashtë atdheut, Rasih Dino, kryetar, Mehmet bej Konica dhe Filip Noga.⁵¹ Më 2 janar 1913 delegacioni i dorëzoi Edward Grey-t, Kryetarit të Konferencës, memorandumun e Qeverisë Shqiptare, i cili i kushtohej kryesisht njohjes së shtetit të pavarur dhe çështjes së

⁴⁹ Përfaqësuesi i Austro-Hungarisë në atë takim ishte ambasadori i saj në Londër, konti Mensdorf Pouilly – Dietrichstein, të cilit iu atashuan si ekspertë të dërguarit për Mbretërinë në Cetinë, baron von Giesl dhe shefi i seksionit Theodor Ippen, ish kryekonsull vite me radhë në Shkodër dhe albanolog i shquar.

⁵⁰ Cambon Paul, - *Correspondance, 1870-1924*, (3 tomes en 2 volumes); 1940-1946, tome 3: (1912-1924), les guerres balkaniques, la Grande Guerre, l'Organisation de la Paix, ed. Bernard Grasset, Paris, 1946, p. 31. Lidhur me modalitetet dhe procedurat, të cilat flasin doemos edhe për rezultatet që pati, kryetari i Konferencës Lordi Eduard Grey shprehet: “Ne ishim gjashtë: Lichnowsky, Mensdorff dhe Imperiali, respektivisht ambasadorët e Gjermanisë, Austrisë dhe Italisë; Cambon dhe Benckendorff, ambasadorët e Francës dhe të Rusisë, dhe unë për Britaninë e Madhe. Më takoi përgjegjësia e drejtimit, por ne vendosëm t'i thjeshtonim procedurat dhe të bënim një komitet miqsh, ashtu siç edhe ishim. Ne mblidheshim pasditeve, zakonisht rreth orës 4 dhe diskutonim deri rreth orës gjashtë ose shtatë me një pushim të vogël çaji. Konferenca vazhdoi deri në gusht 1913, por ne mblidheshim vetëm kur e kërkonin rrethanat dhe, raportet e miqësisë që ne kishim, nuk i penguan debatet të vazhdonin të papërcaktuara në mënyrën më të bezdisshme...” Edward Grey; D' Honfroy, *Memoires de Edward Grey, vicomte De Fallodon, ministre des affaires etrangeres de Grande-Bretagne*, Paris: Payot, 1927, p. 248.

⁵¹ Nuri Dragoj, *Delegacioni shqiptar në Londër*, Gazeta Metropol, 2 gusht 2013.

caktimit të kufijve. Në Memorandum vihej në dukje se kombi shqiptar ka dhënë prova të mjaftueshme për konceptet politike dhe interesin kombëtar. Theksohej se “Populli shqiptar është i bindur që, në rregullimin e konfliktit të sotëm, Fuqitë e Mëdha nuk do të lënë pas dore shqyrtimin e pikave të ngritura në këtë Memorandum dhe nuk do të jenë aspak të pavëmendshëm kundrejt kërkesave të drejta të një kombi të denjë për një fat më të mirë...”⁵² Theksohej gjithashtu se paqësimi i plotë i gadishullit (ballkanik) as që mund të merrej me mend po qe se kufijtë e caktuar për çdo entitet politik nuk do të frymëzoheshin nga caqet gjeografike dhe etnografike të çdo shteti. Të vihen nën një zgjedhë të huaj tokat në të cilat popullsia shqiptare përbën shumicën, do të thotë që të përjetësohet fara e grindjes dhe e trazirave... paqja dhe qetësia e gadishullit do të sigurohen vetëm në qoftë se do t’i jepet Shqipërisë së ardhshme një konfiguracion homogjen. Duke u nisur nga kjo, populli shqiptar kërkon për vendin e vet, kufijtë që janë të natyrshëm dhe që imponohen si nga kushtet etnike, ashtu edhe nga e drejta e tij si banues i parë..⁵³

Memorandumi i 2 janarit 1913 u plotësua nga një i dytë, i datës 25 janar 1913, ku kërkohej, zbatimi i kriterit etnik për caktimin e kufijve, si kusht për sigurimin e paqes dhe të stabilitetit në Ballkan. Në formulimin e kërkesave të dy memorandumeve, rëndësi të veçantë ka pasur “*tradita*” e 4 vilajeteve shqiptare, që kish qenë motiv i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare,⁵⁴ d.m.th përfshirja në territorin e shtetit e popullsisë shqiptare që banonte në 4 vilajetet europiane të Perandorisë Osmane.

Delegacioni në Londër ndiqte me vëmendje punimet e Konferencës dhe përpiqej të ndikonte për mbrojtjen e interesave të vendit. Në njoftimin e 23 dhjetorit 1912, të konsullit austro-hungarez në Vlorë, Lejhanec, thuhet se “dje telegrafoi këtu prej Parisi, Rasih bej Dino. Ai

⁵² Arkivi Qendror Shtetëror (AQSH), Tiranë; Fondi Kuvendi Kombëtar i Vlorës, Qeveria e Përkohshme e Vlorës. Tiranë, fondi 245, viti 1913, dosja 11-19, fleta 34, si dhe AQSH-RPSSH, Fondi: Kryesia e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Vepriaria diplomatike, Dosje 19. Kopje frëngjisht. Citohet nga “Ismail Qemali, përmbledhje dokumentesh (1888-1919)”, Botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të shtetit, Tiranë, 1982, f. 284.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Sipas Prof. Dr. Vebi Xhemali, - Konferenca e Londrës më 17 dhjetor 1912 e njohu shqipërinë etnike por pas tre muajsh më 22 mars 1913 ambasadorët sollën vendim të ri për copëtimin Shqipërisë në pjesë: Sovrane dhe e robruar/ Dielli online November.

bëri me dije se ministri i Jashtëm i Francës paskësh deklaruar se Shqipërisë do t'i akordohej një administratë autonome nën suzerenitetin e sulltanit dhe kontrollin e Fuqive të Mëdha. Kufijve të Shqipërisë do t'ju bëka një ratifikim.”⁵⁵ Më tej ai thotë se delegacioni do të mbronte “kufijtë që vijojnë: Kufiri aktual përkarshi Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë, duke filluar prej Mecovës (në jug) me përfshirjen brenda të qyteve Pejë, Mitrovicë, Prishtinë dhe po të jetë e mundur edhe Shkupin, Manastirin dhe Janinën. Ambasadorët ishin marrë vesh që ditën e parë të punimeve të Konferencës ta nisnin me çështjen shqiptare. Në fjalën e vet “ambasadori austriak deklaroi se pikëpamja e qeverisë së tij ishte që Shqipëria duhet të bëhet autonome dhe “e aftë për të jetuar”, d.m.th. që të jetë aq e madhe, sa të mund të ketë ekzistencë më vete.”⁵⁶ “Ambasadori rus shtoi se Shqipëria autonome duhet të jetë e garantuar dhe e kontrolluar *vetëm* nga gjashtë Fuqitë nën sovranitetin e Sulltanit... Pastaj, thotë Grey, u morëm vesh që Shqipëria autonome duhet të bëhet asnjëherë.”⁵⁷ Për çështjen e kufijve Austria theksoi “se asnjë territor i banuar vetëm nga shqiptarët nuk duhej të shkëputej prej Shqipërisë së ardhshme dhe këmbënguli që territori i quajtur shqiptar në veri binte patjetër brenda kësaj kategorie.”⁵⁸

Së këtejmi del se Konferenca do të merrej me dy çështje kryesore që kishin të bënin me Shqipërinë, me të ardhmen politike, të shtruar në formën e alternativës nëse do të mbetej nën Perandorinë Otomane apo do të dilte më vete dhe me çështjen e kufijve. Ajo i trajtoi ato në funksion të zhvillimeve të pritshme të Perandorisë Otomane. Në alternativën e rënies së saj mund të pranohej krijimi i një Shqipërie autonome ose të pavarur. Nëse zhvillimet do të ecnin drejt ruajtjes së *status quos*, atëherë mund të pranohej krijimi i një Shqipërie autonome, nën suzerenitetin e Sulltanit.⁵⁹ Në fillimet e punimeve, kur situatat ishin të paqarta, Konfe-

⁵⁵ Telegram i konsullit austro-hungarez Lejhanec, nga Vlora për ministrin e jashtëm, Leopold Berchtold, i 23 dhjetorit 1912, të konsullit austro-hungarez në Vlorë, Lejhanec, dërguar eprorëve në Ministrinë e Punëve të Jashtme - Arkivi i Institutit të Historisë Tiranë (AIHT), Vj. 22-9-972.

⁵⁶ *AQSH-RPSSH, Fondi: Kryesia e Qeverisë së Përkohshme, të Vlorës. Veprimtaria diplomatike, Dosje 19. Kopje frëngjisht.* Citohet nga “*Ismail Qemali, përmbledhje dokumentesh (1888-1919)*”, *Botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të shtetit, Tiranë, 1982*, f. 165.

⁵⁷ Po aty, f. 165.

⁵⁸ Po aty, f. 165-166.

⁵⁹ Kjo duket p.sh. edhe nga një telegram i ambasadorit francez në Stamboll, drejtuar kryeministrit të vet Puankarë (Poincare), më 15 gusht 1912. Ai i thotë se diplomacia ruse “përpiqet të mos dobësojë autoritetin e Turqisë ndaj Shqipërisë”,

renca mendoi të konservonte një farë *status quo*-je bashkë me rivendosjen e ekuilibrave strategjikë rajonalë dhe europiane, sipas koncepteve të së drejtës dhe doktrinës ndërkombëtare të kohës. Ishte kjo arsyeja pse në vendimin e parë lidhur me këtë çështje ajo miratoi njohjen e “autonomisë së Shqipërisë”, që, në vështrimin juridiko-ndërkombëtar, ishte pranimi i krijimit të një shteti vasal nën suzerenitetin e Sulltanit. Pol Kamboni (Paul Cambon), ambasadori i Francës, në procesverbalin e 17 dhjetorit 1912, të mbajtur prej tij, shkruan se “ne u morëm vesh për formulën e mëposhtme: “Autonomi e garantuar dhe e kontrolluar ekskluzivisht nga gjashtë Fuqitë nën sovranitetin ose suzerenitetin e Sulltanit.” Kamboni shton më poshtë: “Pastaj ne miratuam këtë vërejtje: Shqipëria autonome do të jetë e neutralizuar.”⁶⁰ Në vështrimin juridiko-ndërkombëtar kjo do të thoshte se Perandoria, shteti suzeren do ta përfaqësonte Shqipërinë krejtësisht ose për çështjet më kryesore në marrëdhëniet ndërkombëtare. Për rrjedhojë ky vendim nuk flet për njohje ndërkombëtare, sepse ajo u akordohet vetëm shteteve sovrane. Përfaqësuesit e 6 Fuqive e injoruan aktin e rëndësishëm juridiko-konstitucional, vendimin e 28 Nëntorit 1912, që themeloi një subjekt të ri të së drejtës ndërkombëtare. Konferenca nuk e pranoi Shqipërinë si të tillë. Bënte fjalë vetëm për njohje të disa të drejtave të popullsisë shqiptare, për një organizim të veçantë, por brenda kuadrit të Perandorisë Osomane. Shqipëria do të kishte statusin e një shteti vasal nën suzerenitetin e Turqisë, e cila do të ushtronte atributet e shtetit suzeren, por vasaliteti i saj do të garantohej dhe do të kontrollohej ekskluzivisht nga gjashtë Fuqitë e Mëdha. Kompetencat e Sulltanit kufizoheshin nga garantimi i neutralitetit të Shqipërisë prej Fuqive të Mëdha. Këtë status të projektuar është vështirë ta klasifikosh sipas skemave klasike të së drejtës ndërkombëtare. Shqipëria do të kishte varësi dhe kontroll të dyfishtë, atë të Turqisë me cilësinë e shtetit suzeren, që i takonte juridikisht sipas nocionit të

ndërsa diplomacia austro-hungareze “ka për qëllim vendosjen në këtë rajon të një regjimi nëse jo autonom, së paku të dalluar nga regjimi i pjesës tjetër të Perandorisë. Është e qartë që në Vjenë synohet krijimi i një entiteti shqiptar në gjirin e të cilit Austria llogarit të ushtrojë një ndikim mbisundues që do ta përdorte për të ndalur shtrirjen sllave në Ballkan”.- Archives du Ministère des Affaires Etrangères (AMAE), Turquie, Guerres Balkaniques, IV, Vol.232,1-20 aout 1912, Prof. Dr. Muhamet Shatri, - *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912, Vëll. II*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Botimet Toena, Tiranë 2012, f.117-118, 123, 124, 132,137.

⁶⁰ Sipas A.Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit*, Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik, Vëll.II, (1912-1918), Tiranë,1987,f. 187-188.

kësaj forme të varësisë juridiko-ndërkombëtare dhe njëkohësisht garancinë dhe madje kontrollin ekskluziv të Fuqive të Mëdha, që ato e kishin mbajtur për vete. Formalisht ky do të ishte një lloj *kondominiumi* ndërkombëtar.

Cili ishte shkak i këtij qëndrimi ambig? Fuqitë e Mëdha ishin të bindura se “bishtrat” ballkanikë të Perandorisë Osmane nuk mund dhe nuk duhet të vazhdonin të mbeteshin sërish në suazën e saj. Atëherë përse nuk u shprehën për shkëputjen e plotë dhe përfundimtare të Shqipërisë, sikurse ishin marrë vesh?⁶¹ Pse e “shkelën” premtimin që i kishin dhënë para pak javësh Ismail Qemalit?

Së pari, shkak ka të bëjë me zhvillimet në gjirin e Koncertit europian, ku midis anëtarëve të tij ishin shfaqur kontradikta për sa i përkiste të ardhmes së Ballkanit, Portës së Lartë dhe vetë Shqipërisë. Austro-Hungaria, sikurse edhe Italia, të cilat në jo pak raste ishin shfaqur hapur si protektorët e Shqipërisë, lëkundeshin në qëndrimet ndaj pavarësisë apo autonomisë së saj.

Së dyti, sipas prof. A. Puto, ky qëndrim lidhet me parimin e integritetit të Perandorisë Osmane, i shpallur në Kongresin e Parisit, 1856, e cila shihej prej tyre si garanci reciproke e shteteve të Europës kundër lakmive të njëra-tjetrës. Dhe ata e mbajtën Shqipërinë si strehën e fundit

⁶¹ Në një korrespondencë intensive diplomatike ndërmjet Vjenës, Berlinit, Romës dhe Londrës së paku gjatë muajve nëntor - dhjetor 1912, flitej qartë për domosdoshmërinë e krijimit të një Shqipërie autonome. P.sh. në Raportin e ambasadorit austro-hungarez Mensdorf nga Londra drejtuar Vjenës, më 8 nëntor 1912, thuhet ndër të tjera se në bisedën me Grein ishte pohuar “Që Shqipëria duhet të jetë autonome, duket se të gjithë janë në një mendje dhe asnjë nuk e kundërshton. Veçse atij (Greit) i duket se mbi përmasat e këtij territori autonom pikëpamjet mund të mos jenë të njëjta.” Në një tjetër raport të po asaj date Mensdorfi raportonte për takimin që kishte pasur me mbretin George, të cilit i kishte transmetuar idenë se “është e domosdoshme që të krijohet një *Shqipëri autonome e aftë për ekzistencë*. Unë i përmenda dendur se po të mos përfillen aspiratat e drejta të shqiptarëve, nuk do të mund të realizohet dëshira e arsyeshme e Madhërisë së Tij dhe e Sir Edward Grey-it për ta zgjidhur një herë e mirë problemin e Ballkanit, sepse po t’u jepen shteteve të tjerë toka shqiptare, për shumë vjet me radhë nuk do të pushojnë luftrat dhe kryengritjet e brendshme.”- Shih, *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi VI, Marenglen Verli, Ledia Dushku, Botimet Albanologjike, Tiranë 2012, f. 109,110. Po më 8 nëntor 1912, shefi i Ballplatzit, Berchtoldi i rikthehej kësaj çështjeje dhe sqaronte gjithë përfaqësitë e veta diplomatike në kryeqytetet e tjera, me nënvizim të veçantë për ambasadorin Thurn në Peterburg. Ai thoshte “Po të bëhet copa-copa e të zvogëlohet Shqipëria nuk mund të jetojë dhe zoti Sazanov e di se *Austro-Hungaria dhe Italia kanë interesa të mëdha për ekzistencën e Shqipërisë*.” Po aty, f.112.

të dogmës së integritetit.⁶² Me sa duket ato kanë dashur t'i jepnin Turqisë një satisfaksion formal, më tepër moral e virtual sesa juridik e real. Kjo kishte të bënte me faktin që Fuqitë e Mëdha e trajtonin atë si anëtar *sui generis* të Koncertit europian, por duke e mbajtur “prapa derës”. Vendosja e Shqipërisë nën suzerenitetin e Sulltanit, do të shërbente si një garanci relative për ruajtjen e integritetit territorial dhe një shqetësim më pak për vetë Fuqitë.

Së treti, ndikim të padyshimtë ka pasur pozicioni antishqiptar i Ruisë, protektore tradicionale të sllavëve. Qëndrimi i saj del i qartë jo vetëm në dokumentet arkivore të diplomacisë cariste, por edhe në një mori botimesh, ndër të cilat në *Kujtimet* e ministrit të Jashtëm rus të asaj kohe, Sergej Dmitrieviç Sazonov. Ai nuk ngurron të flasë për Shqipërinë dhe shqiptarët si për një vakuum që nuk ka pse të përfillen dhe të merren në konsideratë në planet e të ardhmes së Ballkanit. Edhe pse pranon se mbi gërmadhat e pushtetit turk, patjetër duhej të lihej të zhvillohej jeta e re politike e secilit prej popujve të rajonit, mbi parimet e ndarjes së qartë të të drejtave dhe interesave të tij,⁶³ e kufizon sferën e zbatimit të këtij parimi vetëm te popujt e krishterë të gadishullit. Të tjerët, përfshirë edhe shqiptarët, nuk meritonin asnjë lloj vlerësimi e respekti të të drejtave të tyre sovrane.

Për qëndrimin rus, flet edhe amerikani Albert Bushnell Hart, përmend pretendimin malazez për qytetin e Shkodrës dhe thotë se “pavarësisht nga karakteri shqiptar i padyshimtë i popullsisë së atij vendi, në qoftë se zgjidhja e këtij problemi varej vetëm nga vullneti i saj i mirë, qeveria ruse asnjëherë nuk do të kundërshtonte plotësimin e dëshirës së “mikut të vetëm të Ruisë” (Serbisë, *shënim i autorit*), që sipas kujtimeve të vjetra gëzonte atëherë popullaritet të madh në qarqet e gjera të shoqërisë ruse, por problemi qëndronte ndryshe dhe Shkodra mund t'i kalonte Malit të Zi vetëm si vlerësim i luftës së suksesshme kundër aleancës Tripalëshe, e cila këmbëngulte në krijimin e Shqipërisë së pavarur dhe të pavarur.⁶⁴

Së katërti, një faktor tjetër duhet të ketë qenë qëndrimi i Anglisë dhe i Francës, të cilat ishin në pozita pak a shumë të njëjta.

⁶² A.Puto, *Historia diplomatike e ceshtjes shqiptare, 1878-1926*, Botimet Dudaj, Tirane, 2010, f.96-97.

⁶³ Sergej Dmitrieviç Sazonov, *Kujtime*, HELGA's SECRETS, Pa vend dhe vit botimi, f.100.

⁶⁴ Albert Bushnell Hart, Europe's "Autonomous Albania" Absurd, Says Hart; *Gazeta New York Times*, 19.10.1913Po aty, f. 101.

Së pesti, nuk përjashtohet që për vendimin e mosshkëputjes së Shqipërisë nga Turqia, të ketë ndikuar edhe një lloj pasigurie për të ardhmen e Shqipërisë.

Së gjashti, janë ambiciet e pafshehura të fqinjëve për gllabërimin e territoreve të saj, për llogari të humbjes së Turqisë në Luftën turko-ballkanike. Madje disa prej tyre, përfshirë edhe një nga protektorët më të hapur të çështjes së shqiptarëve, Austro-Hungaria, e kuptonte “fare mirë se nuk mund të mos merreshin parasysht edhe ngjarjet e luftës, fitimtarët do të kërkonin plaçkën që u takonte”.⁶⁵

Së shtati, një tjetër shpjegim e jep Faik Konica, i cili pohonte se “është e qartë që, para së gjithash, Shqipëria ka të metën e madhe që është pa miq dhe pa mbrojtje dhe që ndodhet atje ku ndodhet, si një dhuratë e lehtë, e vendosur përgjatë një rruge të rëndësishme. Veç kësaj, ajo ka edhe një tjetër të metë tejet të madhe... të qenit e vogël.”⁶⁶

Së teti, Eduard Grey-i, në shkurt të vitit 1913 shkruante: “Në rast se një zgjidhje e mirë për Shqipërinë nënkuptonte luftën midis dy ose më shumë Fuqive të Mëdha dhe në rast se një zgjidhje më pak e mirë nënkuptonte paqen mes këtyre Fuqive të Mëdha, atëherë do të pëlqejë e dyta.”⁶⁷ Më qartë ai do të shprehej më vonë, kur do të thoshte: “Konferenca e Ambasadorëve nuk kishte zgjidhur ndonjë gjë, madje as hollësitë e kufijve shqiptarë, por ajo kishte shërbyer për një qëllim të dobishëm,”⁶⁸ që nënkuptonte se ajo kishte shërbyer për të shmangur luftën midis Fuqive të Mëdha.

Në vijim të arsyetimit të Grey-it dhe në kontekstin e tij, duhet mbajtur parasysht se shqiptarët kishin shpallur pavarësinë, ishte deklaruar shkëputja e katër vilajeteve shqiptare nga Perandoria Osmane duke ndërprerë edhe lidhjet zyrtare dhe siç u tha, kishin nisur organizimin politiko-shtetëror e administrativ për ngritjen e një shteti të pavarur e sovran me një territor që duhet të shtrihej nga Kosova deri në Çamëri dhe nga Durrësi deri në Shkup.⁶⁹ Ky realitet edhe pse nga disa nuk llogaritej si faktor i rëndësishëm, nuk mund të mos merrej parasysht.

⁶⁵ E. C. Helmreich. *The Diplomacy of the Balkan Wars (1912-1913)*, Cambridge, Jaw USA, 1938, p.254.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ G.M.Trevelyan, *Grey of Falodon: Being the Life of Sir Edward Grey Afterwards Viscount Grey of Falodon* (London, 1937, p.233 si dhe Grey, *Twenty-five Years*, I, f.271.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ Aleksandër Meksi *Shtatë ditët e Kuvendit të Vlorës, 28 nëntor-4 dhjetor 1912*, botuar ne *Gazeta Panorama*, e dielë, 15 Korrik, 2012.

Shteti i pavarur shqiptar, i Vlorës, i kapi në befasi fqinjët dhe fuqitë. Tashmë, kur pavarësia ishte shpallur dhe shteti po ngrihej pak nga pak, nuk rezultonte më e përligjur alternativa e vasalitetit, të cilin Fuqitë e Mëdha e gjykuan si zgjidhjen më të mirë. Për shqiptarët, edhe pse ajo ishte një ndryshim i rëndësishëm politik, sepse përfaqësonte një lloj çlirimi nga vargonjtë shekullorë të zgjedhës otomane dhe kalimin në një status tjetër, nuk ishte ajo që ata kishin dashur dhe kishin vendosur.

Vendimi i 17 dhjetorit 1912 trajtonte dhe zgjidhte në parim në një fazë tranzitore çështjen e statusit të saj politik. Duke mos u shprehur për kufijtë ai e njihte Shqipërinë si një të tërë, të pacopëtuar midis fqinjëve, siç do të ndodhte me vendimet e mëvonshme. Në njëfarë kuptimi ishte pranim i tërësisë territoriale të Shqipërisë sipas parimit etnik, pranim i përfshirjes të të gjitha tokave shqiptare brenda hapësirës së shtetit vasal shqiptar. Ky do të përbëhej nga territori dhe popullsia e katër vilajeteve osmane me popullsi të konsiderueshme etnike shqiptare dhe konkretisht e vilajeteve të Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës.

Kërkesa për anëtarësim (njohje) në Bashkimin Postar Universal

Një tjetër zhvillim sa interesant dhe po aq me rëndësi për çështjen objekt trajtimi, ishte kërkesa e qeverisë së Vlorës, për anëtarësi në organizatat ndërkombëtare të kohës. Krahas kërkesave për njohjen e shtetit dhe njohjen e saj si institucion i shtetit shqiptar, u avancua edhe kërkesa për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare.

Pranimi i një subjekti të ri në një organizatë botërore konsiderohet njohje ndërkombëtare, me pothuajse të njëjtat vlera si njohja nga shtetet. Është njohje, madje jo e thjeshtë, por kolektive, me më shumë vlerë dhe më cilësore. Sepse e fiton njohjen ndërkombëtare në të njëjtën kohë nga më shumë se një shtet.

Ishte kjo arsyeja përse më 7 korrik 1913, Shqipëria, nëpërmjet ministrit të fushës, Lef Nosit, paraqiti kërkesë për anëtarësim në Bashkimin Postar Universal (UPU).⁷⁰ Kërkesa nuk u mor në konsideratë dhe Shqipëria do të bëhej anëtare e UPU vetëm në vitin 1922.⁷¹

⁷⁰ Postal service in Albania. www.postashqiptare.al. Albania.

⁷¹ Albania. Universal Postal Union. Date of entry into the UPU:01-03-1922

Shqipëria, subjekt i së drejtës ndërkombëtare, prej 28 nëntorit 1912

Njohja, e vendosur në kontekstin përkatës kohor, kishte për shtetin shqiptar rëndësinë e vet të padiskutueshme. Por nuk mund të thuhet se ajo do ta themelonte Shqipërinë si subjekt, sikurse është pretenduar nga një numër historianësh apo autorësh të së drejtës ndërkombëtare, përkrahës të *teorisë konstitutive*⁷² të njohjes. Kjo teori mbron pikëpamjen se akti i krijimit të një shteti është njohja ndërkombëtare, prandaj dhe ishte mbizotëruese në kohët e shkuara, kur “Të mëdhenjtë” bënin ligjin në botë.

Vendin e teorisë konstitutive e ka zënë prej kohësh *teoria deklarative*,⁷³ që thotë se shteti ekziston realisht që nga çasti i themelimit në një nga format e parashikuara nga e drejta ndërkombëtare, pavarësisht nëse njihet ose jo prej shteteve të tjera. Njohja ndërkombëtare vetëm e konstaton, e deklaron faktin e lindjes dhe i jep mundësi shtetit që të drejtat inherente që ka, t’i ushtrojë efektivisht. Njohja, si akt juridik bazohet te një situatë që ekziston, të cilën nuk e krijon njohja. Shumica e studiuesve e konsiderojnë atë si manifestim të vullnetit të një subjekti të së drejtës ndërkombëtare, përmes të cilës, ai mban shënime për të dhe shpreh qëllimin për ta pasur në konsideratë.

Çasti dhe akti i themelimit të shtetit, për interesa të caktuara politike ngatërrohen ndonjëherë me atë të njohjes ndërkombëtare, zakonisht në favor të njohjes. Kjo ka ndodhur me Shqipërinë, e cila ekzistonte prej kohësh si një realitet i pakontestueshëm gjeografik, kombëtar, kulturor, social etj. Popullsia e saj, teorikisht dhe juridikisht, pjesë e popullsisë së shtetit osman, si gjithë popujt e tjerë, luftonte për t’u shkëputur nga Perandoria, për të dalë si shtet i pavarur.

Dokumentacioni autentik, ku pasqyrohet gjithçka ndodhi në Shqipëri, në 28 nëntor 1912 dhe në ditët në vijim, si dhe vetë produkti i vendimit të Vlorës së asaj dite, dëshmojnë se Shqipëria e pavarur u shpall në Vlorë, të huajt, diplomacia e Fuqive të Mëdha, vetëm e njohën dhe iu ofruan mbështetje në përshtatje me qëllimet e veta. Shqipëria ishte subjekt i krijuar normalisht nga “vetvetja” dhe jo nga njohja që do t’i vinte prej shteteve të tjerë. Ajo kishte territorin, popullsinë dhe qeverinë e vet. Fakti që territorin nuk e administronte tërësisht, për shkak të pushtimeve të huaja, krijonte vështirësi, por nuk e asgjësonte shtetin e

⁷² Martin Dixon, *E drejta ndërkombëtare*, AiiS, Tirana Times, 2011 f. 212.

⁷³ Martin Dixon, *E drejta ndërkombëtare*, AiiS, Tirana Times, 2011 f. 212.

brishtë shqiptar. Ai punonte intensivisht për krijimin e organeve qeveritare, institucioneve gjyqësore e policore, ngritjen e ushtrisë, sanksionimin e gjuhës shqipe si gjuha zyrtare, fillimin e çeljes së shkollave, nxjerrjen e Fletores zyrtare, e gazetës *Përlindja e Shqypnies*, si organ i Qeverisë së Vlorës etj.⁷⁴ “Është e natyrshme, thotë prof. K. Frashëri, që çdo shtet kombëtar lind me dhimbje, sidomos kur ka jetuar nën zgjedhë të huaj për qindra vjet.”⁷⁵ Kështu ndodhi edhe me shtetin shqiptar.

Gjithë këto zhvillime, të para një shekulli e ca, të vlerësuara sipas koncepteve të së drejtës ndërkombëtare shërbejnë si “lëndë e parë” për të pranuar pa mundim posedimin e shtetshmërisë – *satehood* të shtetit shqiptar të themeluar nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës. Këtij pohimi “vulën” ia ve një ndër ndërkombëtaristët më të mëdhenj të kohës, Ian Brownlie. Ai thotë “që nëse një entitet ka organet e veta ekzekutive dhe organet e tjera, i zhvillon marrëdhëniet e tij të jashtme nëpërmjet këtyre organeve, ka sistemin e vet të gjykatave dhe sistemin e vet ligjor dhe, çka është veçanërisht e rëndësishme, ka një të drejtë kombësie të vetën, atëherë ai jep dëshminë e parë të shtetshmërisë.”⁷⁶ Këto i kishte Shqipëria e asaj kohe, e cila po përpiquej me vështirësi të ngrinte shtetin e vet, sipas përcaktimit të Francis Fukuyama, që thotë se “ndërtimi i shtetit është krijimi i institucioneve të reja qeverisëse dhe fuqizimi i atyre ekzistuese”⁷⁷.

Nga parashtrimi i mësipërm, mbështetur në mënyrë strikte në kuadrin juridik dhe posaçërisht në atë juridiko-ndërkombëtar, mund të konkludohet se shteti shqiptar i pati fillesat e veta te vendimi historik i 28 nëntorit 1912 dhe mbështetjen e disa prej Fuqive të Mëdha. Atë e ndihmoi për konsolidimin dhe afirmimin ndërkombëtar edhe njohja ndërkombëtare, të cilën fillimisht e pati në formën e njohjes *de facto* dhe prej 29 korrikut 1913 edhe në atë *de jure*.

Vendimi i 29 korrikut 1913 – njohja *de jure* e Shqipërisë

Siç u tha, Shqipërinë, njohja *de jure* nga subjektet e tjerë të së drejtës ndërkombëtare i duhej Shqipërisë si *conditio sine quibus non* për

⁷⁴ *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28 nëntor 1912-22 janar 1914)*, Tiranë 1963, d. nr 343, f. 255, 270.

⁷⁵ K. Frashëri, *Identiteti kombëtar shqiptar në ditët tona*, në *Gazeta Shqiptare*, 7 shtator 2006

⁷⁶ Ian Brownlie, *Brownlie's Principles of Public International Law* (9th edn), James Crawford, Oxford University Press 2019 f. 148.

⁷⁷ Francis Fukuyama, *Ndërtimi i shtetit-Qeverisja dhe rendi botëror në shekullin njëzetë e një*, AiiS, Tiranë, 2008, f.17.

ekzistencën e mëtejshme. Ajo do t'i jepte mundësinë që të dilte si palë në marrëdhëniet me shtetet e tjera, për të zënë vendin e vet në komunitetin botëror. Që Shqipëria do ta merrte njohjen *de jure*, kjo dallohej pa vështirësi. Problemi i ndërlikuar nga vështirësitë e caktimit të kufijve me fqinjët u zvarrit rreth tetë muaj dhe iu akordua vetëm më 29 korrikut 1913, me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve. Nëpërmjet tij u abrogua vendimi i 17 dhjetorit 1912, u anulua statusi i vasalitetit osman mbi Shqipërinë dhe u sanksionua njohja e shtetit të pavarur shqiptar. Pavarësia impononte detyrimisht edhe sanksionimin e kufijve, që u bë me vendimet e 22 marsit dhe 11 gushtit 1913.

Në një gjykim të përgjithshëm për diskutimet dhe vendimet që u morën në Londër, mund të thuhet se protagonistët e diplomacisë europiane, në njëfarë kuptimi e zhbënë Shqipërinë e shqiptarëve. Ata e përdorën për disa muaj Qeverinë e Përkohshme të Vlorës, përfaqësuesen autentike të vlerave, kontributeve dhe të ardhmes së shqiptarëve, pastaj e injoruan dhe e rrëzuan. Siç shprehet me të drejtë prof. Gugenheim, Fuqitë e Mëdha e bënë duke ushtruar një pushtet të uzurpuar, ilegjitim, sepse përfaqësimi permanent i interesave europiane që i kishin dhënë vetes pa të drejtë, i kundërvihej parimit të barazisë së shteteve.⁷⁸ Në këtë mënyrë iu kaluan fqinjëve territore shqiptare pothuajse sa një Shqipëri tjetër.

Më konkretisht se çfarë ndodhi në atë kohë, copëtimin e trojeve shqiptare dhe shpërndarjen e tyre te fqinjët, e jep amerikani Edwin Jacques, i cili shkruan se “Pas muaj debatesh e kompromisesh, në mars 1913, të gjashtë ambasadorët dhanë një zgjidhje të palogjikshme. Në bazë të saj, krahinat veriore të Hotit, Grudës dhe një pjesë e madhe e “Kelmendit” u shkëputën nga grupi i pesë bajrakëve, ku bënin pjesë edhe aleatët e tyre Kastrati e Shkreli dhe së bashku me Plavën e Gucinë iu dhanë Malit të Zi. Në verilindje, Serbisë i dhanë të gjithë vilajetin e Kosovës, ku përfshiheshin Shkupi, Peja, Gjakova dhe Prizreni,- qytetet aq të shenjta për Rilindjen Kombëtare, të populluar nga një milion shqiptarë dhe nga fare pak sllavë.... Gjithashtu edhe krahinat shqiptare lindore të Dibrës, Ohrit e Manastirit i kaluan Serbisë. Në jug, grekët ngulën këmbë që popullsia e “Vorioepirit”, me që kishte besim ortodoks grek, ishte rrjedhimisht me kombësi greke..... Më 11 gusht 1913, u arrit një zgjidhje kompromisi. Greqisë i dhanë një pjesë të madhe të

⁷⁸ Paul Gugenheim, *Traité de Droit International public*, Tome I, 1953, Librairie de l'Université, Georg & Cie S.A. Genève, f. 245-246.

Shqipërisë Jugore ku përfshihej krahina e Çamërisë, e populluar kryesisht nga myslimanë shqiptarë, si dhe vetë Janina, kryeqyteti tradicional i Shqipërisë së Jugut.”⁷⁹

Diplomacia europiane përmes vendimit të 29 korrikut 1913 të Konferencës së Londrës, iu dha shqiptarëve njohjen *de jure*, por në shkëmbim të saj, me vendimet e 22 marsit dhe 11 gushtit 1913, iu mori rreth gjysmën e territoreve, për t’ua dhënë grekëve, serbëve dhe malazezëve. Ajo e privoi Shqipërinë nga “tokat më të mira që kishte, fushat më të bukura, qendrat më të rëndësishme dhe i janë shkëputur dy të tretat e popullsisë. Tokat pjellore të Janinës dhe Prevezës, kullat e famshme të Çamërisë iu dhanë Greqisë...”⁸⁰.

Diplomacia e Fuqive të Mëdha ua imponoi shqiptarëve një rregullim shtetëror ndërkombëtar të realizuar nëpërmjet Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, i cili përgatiti dhe miratoi në Vlorë, më 10 prill 1914, Statutin Organik të Shqipërisë. Në fillim të marsit 1914 mbërriti në Durrës princi gjerman Vilhelm Vidi (Wilhelm Wied), i caktuar nga Fuqitë e Mëdha në fronin e Shqipërisë.⁸¹ Në mesin e marsit formoi qeverinë, me kryeministër Turhan Pashën,⁸² e cila ishte e para qeveri shqiptare që u njoh nga Fuqitë e Mëdha, që vendosën me të marrëdhënie diplomatike, akredituan dhe dërguan përfaqësuesit e tyre në Durrës. Të njëjtën gjë bënë edhe fqinjët: Rumania, Greqia dhe Serbia.

Qëndrimet nihiliste

Historinë tragjike të popullit shqiptar, që meriton mirënjohje e vlerësim për kontributet ndaj paqes europiane dhe stabilitetit rajonal, një pjesë politikanësh e studiuesish të huaj kanë dashur ta përdhosin edhe më tej. *Së pari*, janë munduar të përlegjin gjithçka që u kanë bërë shqiptarëve nën falsifikimin se ata, përveç se janë të egër e barbarë, nuk kanë aftësi politike, organizative dhe shtetformuese. *Së dyti*, mashtrojnë duke thënë se shtetin ua krijoi dhe ua dhuroi diplomacia e Fuqive të Mëdha. Këto pikëpamje gjenden rëndom në një pjesë të propagandës

⁷⁹ Edwin Jacques, *Shqiptarët, Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Albania, Tiranë 2000, f. 374-375.

⁸⁰ Mithat Frashëri, *Shqiptarë dhe sllavë*, botuar në frëngjisht në Lozanë (Zvicër) më 1919 dhe në shqip në Tiranë 1997, f. 61.

⁸¹ *Memorandum përmbi Shqypnië, Prej Wilhelmi, Mbret i Shypëniës Princ Wied*, përg. Hasan Bello, Arbëria, Tiranë, 2008

⁸² Po aty.

politike dhe të literaturës së huaj historiografike.⁸³ Dallohen sidomos politikanë dhe autorë nga vendet fqinje ose nga shtete që kishin dalë në rolin e protektorëve të tyre. Njëri prej tyre, Vladan Gjeorgjeviçi, ish-kryeministër dhe ministër i Jashtëm i Serbisë, duke u marrë edhe me historiografi, botoi në vitin 1913, në disa gjuhë e në disa shtete, pamfletin “*Shqipëria dhe Fuqitë e Mëdha*.”⁸⁴ Me gjuhën e urrejtjes dhe të përçmimit ekstrem ndaj fqinjëve jugorë të vendit të vet shpifte se shqiptarët janë trogloditë bashkëkohorë, njerëz që banojnë nëpër shpella, me dhëmbë bishash të egra, jetojnë në gjakmarrje, të zvetënuar, gjaktazues, sepse kryejnë marrëdhënie intime brenda gjinisë, pa gjuhë të veten, pa libra e letërsi, doemos pa histori, pa aftësi shtetformuese dhe nuk kanë të drejtë të formojnë shtet, prandaj duhet “të likuidohen siç janë likuiduar popujt e Afrikës Veriore.”⁸⁵ Pavarësia e Shqipërisë ishte një gabim, i cili duhej korrigjuar duke e copëtuar dhe ndarë territorin e saj.

Një kryeministër tjetër i asaj kohe, gjithashtu serb, Nikolla Pashiç, i shkruante përfaqësuesit të vet në Sankt Petërburg, më 21 janar 1913, se “krijimi i Shqipërisë përbën një rrezik të madh jo vetëm për serbët, por për krejt Lidhjen Ballkanike”,⁸⁶ dhe “shteti shqiptar nuk duhet të ekzistojë fare, ndërsa territoret e tij duhet të ndahen patjetër në mes Serbisë dhe Greqisë”.⁸⁷ Sipas tij, vetëm kështu Ballkani do të kishte

⁸³ Ndërkohë që në Londër ambasadorët e gjashtë Fuqive të Mëdha, sugjestionoheshin me idetë e madhështisë së kombit serb, të vetëviktimizuar nga të ashtuquajturit invazione të shqiptarëve, u hodh në qarkullim edhe një literaturë e bollshme antishqiptare, denigruese, me frymë tepër agresive. Shih p.sh. V. Georgievitch *Les Albanais et les Grandes Puissances*, vep.cit. Balkanicus, *Le probleme albanais, la Serbie et l’Autriche-Hongrie*, Paris, 1913 – *Problemi shqiptar, Serbia dhe Austro-Hungaria*; J. Tomitch, *Les Albanais en Vieille-Serbie et dans le Sandjak de Novi-Pazar, Paris 1913 – Shqiptarët në Serbinë e Vjetër dhe në Sanxhak e Novi Pazar*: J.Cvijic, *Ballkanski rat i Srbija, Beograd, 1912, - Lufta ballkanike dhe Serbia*; J. Hadzi-Vasiljevic, *Juzna Stara Srbija, Kniga 2, Beograd, 1912 - Serbia e Jugut etj.* - Citohe sipas Arben Puto, vep.cit, fq. 61. Për këtë arsye është gjykuar që pikëpamjet, qëndrimet dhe politikat e tyre antishqiptare të trajtohen së bashku.

⁸⁴ Vladan Djordjevic, *Arnauti i Velike sile - Shqipëria dhe Fuqitë e Mëdha* (Beograd, 1913), *Les Albanais et les grandes puissances*, Paris: Calmann-Lévy, (1913).

⁸⁵ Po aty, f.188.

⁸⁶ Enver Bytyçi, *Shqiptarët, serbët dhe grekët*, Shtëpia botuese “KOHA”, Tiranë, 2005, f.19.

⁸⁷ Vladan Djordjevic, *Arnauti i Velike sile - Shqipëria dhe Fuqitë e Mëdha* (Beograd, 1913), *Les Albanais et les grandes puissances*, Paris: Calmann-Lévy, (1913).; Sekula Drleviç, *Ballkanski sukobi 1905–1941*, Zagreb 1941, f. 63; Arben

paqe, njëherazi do të ndërpriteshin pretendimet hegjemoniste të Italisë dhe të Austro-Hungarisë.⁸⁸

Të njëjtën pikëpamje ndante edhe serbi Dragutin Nikoliç, cili gjithashtu mohonte çdo vlerë dhe aftësi të shqiptarëve.⁸⁹

Serbia e shpaloste zyrtarisht synimin e saj për zhdukjen e Shqipërisë edhe në Memorandumin e paraqitur në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës ku shprehej se Shkodra, Ulqini, Kotorri, Tivari, Peja, Gjakova, Deçani dhe gjithë zona tjetër e Kosovës dhe e Rrafshit të Dukagjinit i përkisnin Serbisë. “Përkufizimi i Shqipërisë ashtu siç e kemi propozuar ne, - vazhdohej në Memorandum, do të kënaqte të drejtat historike dhe interesat e ligjshme të kombit serb dhe në këtë mënyrë do t’i jepte atij mundësi të ishte një nga garantuesit kryesorë të paqes, të rendit dhe të përparimit kulturor e ekonomik në Ballkan.⁹⁰

Qëndrimi konstant, permanent antishqiptar i Beogradit ka vazhduar pa u ndalur gjatë gjithë shekullit të kaluar, madje edhe në dekadat e para të shekullit XXI. Fryma e urrejtjes antishqiptare, për fat të keq, vazhdon të kultivohet sistematikisht edhe në kohën tonë.⁹¹

Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (1912–1918)*, vëll II, Tiranë 1987, f. 28.

⁸⁸ Arben Puto, vep.cit. po aty.

⁸⁹ Ai shkruan se vendimi i Konferencës së Londrës “është i një rëndësie historike jo vetëm për popullin shqiptar, i cili ngrihet për herë të parë në një shtet të pavarur, por përgjithësisht edhe për historinë politike të shekullit XX, sepse është me të vërtetë një nga rastet e rralla në histori në të cilin një populli iu dha me anë të një rezolute të thjeshtë, me një dekret, diçka që popujt e tjerë e kanë fituar pas luftërash të përgjakshme e të vështira.” Dragoutine Nicolitch, *Les différends de frontières de l’Albanie et le Traité Italo-Albanais du 27 novembre 1926*, Paris 1927, p. 56 - 57.

⁹⁰ Citohet nga Arben Puto, vep.cit. fq. 194-195, 216.

⁹¹ Studiuesi Armand Plaka shprehet se kohë pas kohe dalin në dritë botime të politikanëve e “akademikëve” serbë, të cilat me zell përkthehen me turravrap në gjuhët kryesore të kohës (anglisht, frëngjisht e gjermanisht), ku, më së shumti, bien në sy veprat e Stojan Protiçit, Grigorije Bozhoviçit, Jasha Tomiçit, Jovan Haxhi-Vasileviçit etj. Këtë fenomen e rrëfen edhe kapitulli i katërt i përmbledhjes së botuar në vitin 2004, “Wild Europe: The Balkans in the Gaze of Western Travellers”, i antropologut sloven, Bozhidar Jezernik, që në mënyrë sinjifikative vjen nën titullin “Men with tails” (Burra me bisht). Studimi në fjalë shqyrton perceptimet e udhëtarëve dhe studiuesve gjermanë, austriakë, francezë, britanikë e amerikanë etj. rreth shqiptarëve, përfshirë edhe pohimet e gënjeshtër se në Ballkan kishin ndeshur në “njerëz me bisht”. Pasazhe nga fletushkat e tyre u deformuan dhe u përdorën me qëllime kriminale nga pseudostudiues madje edhe nga ish-kryeministra e politikanë rangjesh të larta, serbë e malazezë për të justifikuar krimet e masakrat ndaj popullsisë shqiptare dhe për të përligjur

Autorësinë dhe verbërinë antishqiptare, instiktet kriminale, ideologjinë dhe politikën e tyre ekspansioniste veçanërisht në Kosovë, e pohojnë vetë udhëheqësit kryesorë të shtetit serb.⁹² Ata shpjegojnë se nëpërmjet krimeve gjenocidale, spastrimit etnik, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit kundër shqiptarëve, kanë dashur të realizojnë pikërisht zbrazjen e plotë të trojeve shqiptare, ato që deklarorin dekada më parë.

Grekët qëndronin në të njëjtën linjë me aleatët e vet tradicionalë. Përfaqësues të tyre deklarorin zyrtarisht në Londër, më 20 dhjetor 1912, se “është e pamundur të lejohen shqiptarët barbarë të jetojnë të pavarur në djepin e qytetërimit grek”.⁹³

Për sa i përket qëndrimit të Fuqive të Mëdha vlen të përmenden përfaqësuesit e disave prej tyre. Ministri i Jashtëm rus, Sazonov, i referohet një njoftimi që kishte marrë nga N.G.Hartwig-u, i cili i thoshte se aleatët ballkanikë kishin kërkuar ndarjen e Shqipërisë ndërmjet Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Duke komentuar këtë njoftim thotë se “shqiptarët nuk ishin homogjenë dhe të denjë për shtet”⁹⁴, kurse ambasadori i tij në Paris, Izvolksi shprehej se nuk besonte “se do të ishte e mundshme të ngriheshin në një shtet autonom malësorët e egër dhe që nuk njohin e nuk respektojnë asnjë ligj.”⁹⁵

Një vlerësim tjetër, në fakt, një zhvlerësim, vjen nga Berlina, gati 100 vjet më parë. Ai gjendet në një shënim në marzhin e një shkresë, me të cilën Alfred Von Kiderlen-Wächter, Sekretari i shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme gjermane, i paraqiti më 3 nëntor 1913 Kajzerit një letër që Leopold Berchtold-i, ministri i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, ia kishte dërguar homologut të vet gjerman, më 30 tetor 1912. Ai i kërkonte Gjermanisë që “të solidarizohej për “interesin jetësor” të monarkisë në zhvillimin e lirë të Shqipërisë, në mënyrë që në brigjet lindore të Adriatikut të mos instalohet asnjë fuqi e madhe e huaj.”⁹⁶ Sekretari gjerman i Punëve të Jashtme ia përcolli atë Kajzerit, me një shënim ku kishte shkruar se duhet të krijohet një Shqipëri e aftë për të jetuar. Vilhelmi i Dytë shkroi me dorën e vet, një shtet hajdutësh

pretendimet hegjemoniste. Armand Plaka, *Mbi stereotipat antishqiptarë në veprat e autorëve të huaj*, Gazeta DITA, 27 Janar, 2016.

⁹² Këtë e kanë bërë haptaz princi Millan, Nikolla Pashiç, Vaso Çubrilloviç etj

⁹³ Sipas Dorina Topollaj & Qamil Xhani, *Gazeta Tirana Observer*, 11-03-2007.

⁹⁴ Muhamet Shatri, *vep.cit*, f.8.

⁹⁵ Po aty.

⁹⁶ Blendi Fevziu, *vep.cit*, f.14.

nuk mund të bëhet kurrë i aftë për të jetuar,⁹⁷ duke dhënë në këtë mënyrë opinionin e tij për shqiptarët, që të kujton vlerësimin e paraardhësit të tij Otto von Bismarck, i cili 35 vjet më parë, e cilësoi Shqipërinë një shprehje gjeografike.

Edhe Kurt Gostentschnigg-u, shquhet si besnik i idesë se pavarësia e Shqipërisë ishte produkt i diplomacisë së fuqive të Mëdha. Ai shprehet se shpallja e saj (u bë) në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, në korrik të vitit 1913,⁹⁸ duke deformuar të vërtetën dhe duke e zhvendosur atë në kohë për një periudhë tetëmujore.

Kurse albanologu gjerman, Michael Schmidt-Neke, e trajton gjerësisht rolin negativ të bashkëpatriotit të vet, Karl May në fund të shekullit të 19-të e në fillim të shekullit të 20-të, në përfundimin e një realiteti shabllon e negativ për shqiptarët.⁹⁹ Ka stigmatizuar edhe shkrime të autorëve të tjerë, të cilët e trajtojnë Shqipërinë si hapësirë për fantazitë e tyre megalomane. Përmend, fjala vjen, Spiridon Gopçeviç-in, Otto Witte, veprat e të cilëve i konsideron të mbështetura kryesisht në trillime, materiale dhe dorëshkrime të parapaguara nga qeveritë serbe.¹⁰⁰

Ish-diplomati britanik në Serbi, Ralph Paget, i indoktrinuar prej serbve me ndjenjën e urrejtjes ndaj shqiptarëve, do të shfaqte të njëjtat mendime, në njoftimin që i dërgonte Eduard Grey-it më 22 nëntor 1912 nga Beogradi. Thoshte se “shqiptarët e Veriut janë një turmë e paqeverisshme e turbulluese. Shqiptarët e Jugut janë më të qetë, porse që të gjithë konsiderohen të papërshtatshëm për vetëqeverisje. Në vijim pohonte se “një Shqipëri autonome kishte gjasa që të bëhej burim trazirash për shkak të intrigave të Austrisë dhe të Italisë.”¹⁰¹

⁹⁷ Po aty.

⁹⁸ Dr. Kurt Gostentschnigg, *Funksioni komunikativo-politik i Shqipërisë për Austro-Hungarinë*, Gazeta MAPO, 8.12.2012.

⁹⁹ *Pseudologia phantastica und Orientalismus: Albanien als imaginäre Bühne für Spiridon Gopčević, Karl May und Otto Witte*. In: Jahrbuch der Karl-May-Gesellschaft, 2006

¹⁰⁰ Michael Schmidt-Neke thotë se në disa libra të Karl May-it dëshmohet qartë se ato ishin edhe detyra të parapaguara. Sidomos me veprën “*Makedonien und Altserbien*” (në shqip: *Maqedonia dhe Serbia e Vjetër*), botuar në Vjenë, në vitin 1889, ai mori dhe damkën si “The father of Serbian political ethnography” (Babai i etnografisë politike serbe)... Libri i tij u subvencionua nga qeveria serbe në Beograd, e cila i paguante autorit një honorar të majmë dhe i merite përsipër edhe kostot e shtypjes së librit.

¹⁰¹ Muhamet Shatri, *vep.cit*, f.131.

Edhe Edward Grey, ministri i Jashtëm anglez shprehej: ”Fuqitë e Mëdha nuk shihnin asnjë arsye të ndërhyjnë përveç për t’i dhënë kënaqësi Austrisë dhe Italisë për çështjen e Shqipërisë”. Grey këtë gjë ia kishte deklaruar edhe Turhan Pashës, të cilit i kishte pohuar se “Shqipëria, në të vërtetë, qe krijuar vetëm për hir të interesave të Italisë dhe të Austro-Hungarisë”.¹⁰²

*Francezi René Puaux, i ndikuar nga Athina, thoshte pa hezitim, me injorancë dhe keqdashje se Korça, Gjirokastra dhe Himara janë oxhakët e helenizmit.*¹⁰³ *Kamboni, duke shpjeguar arsyet që e kishin shtyrë Francën të pranonte pavarësinë e Shqipërisë, thotë se “pranuam që të krijohej Shqipëria për t’i dalë para një konfiguracioni europian që mund të rridhte nga konflikti austro-rus, ndërsa kontrollin ndërkombëtar e menduam si mjet për të parandaluar vendosjen e austriakëve dhe italianëve në gadishullin ballkanik.”*¹⁰⁴

Në fillimet e shekullit të kaluar grupit të autorëve të kësaj prirjeje iu shtua edhe diplomati e historiani italian Ferdinando Salleo.¹⁰⁵ Shtetin e pavarur shqiptar e konsideron tërësisht produkt të diplomacisë së Fuqive të Mëdha të kohës, duke mos iu shpëtuar paragjykimeve aq shumë të kultivuara në literaturën historiografike të asaj kohe. Shprehet se “në një kuadër të turbullt e të pasigurt dhe, për më tepër, në vigjilje të konfliktit të madh mbareuropian, krejt papritur e pakujtuar, shqiptarët e panë veten të çliruar nga sundimi osman dhe, ashtu siç ishin, të ndarë e të përçarë mes fisesh, etnish e besimesh të ndryshme, u ndodhën përballë një shteti të ri të krijuar nga Fuqitë, mbi trojet e njohura prej tyre si principatë sovraane, të cilën ia besuan princit gjerman Wilhelm të Wiedit”.¹⁰⁶

Pohimet e tij të vendosura në një kontekst sensacionesh janë jehonë e pikëpamjeve të autorëve që dallohen për qëndrimet e tyre tradicionale nihiliste dhe antishqiptare, që paraqiten kryesisht si mbështetje

¹⁰² Edward Grey; D’ Honfroy, *Memoires de Edward Grey, vicomte De Fallodon, ministre des affaires etrangeres de Grande-Bretagne*, Paris: Payot, 1927, p. 248.

¹⁰³ Puaux, René. *Grèce. Terre aimée des Dieux*, Paris (G. de Maleherbe), MCMXXXII (1932).

¹⁰⁴ Cambon Paul, - *Correspondance, 1870-1924*, (3 tomes en 2 volumes); 1940-1946, tome 3: (1912-1924), *les guerres balkaniques, la Grande Guerre, l’Organisation de la Paix*, ed. Bernard Grasset, Paris, 1946, p. 31.

¹⁰⁵ Ferdinando Salleo, ish ambasadori i Italisë në Moskë e në Uashington, ish sekretari i përgjithshëm i Farnezinës, diplomat që nga vitet ’60 të shekullit të kaluar dhe njëkohësisht historian, autor i librit “*Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri*”, Shtëpia e librit dhe e komunikimit, Tiranë, 2001.

¹⁰⁶ Ferdinando Salleo, -*Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri*. Shtëpia e librit dhe e komunikimit, Tiranë, 2001, fq. 14-15.

teoriko - juridike e aspiratave aneksioniste të shteteve, interesat e të cilëve mbrojnë apo përfaqësojnë.

Në këtë linjë ecën edhe autori italian Eugenio Buccioli, i cili thotë se “Për fat të mirë të shqiptarëve, pjesëtimi apo copëtimi i territoreve të tyre, binte ndesh me interesat e Austro-Hungarisë (dhe Italisë), që të dyja të vendosura për zgjidhjen e pavarësisë së Shqipërisë, kundër planeve aneksioniste të vendeve fqinje, të cilët për një kohë të gjatë kishin ushtruar ndikimin e tyre në këtë vënd, Italia nëpërmjet shkëmbimeve tregtare dhe Austro-Hungaria duke mbështetur me financime të mëdha praninë e Kishës Katolike veçanërisht në provincat e Veriut të Shqipërisë”.¹⁰⁷

Një pikëpamje tjetër shfaq studiuesja Nicole Guy, e cila shtetin e pavarur të Shqipërisë e cilëson fare lehtësisht produkt të paanshmërisë në dukje të Grey-it dhe qasjes së tij pragmatiste, të gërshtuar me zgjuarsinë dhe aftësinë e tij për shpikje propozimesh.¹⁰⁸ Ajo duket sikur flet për eksperimente të zakonshme, ku shtetet dhe popujt konsiderohen mone-dha tregu. Me këtë logjikë, nuk ngurron të thotë se “krijimi i Shqipërisë kishte shërbyer për të formatuar një ekuilibër të ri forcash në Ballkan dhe në Adriatik dhe për pasojë kishte ruajtur interesat e Fuqive të Mëdha dhe sistemin në tërësinë e vet. Faktorët gjeopolitikë kishin qenë qartazi më të rëndësishëm sesa arsyet etnike të shpallura.”¹⁰⁹ Më tej ajo i referohet Robert Vansittart-it, ish-sekretar shteti në Forin Offis, i cili thoshte se “në skicimin e kufijve të Shqipërisë shpesh ishte e nevojshme që etnografia të anashkalohej për arsye më të mëdha; por nuk kishte arsye që ajo të anashkalohej kur nuk ishte e domosdoshme.”¹¹⁰

Shqipëria, produkt i traktateve ndërkombëtare

Çështja e faktorit prioritar në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar ka qenë objekt trajtimi edhe në literaturën juridiko-ndërkombëtare. Profesori zviceran, Pol Gugenheim (Paul Guggenheim) e përmend Shqipërinë si shembull të shteteve të krijuara nga e drejta e traktateve (konvencionale, ndërkombëtare) dhe e rendit së bashku me qytetin e lirë

¹⁰⁷ Eugenio Buccioli, - *Albania fronte dimenticato grande guerra*, citohet sipas Dashnor Kaloçi, *Gazeta Shqiptare*, Shkurt 13, 2002

¹⁰⁸ Nicola Guy, *Lindja e Shqipërisë, Nacionalizmi etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e pavarësisë së Shqipërisë*, Botime Pegi, Tiranë 2012, f.80.

¹⁰⁹ Po aty, f.81.

¹¹⁰ Shënimet, Vanistart,5.12.1913,FO371/1823/54900, citohet nga Nicole Guy, cep.cit. f.81.

të Krakovit, shtetin e ishujve Jonianë¹¹¹, qytetin e lirë të Danzingut¹¹² etj. që, siç thotë ai, janë krijuar nga diplomacia e Fuqive të Mëdha.¹¹³ Ishin ato që vendosën ndarjen e Polonisë në vitin 1815, që njohën neutralitetin e Zvicrës më 1815 dhe që krijuan Belgjikën më 1831, Bullgarinë më 1878 dhe Shqipërinë më 1912.¹¹⁴ Por, nuk mund të mos vihet në dukje se te Gugenheimi dallohet pothuajse për herë të parë në doktrinën e së drejtës një vlerësim juridik për ilegjitimitetin e pushtetit të Fuqive të Mëdha për të vendosur për fatet e popujve të tjerë.¹¹⁵

Lui Kavará (Louis Cavaré), duke iu referuar krijimit të shtetit shqiptar, shkruan se Shqipëria u krijua si shtet në saje të Traktatit të Londrës të vitit 1913, nëpërmjet të cilit Turqia ua la Fuqive europiane kujdesin e rregullimit të situatës.¹¹⁶

Në të njëjtat pozita shfaqet edhe ndërkombëtaristi tjetër francez, profesori Charl Ruso (Charles Rousseau), i cili thotë se shteti shqiptar u krijua nëpërmjet vendimit të një organi ndërkombëtar, që ishte Konferenca e Ambasadorëve. Mirëpo, në librin e vet ai i referohet gabimisht vendimit të 17 dhjetorit 1912, i cili edhe në kuptimin që ka parasysh autori, nuk përbën një akt të mirëfilltë të krijimit të shtetit shqiptar, sepse miratoi vetëm vendosjen e Shqipërisë nën suzerenitetin e Sulltanit dhe jo daljen si shtet i pavarur.¹¹⁷ Njohja ndërkombëtare, të cilën ai e identifikon me krijimin e shtetit shqiptar, i përket vendimit të 29 korrikut 1913. Në një botim tjetër të zgjeruar e të ripunuar, që i përket vitit 1974, Rusoi shfaq një tjetër pikëpamje, të ndryshme nga ajo që u parashtua më sipër. Ai, kësaj here rastin e Shqipërisë e përmend duke iu referuar vendimit të 9 nëntorit 1921, të Konferencës së Ambasadorëve të Parisit, të cilin e cilëson si një akt multilateral që përmban angazhimin për të respektuar dhe garantuar pavarësinë e Shqipërisë.¹¹⁸

¹¹¹ Krijuar në vitin 1815 nga Traktati i Parisit i 5 nëntorit 1815, nënshkruar nga Britania e Madhe, Austria, Prusia dhe Rusia.

¹¹² Krijuar nga Traktati i Versajës, 1920, i vendosur nën protektoratin e Lidhjes së Kombeve.

¹¹³ Paul Guggenheim, *Traité de Droit International public*, Tome I, 1953, Librairie de l'Université, Georg & Cie S.A. Genève, f. 218-219.

¹¹⁴ Po aty, f.245-246.

¹¹⁵ Po aty.

¹¹⁶ Louis Cavaré, *Le droit international public positif: Les modalités des relations juridiques internationales. Les compétences respectives des états*, Volume 2 of *Le droit international public positif*, A.Pedone, 1951 *vep.cit*, p.311.

¹¹⁷ Charles Rousseau, *Droit International Public*, Tome II, *Les sujets de droit*, Editions Sirey, Paris, 1974, p. 70.

¹¹⁸ Charles Rousseau, *vep.cit*, pp. 98-99, 288.

Një tjetër ndërkombëtarist, finlandezi Rafael Waldemar Erich, duke përkrahur të njëjtin qëndrim nihilist, shkruan se Shqipëria “u formua si shtet jo si rezultat i ndonjë lufte për pavarësi në kuptimin e vërtetë të fjalës, por në saje të faktit që në Traktatin e Londrës të majit 1913, Perandoria Otomane ua pati lënë Fuqive të Mëdha kujdesin për të rregulluar pozitën e saj.”¹¹⁹

Te gjermano-francezi Robert Redslob-i, gjithashtu profesor i të drejtës kushtetuese dhe i të drejtës ndërkombëtare, gjendet një trajtim krejt ndryshe. Ai thotë: “Kur Fuqitë e Mëdha pretenduan të ngrinin Shqipërinë si principatë më vete me Princ Vidin në krye dhe i dhanë edhe një Statut, kjo ishte nga ana e tyre një vepër pa themel. Monarkia e re nuk u krijua veçse në letër dhe në imagjinatën e diplomatëve. Ajo nuk jetoi kurrë për arsyen e thjeshtë se nuk hodhi rrënjë në popull. Pastaj plasi Lufta e Madhe dhe vetëm pas një periudhe të gjatë anarkie, përleshjesh dhe trazirash, Shqipëria mundi të bëhej vetë me forcat e saj, me vullnetin e saj kombëtar që është edhe e vetmja mënyrë me të cilën mund të themelohet një shtet i vërtetë”.¹²⁰

Konstatimi tij se “Shqipëria mundi të bëhej vetë me forcat e saj, me vullnetin e saj kombëtar...” është pa dyshim i drejtë nga pikëpamja parimore dhe i vërtetuar nga realiteti i Shqipërisë së asaj kohe.

Edhe pohimi i Robert Lari Uodëll, i cili shprehet se “faktori kryesor që e shpëtoi Shqipërinë nga copëtimi përfundimtar, ishte veprimi i vetë shqiptarëve në mbrojtje të vendit të tyre.”¹²¹ Ai del në këtë konkluzion, sepse ishte i bindur që, “në optikën e Fuqive të Mëdha, një Shqipëri e pavarur do të ishte një qenie e padëshirueshme për fqinjët e saj.”¹²²

Vlerësime të tjera

Krahas pohimeve të pafundme me karakter nihilist deri përcmues, ndeshen jo rrallë edhe vlerësime objektive, që riprodhojnë ose i qasen maksimalisht të vërtetës. Ato vijnë nga emra të përveçëm studiuesish, politikanësh ose diplomatësh me integritet. Një prej tyre është Johann Georg von Hahn, studiues gjerman, i cili në vitet 1843-1847 shërbeu si

¹¹⁹ Erich, Waldemar Rafael,- *La naissance et la reconnaissance des Etats*, Recueil des Cours de l'Académie du Droit International, Tome 13 (1926) III, p.444.

¹²⁰ Robert Redslob, *Les principes du droit des gens moderne*, Paris 1937, p. 63.

¹²¹ Robert Lari Uodëll “*Problemet e shqiptarëve gjatë Konferencës së Pages 1919-1920*”, Tiranë 1978, f. 480.

¹²² Po aty.

konsull në rajonet e Shqipërisë Jugore, një tjetër Jakob Philipp Fallmerayer, historian, albanolog dhe publicist austriak, pas tij Gustav Meyer (1850 - 1900) gjuhëtar, studiues i gjuhëve indo-evropiane, një nga albanologët më të rëndësishëm të kohës së tij, që provoi se gjuha shqipe i përket familjes indo-evropiane¹²³ dhe në vijim edhe shumë të tjerë. Ishin jo vetëm studiues të zellshëm të albanologjisë, por edhe mbështetës pa rezerva të çështjes shqiptare.¹²⁴

Meriton të përmendet gjithashtu francezi Gabriel Louis Jaray (Gabriel Lui Zharé), i cili nuk është i përmasave të emrave të mësipërm. Ai pohon se krijimi i Shqipërisë së pavarur ishte kaq pak i parashikuar nga opinioni publik, sa që shumë pyesnin veten nëse ajo nuk ishte veçse një nga sajimet e diplomacisë... një surprizë, duke shtuar se secili shtron pyetjen: mos vallë shqiptarët s'janë gjë tjetër veçse një *souvenir* historik ose pothuajse arkeologjik?... A formojnë ata një komb? Nëse ky komb ekziston, si mund të injorohet? Nëse nuk ekziston, ç'është ky shtet i ri? Ia kanë caktuar kufijtë, por brenda këtyre kufijve ç'do të ndodhë? Do të jetë ai një vatër anarkie që po përgatitet apo që po ndizet?... Ç'do të ndodhë pas vijës së këtyre brigjeve jomikpritëse dhe që ne na rezervon këtë formë të re të *Çështjes Lindore*?¹²⁵

¹²³ Bardhyl Demiraj (2010). *Wir sind die Deinen: Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*. Otto Harrassowitz Verlag. fq. 550. ISBN 978-3-447-06221-3. founder of modern albanology, Gustav Meyer. Philip Baldi (1983). *An Introduction to the Indo-European Languages*. SIU Press. fq. 87–88. ISBN 978-0-8093-1091-3. In fact, Albanian was not established definitively Indo-European until the latter part of the nineteenth century, when certain structural and lexical correspondences that demonstrated the Indo-European character of the language were noted (especially by Gustav Meyer)

¹²⁴ Faik Konica, në *Revistën "Albania"*, Viti I, Nr. 8, 1897, fq 12, në shkrimin me titull "Sëmundja e Zotit Gustav Majer", shkruan ndër të tjera se: "Asnjë shqiptar i vërtetë s'ka të drejtë të mos dijë emërin e Zotit Gustav Majer, mësonjëtor i math n'Oshtri (Austri), i njohur në gjithë botën. Midis aqë të diturve t'Oshtrisë qi kanë punuar për përparimin e gjuhës shqip, as një ndofta s'ka dëftyer aqë thellësi sa Gustavi Majer. I ka provojtur Evropës që gjuha shqip është një gjuhë për të qenë dhe për të vënë re, dhe nukë një gjuhë e poshtër dhe pa vlerë siç thonë armiqtë. Andaj, gjithë Shqipëtarët kemi detyrë t'ia dimë për të mirë Zotit Gustav Majer, edhe si gëzohemi kur mësojmë që gjendet mirë, ashtu dhe na vjen liksh kur mësojmë që i është lajthitur shëndeti." Citohet nga Armand Plaka, "Për në Shqipëri Karl". *Kur autorët e huaj "demonizojnë" shqiptarët –publikuar në Voice of Albanians, më 7 janar 2019.*

¹²⁵ Gabriel Louis-Jaray, *Au jeune royaume d'Albanie, Ce qu'il a été è Ce qu'il est*, Librairie Hachette et Cie, Paris-79, Boulevard Saint-Germain-1914

Akuzues i politikës së Austrisë dhe të Italisë, të stigmatizuar prej tij si dy prej protagonistëve më kryesorë dhe më të drejtpërdrejtë në ngjarjet në Ballkan dhe posaçërisht në Shqipëri, Zharé thotë të vërtetën e madhe se Shqipëria e pavarur ekziston nga forca e nacionalitetit të saj dhe nga vullneti i Europës. Por, vazhdon se Shqipëria do të bëhet një lodër në duart e Austrisë dhe të Italisë. Ajo do të jetë fantazma e një shteti autonom.¹²⁶ Nisur nga kjo premisë, Zharé thotë se “krijimi i Shqipërisë s’është gjë tjetër veçse hipokrizi diplomatike për të fshehur vënien dorë nga ana e këtyre dy fuqive mbi një pjesë të Ballkanit, mbi shtetin më të ri, që doli në Europë, në fillimin e shekullit XX nga konkluzionet e agonisë së Turqisë.” Por, më tej nuk ngurron të afirmojë të vërtetën e padiskutueshme që “nga themeli i historisë, ku shqiptari ndoshta ka luajtur prej kohësh një rol primar, ai rilindi nga forca e ndjenjave të pashuara.”¹²⁷ Dhe konkludon me të drejtë se “cilido qoftë fati i saj, raca dhe sentimente kombëtar do të mbijetojnë. Nuk mund të hiqet nga numri i kombeve ai që për më shumë se pesë shekuj i rezistoi me një trimëri të mrekullueshme pushtimit turk dhe asimilimit mysliman.”¹²⁸

Ish-ministri i Punëve të Jashtme të Francës në vitet 1894-1898, Gabriel Hannotaux në parathënien e librit *Shqipëria e panjohur*, të Zharesë, theksonte tiparet thelbësore dhe veçoritë e “këtij kombi (*shqiptar, K.K.*)... me të cilin do të ketë të bëjë Europa”, tipare që paraqiten në këtë libër, i cili “ka dalë në kohën e duhur, sepse i zbulon Europës provincën e saj më të vonuar, pikërisht në atë çast kur kjo provincë po bëhet kombi më i ri i saj.”¹²⁹

Nga një këndvështrim krejt i ndryshëm do t’i vlerësonte rezultatet e Konferencës së Londrës dhe faktorët e krijimit të Shqipërisë së pavarur, miku i shqiptarëve, amerikani Xhorxh Fred Uilliams, ministri (përfaqësuesi diplomatik) i ShBA-së në Greqi dhe në Mal të Zi, si dhe vëzhgues i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, në Durrës. Në librin *Shqiptarët*, shkruar në vitin 1914, ai deklaronte: Shqipëria nuk mund të copëtohet e t’u ndahet shteteve fqinje. Europa që do ta bëjë paqen dhe ka krijuar shtetin e pavarur të Shqipërisë nuk mund ta mohojë dhënien e lirisë së plotë në qoftë se Shqipëria e organizuar u del përpara dhe

¹²⁶ Po aty, f.80.

¹²⁷ Po aty, f.80, 91.

¹²⁸ Po aty, f.91.

¹²⁹ Gabriel Louis-Jaray, *Au jeune royaume d’Albanie, Ce qu’il a été & Ce qu’il est*, Librairie Hachette et Cie, Paris-79, Boulevard Saint-Germain-1914. Shih parathënien e librit.

ngul këmbë në të drejtat e veta. Një shtet i formuar në këtë mënyrë nuk do të ishte një kanosje për paqen e Ballkanit;...¹³⁰

Listës së mësipërme të studiuesve objektivë e realistë i shtohen edhe emra të tjerë si Dimitrije Tucoviç, kreu i socialdemokratëve serbë, njëkohësisht autor i librit “Serbia dhe Shqipëria” (1914), Leon Bronshtajn “Trocki”, që përcolli në mediet ruse, gjermane e austro-hungareze, reportazhe nga fronti i luftërave ballkanike, ku pasqyroheshin me realizëm të skajshëm mizoritë e serbëve dhe malazezëve ndaj shqiptarëve, si dhe mjaft reportazhe e artikuj në mediet italiane, britanike, austriake, çeke, hungareze, skandinave, pjesërisht në ato franceze e sidomos, në ato amerikane të kohës, të cilat në përgjithësi ndikuan pozitivisht për përcjelljen e një imazhi realist të shqiptarëve, pavarësisht nga kritikrat e shprehjeve të mosbesimit për të ardhmen e një Shqipërie të pavarur. Gjithsesi, duhet pranuar se shpesh në to ndjehej një tautologji joefektive, naivitet e mungesë njohurish të thelluara për “fenomenet” shqiptare të kohës e të djeshmen e tyre, ndikuar kjo edhe nga izolimi e pamundësia financiare për ta furnizuar publikun me “lëndë të parë” nga terreni.¹³¹

Një botim gati i plotë dhe shumë prekës është “*Golgotha shqiptare*”, publikuar nga hebreo-austriaku, Leo Freundlich në vitin 1913, mbetet padyshim një dokument me vlera të pamohueshme historike, i cili përveç argumenteve të qëndrueshme, sjell edhe fakte e të dhëna drithëruese për masakrat serbe në Shqipërinë e asaj kohe.

Duke u rikthyer te specialistët e së drejtës ndërkombëtare që e kanë trajtuar këtë çështje, por në mënyrë realiste dhe objektive, duhet të ndalemi te gjermano-francezi Robert Redslob, ku gjendet një trajtim krejt ndryshe. Ai thotë: “Kur Fuqitë e Mëdha pretenduan të ngrinin Shqipërinë si principatë më vete me Princ Vidin në krye dhe i dhanë edhe një statut, kjo ishte nga ana e tyre një vepër pa themel. Monarkia e re nuk u krijua veçse në letër dhe në imagjinatën e diplomatëve. Ajo nuk jetoi kurrë për arsye të thjeshtë se nuk hodhi rrënjë në popull. Pastaj plasi Lufta e Madhe dhe vetëm pas një periudhe të gjatë anarkie, përleshjesh dhe trazirash, Shqipëria mundi të bëhej vetë me forcat e saj, me vullnetin e saj kombëtar që është edhe e vetmja mënyrë me të cilën mund të themelohet një shtet i vërtetë”.¹³² Konstatimi se “Shqipëria mundi të bëhej vetë me forcat e saj, me vullnetin e saj kombëtar...” është

¹³⁰ George Fred Williams, Shqipëtarët, botuar nga Argeta LMC - Tiranë 1999, f.37.

¹³¹ Armand Plaka, “Për në Shqipëri Karl”. Kur autorët e huaj “demonizojnë” shqiptarët” - publikuar në *Voice of Albanians*, më 7 janar 2019.

¹³² Robert Redslob, *Les principes du droit des gens moderne*, Paris 1937, p. 63.

pa dyshim i drejtë nga pikpamja parimore dhe i vërtetuar nga realiteti i Shqipërisë së asaj kohe.

Afër vlerësimit të tij është edhe pohimi i Robert Lari Uodëll, i cili shprehet se “faktori kryesor që e shpëtoi Shqipërinë nga copëtimi përfundimtar, ishte veprimi i vetë shqiptarëve në mbrojtje të vendit të tyre.”¹³³

Mbrojtësi i kauzës së Shqipërisë për përkatësinë territoriale shqiptare të Shën Naumit, në Dhomën Permanente të Drejtësisë Ndërkombëtare, në Hagë, në vitin 1924, profesori zviceran i së drejtës ndërkombëtare, Zhilber Zhidel (Gilbert Giddel), duke tejkaluar kornizat juridike dhe duke e vendosur rolin e tij të avokatit në një kontekst më të përgjithshëm, deklaronte në Pallatin e Drejtësisë se: “Populli shqiptar ka pas tij një të kaluar të gjatë dhimbjesh dhe vuajtjesh. Me gjithë mundimet, ky komb i vjetër e ruan të paprekur dëshirën për të jetuar - dhe për të jetuar i lirë -, sepse ai beson tek e drejta dhe sepse ka vetëdijen e patundshme të së drejtës së vet... Shqipëria është krenare për homazhet e drejta që i bëhen urtësisë dhe shpirtit të saj të drejtësisë... Por meqë ajo pajtohet me të drejtën, ajo mendon me të drejtë se mund të shpërblehet. Për këtë është e paçmueshme për Shqipërinë të gjendet para jush, Zotërinj, që i thoni Botës të drejtën, të drejtën e njëjtë për të dobëtin ashtu si dhe për të fortin.”¹³⁴

Një pjesë e atyre që u përmendën më sipër, në një mënyrë a në një tjetër, janë aktorë, disa ndoshta edhe me role periferike, të cilët krahas protagonistëve antishqiptarë kanë kontribuar jo për ta bërë Shqipërinë, por për ta zhbërë atë.

Kush e bëri Shqipërinë?

Përgjigja e saktë e pyetjes se kush e bëri Shqipërinë, me të cilën hapet ky referim, do të ishte pavarësia dhe shteti shqiptar janë rezultat i kontributit të faktorit vendas, i luftërave dhe i përpjekjeve të shqiptarëve për t’u shkëputur nga Perandoria Osmane dhe për të konstituar shtetin e tyre. Kjo vërtetohet pa asnjë mëdyshje edhe nga një akt juridik zyrtar me rëndësi kushtetuese. Bëhet fjalë për Statutin Organik të Shqipërisë, të përgatitur nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, në Vlorë, më 10 prill 1914. Në pikën 22, të kreut të tretë, thuhet shprehimisht: “Janë

¹³³ Robert Lari Uodëll “Problemet e shqiptarëve gjatë Konferencës së Paqes 1919-1920”, Tiranë 1978, f. 480.

¹³⁴ K. Naska. *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës*. "Kristalina - K.H.", Tiranë 2012, f.

shtetas shqiptarë të gjithë ata që kanë lindur ose që janë vendosur në Shqipëri përpara 28 nëntorit të 1912-s dhe që, nën qeverinë osmane kanë pasur nënshtetësinë osmane”. Një interpretim i thjeshtë çon në përfundimin se Shqipëria, si shtet, si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, u krijua më 28 nëntor 1912, datë që merret si pikënisje e përcaktimit të shtetësisë së shtetasve të saj. Nëse do të ishte Vendimi i 29 korrikut të vitit 1913, që është akti i njohjes ndërkombëtare, Statuti do t’i referohej atij dhe jo vendimit të Kuvendit të Vlorës. Kjo do të thotë se vetë Fuqitë e Mëdha, nëpërmjet këtij akti juridik të përpunuar e miratuar prej tyre, njohin 28 Nëntorin 1912, si ditën e krijimit të shtetit të pavarur të Shqipërisë, ditën kur Kuvendi Kombëtar i Vlorës, shpalli pavarësinë e Shqipërisë. Nuk njohin 29 korrikun e vitit 1913, nuk kanë ecur nën shembullin e Greqisë, ku si dita e krijimit të shtetit grek njihet 3 mars 1830, dita e njohjes së saj nga Fuqitë e Mëdha, nëpërmjet Protokollit të Londrës.¹³⁵

Është e padiskutueshme që nuk do të kishte Shqipëri, nëse shqiptarët nuk do të kishin luftuar ndër shekuj për liri e pavarësi. Sikurse është po ashtu e padiskutueshme që faktori ndërkombëtar nuk do të ishte aktivizuar dhe nuk do ta kishte marrë në shqyrtim çështjen shqiptare, nëse vetë shqiptarët nuk do të kishin treguar se nuk pranonin të mbeteshin pjesë e Perandorisë Osmane.

Por nuk do të ishte e mundur që Shqipëria e pavarur të vazhdonte të ekzistonte nëse Fuqitë e Mëdha do ta shpërfillnin, duke mos e marrë në konsideratë, duke mos i akorduar njohjen ndërkombëtare. Meriton të vlerësohet ky reagim dhe kontribut i diplomacisë europiane në pavarësinë e Shqipërisë.

Kush e zhbëri Shqipërinë e vërtetë?

Është e sigurt se Shqipëria u bë më 1912. E bënë shqiptarët me përkrahjen e segmentëve progresivë të faktorit ndërkombëtar. “Por ajo nuk u bë siç duhej të bëhej”, sepse e ndrydhën në gjysmën e territoreve të saj.

Pas kësaj ekspozije relativisht të përmbledhur të ngjarjeve që përshkuan historinë e zhvillimeve shqiptare në fillimet e shekullit të kaluar, pyetja me të cilën u hap ky punim, mund të bëhet edhe ndryshe. Kush

¹³⁵ “La Grèce libérée” Révéler l’histoire diplomatique de la Grèce après 1821 à travers les archives diplomatiques et historiques,
[https://www.grecehebdo.gr/category/culture-2/histoire/Juin 24, 2021](https://www.grecehebdo.gr/category/culture-2/histoire/Juin%2024,%202021)

e zhbëri Shqipërinë e vërtetë, atë që duhet të mbante sot emrin Shqipëria?! Sepse, siç u tha më sipër, vendimet e 22 marsit dhe 11 gushtit të vitit 1913, të miratuara nga Konferenca e Ambasadorëve, cunguan ndjeshëm kufijtë e Shqipërisë të 28 nëntorit 1912 dhe lanë brenda saj vetëm atë që është sot, të cilën e njohu *de jure* vendimi i 29 korrikut 1913. Lënia jashtë kufijve të saj shtetërorë e rreth gjysmës së Shqipërisë së vërtetë, mund të interpretohet edhe si zhbërje e saj. Aktet e tjerë të këtij skenari do të vazhdonin pas mbylljes së punimeve të Konferencës. Ajo “gjysmë” Shqipërie e pavarur, e ngarkuar me hipotekat e neutralitetit të garantuar dhe të kapitulacioneve, do të mbetej në mes të rrugës. Probleme të shumta u krijuan gjatë demarkacionit të kufijve jugorë dhe veriorë. U bë e qartë se fqinjët jugorë dhe ata veriorë, u përpoqën ta përdornin demarkacionin si mundësi për të realizuar objektivat që i arritën gjatë vendimeve të delimitacionit. Më e keqja, ajo që nuk imagjinohej, ndodhi gati dy vjet më pas, kur harta e Londrës, 1913, u rimor sërish në Londër, në prillin e vitit 1915. Aty u vendos anulimi i i saj dhe copëtimi i Shqipërisë së mbetur, midis atyre që e “kishin krijuar”, që e kishin shpallur edhe shtet neutral me angazhimin juridik që do ta mbrojnë nëse dikush do ta sulmonte, etj. Pa u tharë ende boja e firmave që kishin hedhur më 29 korrik 1913, e sulmuan vetë, e pushtuan, e kthyen në *place d’armes* dhe e ndanë midis tyre. Prandaj, me sa duket, mezi del nga goja e shqiptarëve, pohimi që ndërkombëtarët e bënë Shqipërinë. E saktë do të ishte të thuhej se ata si autorë dhe aktorë të zhbërjes së saj, bënë vetëm gjysmën e saj, të cilën gjithashtu do ta zhbënin pas një viti kur shpërtheu Lufta e Parë Botërore dhe kur, të gjithë së bashku, e pushtuan dhe e ndanë midis tyre.

Frashër Demaj

KONTRIBUTI I “KOMITETIT SHQIPTAR TË LONDRËS” NË SENSIBILIZIMIN E ÇËSHTJES SHQIPTARE GJATË VITEVE 1912-1913

Abstrakt

Komiteti Shqiptar në Londër ishte një organizatë e themeluar nga politikanë, diplomatë, intelektualë, gazetarë, ish- funksionarë shtetërorë britanikë të cilët ishin kundërshtarë të rreptë të Aleancës Ballkanike të cilët në kohën e luftërave ballkanike ishin vënë në përkrahje të shqiptarëve. Në krye të Këshillit iniciues për formimin e Komitetit Shqiptar në Londër qëndronte Aubrey Herbert. Në takimin e parë të Komitetit Shqiptar të Londrës morën pjesë personalitete të shquara si: Aubrey Herbert, Longworth, Mark Judge, Lordi Lamington që kishte ushtruar detyrën e guvernatorit të Qeeenslandit (1896-1901), të Bombeit (1903-1907) dhe u zgjodh nënkryetar i Komitetit Shqiptar, Tomas Baty sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (1905-1916) dhe personalitete të tjera. Komiteti ndërmori një fushatë kundër copëtimit të tokave shqiptare nga Aleanca Ballkanike. Për të sensibilizuar çështjen shqiptare, Herbert kishte ftuar një takim publik në Whitehall Rooms në Hotel Metropoll më 17 dhjetor 1912 ku organizoheshin takime politike të nivelit të lartë. Në takim morën pjesë njerëz me pikëpamje të ndryshme politike. Një numër prej tyre nuk ishin përkrahës të çështjes shqiptare, por ishin kundërshtarë të Aleancës Ballkanike dhe nuk pajtoheshin me zgjerimin territorial të Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë. Kishte edhe politikanë e diplomatë britanikë që mbronin parimin e vetëvendosjes kombëtare dhe insistonin që ky parim të vrente edhe për shqiptarët. Komiteti i Londrës konsideronte se:” Çështja e autonomisë shqiptare ndryshon ndjeshëm nga çështjet e shteteve të tjera të Ballkanit, sepse është çështje kombësie e jo feje”. Komiteti dënonte me forcë krimet e ushtrisë greke, serbe, malazeze dhe bullgare. Ai miratoi një rezolutë të përbashkët në të cilën kërkohej të respektoheshin të drejtat e shqiptarëve dhe popujve të tjerë. Për një periudhë të shkurtër kohore Komiteti ia arriti që rreth vetes të afronte dymbëdhjetë anëtarë të Parlamentit, dy anëtar të Dhomës së Lordëve, një këshilltar të kurorës, një anëtar të Gjykatës së Apelit dhe një Kryerabin.

Abrey Herbert dhe Komiteti Shqiptar bashkëpunoi me delegacionin shqiptar të Qeverisë së Ismail Qemalit i cili arriti në Londër në janar të vitit 1913 të cilët i paraqitën një memorandum Ministrisë së Jashtme Britanike ku përfshiheshin kërkesat e Qeverisë së Përkohshme Shqiptare.

Me 1 maj 1913 u organizua një takim i Komitetit Shqiptar të Londrës me kryetarin e Qeverisë së Përkohshme Ismail Qemalin. Me insistimin e Herbert u arrit të aranzhoheshin takime të shumta joformale të Ismail Qemalit dhe delegacionit shqiptar me përfaqësues të shtetit dhe politikanë të rangut të lartë britanik.

Komiteti i Londrës dha një kontribut të çmuar për çështjen shqiptare përgjatë kohës sa zhvillonte punimet Konferenca e Ambasadorëve.

Fjalët çelës: Komiteti i Londrës, Abrey Herbert, çështja shqiptare, sensibilizimi, Ballkani.

Dekada e parë e shekullit XX nisi me synime dhe lëvizje të reja politike në Ballkan dhe Evropë. Fuqitë e Mëdha ishin në garë për pozicione të forta gjeostrategjike në Evropë dhe koloni, kurse shtetet ballkanike në kërkim të territoreve të reja dhe konsolidimit të shteteve të tyre. Prandaj secili ishte në kërkim të partneritetit për interesa unilaterale dhe multilaterale brenda mundësive dhe hapësirave të veprimit politik, ushtarak dhe diplomatik. Fillimi i luftërave ballkanike, shpallja e pavarësisë së Shqipërisë dhe fillimi i punimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, krijoi në situatë të re në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo situatë shtroi nevojën për rritjen e intensitetit të aktiviteteve të brendshme dhe të jashtme, si dhe mobilizimin e përgjithshëm të shqiptarëve për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të tyre kombëtare, meqë ata deri tani nuk kishin arritur të krijonin me asnjërin nga Fuqitë e Mëdha marrëdhënie të ngushta partneriteti për shkak të pafuqisë së tyre politike, ushtarake dhe ekonomike.

Më 17 dhjetor 1912, rreth 19 ditë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, fuqitë e mëdha evropiane, si: Britania e Madhe, Gjermania, Rusia, Franca, Austro Hungaria dhe Italia organizuan një konferencë të paqes në nivel ambasadorësh në Londër.¹ Në këtë Konferencë do të merreshin vendime të mëdha dhe të rëndësishme për paqen, perspektivën dhe fatin e shumë popujve dhe shteteve. Fakti që fuqinë e vendimmarrjes do ta kishin vetëm fuqitë e mëdha nënkuptonte se popujt e vegjël ishin “ të privuar nga e drejta për vendimmarrje “ dhe nuk do të kishin mundësi që drejtpërdrejt përmes përfaqësuesve të tyre të mbronin interesat e veta, por duhej që përmes aleancave dhe partneritetit përmes linjave diplomatike të realizonin synimet e tyre.² Meqë Konferenca u vendos të mbahej në Londër, Britania e Madhe në cilësinë e nikoqirit kishte mundësinë që përfaqësohej nga shefi i diplomacisë britanike Sir Eduard Grey³, një politikan e diplomat i shquar dhe me eksperiencë i

¹ Ismail Qemal Vlora, *Kujtime*, Shtëpia Botuese “Grand Prind”, Tiranë 2007, f. 352. Titulli i origjinalit: “*The Memoaris of Ismail Kemal Bey*”, Edited by: Sommerville Story, with a preface by: Wiliam Morton Fulerton, Constable And Company LTD, London 1920.

² Frashër Demaj, *Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913*, Prishtinë 2017, f. 311.

³ Edward Grey, 1st Viscount Grey of Fallodon, KG, PC, DL, FZS (25 prill 1862 - 7 shtator 1933), i njohur më mirë si Sir Edward Grey, ishte një burrë shteti liberal britanik dhe forca kryesore pas politikës së jashtme britanike. Luajti rol të rëndësishëm gjatë zhvillimit të punimeve të Konferencës së Ambasadorëve 1912-1913 në Londër dhe në kohën e Luftës së Parë Botërore. Ai shërbeu si sekretar i jashtëm nga viti 1905 deri në 1916, mandati më i gjatë i vazhdueshëm i çdo mbajtësi të asaj detyre. Në vitin 1919 ai ishte një mbështetës kryesor britanik i

cili njëkohësisht ishte edhe kryetar i Konferencës. Kurse të tjerët përfaqësoheshin në nivel ambasadorësh dhe diplomatë të rangjeve të tjera. Austro-Hungaria përfaqësohej nga ambasadori Mensdorf, Gjermania nga ambasadori Lichnowski, Rusia nga ambasadori Bekendorf, Franca nga ambasadori Cambon dhe Italia nga ambasadori imperial⁴. Këto personalitete përfaqësuese të shteteve të fuqishme që po përcaktonin fatin e popujve të vegjël, gjatë gjithë kohës kur po zhvillonte punimet Konferenca, ishin në kontakte të drejtpërdrejta dhe të ngushta me ministritë e tyre të jashtme dhe asnjë vendim nuk mund të merrej pa konsulenca paraprake dhe miratim nga qeveritë e vendeve të tyre.

Në kohën e fillimit të Konferencës, zhvillimet politike dhe situata në shtetin e saposhpallur shqiptar ishte shumë e ndërlikuar, e paqartë dhe me shumë të panjohura të cilat vinin si rezultat i ndryshimeve të shpejta dhe relacionit të forcave në terren. Elita intelektuale shqiptare, jo shumë e madhe në numër e ndjente nevojën e një bashkërenditjeje të veprimeve politike dhe diplomatike dhe sensibilizimin e kauzës shqiptare në diplomacinë ndërkombëtare. Kjo elitë jounike dhe e paorganizuar si duhet, ndërmori aktivitete të ndryshme dhe kontakte me personalitete përfaqësuese të diplomacisë së Fuqive të Mëdha, si me konsuj, ambasadorë, politikanë, ish-politikanë dhe njerëz të tjerë me ndikim në politikëbërje dhe në diplomaci. Pra, shqiptarët krahas kryengritjeve kundër Perandorisë Osmane dhe rezistencës ndaj monarkive ballkanike të cilat i kishin filluar luftërat me qëllim të shkatërrimit dhe shpërbërjes së Perandorisë dhe ndarjes në mes tyre të “trashëgimisë“ së saj që nënkuptonte territoret shqiptare të shtrira në katër vilajete, duhej të siguronin përkrahje ndërkombëtare fillimisht për njohjen e shtetit të pavarur shqiptar dhe shtrirjen territoriale të këtij shteti. Në këtë rrugëtim pengesat kryesore ishin shtetet ballkanike, por edhe Perandoria Osmane cila u përpoq që të neutralizojë zemërimin e shqiptarëve dhe të bëjë përpjekje që t’i shfrytëzojë ata, të formojë një ushtri popullore e cila do të bashkëvepronte me atë osmane, kinse për mbrojtjen e tokave nga sulmet serbe, malazeze dhe greke.⁵ Çuditërisht, Stambolli pavarësisht se gjendej në frymën e fundit të ekzistencës së Perandorisë nuk gjente kurajo politike që t’u njihte shqiptarëve të drejtat e tyre kombëtare dhe shtrirjen e tyre

Lidhjes së Kombeve. Udhëheqës i Partisë Liberale në Dhomën e Lordëve midis 1923 dhe 1924.

⁴ Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, vëllimi I, Tiranë 2022, f. 148.

⁵ Frashër Demaj, *Pozita gjeografike, politike dhe popullsia shqiptare në dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe 1912-1918*, ASHAK, Prishtinë 2021, f. 118.

gjeografike në të katër vilajetet, por pretendonte edhe më tej që t'i përdorte ata në përpjekjet e fundit të saj për ruajtjen e Perandorisë. Qeveria e Stambollit i ftonte shqiptarët që, për shkak të rrezikut të përbashkët nga shtetet fqinje, të lënë anash armiqtë me regjimin xhonturk dhe të bashkohen "rreth kauzës së përbashkët". Ibrahim Pasha, kryekomandant i forcave ushtarake në vilajetin e Kosovës, i kishte ftuar të gjithë krerët shqiptarë në Prishtinë për të diskutuar për kërkesat e tyre dhe për mobilizim me reparte vullnetarësh për mbrojtjen e Perandorisë dhe të trojeve të tyre etnike⁶. Këto kalkulime politike të qeverisë osmane ishin në kuadrin e përpjekjeve për mashtrimin e radhës në marrëdhëniet e tyre me shqiptarët. Elita intelektuale shqiptare që ishte përcaktuar për angazhimet e veta në drejtim të realizimit të plotë të pavarësisë dhe shtetit shqiptar nuk kishte hamendje për refuzimin e "ofertës dashamirëse" të Stambollit, por një numër i funksionarëve politikë dhe ushtarakë të Perandorisë me kombësi shqiptare ishin të pajtimit për një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të plotë me Stambollin përballë situatës së krijuar në fund të vitit 1912 dhe në fillim vitin 1913. Pavarësisht nga polarizimi dhe luhatjet në njërin krah dhe tjetrin, interesi i shqiptarëve kërkonte që të bënin politikë të mençur edhe në raport me turqit, sepse acarimi i skajshëm i marrëdhënieve dhe luftërat e vazhdueshme midis tyre i dëmtonin interesat dypalëshe dhe më këtë rast përfitonin shtetet ballkanike. Por edhe afrimi i tepërt me Stambollin do të krijonte përshtypjen në diplomacinë ndërkombëtare, sikur shqiptarët nuk e kanë krijuar logjikën e kombit dhe shtetit, nuk kanë interesa kombëtare, por synimet e tyre ndërlidhën ngushtësisht me interesat dhe fatin e Perandorisë Osmane.

Për rrezikun nga acarimi ekstrem i marrëdhënieve shqiptaro-turke u diskutua edhe në takimin e Hasan Prishtinës dhe Nexhip Dragës me konsullin austro-hungarez në Shkup. Draga dhe Prishtinën kishin deklaruar se: "shqiptarët në tërësinë e tyre do të kthehen kundër armikut sllav. Ata pranuan se kanë blerë nga Serbia armë, por në rast nevojë me armët e saj do të luftohet Serbia"⁷. Por në anën tjetër ata nuk tregonin asnjë simpati dhe ndërlidhje të fatit të shqiptarëve me fatin e Perandorisë Osmane, por përtej fjalorit dhe qëndrimeve të matura politike ishin të bindur që lufta e shqiptarëve duhet të zhvillohej kundër çdo pushtuesi përfshirë këtu edhe luftën kundër pushtuesve osmanë. Takime të

⁶ Arkivi i Institutit të Historisë-Tiranë, më tej AIHT, Vj. 22-16-1670, nr. 56, Raport i nënkonsullit von Tahy nga Mitrovica, dërguar MPJ në Vjenë, më 1 tetor 1912.

⁷ AIHT, Vj-22-2023, Raport i konsullit austro-hungarez nga Shkupi, Nr. 67, dt. 8 tetor 1912, dërguar MPJ në Vjenë

shumta me konsuj, ambasadorë, politikanë dhe diplomatë u organizuan edhe nga personalitete të tjera shqiptare. Por nuk mbeten anash as aktivitetet dhe mobilizimi i shqiptarëve në terren. Nga burimet britanike bëhej me dije edhe mobilizimi i shqiptarëve të Vilajetit të Shkodrës myslimanë dhe të krishterë të përkushtuar të mbronin territoret e tyre. Mobilizimi i shqiptarëve bëhej sipas parimit të traditës së tyre ndër shekuj, mirëpo kishte ndonjë shqiptar religjioz të krishterë fanatik që ishte joshur nga premtimet e malazezëve dhe për arsye të urrejtjes ndaj turqve nuk dëshironin të merrnin pjesë në ndonjë luftë ku konsiderohej se do të përfitonte Perandoria Osmane.⁸ Në anën tjetër kishte edhe shqiptarë fanatikë myslimanë që për arsye të injorancës, bindjeve të tyre dhe ndikimit religjioz, pavarësisht nga thirrjet për dezertim nuk i lëshuan radhët e ushtrisë osmane.⁹ Kjo nënkupton se në të dyja anët e palëve ndërluftuese “pavullnetshëm” u gjendën shqiptarë të cilët duke menduar se po luftonin për kauzat e tyre, në fakt, ata (për aq sa ishte numri i tyre në palët ndërluftuese) po e luftonin njëri-tjetrin. Por, me gjithë këto ekstremeve një numër nizamësh shqiptarë nën urdhrat e komandantit Hasan Riza Pasha, mbrojtën Shkodrën deri në momentet e fundit. Për mobilizimin e burrave në Vilajetin e Shkodrës raportohej çdo ditë nga përfaqësuesit diplomatikë austro-hungarezë të cilët konstatonin se “të gjithë burrat e Shkodrës filluan të regjistroheshin vullnetarë për të mbrojtur kufirin me Malin e Zi”¹⁰.

Udhëheqësit e Lëvizjes kombëtare shqiptare kishin dy qëllime kryesore: të shpëtoheshin territoret shqiptare nga copëtimi dhe të njëihej shteti i pavarur shqiptar në gjithë kufijtë dhe shtrirjen etnike të tyre. Qëllimi i parë synohej të arrihej me vetorganizim të forcave vullnetare në mbrojtje të territorit dhe përkrahjes austro-hungareze e deri diku edhe të Italisë meqë shqiptarët nuk kishin armë dhe ushtri të organizuar, kurse qëllimi i dytë nuk mund të arrihej në asnjë mënyrë pa sensibilizimin e kërkesave politike në opinionin ndërkombëtar dhe pa përkrahjen e ndonjëres nga diplomacitë e Fuqive të Mëdha.¹¹ Kishte personalitete shqiptare të ngritura intelektualisht që mendonin se kauza e autonomisë dhe pavarësisë duhej të niste fillimisht në bisedimet me Portën

⁸ The National Archive-London, më tej TNA, Albania, FO /373/2/1, Fondi 132, Confidential, Handbooks prepared under the directions of the historical section of the Foreign Office-nr.16, (11), “Albania and Balkan Allies” f. 46.

⁹ Më gjerësisht, Frasher Demaj, *Shqiptarët në dokumentet diplomatike të Britanisë së Madhe 1911-1912*, Prishtinë 2019.

¹⁰ AIHT, Vj-22-12-1251, Telegram nga Shkodra, Nr. 65, dt. 3 tetor 1912.

¹¹ Frashër Demaj, *Pozita gjeografike...*f. 135.

e Lartë, të kërkohej me ngulm edhe përkrahja e Stambollit dhe të shfrytëzoheshin kapacitetet diplomatike osmane për ta ndihmuar çështjen shqiptare. Por më i madh ishte numri i kundërshtarëve të revoltuar të cilët mendonin se qeveria osmane nuk kishte asnjë minimum vullneti politik për të ndihmuar autonominë e shqiptarëve, sepse këta të fundit që nga viti 1910 me dhjetëra herë kishin kërkuar nga kjo qeveri që të përkraheshin kërkesat politike, arsimore e kulturore të shqiptarëve, por asnjëherë nuk kishin marrë përgjigje pozitive. Madje ata u mashtruan edhe nga regjimi i fundit (xhonturk) i cili për të përfutur përkrahjen e shqiptarëve u kishin premtuar atyre trajtim më të mirë pas ardhjes në pushtet përfshirë këtu edhe kërkesat e tyre politike. Mirëpo të gjitha së bashku mbeten në kuadër të kalkulimeve politike për blerjen e kohës dhe premtime të pambajtura nga Qeveria e Stambollit. Prandaj çdo përpjekje më shumë në situatën e krijuar pas fillimit të Luftës së Parë Ballkanike do t'i qonte shqiptarët në vetëmashtrim që do të kishte pasojë të pariparueshme për të ardhmen e tyre.

Ismail Qemali, Luigi Gurakuqi dhe ndonjë tjetër kishte bërë përpjekje të vazhdueshme në takime me ambasadorë e diplomatë të Fuqive të Mëdha dhe kishin arritur që të fitonin deri diku përkrahjen e Austro-Hungarisë dhe Italisë. Kurse Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi dhe tribunë të tjerë mundoheshin që përmes organizimit të rezistencës kundër osmanëve dhe pushtuesve të rinj me qëllim të mbrojtjes së territoreve dhe kufijve etnikë shqiptarë.

Shtetet ballkanike përveç koalicionit midis tyre për luftë të përbashkët dhe pushtime të reja ruajtën të drejtën t'i paraqitnin Konferencës së Ambasadorëve kërkesat e tyre territoriale, kërkesë të cilën Shqipëria nuk kishte të drejtë ta bënte¹², meqë ajo ende nuk e kishte fituar njohjen si shtet i pavarur dhe subjekt ndërkombëtar.

Duke parë synimet e Aleancës Ballkanike, këmbënguljen e Perandorisë Osmane dhe interesimin direkt të dy fuqive siç ishin Austro-Hungaria dhe Italia, shteti i shpallur shqiptar dhe territori i tij doli të jetë një vend shumë i rëndësishëm gjeostrategjik. Në Shqipëri gërshetoheshin interesat e të dy grupeve të mëdha politiko-ushtarake siç ishte Pakti Trepalësh dhe Blloku i Antantës të cilat kishin kontradikta të mëdha midis tyre dhe secili bashkë me aleatët e vegjël bënte përpjekje për të fuqizuar pozicionet e veta diplomatike dhe gjeostrategjike. Krijimi i një shteti të pavarur shqiptar shikohej me simpati nga Aleanca Trepalëshe, e cila shpresonte që këtë vend ta tërhiqte në orbitën e saj për shkak të ndikimit

¹² Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë 2007, f. 25.

që kishte Austro-Hungaria dhe Italia te shqiptarët, por edhe për shkak të përkrahjes së kauzës së tyre.¹³ Diplomacia austriake dhe italiane prej kohësh kishin shtuar prezencën e tyre përmes konsullatave, misionarëve katolikë, por edhe përmes agjenturave duke përdorur këtu kryesisht elementin katolik shqiptar dhe duke hapur shkolla në lokalitete të ndryshme në trevat shqiptare. Austro-Hungaria e shikonte Shqipërinë si barrierë të rëndësishme e cila do të pengonte shtrirjen e sllavizmit në Ballkan, kurse Italia e shikonte Shqipërinë në perspektivë si “bregun e pestë” që mund t’i shërbente si urë për depërtim në Lindje.¹⁴

Elita politike shqiptare dhe përkrahësit e paktë të saj ishin të bindur se duhet shfrytëzuar predispozimi austro-italian dhe duhej bërë përpjekje në vazhdimësi për shtimin e numrit të personaliteteve dhe shteteve që do të përkrahnin kërkesat e shqiptarëve në kuadrin e vendimeve që do të merrte Konferenca e Ambasadorëve në Londër. Për të arritur sa më shumë rezultate në përfaqësimin e interesave shqiptare, në kauzën antiosmane dhe në pengimin e shtrirjes së interesave pansllave, në Londër ishte formuar një grup njerëzish që direkt dhe indirekt përkrahnin kauzën shqiptare dhe e mori emrin “Komiteti Shqiptar në Londër”. Ky Komitet kishte tiparet e një organizate të themeluar dhe përfaqësuar nga politikanë, diplomatë, intelektualë, gazetarë, ish-funksionarë shtetërorë britanikë të cilët ishin kundërshtarë të rreptë të Aleancës Ballkanike.¹⁵ Ata në kohën e luftërave ballkanike ishin vënë në përkrahje të shqiptarëve dhe çështjes së tyre kombëtare duke kundërshtuar me forcë pushtimin e territoreve shqiptare nga Greqia, Serbia dhe Mali i Zi.

Në krye të Këshillit iniciues për formimin e Komitetit Shqiptar në Londër qëndronte Aubrey Herbert¹⁶ i cili në jetën parlamentare brita-

¹³ Frashër Demaj, *Pozita gjeografike...*f. 143.

¹⁴ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë 2009, f. 53.

¹⁵ Frashër Demaj, *Pozita gjeografike...*f. 153.

¹⁶ Aubrey Nigel Henry Molyneux Herbert (1880 – 26 shtator 1923) ishte një diplomat, udhëtar dhe oficer i zbulimit britanik i lidhur me pavarësinë e Shqipërisë. Dy herë iu ofrua fronin e Shqipërisë. Nga viti 1911 deri në vdekjen e tij ishte deputet konservator i Parlamentit. Aubrey ishte djali i dytë i Henry Herbert-it, Earl i 4-të i Carnarvon, (*Earl është titulli dhe grada më e vjetër e fisnikëve anglezë dhe ishte gjithashtu më e larta, deri në vitin 1337. Tani qëndron e treta për nga rëndësia, midis Markezit (1385) dhe Viskontit (1440)*), një pronar tokash i pasur, ministër i kabinetit britanik dhe Lord Toger i Irlandës dhe gruas së tij të dytë, Elizabeth Howard e Greystoke Castle, Cumberland, motra e Esme Howard. Ai ishte gjysmë vëlla i Xhorxh Herbertit, Konti i 5-të i Carnarvon, egjiptologu i famshëm që bashkëzbuloi varrin e mbretit Tutankhamon së bashku me Howard Carter. Aubrey u arsimua në Kolegjin Eton dhe Kolegjin Balliol, Universiteti i

nike u njoh si “avokat i kombeve të vogla”. Ai u bë një avokat i pasionuar edhe i pavarësisë së Shqipërisë, pasi kishte vizituar vilajetet shqiptare në vitet 1907, 1911 dhe 1913. Më 1912–1913 përfaqësuesit shqiptarë në Konferencën e Paqes në Londër e kishin të përhershme ndihmën e Herbertit i cili u shërbeu si këshilltar në momentet më të rëndësishme. Madje njohësit e rrethanave politike dhe diplomatike të kohës e vlerësonin Herbertin si njeriun më me ndikim në vendimin e Konferencës dhe Traktatit e Londrës (1913) që njohu pavarësinë e Shqipërisë. Ai së bashku me Edit Durham konsiderohen ndër miqtë më të mirë britanikë, përkrahës të kauzës së tyre në momentet më kritike për kombin dhe shtetin shqiptar.¹⁷ Herberti kishte arritur që të bashkonte rreth Komitetit edhe njerëz të tjerë me ndikim në politikën britanike të cilët fillimisht nuk kishin ndonjë simpati për shqiptarët të cilët nuk i njihnin nga afër, nuk e njihnin as kauzën e tyre, por i identifikonin me Perandorinë Osmane ndaj të cilës kishin rezerva të theksuara më shumë për arsye religjioze, por edhe për shkak të modelit të sistemit sulltanist dhe faktorëve të tjerë me bazë interesat politike, gjeostrategjike, ekonomike dhe tregtare.

Herberti në kohën kur kishte udhëtuar nëpër territoret shqiptare kishte takuar njerëz nëpër fshatra dhe qytete të cilët i kishin lënë mbresa si njerëz të dashur, mikpritës dhe shumë tradicionalë të udhëhequr nga traditat e tyre kanunore për besë ndaj mikut, bukëdhënë e të përzemërt pavarësisht se ishin të varfër dhe po vuanin shumë nga sundimi osman dhe ishin të preokupuar me fatin dhe të ardhmen e tyre meqë druheshin nga synimet e ushtrive serbe, greke dhe malazeze. Edhe shërbyesi i tij që quhej Qazim Kukeli një shqiptar nga Dibra i cili i qëndroi afër për një kohë të gjatë i dha mundësi Herbertit që të mësonte më shumë për nderin, besnikërinë dhe traditat shqiptare. Aubrey Herberti si një burrë me kulturë të gjerë dhe të përgjithshme ishte njohës i mirë i kulturës orientale dhe përveç gjuhës angleze fliste edhe frëngjisht, italisht, gjermanisht, turqisht, arabisht, greqisht dhe shqip.¹⁸ Pra ai duke qenë njohës i gjithë këtyre gjuhëve merrte informacione nga shumë njerëz në shumë

Oksfordit, ku mori një diplomë të klasit të parë në historinë moderne. Ishte mik me Adrian Carton De Wiart, Raymond Asquith, John Buchan, Hilaire Belloc dhe Reginald Farrer i cili mbeti i afërt gjatë gjithë jetës së tij.

¹⁷ Më gjerësisht Edith Durham, *Brenga e Ballkanit*, Tiranë 2009; Edit Durham, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë 2001; Edith Durham, *Shqipëria e Epërme*, Tiranë 2013.

¹⁸ <https://www.ladycarnarvon.com/>, The official website of the countess of Carnarvon; parë me 2 shkurt 2024.

gjuhë, dhe kjo i mundësonte atij të mos rrëshqiste në subjektivizëm për shkak të informacioneve të njëanshme dhe njëburimore.

Intensiteti i aktiviteteve të tij u intensifikua me të filluar konferenca e paqes, në dhjetor 1912, pas Luftës së Parë Ballkanike, në të cilën Turqia humbi pjesën më të madhe të territorit të saj në Evropë. Herberti punoi me energji dhe efektivitet për lirinë e Shqipërisë, sepse arriti të afronte rreth vetës personalitete të shquara publike të cilët u rreshtuan në anën e interesave të shqiptarëve duke konsideruar se ky popull po viktimizohej nga Perandoria Osmane, pushtimet e Aleancës Ballkanike dhe interesat kontraverse të Fuqive të Mëdha, të cilat po e mbanin peng fatin e një populli të vogël, të nënshtruar dhe të pambrojtur.¹⁹

Herën e fundit (1912) para se të shkonte në Stamboll, Herbert kishte vizituar edhe Vilajetin e Kosovës ku ishte njohur drejtpërdrejt me situatën e përgjithshme dhe me pozitën e vështirësuar të shqiptarëve për shkak të ngjarjeve të fundit. Ai kishte parë me sytë e tij dhe përjetuar bashkë me popullsinë shqiptare mjerimin në të cilin e kishte zhytur Perandoria Osmane këtë popull, të lënë pa arsimim, emancipim, mbrojtje, zhvillim ekonomik dhe pa perspektivë kombëtare duke ua mohuar edhe qenësinë e ndjesinë shqiptare dhe duke i konsideruar ata si turq (popullsinë shumicë shqiptare muhamedane). Ai në rrugëtimin e tij për në Pazar të Ri, në gusht të vitit 1912 kishte ndaluar në Mitrovicë, kishte takuar shumë njerëz, në mesin e tyre edhe Isa Boletinin, të cilin ai e përshkruan si Robin Hudin e Shqipërisë.²⁰ Në mëngjesin e 25 gushtit 1912, në Pazar të Ri, Herbertit i kishte mbërritur një telegram nga Isa Boletini, i cili e garantonte sigurinë fizike të tij. Në telegram në mes tjerash thuhej se: nëse dikush do të guxonte të lëndonte Herbertin, hakmarrja e tmerrshme do të binte mbi ata që do ishin përgjegjës”.²¹ Kjo dalje zot e personalitetit të Abrey Herbertit nga ana e Isa Boletinit e bëri atë të ndjehej si “hero i momentit” që po mbrohej nga figura më e njohur militante e një udhëheqësi të masave popullore shumë autoritativ dhe i pushtetshëm. Madje Herberti shkon edhe më larg duke e ndier dhe konsideruar si nderim të veçantë që po i bënte atij një prijës i lartë shqiptar dhe bazuar në traditën e këtij populli, ai si mik i këtij populli zë një pozitë të lartë nderi në traditën dhe kulturën shqiptare. Të

¹⁹ Jeffrey Meyers, *Aubrey Herbert, the man who would not be king*, <https://www.thearticle.com/>, parë me 12 shkurt 2024.

²⁰ Robert Elsie, *Aubrey Herbert: A Meeting with Isa Boletini*, Extract from *Aubrey Herbert: Ben Kendim, a Record of Eastern Travel* (London: Hutchinson & Co., 1924), p. 198-213.]

²¹ Po aty, f. 2.

gjitha këto detaje ndikuan pozitivisht në angazhimin e Herbertit për interesat shqiptare dhe në miqësinë e ngushtë që krijoi në muajt në vijim me Isa Boletinin gjatë kohës së qëndrimit të Isait në Londër.

Herberti në kujtimet e tij, ndër të tjera, i përshkruan shqiptarët si njerëz shumë mikpritës e bujarë, por edhe të trima e ngatërrestarë të cilët nuk përtojnë të hidhen në armë. Madje në një letër të ruajtur nga ana e tij ai flet për “Rifatin, një burrë me shtat të hedhur, me tre vëllezër sa ai vetë”, që një ditë e kishte shoqëruar. Rifati i kishte thënë Herbertit se kishte vrarë dymbëdhjetë burra në një luftë në atë verë...”. Mirëpo britanikut nuk i pëlqente vetëlavdërimi i Rifatit që ishte në ekipin e eskortës së tij, por i duhej ta duronte deri në përfundimin e ekspeditës së tij në Pazar të Ri. Në një nga letrat e tij dorëshkrim, Herberti thoshte për Rifatin se: “Nuk kam takuar kurrë një turk apo një shqiptar që të mburrej me burrat që kishte vrarë më parë dhe nuk do të më vinte aspak keq nëse ai do të qëllohej me plumb”.²² Pra Herberti duke qenë një burrë me kulturë të gjerë dhe nivel i lartë prej diplomati nuk i pëlqente “ngatërrestarët” e vetëlavdëruesit, sidomos kur bëhej bilanc për vrasjen e njerëzve pavarësisht kombësisë së tyre dhe veprimtarive që ata ushtronin në jetën e tyre.

Eskorta e Herbertit u kthye prapë në Mitrovicë dhe ai u takua me konsujt e Austro-Hungarisë dhe Rusisë të cilët kishin shfaqur mos-pajtimet mes tyre lidhur me çështjet për të cilat kishte shfaqur interesim britaniku. Në mbrëmje, Herberti ishte i ftuar në darkë nga austriakët me të cilët kishin shkëmbyer shumë mendime dhe ide për çështje të rëndësishme sidomos për interesat dhe kërkesat e shqiptarëve disa prej të cilave i kishte mbledhur nga njerëz të zakonshëm nëpër fshatra dhe qytete dhe i kishte shënuar në mënyrë të përmbledhur. Ndër kërkesat kryesore të shqiptarëve të zakonshëm të paarsimuar dhe që nuk shërbenin në administratën osmane, myslimanë e të krishterë ishin: Shkolla ku do të mësohet shqip; zyrtarë që dinë gjuhën shqipe; më shumë vëmendje për fenë; armë për të gjithë njësoj, të krishterë dhe muhamedanë; shkolla bujqësore dhe ankesa të shumta për pushtetin osman dhe për Haki Pashën.²³

Ende pa përfunduar darka, Herberti mori një mesazh ku thuhej se e priste jashtë qytetit Isa Boletini. Ftesën nuk e mbajti të fshehur nga austriakët të cilët i falënderoi për darkën dhe me shumë sens diplomatik u largua për t’u takuar me Isa Boletinin.

²² Po aty, f. 3.

²³ Po aty, f. 4.

Isa e priste Herbertin në një nga Hanet e qytetit i rrethuar nga shoqëruesit e tij malësorë besnikë të armatosur. Isa shoqërohej me njërin nga djemtë e tij, një djalë i pashëm, i cili qëndroi në dhomë për të përkthyer në italisht-shqip bisedat që do zhvilloheshin në mes Herbertit dhe Isa Boletinit.

Diplomati britanik që në nisje të bisedës e kishte falënderuar për telegramin mbështetës me të cilin i garantonte lirinë e tij dhe sigurinë fizike të delegacionit që udhëhiqte. Isa ishte deklaruar se shqiptarët e donin Anglinë dhe shpresonin që anglezët t'i përkrahnin shqiptarët në synimet e tyre për mbrojtjen nga sulmet e Aleancës Ballkanike dhe t'u garantonin shqiptarëve lirinë e tyre. Kurse Herberti në kujtimet e tij e profilizonte Isain si njeri të ndershëm dhe trim që e donte popullin dhe vendin e tij për interesat e të cilit ishte i gatshëm të sakrifikohej, por që nuk shquhej për politikë as diplomaci, sepse mendimet e tij i thoshte troç, sidomos kur bëhej fjalë për turqit, serbët dhe malazezët të cilët i fajësonte për tragjedinë që kishte përjetuar populli i tij.

Përderisa Herberti dhe Isa vazhdonin bisedën në mes tyre, jashtë ish-in dëgjuar disa të shtëna nën dritaret e Hanit ku po qëndronin. Isa kishte tërhequr një perde të vogël dhe kishte shikuar në dritën e hënës pa u shqetësuar shumë për rrezikun. Ndërkohë ushtarët e tij hyjnë në dhomë dhe lajmërojnë Isën se ish-in të rrethuar nga turqit. Isa u hodh këmbë mori pushkën në dorë dhe i tha Herbertit: "Shtëpia është e rrethuar nga turqit, unë do të luftoj për të dalë nga rrethimi".²⁴ Herberti ishte përgjigjur se nuk kishte frikë nga turqit, sepse nuk kishte bërë asgjë të kundërligjshme dhe ishte i gatshëm të dilte me Isën dhe në rast se do të kapej Isa Boletini nga turqit "nuk do të lejonte që ta pushkatonin". Kurse Isa nuk e kishte lejuar Herbertin të dilte jashtë, por të qëndronte brenda ku nuk kishte rrezik me djalin e tij, sepse nderi dhe tradita shqiptare e kërkojnë që miku të ruhet dhe të mbrohet derisa të kthehej ai. Isa me njerëzit e tij pas pak kohësh u kthyen sërish pas një përleshjeje të shkurt nga e cila nuk u lëndua askush, meqë nizamët turq ish-in larguar. Këtë skenë, Herberti në kujtimet e tij e përshkruan si një ngjarje të veçantë edhe për nga mënyra se si shoqëruesit e Isa Boletinit të shkathët, trima dhe të bindur reagan shpejt dhe në mënyrë efikase për ta mbrojtur udhëheqësin e tyre.²⁵

Ata vazhduan sërish bisedën ku Isa foli sërish për marrëdhëniet e acaruar të shqiptarëve me turqit ku hetohej njëfarë hezitimi për të

²⁴ Po aty, f. 5.

²⁵ Po aty, f. 9.

gjykuar Sulltanin, duke konsideruar se njerëzit e kqinj janë qeveritarët lokalë të cilët ushtronin presion ndaj popullsisë shqiptare. Hezitimi për ta gjykuar Sulltanin mund të vlerësohet si taktikë e tij për shkak të besnikërisë së shumë njerëzve ndaj tij, shqiptarë të cilët Isai mendohej t'i përvetësonte për kauzën e tij dhe rrezikut nga ndonjë arrestim i mundshëm për shkak të atakimit të figurës së Sulltanit. Ai gjithashtu ishte i preokupuar për Kosovën dhe Malësinë e Shkodrës dhe në bisedë me Herbertin deklaronte se gjithë burrat e Kosovës dhe Malësisë duhet të ngritën burrërisht në luftë kundër tiranëve dhe pushtuesve të rinj për t'u bashkuar me vëllezërit e tjerë të Shqipërisë së lirë.²⁶ Isa Boletini ishte besimplotë se angazhimi i drejtpërdrejtë dhe intensiv i Herbertit do të ndikonte pozitivisht në ndryshimin e qëndrimeve në favor të shqiptarëve në diplomacinë britanike. Prandaj ai e kishte pyetur direkt Herbertin se çka do të bënte ai për të ndihmuar shqiptarët kur të kthehej në Londër? Kurse ky i fundit ishte përgjigjur se me kënaqësi do të bënte gjithçka që ishte në mundësitë e tij, sepse e admironte popullin shqiptar, si një popull trim, mikpritës e me vlera tradicionale dhe përpjekjet e tij për liri. Ndonëse Herbertit i dukej patetik besimi i madh që shqiptarët kishin në drejtësinë ndërkombëtare duke harruar se në politikë dhe diplomaci ka përfaqësim të interesave politike ekonomike, gjeostrategjike e assesi nuk demonstrohet fuqia e drejtësisë për popujt në nevojë që luftonin për lirinë e tyre, megjithatë ai ishte i bindur që suksesi i kauzës shqiptare mund të rezultonte pozitivisht nëse udhëheqësit e këtij populli do të krijonin më shumë lidhje miqësore me grupin e vendeve që përbënin Fuqitë e Mëdha.

Aubrey Herberti e vizitoi edhe Pejën dhe në takim me shumë shqiptarë, ai konstatonte se për ata më e rëndësishmja ishte liria dhe pavarësia e vendit të tyre dhe moslejimi i forcave ushtarake serbe e malazeze për pushtimin e tyre. Pra, ata nuk pajtoheshin në asnjë mënyrë që nga pushtimi osman të kalonin në pushtimin serb e malazez. Më së shumti përshtypje atij i kishte lënë fjetja në një Han të madh me njëzet e më shumë veta në një dhomë, me një zjarr të madh që digjej në vatër dhe pyetja e hanxhiut trupmadh shqiptar "Si do të shkojë gjithë kjo punë?". Pra hanxhiu ishte interesuar për fatin e tij dhe të popullit të tij duke menduar që një burrë fisnik nga Anglia siç ishte Herberti dinte më shumë për fatin e Pejës dhe të popullit shqiptar. Kjo ishte një nga pyetjet më të vështira për t'iu përgjigjur, sepse jo vetëm Herberti, por asnjëri, qoftë edhe ata që me vendimet e tyre do të vendosnin për fatin e

²⁶ Përlindja e Shqipëniës, Prishtinë 2012, f. 38.

shqiptarëve dhe popujve të tjerë nuk ishin në gjendje t'u përgjigjeshin dilemave të tilla.

Ai kishte takuar edhe nizamë e xhandarë me kombësi shqiptare që shërbenin në ushtrinë dhe xhandarmërinë osmane. Ankesat e xhandarëve ishin të njëjta si gjithmonë - paga e vogël, shumë punë, pa konsideratë, internim i gjatë; por ankesa e vërtetë e shqiptarëve, e para dhe e fundit, është se nderi dhe liria e tyre nuk merren parasysh sa duhet. Pra ata pavarësisht nëse ishin myslimanë apo të krishterë, ishin të pakënaqur me trajtimin e të drejtave të tyre kombëtare nga ana e qeverisë së Stambollit dhe interesi i tyre kombëtar ishte faktor vendimtar që i bashkonte ata. Kjo pakënaqësi kishte shtuar edhe radhët e dezertimit të nizamëve dhe oficerëve shqiptarë të ushtrisë osmane të cilët ishin të bindur se bashkimi me kryengritjen antiosmane është e ardhmja e tyre më e mirë. Natyrisht një numër i nizamëve shqiptarë mbetën në radhët e ushtrisë osmane për arsye të ndryshme nga të cilat dominonte frika nga hakmarrja e shtetit ndaj nizamëve dhe familjeve të tyre, mungesat e theksuara të emancipimit kombëtar dhe indoktrinimi religjioz. Për një homogjenizim ndërshqiptar dhe bashkim të nizamëve dhe punonjësve të administratës osmane me kombësi shqiptare, fliste edhe Ismail Qemali në deklaratimet e tij publike kur deklaronte se: "Të gjithë shqiptarët, myslimanë, katolikë apo ortodoksë janë të bashkuar për të mbrojtur të drejtat e kombit dhe për të ruajtur pavarësinë e Shqipërisë".²⁷ Këto deklarata Ismail Qemali i përsëriste forcërisht në intervistat e tij për gazetatat dhe revistat evropiane, për të hequr çdo dilemë rreth kauzës së tyre dhe për të mobilizuar gjithë potencialin kombëtar rreth interesave të përbashkëta.

Me t'u larguar nga Kosova, Herberti kaloi disa javë së bashku me bashkëshorten e tij në Stamboll ku takoi miq e bashkëpunëtor të ambasadës britanike. Ai pas kthimit në Londër kishte vendosur të ndërmerre një fushatë kundër copëtimit të tokave shqiptare të Turqisë europiane nga Aleanca Ballkanike.²⁸ Për këtë arsye ai kishte ftuar një takim publik në Whitehall Rooms në Hotel Metropoll më 17 dhjetor 1912 ku organizoheshin takime politike të nivelit të lartë. Ftesa e Hebertit kishte zgjuar interesim të madh meqë te pjesëmarrësit nuk e kishin shumë të

²⁷ Ilir Ikonomi, *Udhëtimi i paharruar i Ismail Qemalit*, UET/PRESS, Tiranë, 2012, f. 263

²⁸ Ben Kendim: a record of eastern travel / by Aubrey Herbert; edited by Desmond MacCarthy; Bejtullah Destani, Jason Tomes, *Miku më i madh i shqiptarëve Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme, Ditarë dhe Letra 1904-1923*, Prishtinë 2020, f.162.

qartë qëndrimin dhe konceptin e tij politik lidhur me ngjarjet në Ballkan, Luftën e Parë Ballkanike, fatin e Perandorisë Osmane, shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe kërkesat politike të këtyre të fundit. Në takim morën pjesë njerëz me pikëpamje të ndryshme politike, konservatorë, liberal socialistë etj. Një numër prej tyre nuk ishin përkrahës të çështjes shqiptare, por ishin kundërshtarë të Aleancës Ballkanike dhe nuk pajtoheshin me zgjerimin territorial të Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë, por kishte edhe politikanë e diplomatë britanikë që mbronin parimin e vetëvendosjes kombëtare dhe insistonin që ky parim të vrente edhe për shqiptarët sikurse për popujt e tjerë ballkanikë. Britanikët përkrahës të çështjes shqiptare konsideronin se: "Çështja e autonomisë shqiptare ndryshon ndjeshëm nga çështjet e shteteve të tjera të Ballkanit, sepse është çështje kombësie e jo feje".²⁹ Bindjen se çështja shqiptare ndërlihet ngushtë me lirinë dhe pavarësinë kombëtare të një populli të sunduar prej më shumë pesë shekujve e kishin avancuar edhe personalitete britanike siç ishin C. F. Ryder, z. Mark Judge, z. J. C. Paget dhe major Paget. Madje majori Paget, i cili kishte jetuar në Shkodër, dhe Herberti që kishte vizituar krahina shqiptare e kishin kuptuar në esencë se shqiptarët pavarësisht nëse ishin muhamedanë apo të krishterë ishin të lidhur ngushtë me kombësinë dhe territoret e tyre për të cilat shumica ishin të gatshëm të bashkoheshin dhe të luftonin kundër secilit që synonte t'i pushtonte ata.³⁰ Shumica e pjesëmarrësve që u bënë pjesë e Komitetit të Londrës ishin edhe antirus të përbetuar dhe nuk pajtoheshin me ndikimin e Ruisë në territoret e Evropës Juglindore. Këta politikanë me eksperiencë, ndikimin rus tek aleatët ballkanikë e shihnin si urë lidhëse e Petrogradit drejt Pellgut të Mesdheu që për politikën britanike paraqiste kërcënim të vazhdueshëm strategjik të interesave të ishullorëve. Këto konstatime ishin shumë të sakta, sepse britanikët dhe rusët shpeshherë ishin përplasur politikisht dhe kërcënuar njëri-tjetrin ushtarakisht për shkak të pozicioneve të rëndësishme strategjike.

Në takimin e parë të Komitetit Shqiptar morën pjesë personalitete të shquara dhe të tjerë që e përkrahen pa rezervë si: Aubrey Herbert, Longworth, Mark Judge, Lordi Lamington që kishte ushtruar detyrën e

²⁹ Bejtullah Destani, Jason Tomes, *Miku më i madh i shqiptarëve Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme, Ditarë dhe Letra 1904-1923*, Prishtinë 2020, f.164.

³⁰ Robert Elsie, Aubrey Herbert: *A Meeting with Isa Boletini*, Extract from Aubrey Herbert: *Ben Kendim, a Record of Eastern Travel* (London: Hutchinson & Co., 1924), p. 198-213., f. 10.

gubernatorit të Qweenslandit (1896-1901), të Bombeit (1903-1907) dhe u zgjodh nënkryetar i Komitetit Shqiptar, dr. Tomas Baty sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (1905-1916), Arthur Diasy shkrimtar, Robert Cuninghame-Graham, politikan me prirje socialiste me kombësi skoceze, Amer Ali, Syed Shahjahan, L. Cranmer Byng,, S.L. Bensusan, O. Brilliant, M. Gaster, M. A. Hafeez, J. E Hayes me bashkëshorten, Sybil Judge, M. R. Russell, Lightbody,, Duse Mohammed, dr. Sayed A. Majid, Dr. J. Pollen, Thos Dundas Pillans, J.C. Paquet, Arthur Price, Dr MacGregor Reid, Charls Rosher, C.F. Ryder dhe personalitete të tjera me orientime nacionaliste, konservatore, liberale dhe socialiste.³¹

Komiteti bëri një deklaratë të përbashkët ku në mes tjerash shprehej për të drejtat e shqiptarëve, myslimanëve, vllahve dhe hebrenjve të Ballkanit. Nga ana tjetër dënonte me forcë krimet e shëmtuara të ushtrisë greke, serbe, malazeze dhe bullgare ndaj shqiptarëve të cilët u trajtuan në mënyrën më mizore në Luftën Ballkanike. Herberti duke njohur marrëdhëniet e acaruar në mes tyre konstatonte se popujt ballkanikë janë aq të armiqësuar mes tyre saqë janë të gatshëm t'i heqin kokën njëri-tjetrit. Ai kishte një simpati të veçantë për shqiptarët dhe deklaronte se ata janë shumë bujarë, besnikë, të ndershëm, hakmarrës, të ashpër, shumë tradicionalë dhe luftëtarë të shquar të cilët për shkak të qëndrimit të gjatë nën Perandorinë Osmane janë të gatshëm të luftojnë deri në fund e të mos bien nën sundimin e pushtuesve të rinj.

Komiteti miratoi një rezolutë të përbashkët në të cilën kërkohej të respektoheshin të drejtat e shqiptarëve dhe popujve të tjerë. Kjo rezolutë iu dërgua edhe gazetave britanike por ato nuk e botuan. Megjithatë Komiteti pagoi gazetën "The Times" për ta botuar rezolutën e Komitetit Shqiptar në Londër. Pas këtyre aktiviteteve Komiteti ishte i bindur se kishte dhënë një kontribut të çmuar meqë më 20 dhjetor 1912 Konferenca kishte miratuar në parim shtetin autonom shqiptar. Komiteti për një periudhë të shkurtër kohore ia arriti që rreth vetes të afronte dymbëdhjetë anëtarë të Parlamentit, dy anëtar të Dhomës së Lordëve, një këshilltar të kurorës, një anëtar të Gjykatës së Apelit dhe një Kryerabin.³² Shtimi i radhëve të Komitetit Shqiptar ndikoi në masivizimin e kauzës shqiptare dhe popujve të tjerë të shtypur dhe ashpërsoi kontradiktat në mes komiteteve lobuese kundërshtarë me njëra-tjetrën.

³¹ Bejtullah Destani, Jason Tomes, *Miku më i madh i shqiptarëve Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme, Ditarë dhe Letra...* f. 165.

³² Bejtullah Destani, Jason Tomes, *Miku më i madh i shqiptarëve Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme, Ditarë dhe Letra...* f. 177.

Komiteti Shqiptar e kundërshtonte Komitetin Ballkanik dhe Komitetin Anglo-Grek (The Anglo-Hellenic of Salonica, Manchester, London, Salonica) të cilët ishin shumë aktivë në çështjet e lobimit dhe përkrahte pretendimet territoriale të shteteve ballkanike në kurriz të tokave shqiptare. Komitetin Anglo-Grek, shkonte aq larg sa që kërkonte shpërblim nga ana e britanikëve për kontributin e Greqisë për kulturën evropiane. Shpërblimi për grekët nënkuptonte përkrahjen britanike për pushtimin e krahinave shqiptare nga Greqia.³³ Herberti e gjykonte Komitetin Ballkanik dhe kërkonte që para përkrahjes së pretendimeve të monarkive ballkanike do të duhej t’i gjykonte dhe t’i dënonte krimet e serbëve ndaj shqiptarëve dhe ato të bullgarëve kundër myslimanëve të cilat Herbert i quante “barbarizëm i paharrueshëm dhe i pafalshëm”.³⁴ Ai në një letër që i dërgonte Filip Graves, korrespondenti i “The Times” në Stamboll deklaronte se Londra do të bënte gabim të madh nëse do t’i përkrahte serbët të cilët bënë shumë krime ndaj shqiptarëve dhe “nuk dinë gjë tjetër veç hanë derra dhe i çajnë barkun mbretëreshës së tyre”.³⁵ (fjala është për vrasjen e Mbretëreshës Draga të Serbisë në vitin 1903 pas një grushtshteti ushtarak).

Komiteti i Londrës bashkëpunoi me delegacionin shqiptar të Qeverisë së Ismail Qemalit i cili arriti në Londër në janar të vitit 1913. Ky delegacion përbëhej nga Mehmet bej Konica, Rashik bej Dino dhe Filip Noga të cilët i paraqitën një memorandum Ministrisë së Jashtme britanike ku përfshiheshin kërkesat e e Qeverisë së Përkohshme shqiptare.³⁶

Më 5 shkurt 1913 u mbajt mbledhja e radhës e Komitetit. Në këtë mbledhje të kryesuar nga Herberti merrnin pjesë edhe C.F Abbott, Madmuazel Elise Aybrey, dr. Tos Baty, S. L Bensusan, O. Brilliant, L. Cranmer Byng, Josee Dowling, Mark H. Judge, Lord Lamington, F.S. Noli, J.C. Paget etj. si dhe Mehmet Konica e Filip Noga. Delegacioni shqiptar në emër të Qeverisë së Vlorës shprehu mirënjohjen e thellë për punën që kishte bërë Komiteti Shqiptar i Londrës në favor të çështjes shqiptare.³⁷ Dr. Gaster një nga anëtarët e Komitetit vlerësonte që ishte

³³ TNA, FO. 320/1 Grand Livre nr. 03.

³⁴ Bejtullah Destani, Jason Tomes, *Miku më i madh i shqiptarëve Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme, Ditarë dhe Letra...* f. 179.

³⁵ Po aty f. 181.

³⁶ TNA, FO. 421/287, E 2031, Part 1, Correspondence respecting the Affairs of Albania, f.2.

³⁷ TNA, FO. 421/287, E 2031, Part 1, Correspondence respecting the Affairs of Albania, f.4.

shumë me rëndësi të vazhdonte sensibilizimi i opinionit publik dhe politik më qëllim që njerëzit të njoftoheshin saktë me kërkesat e shqiptarëve e të mos bien pre e propagandës së shteteve ballkanike dhe aleatëve të tyre në kohën kur po vazhdonin seancat e Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Komiteti konstatonte se në Shqipëri ekzistonin besimet fetare katolike, ortodokse dhe muhamedane, por shqiptarët kërkonin të njiheshin si popull unik pavarësisht nga feja e tyre.³⁸ Ata janë ndër popujt më të vjetër në Europë, prandaj shteti dhe kufijtë e tyre në Ballkan duhet të përcaktohen nga linja etnike. Çfarë kuptimi ka pretendimi i malazezëve për Shkodrën kur mbi nëntëdhjetë për qind e popullsisë janë shqiptarë etnikë të krishterë dhe muhamedanë. Të gjithë së bashku i mobilizon gjuha, historia dhe lidhjet familjare e etnike që janë lidhje aq të forta sa që këtë mund ta kuptojnë vetëm ata që e njohin këtë popull. Një konstatim përafërsisht të tillë e kishte bërë publik edhe ministri i Jashtëm britanik sër Eduard Grey kur ishte pyetur për përbërjen etnike dhe historinë e Gjakovës dhe Shkodrës kur bëhej fjalë për përfshirjen e krahinave etnike brenda shtetit shqiptar dhe ballafaqimit të këtyre fakteve me synimet serbe për pushtimin e tokave shqiptare.

Ndërkohë përderisa po vazhdonte Konferenca e Ambasadorëve më 29 prill 1913³⁹ kryetari i Qeverisë së Përkohshme Shqiptare, Ismail Qemali, i shoqëruar nga Isa Boletini një nga prijësit kosovarë i cili tashmë ishte emëruar komandant i "Milicisë Kombëtare Shqiptare" nisen një turne lobimi me përfaqësuesit e diplomacisë ndërkombëtare që përbënin grupin e Fuqive të Mëdha. Një kontribut të çmuar e dha Komiteti ku me insistimin e Herbert u arrit të aranzhoheshin takime të shumta joformale të delegacionit shqiptar me përfaqësues të shtetit dhe politikanë të rangut të lartë britanik. Më 1 maj 1913 u organizua një takim i Komitetit Shqiptar të Londrës me kryetarin e Qeverisë së Përkohshme Ismail Qemalin. Herbert pasi hapi mbledhjen e deklaroi prezencën e Ismailit në takim dhe kërkoi prej tij që t'u drejtohej atyre me një fjalë rasti. Pas fjalës përshëndetëse dhe falënderuese për kontributin e Komitetit, kryeministri shqiptar deklaronte: "Qeveria e Përkohshme e Shqipërisë ka shpresë të madhe të përkrahja e kombit anglez dhe një nga dëshmitë e përkrahjes është edhe pritja dhe përkrahja e Komitetit në Londër. Është në nderin tim që në emër të popullit shqiptar, përzemërsisht të falënderoj kryetarin dhe anëtarët e Komitetit për angazhimin e

³⁸ Po aty.

³⁹ Bejtullah Destani, Jason Tomes, *Miku më i madh i shqiptarëve Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme, Ditarë dhe Letra 1904-1923*, Prishtinë 2020, f. 202.

tyre në interes të çështjes tonë kombëtare theksonte Ismail Qemali. Shqiptarët që përbëjnë elementin më të vjetër etnik në Ballkan dhe kanë luftuar për të fituar të drejtën e kombësisë kërkojnë që përpjekjet e tyre të kurorëzohen me sukses. Për fat të keq fqinjët tanë të dehur nga fitoret e tyre kanë shpërfillur të drejtat e shqiptarëve deri në atë masë sa që dëshirojnë të na lënë pa trashëgimi. Prandaj kombet e qytetëruara e posaçërisht britanikët të cilët përfaqësohen kaq mirë në Komitetin tuaj, e kanë marrë përsipër me kaq fisnikëri që të mbrojnë çështjen tonë kombëtare.⁴⁰

Ismail Qemali në fund të takimit me mirësjellje e sens prej diplomati të rryer, me fjalë të zgjedhura, në emër të popullit shqiptar e falënderoi Komitetin dhe vlerësoi politikanët konservatorë e liberalë dhe Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar për mirëkuptimin dhe përkrahjen që i kanë ofruar dhe po i ofrojnë popullit dhe Qeverisë së Përkohshme Shqiptare.

Aubrey Herberti në kujtimet e tij i vlerësoi secilin nga shqiptarët personalitete të shquara që kishte njohur. Për Ismail Qemalin thoshte se e njohu në moshë të shtyrë dhe bindja e tij ishte se ai dukej një burrë i mençur, i urtë e dashamirës, nga pikëpamja politike dukej liberal dhe ishte shumë i preokupuar për të ardhmen e popullit të tij. Por ajo që i kishte lënë më shumë mbresë në pamjen e Ismailit ishte ngjyra blu e syve dhe thellësia e shikimit të këtij njeriu që kishte durimin dhe ngadalësinë e breshkës. Kurse për veshjen e tij, Herberti thoshte se po t'i hiqje fesin e kuq, stili dhe shija e veshjes së tij ishin krejt evropiane.⁴¹ Figura të shquara dhe burra me mend i quante edhe Fan Nolin dhe Faik Konicën që ishin përfaqësues të Federatës Shqiptare “Vatra” në Amerikë.⁴² Filip Noga sipas bindjeve të Herbertit ishte një katolik i përkushtuar për çështjen e kombësisë së vet dhe pëlqente edhe muzikën. Kurse personaliteti më karakteristik sipas Herbertit ishte Isa Boletini të cilin ai e quante “Robin Hudi i shqiptarëve”, një burrë me autoritet në vendin e tij, nuk ia thoshte asnjë fjalë në anglisht, por ishte burrë i fjalës dhe i besës. Këto përshtypje, kryetari i Komitetit të Londrës i kishte krijuar në bisedat e gjata që kishte pasur me Isain edhe në Londër. Isa Boletini i përsëriti sërish Herbertit qëndrimet e tij të deklaruara më parë se nëse Londra nuk i merr parasysh të drejtat e shqiptarëve, ata janë gati të

⁴⁰ Bejtullah Destani, Jason Tomes, *Miku më i madh i shqiptarëve Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme, Ditarë dhe Letra 1904-1923*, Prishtinë 2020, f. 207.

⁴¹ Ilir Ikonomi, *Pavarësia, udhëtimi i paharruar i Ismail Qemalit*, Tiranë 2012, f. 18.

⁴² Më gjerësisht, Fotaq Andrea, *Faik Bej Konica dhe Baroni Julius Zwiedinek, Letërkëmbim 1897-1912, “Albania” dhe Vjena*, Prishtinë 2020.

marrin armët dhe krejt natyrshëm të luftojnë për të drejtat e veta për ta bindur Evropën e qytetëruar se janë të gatshëm të bëjnë çdo gjë për lirinë e tyre.⁴³ Shqiptarët e Kosovës, të Hotit dhe të Grudës do të luftojnë derisa të mos mbetet këmbë burri në ato troje kishte thënë Isa në konakun e Aubrey Herbertit në Londër. Shtëpia e Herbert-it në Londër ishte bërë qendër e shqiptarëve përgjatë kohës sa zhvillonte punimet Konferenca e Ambasadorëve.

Dashamirësinë ndaj shqiptarëve Herberti e kishte shprehur edhe me rastin e vizitës së tij në Shqipëri në vjeshtë të vitit 1913. Gazeta “Përlindja e Shqipëniës” i kishte kushtuar një artikull duke e vlerësuar shumë lart personalitetin e Herbertit. Ai shkruante gazeta ka ardhur në Shqipëri për të marrë pjesë në gëzimin e popullit shqiptar për të cilin u përpoq me aq fuqi sa kishte për të mbrojtur të drejtat e këtij kombi.⁴⁴ Herberti e vizitoi Shkodrën ku u prit me entuziazëm e shumë respekt nga banorët shkodranë të cilët kishin dëgjuar për përkrahjen e tij të madhe për shqiptarët. Pas Shkodrës ai vizitoi Vlorën ku u prit nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe personalitete të shquara jo vetëm nga Vlora, por nga e gjithë Shqipëria të cilët gjendeshin në Vlorë duke u marrë me punët e Qeverisë. Herberti ishte ndarë shumë i kënaqur me pritjen e organizuar nga shqiptarët dhe shprehte mirënjohjen e tij për falënderimet e këtij populli për ndihmën e pakursyer që kishte bërë në kuadër të Komitetit Shqiptar të Londrës. Pothuajse në çdo takim Herberti shprehej fort i kënaqur dhe shumë i lumtur që kishte mbrojtur të drejtat e këtij kombi të cilit Europa i bëri shumë padrejtësi duke i rrëmbyer copa nga territori i saj.⁴⁵ Ai deklaronte se nuk do të hiqte dorë asnjëherë nga mbrojtja e të drejtave të shqiptarëve dhe posa të kthehej në Angli do të vazhdonte të punonte për kauzën shqiptare të cilën nuk e konsideronte si çështje të mbyllur për shkak të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve dhe mospajtueshmërinë e shqiptarëve me këto vendime.

Edhe pas kthimit në Londër, Herberti mbante kontakte të vazhdueshme me shqiptarët për t’u njoftuar me zhvillimin e ngjarjeve sidomos në tokat e pushtuara shqiptare nga Greqia, Serbia dhe Mali i Zi. Më 15 tetor të vitit 1913, pas informacioneve që i dërgonte Herbertit Qeveria e Ismail Qemalit për terrorin e ushtruar nga forcat serbe e malazeze në Kosovë, Hot, Grudë, e krahina të tjera të Malësisë, ai ndërmoi

⁴³ Përlindja e Shqipëniës... f. 38.

⁴⁴ Po aty f. 53.

⁴⁵ Po aty.

një fushatë sensibilizuese në Londër. Herberti takoi politikanë e diplomatë të cilëve u dorëzoi fakte dhe protestoi për dhunën, dëbimin dhe vrasjet masive të shqiptarëve që po bënte ushtria serbe për ta shpopulluar Kosovën dhe viset e tjera nga demografia shqiptare dhe për ta kolonizuar me popullsi sllave. Gjithashtu ai u dërgoi gazetave të përditshme londineze për botim një artikull të titulluar “Serbët vrasin robërit”. Në këtë artikull ndër të tjera thuhej:” Është e tepërt të thuhet se çfarë poshtërsie është të vrasësh robër të paarmatosur...kjo është e ndaluar edhe me kanunet ndërkombëtare, e dënueshme dhe jonjerëzore. Por serbët nga urrejtja kanë harruar rregullat e botës së qytetëruar. Të vrasësh robërit e çarmatosur, të lësh të vdesin nga uria fëmijët dhe gratë, njerëzit e pafajshëm, të djegësh shtëpitë për t’i grabitur dhe për t’i dëbuar banorët shqiptarë është më tepër se një egërsi e pashpjegueshme”.⁴⁶ Ndaj telegramit të Komitetit të Londrës kishte reaguar përfaqësuesi i Serbisë në Londër, kurse në kundërpergjigjen e tij, Abrey Herbertit theksonte “Unë kam prova të pamohueshme për terrorin e ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve. Prova të pakontestueshme kanë edhe zonja Durham⁴⁷ dhe Mak Rury të cilët flasin për vrasjen e fëmijëve, grave dhe burrave të paarmatosur brenda dhe jashtë kufijve të rinj”.⁴⁸ Pohimet e Herbertit i vërtetonte edhe gazeta “Përlindja e Shqipënisë” e datës 21 tetor 1913 në një artikull të titulluar “Luftimet në mes shqiptarvet të Kosovës e të sllavëve”. Në fillim të artikullit kritikohet mosreagimi i diplomacisë së Fuqive të Mëdha e cila ishte e informuar nga përfaqësuesit e vet diplomatik për mizoritë serbe ndaj shqiptarëve dhe nuk kishte ndërmarrë asnjë hap për të ndaluar barbaritë serbe. Mizoritë më të mëdha u bënë në krahinën e Gjakovës dhe Pejës ku ushtria serbe vrau, rrëmbeu e shkretoi fshatra të tëra. Për t’i dalë zot popullsisë ishin organizuar çeta burrash të cilët luftuan për 12 ditë rresht derisa iu harxhuan municionet. Ushtria serbe dhe malazeze të ndara në 22 batalione luftuan kundër rezistencës shqiptare edhe në krahina të tjera që mbeten jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Ata vranë dhe plaçkitën edhe në krahinat e Shkupit, Gjilanit, Kumanovës, Gostivarit, Tetovës, Kërçovës, Strugës, Dibërës e deri në Ohër. Këto dëshmi u morën nga shqiptarë të dëbuar e të zhvendosur nga shtëpitë e tyre të cilët pas deportimit kishin hyrë në zonat e thella më të sigurta që ishin brenda shtetit të njohur shqiptar.

⁴⁶ Përlindja e Shqipëniës... f. 104.

⁴⁷ Më gjerësisht Edith Durham, *Brenga e Ballkanit*, Tiranë 2009; Edith Durham, *Njezët vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë 2001; Edith Durham, *Shqipëria e Epërme*, Tiranë 2013.

⁴⁸ Po aty f. 115.

Ata ishin të lodhur, të uritur, të sëmurë dhe të pashpresë për rikthim në shtëpitë dhe tokat e tyre të plaçkitura, të rrënuara dhe të djegura.⁴⁹

Për tmerret e ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve në territoret e pushuara shkruanin edhe gazetat e tjera ndërkombëtare si: "Neue Freie Presse", "Neues Wiener Abendblatt", "Giornale d'Italia", "Corriere d'Italia", "Times", "Manchester Guardian" etj.⁵⁰

Në qershor 1913, Komiteti i Londrës kishte mbledhur edhe ndihma financiare me destinim Shkodrën për të ndihmuar popullsinë shqiptare të zhvendosur nga shtëpitë e tyre si shkak pasojë e agresionit malazez.

Bazuar në angazhimin dhe aktivitetin disavjeçar të personaliteteve të shquara britanike konstatojmë se kontributi i Komitetit të Londrës është shumëdimensional dhe fillon nga dashamirësia dhe solidariteti për shqiptarët, sensibilizimi i kauzës së tyre, kërkesa drejtuar qeverisë britanike për përkrahjen e çështjes shqiptare, kundërshtimi me forcë i copëtimit të tokave të tyre dhe pushtimi nga aleatët ballkanikë, përkrahja për ndërtimin e institucioneve të shtetit e deri te shfaqja me premisa humaniste dhe mbledhja e ndihmave financiare për popullin shqiptar.

Për kontributin e tij për çështjen shqiptare, kryetarit të Komitetit Shqiptar të Londrës Aubrey Herberti iu ofrua nga ana e shqiptarëve dy herë froni i Shqipërisë. Në rastin e parë, pak para Luftës së Parë Botërore, kur kërkohej që shteti i pavarur shqiptar të udhëhiqej nga një princ i huaj që do të vinte nga një shtet me traditë që nuk ka konflikt interesi në Shqipëri. Herberti duke qenë i përkushtuar për kauzën shqiptare, natyrisht që kishte shfaqur interesim për ofertën shqiptare, por kjo ofertë nuk u miratua nga kryeministri i atëhershëm i Britanisë së Madhe Herbert Asquith, i cili ishte edhe një mik i familjes së Herbertit. Oferta për kurorën shqiptare mbeti jozyrtare dhe u refuzua nga Ministria e Jashtme e Britanisë së Madhe. Refuzimi i shtetit britanik e favorizoi princin Vilhelm Wied-in të cilit ia dhanë kurorën shqiptare dhe drejtimin e shtetit më të ri evropian.⁵¹

Rasti i dytë që u ofrua kurora e Shqipërisë ishte pas disfatës së ushtrisë italiane nga shqiptarët në shtator 1920. Sërish oferta ishte jozyrtare, ndonëse ishte bërë në emër të qeverisë shqiptare. Ofertën e

⁴⁹ Po aty f. 121.

⁵⁰ Po aty f. 105.

⁵¹ *Jeffrey Meyers*, Aubrey Herbert, the man who would not be king, <https://www.thearticle.com/>, parë me 12 shkurt 2024.

radhës, Herberti e diskutoi me Philip Kerr-in dhe Maurice Hankey, por për arsye jo shumë të njohura edhe oferta e dytë mbeti e parealizuar. Megjithatë, Herberti vazhdoi angazhimin e tij për çështjen shqiptare duke shfrytëzuar Eric Drummond, një mik i tij i cili ishte bërë Sekretari i Parë i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve. Bashkëkohanikët dhe studiuesit e vlerësojnë me nota të larta lobimin e Herbertit që çoi në pranimin e Shqipërisë si anëtare në Lidhjen e Kombeve në dhjetor 1920.⁵²

Pra, kontributi i Komitetit Shqiptar të Londrës dhe udhëheqësit të këtij Komiteti, Aubrey Herbert-it ndërlidhet ngushtësisht me angazhimin e tij direkt në njohjen e pavarësisë së shtetit shqiptar, rritën dhe zhvillimin e tij dhe pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve.

Pavarësisht gjithë angazhimeve të shqiptarëve, diplomacive përkrahëse të kauzës së tyre siç ishte ajo austriake dhe italiane, miqve të tyre siç ishte Komiteti Shqiptar i Londrës dhe ndonjë tjetër, diplomacia europiane përmes vendimit të 29 korrikut 1913 të Konferencës së Londrës, iu dha shqiptarëve njohjen *de jure*, por në shkëmbim të saj, me vendimet e 22 marsit dhe 11 gushtit 1913, iu mori rreth gjysmën e territoreve, për t'ua dhënë grekëve, serbëve dhe malazezëve. Ajo e privoi Shqipërinë nga “tokat më të mira që kishte, fushat më të bukura, qendrat më të rëndësishme dhe i janë shkëputur dy të tretat e popullsisë. Tokat pjellore të Janinës dhe Prevezës, kullat e famshme të Çamërisë iu dhanë Greqisë...”⁵³.

Me gjithë zhvillimet dhe pamundësisë së shqiptarëve për ta krijuar shtetin e tyre me shtrirje territoriale në të katër vilajetet, megjithatë duhet pasur në konsideratë mbështetjen që kauza e tyre gjeti te shteti austro-hungarez, diplomacia italiane, komitetet lobuese siç ishte Komiteti Shqiptar i Londrës dhe personalitete të shquara si Edit Durham, Aubrey Herberti dhe dashamirës të tjerë të kauzës shqiptare që vinin nga arena publike, politike dhe diplomatike ndërkombëtare. Pavarësisht nga mosarritja e rezultateve të synuara nga shqiptarët, kontributi i Komitetit Shqiptar të Londrës në sensibilizimin e çështjes shqiptare gjatë viteve 1912-13 ishte shumë i rëndësishëm për trajtimin e një çështjeje që për vite e shekuj kishte mbetur në margjinat e një pushtuesi siç ishte Perandoria Osmane e cila i kishte lënë shqiptarët në bilanc tragjik, pa shkollë, pa emancipim kombëtar, pa kulturë kombëtare, pa rrugë të tra-

⁵² Aubrey Herbert, https://military-history.fandom.com/Languages_and_travels, parë me 20 janar 2024.

⁵³ Mithat Frashëri, *Shqiptarë dhe sllavë*, botuar në frëngjisht në Lozanë (Zvicër) më 1919 dhe në shqip në Tiranë 1997, f. 61.

suara moderne që lidhnin qendrat shqiptare, pa zhvillim ekonomik, politik, pa polici, pa ushtri që nënkupton pa mbrojtje dhe pa njohje të kombësisë së tyre duke i quajtur tradhtar të Perandorisë ata që kërkonin liri dhe shtet kombëtar.

Përfundimi

Fillimi i Luftës së Parë Ballkanike dhe turrja e kufijve të Perandorisë Osmane nga pjesa europiane krijuan një situatë të re ndërkombëtare. Konferenca e Ambasadorëve në Londër nxori në sipërfaqe tendencat e Fuqive të Mëdha për ridefinimin e interesave të tyre politike dhe gjeostrategjike. Mbi këto interesa u krijuan platforma dhe u hartuan strategji të cilat rezultuan me propozime konkrete të projekteve të tyre për ridefinimin e aleancave politike për interesa të përbashkëta. Përtej pozicionimit të Fuqive të Mëdha në blloqet rivale politiko-ushtarake u bënë përpjekje të vazhdueshme për të tërhequr pas politikave të tyre edhe shtetet e vogla, kryesisht shtetet ballkanike të cilat vlerësoheshin se ishin në fazën e konsolidimit të tyre dhe tendencave për zgjerim territorial në rastin e shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Ridimensionimi i interesave të Fuqive të Mëdha dhe synimet e aleatëve ballkanikë më së shumti u reflektuan në interesat dhe të ardhmen e popullit shqiptar. Vitet 1912-1913 ishin përcaktuese për fatin e shqiptarëve të cilët kishin mbetur populli i vetëm, më i vonuari në konsolidimin e brendshëm dhe krijimin e shtetit kombëtar. Çdo vonesë e tyre mund të përcillej me pasoja për një popull të sunduar me shekuj të cilit i kanosej zhbërja.

Shqiptarët pavarësisht nga kundërshtimi osman e shpallen shtetin e tyre, por pozicionet e këtij shteti të saposhpallur ishin shumë të brishta dhe mundësitë e shqiptarëve për përfaqësimin e interesave të tyre në Konferencën e Londrës, fare të vogla. Prandaj ishte shumë e rëndësishme që ata të mobilizonin potencialet e tyre duke shfrytëzuar miqtë e paktë ndërkombëtarë për të sensibilizuar kauzën kombëtare. Në këtë situatë shpresa e tyre ishte e varur në “drejtësinë ndërkombëtare” me rastin e marrjes së vendimeve në Konferencën e ambasadoreve në Londër. Mirëpo në konferencat e paqes drejtësia nuk ishte asnjëherë synim kryesor. Gjithmonë në qendër të vëmendjes ishte përfaqësimi i interesave politike dhe gjeostrategjike edhe nëse cenohen të drejtat e popujve si në rastin e mostrajtit të së drejtës së shqiptarëve për shtet me shtrirje brenda gjeografisë etnike e kombëtare.

Projektet e ofruara nga Fuqitë e Mëdha për shtrirjen e shtetit shqiptar dhe kufijtë e tij sollën shumë përplasje në seancat e Konferencës që nga fillimi i punës e deri në përfundimin e saj. Aty dolën në sipërfaqe pretendimet shoviniste të shteteve që përbënin Aleancën Ballkanike, por edhe qëndrimi veç e veç i secilës nga Fuqitë e Mëdha. Prandaj ishte shumë i rëndësishëm angazhimi i Komitetit Shqiptar të Londrës me në krye Aubrey Herbertin dhe politikanëve liberalë, konservatorë dhe socialistë britanikë të cilët drejtpërdrejt ose tërthorazi u angazhuan për përfaqësimin e dinjitetshëm të interesave shqiptare.

Në punimet e Konferencës u shfaq një prirje në favor të çështjes shqiptare që kryesisht identifikohet me Austro-Hungarinë dhe Italinë; prirja e dytë ishte më neutrale dhe mund të shihet në qëndrimet e Gjermanisë e ndonjëherë edhe të Britanisë së Madhe (Megjithëse britanikët duke luajtur rolin e ndërmjetësit shpesh përkrahën edhe projekte dhe propozime në dëm të interesave shqiptare), kurse prirja e tretë ishte krejtësisht kundër interesave shqiptare dhe identifikohet me qëndrimet e Francës e posaçërisht të Rusisë e cila kishte dalë hapur në favor të Serbisë e Malit të Zi dhe në kundërshtim me interesat shqiptare.

Por pavarësisht nga politika zyrtare pro dhe kontra çështjes shqiptare, formimi i shtetit kombëtar dhe njohja ndërkombëtare ndodhi si rezultat i faktorit të brendshëm që ndërlidhet kryesisht me lëvizjet kryengritëse shqiptare 1910-1912 të identifikuara me tribun popullor si Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi, Dedë Gjon Luli, Çerçiz Topulli, etj, kërkesave të përsëritura politike, angazhimit të pakursyer të një elite politike dhe intelektuale që lidhet ngushtë me emrat e Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës, Luigj Gurakuqit, Fan Nolit, Faik Konicës, etj. dhe gatishmërisë së diplomacisë austro-hungareze e italiane, përkrahjes së pjesshme të ndonjë faktori tjetër ndërkombëtar pa e mohuar rolin dhe rëndësinë e pazëvendësueshme të personaliteteve si Aubrey Herberti dhe Komitetit Shqiptar të Londrës të cilët me aktivitetet e tyre sensibilizuese ndryshuan qasjen e një pjese të konsiderueshme të opinionit politikëbërës dhe intelektual e kulturor të Mbretërisë së Bashkuar.

Arsim Bajrami

ASPEKTE JURIDIKE DHE KUSHTETUESE TË NDARJES DHE ANEKSIMIT TË KOSOVËS NGA KONFERENCA E LONDRËS DERI TE PAVARËSIA E KOSOVËS

Abstrakt

Pavarësia dhe shtetndërtimi i Kosovës ka qenë një proces shekullor i luftës së popullit shqiptar të Kosovës, përpjekjeve të tij titanike për të ndërtuar një shtet të pavarur dhe sovran. Kosova pas çlirimit nga Perandoria Otomane u aneksua nga Serbia si pasojë e pazareve të Fuqive të Mëdha me territoret e Kosovës dhe për më shumë se një shekull iu nënshtrua një dhune dhe terrori sistematik në shkallë të gjenocidit. Por kjo dhunë, ky terror dhe gjenocid asnjëherë nuk arriti të shuajë vendosmërinë e popullit shqiptar të Kosovës për të realizuar të drejtën e tij historike, të drejtën e vetëvendosjes, për të realizuar atë që u takon të gjithë popujve evropianë, pra ta ketë shtetin e vet dhe të ketë të drejtën e bashkimit.

Kosova pas Luftës së Dytë Botërore u aneksua dhunshëm nga Serbia përmes administrimit ushtarak dhe dhunës shtetërore. Përmes një procesi shtetrrëthimi, ish-Jugosllavia ndaloi Kosovën të bashkohet me shtetin amë, me Shqipërinë. Qysh në Konferencën e Bujanit përfaqësuesit e zgjedhur të popullit në mënyrë legjitime kishin shprehur vullnetin e popullit të Kosovës që pas Luftës së Dytë Botërore do të bashkohen me shtetin amë – Shqipërinë. Mirëpo, Serbia e ndaloi këtë bashkim dhunshëm, duke vendosur gjendjen ushtarake dhe duke zbatuar politikën e terrorit dhe dhunës për t'i frikësuar shqiptarët të heqin dorë nga kjo kauzë e drejtë. Si pasojë e kësaj, Kosova është aneksuar dhunshëm dhe gjerë në vitin 1989, përkatësisht deri më 2 korrik 1990 ishte dhunshëm pjesë e Jugosllavisë dhe në kuadrin e Serbisë.

Kosova u pavarësua përmes një procesi të pavarësisë së koordinuar duke i dhënë fund përpjekjeve të popullit të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Natyrisht, rolin vendimtar në këtë proces e kishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe shtetet e Bashkimit Evropian, në radhë të parë Anglia, Franca, Gjermania, Italia, etj. Shtetet e Grupit të Kontaktit arritën paraprakisht konsensusin që Kosova të shpallë pavarësinë mbi bazën e Planit të Ahtisaarit dhe të ndodhë njohja ndërkombëtare e Kosovës si një shtet sovran dhe i pavarur. Mund të themi se klasa politike e Kosovës, liderhipi i Kosovës asnjëherë nuk ka qenë më unik, më i përgatitur, më i vendosur në historinë e saj politike sesa në fund të vitit 2007 dhe në fillim të vitit 2008 kur u përgatit shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Duhet theksuar se Pavarësia e Kosovës nuk është një koncesion apo një dhuratë që i është bërë popullit të Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare. Përkundrazi, është pranimi i një të drejte të mohuar me shekuj të popullit të Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare. Pra, në një mënyrë, është një përmirësim i gabimeve historike që kishin bërë ndaj shqiptarëve të Kosovës në Konferencën e Berlinit, në Konferencën e Londrës ku territori i Kosovës i ishte dhënë nën administrim Serbisë, përkatësisht

Jugosllavisë. Lindja e shtetit të pavarur të Kosovës dhe njohja ndërkombëtare e tij është rikthimi i drejtësisë në vend. Edhe pse mund të quhet një rast i drejtësisë së vonuar është një drejtësi që pak a shumë shpërblen sakrificën shekullore të popullit të Kosovës.

Fjalët çelës: Konferenca e Londrës, Pavarësia, Kosova, Grupi i kontaktit, shtetësia.

Aspekti historik i mëvetësisë së Kosovës

Ideja e vetëvendosjes shqiptare, si dhe kërkesat politike shqiptare, për një status të mëvetësishëm politiko-territorial të Kosovës nga regjimet e ndryshme koloniale, nuk ishin të kohës së re. Po të analizohet historia politike e çështjes së Kosovës dhe e çështjes shqiptare, mund të vërehet se ajo ishte e bujshme, mirëpo historia asnjëherë nuk i doli zot asaj. Kosova dhe çështja shqiptare ishin objekt i padrejtësive historike, që kishin për qëllim copëtimin e substancës kombëtare të popullit shqiptar dhe rrudhjen e copëtimin e trojeve etnike shqiptare¹.

Kosova me shekuj paraqiste një kolektivitet të mëvetësishëm territorial brenda Perandorinë Osmane. që shquhej me një shumicë etnike shqiptare. Gjatë historisë, Kosova ka qenë në një tërësi të mëvetësishme territoriale². Kosova si një njësi e veçantë administrative-juridike, u konstituua me rregullativën turke të vitit 1864³. Vilajeti i Kosovës⁴ ishte njëri ndër katër vilajetet e Perandorisë Osmane (Territori që e bannonin shqiptarët në kuadër të Vilajetit të Kosovës kishte 22.900 kilometra katrorë)⁵.

Vilajeti i Kosovës në sistemin e tërësishëm të pushtetit shtetëror të Perandorisë Osmane, kishte një status specifik administrativ. Organizimi i Vilajetit të Kosovës kishte disa specifika të veçanta nga vilajetet

¹ Shih më shumë: Noel Malcolm “*Kosova një Histori e Shkurtër*”, Mecmilan, London, 1993, fq.188-200.

² Shukri Rrahimi, “*Vilajeti i Kosovës*”,Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë, 1989,fq.12.

³ Cristian Jura “*KOSOVO – HISTORY AND ACTUALITY*” AGORA International Journal of Juridical Sciences, www.juridicaljournal.univagora.ro ISSN 1843-570X, E-ISSN 2067-7677 No. 3 (2013), pp. 78-84, fq.79.

⁴ Oliver Jens Schmitt “*Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*”, botimet Koha, Prishtinë, Nëntor 2012, fq.64-66.

⁵ Noel Malcolm “*Kosova një Histori e Shkurtër*”, Mecmilan, London, 1993, fq.198-209.

e tjera, përkatësisht kishtetribute si njësi e veçantë e perandorisë turke. Në favor të këtij konstatimi është edhe e dhëna se në kuadër të Vilajetit të Kosovës kanë ekzistuar dhe kanë funksionuar më shumë se dhjetë mekanizma të pushtetit, kuptohet, me qëllim të institucionalizimit të veprimtarisë juridike të Perandorisë⁶.

Deri në vitin 1912⁷ shqiptarët ishin nën Perandorinë Osmane. Siç u tha, tokat shqiptare ishin të ndara në katër vilajete si njësi më të mëdha administrative, Vilajeti i Kosovës, Vilajeti i Shkodrës, Vilajeti i Manastirit dhe Vilajeti i Janinës. Ndër këto katër vilajete Kosova kishte shtrirje më të madhe territoriale. Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912 dhe largimit të Perandorisë Osmane, shtetet ballkanike filluan luftën për pushtimin dhe copëtimin e tokave shqiptare⁸. Si rezultat patëm krijimin e një shteti shqiptar i cili përbënte më pak se 1/3 e territoreve të banuara me shumicë shqiptare. Shteti i ri verior i Serbisë i cili kishte fituar pavarësinë nga Perandoria Osmane disa dekada më parë me ndihmën e Ruisë, filloi luftën për pushtimin e territoreve shqiptare. Më herët, pas Kongresit të Berlinit që rezultoi nga Paqja e Shën Stefanit ku Perandoria Osmane u mund nga ajo Ruse, Serbisë iu dhanë territore të tëra të banuara me shqiptarë që në atë kohë ishin akoma nën Perandorinë Osmane. Pas aneksimit të atyre territoreve duke filluar nga Nishi, Leskovci, Vranja, Toplica etj. Serbia ndërmori një fushatë të egër spastrimi etnik. Kjo fushatë vazhdoi prapë më 1912 dhe në luftërat e mëvonshme ballkanike. Si rrjedhojë territoret shqiptare u tkurrën shumë dhe numri i popullsisë shqiptare u zvogëlu. Në këtë kohë Serbia pushtoi Kosovën. Pozita e Kosovës dhe shqiptarëve nën Serbinë dhe më vonë pas 1918 nën Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene dhe Jugosllavinë ishte shumë e rëndë⁹.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878 -1881)

Përpjekjen e parë serioze për të përcaktuar bazat e shtetësisë së Kosovës, i hasim në aktivitetin politik të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878 -1881), në të drejtat dhe detyrat që parashikonte kjo organizatë

⁶ Ibid.

⁷ Miranda Vickers, *“Between Serb and Albanian: a History of Kosovo”*, prill 1998, fq.12-20.

⁸ Sylejman Kylçe, *“Shqipëria dhe historia Osmane”*, Tiranë, 2004, fq. 111- 120.

⁹ Lillian Vasi *“The Question of Democracy in a Limbo State:Case Study of the Republic of Kosovo”*, International Journal of Education and Social Science, Vol. 1 No. 3; October 2014, fq.63-64.

politike për mëvetësi, përkatësisht për pavarësi të plotë politike dhe territoriale. Kjo lidhje, përcaktonte mekanizmat embrionalë dhe shtetërorë dhe programin politik të bashkimit të tokave (vilajeteve) me shumicë etnike shqiptare në një shtet autonom shqiptar nën sovranitetin e portës, si një qëllim, pa dyshim transitor, drejtë pavarësisë së plotë, siç kishin ndodhur edhe me lindjen dhe formësimin e shteteve të tjera nacionale në Ballkan. Po ashtu, pikërisht në Kosovë u zhvillua kryengritja masive shqiptare (1910-1912) kundër pushtuesit turk me synim themelimin e shtetit të pavarur kombëtar shqiptar në Ballkan¹⁰.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit përbën ngjarjen më të rëndësishme deri atëherë të Rilindjes Kombëtare dhe një nga ngjarjet më madhore në historinë e popullit shqiptar. Drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare vlerësuan drejt momentin historik për themelimin e kësaj organizate politike-ushtarake për t'i dal zot tërësisë së Shqipërisë përballë pretendimeve gllabëruese e shoviniste të shteteve fqinje të mbështetura nga Fuqitë e Mëdha dhe njëkohësisht për të luftuar për jetësimin e së drejtës për të formuar shtetin shqiptar në kuadër të Perandorisë Osmane, që do të përmbushte një aspiratë të ligjshme historike të popullit shqiptar. Pëzullimi i zbatimit të Traktatit të Shën Stefanit deri në Kongresin e Berlinit u jepte patriotëve shqiptarë një kohë shumë të çmueshme për të organizuar më mirë qëndresën shqiptare politike e ushtarake dhe për t'u përgatitur që t'i bënin ballë rrezikut të copëtimit të atdheut. Në këto rrethana, u përhap te mbarë shqiptarët ideja për të formuar një lidhje të përgjithshme kombëtare, në të cilën do të përfshiheshin të gjithë shqiptarët, pavarësisht nga krahinat, feja dhe gjendja e tyre shoqërore. Patriotët shqiptarë dhe veçanërisht Komiteti i Stambollit fillimisht u përpoqën ta bindin Portën e Lartë që të lejonte formimin e një lidhjeje shqiptare, por ajo nuk pranoi. Meqenëse nuk qe një gjendje të pengonte mbajtjen e kuvendin shqiptar, ajo u përpoq me anën e agjentëve dhe përkrahësve të saj të formonte jo një lidhje shqiptare, por një lidhje islame pro-osmane, ku do të bënin pjesë të gjithë banorët myslimanë të Gadishullit Ballkanik. Nismën për thirrjen e Kuvendit të Përgjithshëm e mori Komiteti i Stambollit, por për të mos shkaktuar reagimin e hapur të organeve qeveritare osmane, Komiteti i Stambollit vepronte si dhe më parë në fshehtësi të plotë. Si vend për mbledhjen e Kuvendit u caktua Prizreni, qyteti kryesor i Kosovës dhe një nga me të mëdhenjtë e Shqipërisë, që ndodhej në afërsi të krahinave ku do të zhvillohej qëndresa e armatosur

¹⁰ Akademik Gazmend Zajmi, "Çështja e Kosovës në kuadër të çështjes shqiptare si sfidë e madhe dhe madhore e kohës dhe ndaj kohës", Prishtinë, Revista *E Drejta* 1/96, fq. 31.

e Lidhjes për mbrojtjen e tërësisë tokësore shqiptare. Me organizimin e drejtpërdrejtë të veprimeve për thirrjen e Kuvendit u ngarkua një komision i posaçëm, shumica e anëtarëve e të cilit ishin nga Prizreni dhe Gjakova, ndërmjet tyre njihen Ymer Prizreni dhe Ahmet Koronica. Sapo u hap lajmi se Kongresi i Berlinit do të mbledhë më 13 qershor 1878, në viset e katër vilajeteve u zhvilluan mbledhje për t'u zgjedhur delegatët që do të niseshin për në Prizren. Në viset shqiptare të vilajetit të Kosovës, të Shkodrës, të Manastirit dhe të Janinës, nuk u caktua si delegatë asnjë nga elementët proosmanë. Megjithatë, ulematë dhe funksionarët osmanë, duke përdorur mjetet nga me të ndryshmet, bënë që në ato Kaza ku banonin popullsi e përzier myslimane shqiptare, boshnjake, turke të caktoheshin si delegatë edhe mjaft pashallarë dhe bejlerë sulltanistë.

Kuvendi Kombëtar u hap më 10 qershor 1878, atë ditë në Prizren nuk kishin arritur të gjithë delegatët e krahinave shqiptare, mungonin delegatët e vilajetit të Shkodrës, nisjen e të cilëve e kishin penguar intrigat e valiut osman, Hysen Pashës, ndërsa nga vilajeti i Janinës kishin arritur vetëm dy delegatë.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Kosova dhe viset e tjera etnike shqiptare ishin në kuadër të Shqipërisë. Mirëpo, pas mbarimit të kësaj lufte, në Konferencën e Versajës (1919) Fuqitë e Mëdha, edhe kësaj radhe dënuan popullin shqiptar, duke lënë më shumë se 50% të trojeve etnike të popullatës shqiptare nën juridiksionin grek dhe jugosllav.

Copëtimi i Shqipërisë

Copëtimi i Shqipërisë ishte procesi i ndarjes së trojeve shqiptare nga Kongresi i Berlinit deri në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913. Copëtimi i 1913-ës la pasojë të rënda në kombin shqiptar dhe ishte tragjedia më e madhe kombëtare deri më sot, me pasoja që vazhdojnë të rëndojnë mbi kombin shqiptar i cili është në tkurrje e sipër si pasojë e këtij copëtimi edhe në ditët e sotme. Katër vilajetet shqiptare të Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës që u propozuan për autonomi nga Lidhja e Prizrenit. Lufta ruso-turke (1877-1878) i ceni rëndë zotërimet osmane në gadishullin ballkanik, duke e lënë Perandorinë vetëm të mbahej në pozicione të pasigurta në Maqedoni dhe në trojet e banuara nga shqiptarët. Në anën tjetër i dha një frymëmarrje shumë të gjerë shteteve dhe popullsive ortodokse, për analogji me Rusinë që tashmë konsolidoheshin në shtetet fqinje që njëkohësisht e

përdorën si një armë propagande edhe kundër kombeve si ai shqiptar. Shqiptarët në atë kohë banonin në katër vilajete: në vilajetin e Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës. Llogaritet se nga 2 500 000 banorë që kishin këto vilajete, 2 milionë ishin shqiptarë dhe pjesa tjetër vllleh, maqedonas sllavë, grekë dhe romë. Shqiptarët ishin shumica absolute në të katërt vilajetet.

Copëtimi i parë

Copëtimi i parë i trojeve shqiptare u realizua pas vendimeve të Kongresit të Berlinit për të shpërblyer Malin e Zi me Plavën e Gucinë. Gjatë kësaj kohe, iu kaluan Serbisë zonat e Toplicës, Prokuples, Kurshumlisë, Nishit, Vranjës dhe Leskovcit. Popullsia shqiptare në këto zona u përzu me dhunë dhe e gjithë u spastrua etnikisht nga shqiptarët, duke krijuar 70 000 refugjatë shqiptarë nga këto zona që u vendosën në Kosovë e 60 000 të tjerë që u vendosën në zonën që sot është në Maqedoni. Kongresi i Berlinit i dha Malit të Zi dhe qytetin e Tivarit dhe Podgoricën, ku gjithashtu kishte popullata shqiptare. Për t'i bërë ballë copëtimit të trojeve shqiptare, u krijua Lidhja e Prizrenit, e cila kundërshtoi me armë aneksimin e trojeve shqiptare. Luftime të rrepta u zhvilluan në Plavë e Guci ku sipas burimeve të kohës "zona kufitare u mbulua me gjak". Forcat malazeze nuk mundën të marrin Plavën e Gucinë dhe kërkuan nga Kongresi i Berlinit një zonë tjetër. Kongresi caktoi Hotin e Grudën ku sërisht pati luftime të përgjakshme dhe forcat malazeze nuk arritën të thyejnë qëndrësën shqiptare. Kongresi atëherë i dha Ulqin Malit të Zi. Forcat e Lidhjes së Prizrenit në Ulqin u ndodhën para sulmeve të ushtrisë malazeze dhe nga lindja nga sulmet e ushtrisë osmane, e cila u dërgua nga sulltani për të shtypur Lidhjen dhe për të dorëzuar Ulqinin te malazezët. Shqiptarët u tërhoqën dhe u mundën nga forcat e shumta osmane të udhëhequra nga Dervish Pasha, të cilat shkatërruan Lidhjen e Prizrenit në një sërë betejash. Gjatë copëtimit të parë, shqiptarët humbën zonat veriore të Toplicës, Pazarit të Ri, Nishit, Ulqinin dhe disa territore në jug të Çamërisë.

Copëtimi i dytë: Konferenca e Ambasadorëve në Londër

Kryengritjet e armatosura të shqiptarëve të viteve 1910, 1911, 1912, nxitën shtetet ballkanike që të vepronin me shpejtësi në copëtimin

e trojeve shqiptare. Serbia, Bullgaria, Mali i Zi dhe Greqia lidhën aleanca politike dhe ushtarake ndërmjet tyre dhe në tetor të vitit 1912, ato i shpallën luftë Perandorisë Osmane duke shënuar kështu fillimin e Luftës së Parë Ballkanike. Shqiptarët mbajtën një qëndrim asnjës në këtë luftë, por u shqetësuan kur shihnin se shtetet ballkanike synonin ndarjen e territoreve shqiptare. Për pasojë shqiptarët mbajtën një Kuvend në Vlorë dhe më 28 nëntor 1912 shpallën Pavarësinë e Shqipërisë. Pavarësia nuk u njoh nga disa vende, kurse Serbia, Mali i Zi dhe Greqia vazhduan t'i mbanin trupat e tyre në territoret shqiptare. Gjatë kësaj kohe u kryen masakra të tmerrshme kundër popullsisë civile shqiptare. Leon Trocki, i dërguar si korrespondent në Ballkan, tregon se si "fshatra të tërë shqiptarë ishin kthyer në grumbuj zjarri. Nga kufiri me Serbinë e deri në Shkup shihje vetëm zjarr e plaçkitje...". Sipas burimeve të huaja, rreth 25 mijë shqiptarë u vranë vetëm në Kosovë në muajt nëntor 1912 janar 1913. Më 17 dhjetor 1912 në Londër u mbledhën Fuqitë e Mëdha të kohës të cilat diskutuan për fatin e Shqipërisë. Më 29 korrik 1913 u mor vendimi që Shqipëria të shpallej principatë autonome, sovraane e trashëgueshme nën garancinë e Fuqive të Mëdha. Ndërsa kufijtë, pas shumë diskutimesh u caktuan, por duke lënë jashtë tyre Kosovën dhe Çamërinë, por duke lënë brenda kufijve territore që sot janë janë jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë si p.sh. Shën Naumi. Të gjendur nën pushtimin e ushtrive serbe, malazeze e greke, me qindra mijëra shqiptarë nga troje që sot gjendjen në Mal të Zi, Serbi, Kosovë, Maqedoni e Greqi, morën rrugën e u dyndën si refugjatë brenda kufijve të njohur nga Konferenca e Londrës. Në të gjitha trojet shqiptare u kryen masakra të mëdha ndaj popullsisë civile, dhe u krye spastrim etnik me qëllim përzënien ose eliminimin e popullsisë shqiptare. Copëtimi i trojeve shqiptare la jashtë kufijve më shumë se gjysmën e territoreve të banuara nga shqiptarët historikisht, dhe më shumë se gjysmën e popullsisë shqiptare të asaj kohe. Në Kosovë, trupat serbe ushtruan terror dhe u munduan ta ndërrojnë përbërjen e popullsisë me anë të shpërnguljeve me dhunë. Gjuha shqipe u ndalua dhe dhjetëra mijëra serbe kolonë u vendosën në tokat e shqiptarëve të vranë ose të përzënë. Më shumë se 150. 000 shqiptarë u detyruan ta lënë Kosovën në vitet 1912-1920.

Gjenezja e statusit autonom të Kosovës

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Kosova dhe viset e tjera etnike shqiptare ishin në kuadër të Shqipërisë. Mirëpo, pas mbarimit të kësaj

lufte, në Konferencën e Versajës (1919) Fuqitë e Mëdha, edhe kësaj radhe dënuan popullin shqiptar, duke lënë më shumë se 50% të trojeve etnike të popullatës shqiptare nën juridiksionin grek dhe jugosllav¹¹.

Gjatë kohës së Jugosllavisë së vjetër, borgjezia serbomadhe, duke pasur parasysh aspirata asimiluese ndaj popullit shqiptar, territorin e Kosovës, sipas ndarjes administrative territoriale të vitit 1921, e ka ndarë në katër qarqe, me seli në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren e Pejë. Më vonë, me reformën e re territoriale të vitit 1929/30, ky territor ndahet ndërmjet tri banovinave: banovinës së Vardarit, të Moravës dhe të Zetës¹².

Gjenezën e statusit të mëvetësishëm autonom të Kosovës, në kuadër të Federatës Jugosllave, e hasim qysh në vitin 1937, kur në Kosovë formohet Komiteti Krahinor i PKJ-së, i cili atëbotë ka qenë i lidhur me Komitetin Krahinor për Mal të Zi, Sanxhak dhe Bokë. Vetë fakti i formimit të këtij organi partiak, qysh para fillimit të luftës antifashiste, tregon se PKJ në planet e saj për formimin e Jugosllavisë së re, ka paraparë një status të mëvetësishëm për Kosovën. Këtë e vërteton, edhe vendimi i Konferencës së Pestë të vendit të PKJ-së, në Zagreb më 1940, kur me kërkesën e delegatëve nga Kosova, Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit, lidhet drejtpërdrejt me KQ të PKJ-së¹³.

Dokumentet historike të kësaj periudhe, tregojnë se PKJ-ja, në qëndrimet e saj për zgjedhjen e çështjes kombëtare, i është referuar edhe parimeve të vetëvendosjes. Një parim i këtyllë ka qenë proklamuar edhe për popullin shqiptar, të cilit në qëndrimin e organeve më të larta partiake i është premtuar, që pas përfundimit të luftës antifashiste të deklarohet, në bazë të parimeve të vetëvendosjes, për fatin e vet politik.

Qëndrimet e këtylla të PKJ-së rreth zgjidhjes së çështjes kombëtare kanë ndikuar që populli shqiptar t'i bashkohet luftës antifashiste, të udhëhequr nga PKJ dhe të japë ndihmën e vet në luftën antifashiste.

Në Kosovë, gjatë luftës antifashiste janë formuar organet e pavarura ushtarake dhe civile. Kështu më 7 korrik 1941, Komiteti Krahinor formoi Komitetin Ushtarak, i cili luajti rol të rëndësishëm në përgatitjet ushtarake për luftë të armatosur. Në fund të këtij viti, formohet shtabi

¹¹ Në kontekst shih: Bob Allen, "Why Kosovo? Anatomy of a Needless War", CANADIAN CENTRE FOR POLICY ALTERNATIVES, July 1999, fq.4-7.

¹² Noel Malcolm "Kosova një Histori e Shkurtër", Mecmilan, London, 1993, fq.289-297.

¹³ Ibid, fq. 296-303.

kryesor i përkohshëm i LNÇ-së për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit, i cili ka luajtur rol të rëndësishëm sidomos në masivizimin e mëtejme të luftës kundër okupatorit¹⁴.

Krahas organeve ushtarake, gjatë Luftës së Dytë Botërore, u formuan organet e para të pushtetit të parë shtetëror, të ashtuquajturit “këshilla nacionalçlirimtare”. Formimi i “këshillave nacionalçlirimtare” lokale (të fshatrave, qyteteve, komunave), shtroi nevojën e pashlyeshme për formimin e një organi të përbashkët (Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar), i cili do të koordinonte punët e organeve lokale të pushtetit dhe do të merrte vendime të rëndësishme, rreth statusit të ardhshëm të Kosovës.

Më 29 nëntor 1943, në Jajce u mbajt mbledhja e dytë e KAÇKJ-së, në të cilën u morën vendime të rëndësishme politike dhe u përçaktuan bazat e federalizmit jugosllav. Në këtë mbledhje historike, nuk qenë ftuar dhe nuk morën pjesë përfaqësuesit nga Kosova. Në teorinë jugosllave, mosprania e përfaqësuesve të Kosovës, në këtë mbledhje zakonisht, është përpjekur të arsyetohet me kushtet e vështira gjeografike, të cilat kanë penguar përfaqësuesit e Kosovës të shkojnë në mbledhje, lidhjet e dobëta të komunikimit midis KQ të PKJ-së dhe Komitetit Krahinor të PKJ-së etj. Këto arsyeime janë të pasakta dhe nuk i përgjigjen realitetit. Shkaqet e mospranisë së përfaqësuesve të Kosovës në mbledhjen e dytë të KAÇKJ-së janë, para së gjithash, të natyrës politike. Ato qëndrojnë në faktin se në kohën e mbajtjes së kësaj mbledhjeje, Kosova kishte status të padefinuar dhe se ishte e hapur dilema se a t’i bashkëngjitet Shqipërisë, apo të mbetet në kuadrin e Jugosllavisë. Nga këto, mund të konstatojmë se çështja e statusit të Kosovës, në këtë mbledhje me qëllim ishte heshtur dhe ishte shtyrë për më vonë. Mirëpo, duhet theksuar se dokumentet partiake të kësaj periudhe, kur bëhet fjalë për Kosovën, kësaj çështjeje i janë qasur duke u mbështetur në parimet e vetëvendosjes (parim ky me të cilin PKJ kishte përfituar popullin shqiptar në luftën antifashiste).

Konferenca e Bujanit dhe roli i saj në aspektin e statusit politik dhe vetëvendosjes së Kosovës

Pas përgatitjeve të nevojshme, më 31 dhjetor 1943 në territorin e çliruar, në fshatin Bujan të Malësisë së Gjakovës, filloi konferenca themeluese e KKNÇ-së, e njohur si Konferenca e Bujanit, e cila vazhdoi

¹⁴ Sabit Syla, “Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj çështjes kombëtare të Kosovës 1939-1981” tezë doktore, Tiranë 2011, fq.22.

punimet edhe më 1 e 2 janar 1944. Në Konferencë, prej 61 delegatëve, sa ishin ftuar nga ana e Shtabit të UNÇ-së dhe AP të Kosovës, merrnin pjesë 49 delegatë, ndërsa 12 nuk kishin mundur të arrinin për shkak të kushteve të vështira. Në punimet e Konferencës merrnin pjesë përfaqësuesit e UNÇ-së të Shqipërisë dhe të UNÇ-së së Jugosllavisë¹⁵.

Dokumenti më i rëndësishëm i kësaj Konference ishte Rezoluta e Konferencës, e cila u miratua njëzëri nga të gjithë pjesëmarrësit e Konferencës.

Në pjesën e parë të Rezolutës konstatohet se në punimet e Konferencës kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjitha viseve të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit: shqiptarët, serbët, malazezët, nacionalistët, komunistët, rinia antifashiste, përfaqësuesit e ushtrisë, të rinisë komuniste, përfaqësuesit e grave antifashiste etj. Të frymëzuar nga ideali i lartë për bashkimin e tendencave të ndryshme politike.

Pa dyshim, pjesa më e rëndësishme e rezolutës është ajo në të cilën shprehimisht thuhej:

“Kosova e Rrafshi i Dukagjinit është një krahinë e banuar në shumicë nga populli shqiptar i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot dëshiron të bashkohet me Shqipërinë. Prandaj e ndjejmë për detyrë t’i tregojmë rrugën e drejtë që duhet të ndjekë populli shqiptar për t’i realizuar aspiratat e veta. Rruga e vetme, pra, që populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit të bashkohet me Shqipërinë është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist gjakatar e rrogëtarëve të tij. Sepse kjo është e vetmja rrugë për ta fituar lirinë, në të cilën të gjithë popujt, pra edhe shqiptarët, do të kenë mundësi të vendosin për fatin e vet me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje. Garanci për këtë është Ushtria Nacional Çlirimtare e Jugosllavisë dhe Ushtria Nacional Çlirimtare e Shqipërisë, me të cilën është ngushtësisht e lidhur. Përveç këtyre, për këtë garantojnë aleatët tanë të mëdhenj: Bashkimi Sovjetik, Anglia e Amerika, (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe ajo e Teheranit)¹⁶.

Në këtë Rezolutë, në mënyrë burimore shprehet dëshira e popullit shqiptar të Kosovës që si popull shumicë dominant i saj, të bashkohet me Shqipërinë. Me të, njëkohësisht, shprehej ”bindja që Shqipëria dhe Jugosllavia, ashtu edhe aleatët e aleancës antifashiste, në bazë të Kartës

¹⁵ Sabit Syla, *“Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj çështjes kombëtare të Kosovës 1939-1981”*, tezë doktrature, Tiranë 2011, fq.32-33.

¹⁶ Rezoluta e Konferencës së Bujanit, botuar në librin *Këshilli Popullor i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Dukagjinit*.

Atlantike, do të respektojnë pranimin e vetëvendosjes, përkatësisht vullnetin konkret të popullit të Kosovës.

Duke u nisur nga këto përcaktime burimore të Konferencës, mund të thuhet se Rezoluta e Konferencës së Bujanit ishte një akt me fuqi konstitutive dhe me garanci ndërkombëtare. Në fakt, Rezoluta e Bujanit paraqiste dokumentin themelor të vetëvendosjes së shqiptarëve të Kosovës¹⁷.

Zbërthimi juridik-politik i pasuesit të cituar të Rezolutës nxjerr në pah tri elemente qenësore, që e përcaktojnë të drejtën e vetëvendosjes së popullit shqiptar në Kosovë:

1. **Elementi etnik**, sipas të cilit populli shqiptar është ai që vetëvendos, dhe kjo e drejtë e tij buron nga të banuarit dhe shtrirja kompakte në shumicë në atë territor (“Kosova...krahina e banuar me shumicë nga populli shqiptar...”),

2. **Elementi historik**, pra lashtësia e banueshmërisë së kësaj krahine nga shqiptarët dhe kontinuiteti historik i ekzistimit të saj, entitet (formulimi ”si gjithmonë ashtu edhe sot”) dhe

3. **Elementi politik** apo shprehja e vullnetit politik plebishitar për t’iu bashkuar një shteti, në këtë rast Shqipërisë, si synim shekullor dhe aktual i shqiptarëve të Kosovës (formulimi “populli shqiptar deshi-ron të bashkohet me Shqipërinë”).

Përpos këtyre tri elementeve valide për vetëvendosjen e një populli, në rrethana paqeje, populli shqiptar në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore, kishte përmbushur edhe një element të veçantë, për rrethanat e luftës, atë që e përcakton Karta e Atlantikut, luftën e shqiptarëve kundër fashizmit, si parakusht që pas përfundimit të luftës “çdo popull të vendosë për fatin e vet”.

Përcaktimet politike, të përcaktuara në Rezolutën e Konferencës së Bujanit, hasën në reagime të ashpra të kreut politik jugosllav. Qëllimi i këtyre reagimeve politike ishte devaluimi i pjesës së Rezolutës, e cila popullit shqiptar i përcakton të drejtën e vetëvendosjes, dhe mënjanimi i mundësisë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës jashtë Jugosllavisë. Menjëherë pas miratimit, kreu politik i PKJ-së nëpërmjet komisarëve të vet politikë (Tempo, Mugosha, Dedijer, Rajoviq, Joviqeviq, Aksiq etj.) filloi fushatën e diskualifikimit politik të Rezolutës së Konferencës së Bujanit, fushatë që vazhdoi më se pesë decenie.

¹⁷ Noel Molcolm, “Kosova një Histori e Shkurtër”, Macmillan, London 1998, fq. 307-308.

Pa marrë parasysh kontestimin që i është bërë pjesës së Rezolutës, e cila përcakton të drejtat e vetëvendosjes së popullit shqiptar, përmbajtja e kësaj paraqet një fakt historik dhe më shumë - një të vërtetë historike e cila nuk mund të hidhet dhe të anulohet, siç bëri përpjekje pushteti jugosllav.

Aneksimi i dhunshëm i Kosovës pas Konferencës së Bujanit

Periodha pas miratimit të Rezolutës së Bujanit, karakterizohet me presione të vazhdueshme politike, e që kishte për qëllim krijimin e rrethanave politike, në të cilat kjo Rezolutë do të diskualifikohej dhe do të krijoheshin kushtet për aneksimin e dhunshëm të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë. Në këtë kontekst, në periudhën prej 8 shkurtit e deri në gjysmën e majit 1945, në Kosovë, me urdhrin e komandantit suprem (Tito)¹⁸ vendoset administrimi ushtarak si organ i pushtetit ushtarak-shtetëror¹⁹. Ndonëse, me vendosjen e gjendjes së administrimit (sundimit) ushtarak nuk u rrëzua plotësisht pushteti popullor, puna e organeve të pushtetit popullor dukshëm qe zbehur, meqë ai iu nënshtrua detyrave që parashtrroi ushtrimi ushtarak²⁰.

Çështja e statusit të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit nga kreu politik i PKJ-së filloi të shtrohet në fund të vitit 1944 dhe në gjysmën e parë të vitit 1945. Biseda e parë, në udhëheqjen partiake, për fatin e mëtejshëm të Kosovës, sa dihet, është mbajtur në Komitetin Qendror të PKJ-së, gjatë shkurtit të vitit 1945. Në këto biseda, ku merrte pjesë kreu politik i PKJ-së, ishin të kristalizuara tri mundësi të zgjidhjes së çështjes së Kosovës:

1. Kosova t'i bashkohet Shqipërisë;
2. Kosova të inkuadrohet në Serbinë federale;
3. Kosova të ndahet në mes të Serbisë dhe Malit të Zi (të cilit do t'i bashkëngjitej Rrafshi i Dukagjinit).

¹⁸ Me gjerësisht, Stipe Mesiq, *"Si u shkatërrua Jugosllavia"*, Prishtinë, 2011, fq.

¹⁹ Bob Allen, *"Why Kosovo? Anatomy of a Needless War"*, Canadian Centre for Policy Alternatives, July 1999, fq.8

²⁰ Gazmend Zajmi *"Vepra I"*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, libri 9, Prishtinë 1997, fq.10-11.

Nga këto tri alternativa, dominoi ajo e komunistëve serbë, që Kosova t'i bashkohet Serbisë federale në kuadër të Jugosllavisë federale.

Duke u mbështetur në këto qëndrime të reja politike, të cilat ishin në kundërshtim me qëndrimin e mëparshëm të PKJ-së lidhur me Kosovën (dhe premtimet që u ishin dhënë shqiptarëve për vetëvendosje) filluan përgatitjet për aneksimin e dhunshëm të Kosovës.

Kosova u aneksua nga Serbia, nga rrethanat e administrimit ushtarak, më 10 korrik 1945, në Kuvendin e Prizrenit (i ashtuquajtur i plebishitit i Prizrenit), i cili u organizua nga forcat politike serbe. Në këtë Kuvend u miratua “Rezoluta për bashkimin e Kosovës dhe Metohisë me Serbinë Federale”. Në këtë rezolutë, supozohet se përmes delegatëve, Këshillit Krahinor të Kosovës e të Dukagjinit “shprehej vullneti për t’iu bashkëngjitur Serbisë”²¹. Ky konstatim nuk është i saktë, ngase nuk i përgjigjet realitetit historik. Vullnetin e vet burimor përfaqësuesit e popullit shqiptar e shprehën në Konferencën e Bujanit, u bë një falsifikim ordinar i përcaktimit politik të popullit shqiptar dhe u bë aneksimi i dhunshëm i Kosovës me Serbinë federale.

Edhe pse formalisht, Kosova u aneksua nga ana e Serbisë, më 10 korrik 1945, burimet historike flasin se marrëveshjet për aneksin e Kosovës, u kryen më herët, në kuadër të KQ të PKJ-së, KQS dhe KK të PKJ-së. Këtë e vërteton edhe fakti se një vendim të këtillë para Kuvendit kontestues të Prizrenit, e shprehën përfaqësuesit nga Kosova (Dushan Mugosha dhe Mehmet Hoxha) në Mbledhjen e Këshillit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë (7-9 prill 1945) të mbajtur në Beograd, ku këta dy deklarohen për bashkimin e Kosovës me Serbinë²².

Në aspektin konstitucional, është me rëndësi të theksohet fakti se, edhe pse vendimi kontestues për bashkimin e Kosovës me Serbinë federale, u mor pa vullnetin e shqiptarëve (sepse ata që vendosën, nuk kishin mandat për një deklaram të këtillë), ai mbështetej mbi supozimin se edhe atëherë është realizuar parimi i vetëvendosjes²³.

Në anën tjetër, në vendimin e përmendur “Kosova i bashkohet Serbisë federale në kuadër të Jugosllavisë”. Edhe ky formulim ka rëndësi, ngase i jep të drejtë Kosovës që të dërgojë në aktet e veta burimore kushtetuese, këtë vendim pas procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë.

²¹ Noel Malcolm “Kosova një Histori e Shkurtër”, Mecmilan, London, 1993, fq.

²² Sabit Syla, “Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj çështjes kombëtare të Kosovës 1939-1981” tezë doktrature, Tiranë 2011, fq.34.

²³ Kërë qëndrim e mbron edhe Profesor Gazmend Zajmi. Shih: Esat Stavileci “Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit”, Shoqata e Pavarur e Juristëve-Prishtinë, 1997, fq.15-16.

Për shkak të aktualitetit politik, me qëllim të argumentimit të së drejtës së vetëvendosjes të popullit shqiptar pas zhbërjes së ish RSFJ-së, do të analizojmë shkurtimisht këto dy aspekte të këtij vendimi kontestues.

Formulimi që u bë në rezolutë, që Kosova t'i bashkohet Serbisë, “*me dëshirën e popullatës së saj*”, ndonëse nuk i përgjigjet realitetit, në fakt, ngërthen në vete faktin, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë se çështja e Kosovës qysh atëherë trajtohej si çështje e vetëvendosjes së popullatës së saj. Në Kuvendin e Prizrenit, jo rastësisht u la “plotësisht në heshtje” Rezoluta e Bujanit, e cila kishte një ” një kontekst krejtësisht tjetër gjeopolitik”. Në Rrafshin konstitucional-juridik mund të nxirret përfundimi se në Kuvendin e Prizrenit, në fakt, nuk u bë shfuqizimi i Rezolutës së Bujanit, por siç thekson me të drejtë akademik Gazmend Zajmi, ”u bë dërgimi i saj nëpërmjet një zgjidhjeje tjetër të mëvonshme për fatin shtetëror politik të Kosovës”. Po këtë fat të dërgimit, sipas akademik Gazmend Zajmit, “e pësoi edhe Rezoluta e nxjerrë më 1945 për bashkimin e Kosovës me Serbinë nëpërmjet Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990, nxjerr nga Kuvendi i Kosovës mbi pavarësinë dhe barazinë e Kosovës në ish-Federatën - Konfederatën e ish-Jugosllavisë”²⁴.

Vendimi sipas të cilit Kosova i bashkohet Serbisë federale në kuadër të Jugosllavisë federative është më rëndësi nga se, edhe pse nuk përkon me vullnetin burimor të popullit shqiptar, i jep të drejtë atij, që pas shpërbërjes së RSFJ-së, të riformulojë dhe përcaktojë sërish statusin e vet konstitucional. Ky argument është mjaft i rëndësishëm dhe i shërben Kosovës për t'u rikthyer në gjendjen para vendosjes për asocim me Serbinë në vitin 1945. Duke u bazuar në këtë, Kosova ka të drejtë që të thirret në parimin juridik “*Restitutio in integrum*”. Ky parim nënkupton të drejtën e Kosovës, që sërish të deklarohet për statusin e vet konstitucional, gjë që edhe e bëri në vitin 1990 dhe 1991, kur nëpërmjet organeve të veta legjitime (Kuvendit) dhe me deklaram gjithëpopullor politik (referendum) nxori dhe miratoi aktet burimore kushtetuese dhe politike, me të cilat lindi Republika e Kosovës shtet sovran dhe i pavarur.

Konstituimi formal juridik i statusit autonom të Kosovës, në kuadrin e ish-Federatës jugosllave u bë me këto akte:

²⁴ Akademik Gazmend Zajmi, “*Rrjedhat e konfliktësisë shqiptaro-serbe në rrafshin kushtetues të ish-Federatës Multinacionale të Jugosllavisë*”, Vjetari 1996, Prishtinë, 1996.

1. Vendimi i Kuvendit Krahinor të Kosovës e Metohisë (i shprehur në formë të rezolutës), me të cilin bëhet aneksimi i dhunshëm i Kosovës nga Serbia federale në kuadrin e ish-Jugosllavisë;
2. Vendimi i mbledhjes së Tretë të KAÇKJ-së, me të cilin është miratuar Vendimi kontestues i Kuvendit Krahinor;
3. Ligji i Kryesisë së Kuvendit Popullor të Serbisë për themelimin dhe organizimin e KAKM-së;
4. Kushtetuta e RFPJ-së e vitit 1946²⁵.

Nga kjo që u theksua më lart, mund të nxjerrim këto përfundime:

1. Kosova historikisht ka qenë një territor kompakt, i banuar nga populli shqiptar si popull autokton dhe si një nga popujt më të vjetër të Ballkanit;
2. Në saje të politikës joparimore të Fuqive të Mëdha, trojet etnike shqiptare gjatë gjithë historisë kanë qenë objekt i copëtimeve territoriale dhe i pushtimeve të huaja;
3. Çështja e Kosovës nuk mund të paraqesë vetëm një anë të çështjes shqiptare, e cila paraqet një çështje unike, e që mund të zgjidhet vetëm me bashkimin kombëtar dhe me krijimin e një shteti shqiptar në kufijtë e tij historikë dhe natyrorë;
4. Kosova u aneksua në mënyrë të dhunshme nga ana e Serbisë, në kushtet e gjendjes së administrimit ushtarak në Kosovë;
5. Shpërbërja e ish-RSFJ-së krijoi një gjendje të re gjeopolitike, e cila Kosovës i jep të drejtën e shkëputjes nga ish-Jugosllavia dhe, duke shpallur pavarësinë, të vetëpërcaktohet që të jetojë me ligjet e veta dhe të ketë institucione dhe organizim të pavarur politik.

Nxjerrja e Kushtetutës së ish-RSFJ-së në vitin 1974 vazhdoi procesin e avancimit të pozitës së Kushtetutës së Kosovës në kuadrin e federalizmit jugosllav. Kosova me dispozitat e kësaj Kushtetute u përcaktua si njësi autonome politike territoriale dhe si element konstitutiv i federalizmit²⁶.

²⁵ Kurtesh Salii, "Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të KSAK në Jugosllavinë Socialiste", Prishtinë, 1984, fq.31.

²⁶ Kjo pozitë e Kosovës kishte ardhur në të ashtuquajturën Jugosllavinë e Titos, edhe pse formalisht dhe juridikisht Kosova ishte pjesë e Serbisë me statusin e krahinës së bashku me Vojvodinën. Shih: David Anderson "The Collapse of Yugoslavia Background and Summary" research paper, Australia, 1995, fq.5-6.

Pozita kushtetuese juridike e Kosovës, sipas Kushtetutës së ish-RSFJ-së së vitit 1974, në shumë sfera ishte e ngjashme (por jo krejtësisht e barabartë) me pozitën e republikave socialiste. Edhe pse dispozitat e kësaj Kushtetute, këtë nuk e përcaktojnë shprehimisht, mund të thuhet se Kosova, sipas kësaj Kushtetute, ishte njësi e mëvetësishme federale dhe element konstitutiv, gjë që ka rëndësi të theksohet, ngase pikërisht një pozitë e këtillë e sanksionuar me këtë Kushtetutë, Kosovës (njësoj si njësitë të tjera federale) i jep të drejtën e vetëpërcaktimit të ri statusor-konstitucional të pozicionit të saj pas shpërbërjes së RSFJ-së.

Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974, sikur edhe Kushtetuta e KSA të Kosovës të vitit 1974, përcaktojnë Kosovën:

1. Njësi të mëvetësishme politike territoriale;
2. Element konstitutiv të federalizmit jugosllav²⁷.

Pozita e Kosovës, sipas zgjedhjeve kushtetuese të vitit 1974, përpos dy komponentëve të lartpërmendur, karakterizohej edhe me qenien e saj specifike në kuadër të strukturës së ndërlikuar kushtetuese të Serbisë. Kosova nuk ishte pjesë e Serbisë, por gjendej në kuadrin e strukturës kushtetuese dhe hibride të Serbisë.

Analiza e këtyre zgjidhjeve mund të jetë në funksion të argumentimit të pohimit tonë se edhe Kosova, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë ka të drejtë për vetëvendosje dhe suksesion²⁸.

Disa argumente kushtetuese që Kosova nuk ishte asnjëherë pjesë e Serbisë

Pozita kushtetuese hibride e Kosovës siç e quante akademik Gazmend Zajmi, “në kuadrin e Federatës së ish-Jugosllavisë dhe pjesë konstitutive e saj dhe njëkohësisht e strukturuar në kuadër të Serbisë ishte, synim balancimi që shkaktohej përmes tendencave konfliktore për status plotësisht të barabartë të Kosovës në Federatë, që nënkuptonte pavarësinë e Kosovës dhe daljen e saj nga përbërja kushtetute e Serbisë

²⁷ Arsim Bajrami “*Aktet Kushtetuese dhe Politike të Shtetësisë së Kosovës*”, Prishtinë 1996, fq.9-13.

²⁸ Shih për më tepër: Charles W. Ingraio, Gary B. Cohen “*Confronting the Yugoslav Controversies*”, United States Institute of Peace Press Washington, D.C., Purdue University Press West Lafayette, Indiana, 2009, fq.57-60; (Kosovo under Autonomy, 1974–1990 by Momčilo Pavlovi).

dhe tendencat për mbajtjen e Kosovës në suaza kushtetuese të Serbisë në shkallë sa më të theksuar të unitaritetit që ishte e mundur”²⁹.

Strukturimi i Kosovës, në kuadër të kornizave kushtetuese juridike të Serbisë ishte një pozitë vërtet paradoksale, jo vetëm nga aspekti formal-juridik, por edhe nga aspekti politik-kushtetues, që nuk ka mundur të quhej ndryshe veçse një logjikë kushtetuese juridike e panatyrshme, pra një palogjikshmëri në aspektin kushtetues politik, e cila nuk mund të mbrohet, së paku jo për të arsyetuar qenien e Kosovës “në kuadër të strukturës komplekse kushtetuese të Republikës së Serbisë në emër të integrujesit të përbashkët”³⁰.

Një pozicion i këtillë i Kosovës në kuadrin e Republikës së Serbisë nuk ishte në përputhje me vullnetin e popullit shumicë të Kosovës. Së këndejmi, akademik Zajmi me të drejtë pohon se Kosova si njësi me Kushtetutë të vetën dhe pjesë konstitutive e Federatës, sipas Kushtetutës së saj dhe kushtetutës së Federatës multinacionale të Serbisë, nuk ishte pjesë e Serbisë, por vetëm ishte në kuadër të strukturës komplekse kushtetuese sipas prezumpcionit të vet vullnetit të Kosovës. Në të kundërtën, vazhdon Zajmi, do të kishim situatë paradoksale juridike “të inkuadrimit të Serbisë në Serbi” dhe të inkuadrimit të tri Serbive me tri vota në Federatë, ndërsa njësitë e tjera do të kishin nga një votë³¹. Se Kosova nuk ishte pjesë e Serbisë, prof. dr. Esat Stavileci thekson këto të dhëna historike dhe juridike:

E para, Kosova nuk ishte në përbërje të shtetit sovran dhe të pavarur të Serbisë me subjektivitet juridik-ndërkombëtar të pranuar në Kongresin e Berlinit 1878;

E dyta, Kosova nuk ishte pjesë në Kuvendin e dytë të AVNOJ-it (1943);

E treta, Kosova nuk ishte në përbërjen e Serbisë gjatë konstituiimit të saj si njësi federale në Këshillin Antifashist të Çlirimit Popullor (1944);

²⁹ Akademik Gazmend Zajmi, “Rrjedhat e konfliktësive shqiptaro-serbe në rrafshin kushtetues të ish-Federatës multinacionale të Jugosllavisë”, “e drejta”, nr. 1/96, Prishtinë, 1996.

³⁰ Ibid.

³¹ Akademik Gazmend Zajmi, “Çështja Shqiptare dhe Federalizmi”, “Zëri”, Prishtinë, 5 nëntor 1994.

E katërta, Kosova nuk ishte në përbërje të Serbisë në strukturën e Asamblesë Kushtetutëdhënëse të Jugosllavisë me rastin e shpalljes së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë³²;

E pesta, Kosova nuk ishte e inkadruar në Serbinë sovraane dhe të pavarur, veçse në përbërje të “Serbisë Federale në kuadrin e Jugosllavisë Federale” (1945), me ç’rast klauzola juridike *Rebus Sic Standitibus* me logjikën e vet domosdo imponon edhe në jetën politike ndryshime të mëdha strukturale.³³ Kuvendi i Kosovës sipas zgjidhjeve Kushtetuese të vitit 1974 ka dhënë pëlqimin për ndryshimin e Kushtetutës së Serbisë, pëlqim ky (sikurse te ndryshimi i Kushtetutës Federative) që ka pasur karakter konstitutiv juridik, ngase pa dhënien e tij nuk ka mund të bëhen kurrfarë ndryshimesh kushtetuese në Serbi.

Avancimi i pozitës kushtetuese të Kosovës, si njësi e barabartë e mëvetësishme politiko-territoriale dhe si pjesë e barabartë dhe konstitutive e federalizmit jugosllav, e në këtë kontekst edhe afirmimi dhe emancipimi kombëtar i popullit shqiptar, ishte i papranueshëm për forcat nacionaliste serbe, të cilat Kosovën dhe shqiptarët kanë tentuar gjithmonë t’i mbanin nën sundim dhe ndaj tyre të udhëheqin një politikë diskriminuese.

Pozita kushtetuese juridike e Kosovës e përcaktuar në zgjidhjet kushtetuese të vitit 1974, ishte vazhdimisht objekt i kritikave dhe sulmeve, në fillim nga forcat nacionaliste dhe shoviniste serbe, e pas vitit 1981 edhe nga politika zyrtare serbe. Jo shumë vonë, pas nxjerrjes së Kushtetutës së vitit 1974, u hartua i ashtuquajti “*Libri i Kaltër*”, në të cilin, në kuadër të kreut politik të Serbisë ishte përcaktuar strategjia e veprimit politik në drejtim të ngushtimit dhe rrënimit të mëvetësisë kushtetuese dhe politike të Kosovës.

Edhe pse studiuesit ndërkombëtarë ligjërisht në punimet e tyre e kanë trajtuar Kosovën si pjesë të Serbisë, argumentet shkencore dhe faktike flasin të kundërtën. Të gjitha këto argumente çojnë në konkluzionin që Kosova asnjëherë nuk ka qenë pjesë e Serbisë³⁴.

³² Esat Stavileci, “Çështja e Kosovës në Veprën e Gazmend Zajmit”, Shoqata e Juristëve të Kosovës, Prishtinë 1997, fq.15-25.

³³ Esat Stavileci, “Çështja Shqiptare në Udhëkryqin e Zgjidhjeve Paqësore”, Prishtinë 1995, fq. 47.

³⁴ David Anderson “*The Collapse of Yugoslavia Background and Summary*” research paper, Australia, 1995, fq.6.

Lindja e Republikës së Kosovës - dimensionet kushtetuese

Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë rrethanat politike për Kosovën ndryshuan. Siç e thamë edhe më lart, autonomia dhe pozita që kishte Kosova në kuadër të Kushtetutës së vitit 1974 u rrënuar në mënyrë kundërkushtetuese dhe kundërligjore, në kushtet e dhunës dhe shtetrrëthimit³⁵. Të gjendur në këto rrethana Kosova krijoi institucionet e saj të ashtuquajtura “paralele”, mirëpo të njëjtat institucione përfaqësonin vullnetin e popullit të Kosovës³⁶. Po ashtu në këtë kohë u krijua edhe lëvizja e parë politike e cila mishërohej me përfaqësimin e vullnetit të popullit të Kosovës e cila u quajt Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të cilën e udhëhiqte Dr.Ibrahim Rugova³⁷.

Populli i Kosovës dhe përfaqësuesit e tij, të ndodhur në një situatë të rrënimit të autonomisë dhe udhëkryqit të vendosjes për fatin e tyre, ndër morën një numër veprimesh juridike dhe politike duke nxjerrë një numër të caktuar të akteve kushtetuese përmes të cilëve transmetonin vullnetin e tyre, duke e krijuar kështu Republikën e Kosovës.

Nga kjo që u theksua më lart, rrjedh se Republika e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, lindi dhe u krijua me këto akte kryesore kushtetuese dhe politike:

- Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut të vitit 1990;
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës e 7 Shtatorit të vitit 1990 (Kushtetuta e Kaçanikut);
- Referendumi gjithëpopullor për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur i mbajtur më 26-30 shtator të vitit 1991;
- Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 tetor 1991;
- Amendamentet Kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës më 19 tetor 1991³⁸;
- Zgjedhjet e lira dhe shumëpartiake për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës të

³⁵ Noel Malcolm, “Kosova një Histori e Shkurtër”, Mecmilan, London, 1993, fq.361-364.

³⁶ Michael Salla, “Kosovo, non-violence and the break-up of Yugoslavia”, SAGE publications, vol,26(4)-427-438, 1995, fq.428-429.

³⁷ Ibid, 429-430.

³⁸ Ibid.

mbajtura më 24 maj 1992 dhe për të dytën më 22 mars të vitit 1998³⁹.

Renditja e akteve dhe veprimeve të lartpërmendura është bërë në mbështetje të kohës së nxjerrjes së tyre, nga se ato paraqesin një proces të pashkëputshëm me të cilin është bërë rumbullakësimi kushtetues dhe politik i Republikës së Kosovës.

Këto akte njëherësh mund të cilësohen edhe si akte burimore me të cilat lindi dhe u krijua Republika e Kosovës.

Okupimi i Kosovës dhe eskalimi i luftës së armatosur⁴⁰

Pas shpalljes së Republikës së Kosovës, Serbia intensifikoi dhunën shtetërore ndaj shqiptarëve, duke zbatuar politikën e saj të shtypjes, keqtrajtimit, të shkeljes së të drejtave elementare (përfshirë këtu edhe të drejtën për jetë) dhe një arsenal të tërë të dhunës shtetërore që synonte spastrimin etnik dhe vënien e plotë të Kosovës nën juridiksionin serb. Pas vitit 1990, Serbia përmes metodës së puçit kushtetues shkatërroi të gjitha institucionet legjitime të Kosovës dhe me ndihmën e dhunës policore, okupoi të gjitha institucionet publike në Kosovë, që nga ato politike, arsimore, kulturore, informative, shëndetësore, sportive etj⁴¹.

Praktikisht, shqiptarët dhe Kosova, përmes një varg ligjesh diskriminuese, vendosën në gjendje jashtëligjore dhe Serbia zbatoi një segregacion etnik në shkallë apartheidi, duke kufizuar dhe shkelur të gjitha liritë individuale dhe politike, duke siguruar sundimin e pakicës serbe ndaj shumicës shqiptare. Si përgjigje ndaj dhunës serbe, shqiptarët zgjodhën rrugën e jodhunës dhe përmes mjeteve politike shprehën kundërshtimin e okupimit serb dhe padëgjueshmërinë qytetare ndaj këtij okupimi. Ata nuk morën pjesë në zgjedhjet serbe dhe jugosllave dhe nuk participuan në asnjë proces politik të cilin Serbia dhunshëm e imponoi në Kosovë. Në anën tjetër, shqiptarët në Kosovë bënë përpjekje për

³⁹ Arsim Bajrami “Aktet Kushtetuese dhe Politike të Shtetësisë së Kosovës”, Prishtinë 1996, fq.24-41.

⁴⁰ Shih më shumë edhe: Dusan Janjić, with Anna Lalaj and Besnik Pula “Kosovo under the Milošević Regime”, fq.272-301. Publikuar në kuadër të: “Confronting the Yugoslav Controversies” United States Institute of Peace Press Washington, D.C., 2009, Purdue University.

⁴¹ Peter Hilpold, “The International Court of Justice’s Advisory Opinion on Kosovo: Perspectives of a Delicate Question”, Austrian Review of International and European Law, fq.264-266.

organizim paralel të institucioneve politike, arsimore, kulturore, informative etj. Në periudhën deri në eskalimin e plotë të luftës në Kosovë, siç u tha u mbajtën dy cikle të zgjedhjeve parlamentare, por mungoi funksionalizimi i organeve të Kosovës. Këtë, e pengoi regjimi serb i cili ndëshkonte dhe pamundësonte çdo përpjekje të shqiptarëve për organizim shtetëror, por edhe mungesa e një strategjie të qartë politike të subjekteve të atëhershme politike, për realizimin e përcaktimit politik të popullit të Kosovës për pavarësi, me referendumin e vitit 1991⁴².

Paraqitja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Duke mos u pajtuar me okupimin serb të Kosovës dhe duke parë paaftësinë e zgjidhjes politike të krizës në Kosovë, pas vitit 1990, filluan përgatitjet për formimin e UÇK-së, si formacion i rregullt ushtarak dhe si kryengritje e armatosur për çlirimin e Kosovës. Këto përgatitje u kurorëzuan në vitin 1997, kur UÇK-ja doli publikisht në skenë dhe filloi luftën çlirimtare në Kosovë. Formimi i UÇK-së paraqet një ngjarje historike për popullin e saj, në luftën e tij historike për pavarësi. Formimi i UÇK-së⁴³ bazohej në vetë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të 7 Shtatorit të vitit 1990, e cila në nenin 77 shprehimisht përcaktonte se: “mbrojtja e vendit, është e drejtë e pacenueshme dhe e patjetërsueshme, obligim dhe nder i madh i çdo qytetari”.

Themelimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bëri që të krijohen raporte të reja në Kosovë dhe rajon, që problemi i Kosovës të dalë në skenë me tërë kompleksitetin e tij. Kundërvënia e armatosur e shqiptarëve, përmes UÇK-së ishte një dëshmi e fuqishme e gatishmërisë së popullit të Kosovës, që me vetëflim dhe sakrificë, të dëshmojë përcaktimin e tij të fuqishëm për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ky fakt bëri që problemi i Kosovës të arrijë kulminacionin e ndërkombëtarizimit dhe të marrë një trajtim më adekuat. Më të vërtetë fillimi i luftës çlirimtare nga UÇK-ja, nxori në shesh faktin se çështja e Kosovës nuk paraqet çështje të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të shqiptarëve (siç trajtohej deri atëherë ky problem), por një problem politik në thelbin e së cilës

⁴² Stefan Troebst, “*Conflict in Kosovo: Failure of Prevention? An Analytical Documentation, 1992-1998*”, European Centre for Minority Issues (ECMI) Flensburg, 1998, fq.31.

⁴³ Peter Hilpold, “*The International Court of Justice’s Advisory Opinion on Kosovo: Perspectives of a Delicate Question*”, Austrian Review of International and European Law, fq.264.

është e drejta e vetëvendosjes së shqiptarëve, përkatësisht pavarësia e Kosovës.

E formuar nga motivi çlirimtar, UÇK-ja arriti shumë shpejt të fitojë mbështetjen e popullit të Kosovës dhe të jetë faktor kryesor në komunikimet me faktorin ndërkombëtar, rreth zgjidhjes së krizës në Kosovë. Në doktrinat ushtarake ndërkombëtare, UÇK-ja paraqet formacionin ushtarak i cili gëzoi njohje shumë të shpejtë ndërkombëtare⁴⁴.

Që nga ditët e para të paraqitjes publike, filluan kontaktet diplomatike të UÇK-së, me diplomatët e huaj, sidomos atyre amerikanë rreth zgjidhjes së krizës. Në këto kontakte, u bë njohja *de facto* e UÇK-së, kurse njohja *de jure* e saj, pasoi në Konferencën e Rambujesë ku përfaqësuesit e saj u legjitimuan si negociatorë kryesorë, kurse ish-udhëheqësi i Drejtorisë Politike të UÇK-së, njëkohësisht kryeson delegacionin kosovar në këtë Konferencë.

E formuar fillimisht përmes njësive të vogla guerile, UÇK-ja shumë shpejt mori formën e një ushtrie të rregullt me një strategji të qartë politike, me një komandim unik dhe me strukturë tipike ushtarake. Ajo arriti të çlirojë shumë territore të Kosovës dhe të përfitojë simpatinë ndërkombëtare për luftën e drejtë të saj. Në anën tjetër, policia dhe ushtria serbe, si dhe formacionet e saj paramilitare, duke mos qenë në gjendje të mposhtin UÇK-në, vazhduan vrasjen joselektive të civilëve shqiptarë, masakrimin e tyre kolektiv, djegien e shtëpive dhe pasurisë së tyre, si dhe deportimin e tyre të dhunshëm jashtë Kosovës. Ky deportim, pas dështimit të Konferencës së Rambujesë, mori trajtën e një eksodi masiv, me synim të spastrimit etnik dhe gjenocidit të shqiptarëve. Më tepër se 1 milion shqiptarë të Kosovës u dëbuan dhunshëm nga policia serbe në Maqedoni, Shqipëri dhe anembanë Evropës. Ky eksod masiv, dhuna dhe gjenocidi, të cilën Serbia e ushtroi në Kosovë, si dhe lufta e drejtë e UÇK-së zgjoi ndërgjegjen e komunitetit ndërkombëtar dhe nevojën e ndërhyrjes ushtarake kundër Serbisë. Kjo edhe ndodhi, më dt. 24.03.1999, kur NATO filloi luftën kundër Serbisë, luftë kjo që zgjati 78 ditë dhe që përfundoi me kapitullimin e Serbisë dhe tërheqjen e saj të plotë nga territori i Kosovës. Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së Kosovës nën prezencën civile dhe ushtarake ndërkombëtare dhe marrjes përsipër të sigurisë së Kosovës nga forcat e KFOR-it, erdhi deri te demilitarizimi i UÇK-së dhe formimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

⁴⁴ Greg Campbell, "The road to Kosovo", 2000, fq. 159-181.

Konferenca e Rambujesë - aspekti juridik dhe ndërkombëtar

Gjenocidi serb në Kosovë që manifestohej në forma të ndryshme të dhunës dhe masakrimit të shqiptarëve, riktheu interesimin e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë dhe nevojën e pashlyeshme, për një zgjidhje të shpejtë politike të konfliktit. Në këtë kontekst, Masakra e Reçakut dhe gjykimi i drejtë i saj nga ambasadori i OSBE-së në Kosovë, Uoker, ishte ngjarje kyçe, e cila ndikoi në thirrjen e një Konference Paqësore Ndërkombëtare për Kosovën, në Rambuje të Francës.

Konferenca ndërkombëtare paqësore për Kosovën u mbajt në Rambuje dhe Paris prej 6 deri me 23 shkurt dhe prej 15 deri në 18 mars 1999, në kohën kur kriza në Kosovë kishte përshkallëzuar në një luftë të përgjakshme me rrezik për t'u shtrirë edhe jashtë kufijve të Kosovës. Konferenca paraqiste përpjekjen e fundit politike për ndaljen e luftës dhe gjenocidit serb kundër shqiptarëve, vendosjen e Kosovës nën protektoratin e NATO-s, krijimin e një statusi kalimtar për Kosovën dhe evitimin e rrezikut potencial që kërcënonte paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Konferenca ishte organizuar nga i ashtuquajtimi Grup i Kontaktit dhe në Konferencë mori pjesë delegacioni shqiptar, ai serbo-jugosllav dhe pala ndërkombëtare, ku bënin pjesë anëtarët e Grupit të Kontaktit dhe shumë shtete evropiane. Delegacioni shqiptar përfaqësohej nga subjektet e atëhershme politike dhe përfaqësuesit e UÇK-së, si dhe nga ekspertët e pavarur. Delegacioni serbo-jugosllav përfaqësohej nga zyrtarët e lartë serbë dhe nga anëtarët luajalë të politikës së regjimit serb. Konferenca kryesohej nga tre bashkëkryesues, Kristofer Hill nga ShBA-ja, Volfang Petriç-i nga Këshilli i Evropës dhe Boris Majorski nga Federata Ruse⁴⁵.

Procesi negociator në Rambuje zhvillohej mbi bazën e Projekt-marrëveshjes së Rambujesë, respektivisht Projekt-marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë, të cilën e kishte përgatitur Grupi i Kontaktit.

Konferenca e Rambujesë synonte arritjen e një marrëveshjeje juridike dhe politike për zgjidhjen e krizës në Kosovë, duke përcaktuar një zgjidhje kalimtare që parashihte vendosjen e Kosovës nën mbrojtjen

⁴⁵ Stephen T.Hosmer, "WHY MILOSEVIC DECIDED TO SETTLE WHEN HE DID", Prepared for the UNITED STATES AIR FORCE, 2001, fq.8-16.

e NATO-s, të mundësonte një vetadministrim të përkohshëm për Kosovën në periudhën trevjeçare dhe të hapte mundësinë e zhvillimit të një procesi politik për përcaktimin e statusit final për Kosovën. Konferenca parashihte një proces negociues të palës shqiptare dhe serbe për marrëveshjen politike, të cilën e propozonin ndërmjetësuesit ndërkombëtarë. Me gjithë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar, në këtë Konferencë nuk kishte kontakte të drejtpërdrejta shqiptaro-serbe, për shkak të refuzimit të delegacionit shqiptar për t'u takuar me palën serbe. Në Konferencë dominonin dy qasje dhe koncepte. Qasja e delegacionit shqiptar, që ishte konstruktive dhe kooperative me faktorin ndërkombëtar dhe qasja e dytë serbe, destruktive dhe joserioze, e cila bënte obstruksion në arritjen e kësaj marrëveshjeje dhe përjashtonte çdo opsion të ndarjes së Kosovës nga Serbia dhe të vendosjes së saj nën administrimin ndërkombëtar. Konferenca, krahas negociatorëve politikë ndërkombëtarë udhëhiqej dhe përgatitej nga ekspertët amerikanë, të cilët ishin hartues të të gjitha drafteve që diskutoheshin në Konferencë. Në fund të pjesës së parë të Konferencës në Rambuje, në punimet e saj u kyç në mënyrë aktive edhe zonja Medllin Ollbrajt (Madeleine Albright), Sekretare e Jashtme e shtetit amerikan, e cila i ofroi ndihmë të konsiderueshme delegacionit kosovar.

Në pjesën e parë të punës së kësaj Konference, delegacioni kosovar përkrahu në parim tekstin e marrëveshjes së propozuar nga negociatorët ndërkombëtarë dhe kërkoi që nënshkrimin e saj ta bëjë pas një konsultimi të sërishëm me popullin në Kosovë. Ndërkaq, pala serbe refuzoi në tërësi marrëveshjen, duke mos treguar seriozitet në negociata dhe duke refuzuar çdo zgjidhje politike të krizës.

Në pjesën e dytë të Konferencës në Paris, delegacioni kosovar bëri nënshkrimin solemn të Marrëveshjes, kurse ai serb sërish refuzoi nënshkrimin e saj. Marrëveshja u nënshkrua edhe nga tre ndërmjetësuesit ndërkombëtarë.

Teksti i Marrëveshjes përbëhej nga Marrëveshja bazë e quajtur Marrëveshje e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë dhe tetë kaptina (anekse) kryesore.

Në fund të tekstit të Marrëveshjes së Rambujesë, me insistimin e delegacionit kosovar, është dhënë një klauzolë e veçantë në të cilën shprehimisht përcaktohet se “tri vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të thirret një mbledhje ndërkombëtare për të determinuar një mekanizëm për një vendosje (zgjidhje) finale për Kosovën, në bazë të vullnetit të popullit, të mendimeve të autoriteteve relevante, të për-

projekteve të secilës palë në lidhje me implementimin e kësaj marrëveshjeje dhe të Aktit Final të Helsinkit dhe që të ndërmerren vlerësimet e përgjithshme për implementimin e kësaj marrëveshjeje, duke i konsideruar propozimet nga secila palë për masat shtesë. Edhe pse nga ky formulim nuk përcaktohet shprehimisht e drejta e mbajtjes së referendumit me rastin e zgjidhjes finale të statusit të Kosovës, mendojmë se ky formulim ishte një bazë e mjaftueshme juridike për mbajtjen e tij, pas kalimit të periudhës trevjeçare, sa edhe parashihej vlefshmëria e Marrëveshjes së Rambujesë. Kjo aq më parë, kur si garancion shtesë për mbajtjen e referendumit, zonja M.Ollbrajt kishte deponuar me shkrim garancionin në të cilin konstatohet se propozimi për shprehjen e vullnetit të popullit paraqet një konfirmim i të drejtës së popullit të Kosovës për të mbajtur një referendum për statusin final të Kosovës pas tre vjetësh. Nënshkrimi i marrëveshjes së Rambujesë nga delegacioni kosovar ka qenë një akt pragmatik, i cili mundësoi ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në Kosovë dhe çlirimin e territorit të saj. Mirëpo, vështruar nga aspekti i legalitetit, kjo marrëveshje është e paqëndrueshme, ngase ajo nuk është akceptuar dhe nënshkruar nga pala serbe. Kjo është më rëndësi të theksohet, sepse Rezoluta 1244 i referohet kësaj marrëveshjeje dhe parimeve të saj, si bazë për statusin politik të Kosovës. Një referim i tillë, është plotësisht i paqëndrueshëm, jo vetëm nga aspekti juridik, por edhe ai politik.

Ndërhyrja e NATO-s dhe çlirimi i territorit të Kosovës

Pas dështimit të Konferencës në Rambuje, filluan përgatitjet intensive të NATO-s, për fillimin e aksioneve ushtarake kundër Serbisë, në bazë të planit të përgatitur më herët dhe të aprovuar nga NATO-ja. Këto bombardime ajrore nisen me dt. 24.03.1999 dhe zgjatën plotë 78 ditë, për të rezultuar me fitoren e plotë të NATO-s dhe kapitullimin e Serbisë. Krahas me fillimi e bombardimit të caceve serbe nga ana e NATO-s, Millosheviçi dha urdhër që forcat e veta në Kosovë të fillonin një fushatë terrori, e cila kaloi për nga përmasat, ashtu edhe për nga shpejtësia më të cilën u krye, edhe vetë spastrimin etnik që ai kreu në Bosnjën Lindore dhe Veriore gjatë vitit 1992.⁴⁶

Lufta e përbashkët e UÇK-së dhe e NATO-s rezultoi me çlirimin e territorit të Kosovës dhe largimin e plotë të forcave policore militare

⁴⁶ Neol Molcolm, "Të drejtat e Kosovës", botuar në librin Lufta kundër luftës, Tiranë, 2001, fq.96.

dhe paramilitare dhe atyre ushtarake, si dhe me largimin nga Kosova të administratës së dhunshme civile të Serbisë.

Fillimi i fushatës së bombardimeve të NATO-s ndaj Serbisë, hapi debatet në lidhje me legalitetin, shkaqet dhe qëllimet e luftës, efektivitetin e fushatës së NATO-s, si dhe çështjet e tjera që lidheshin me promovimin e një doktrine të re ushtarake dhe me krijimin e rendit të ri ndërkombëtar. Këto debate dhe polemika buronin në faktin se ky ishte aksioni i parë ushtarak që ndërmoi NATO-ja në historinë e saj pesëdhjetëvjeçare pa mandatin formal të Këshillit të Sigurimit të OKB-së kundër një shteti sovran; dhe përmasat e tij ishin shumë më të mëdha se ato të ndërmarra në Bosnjë, e cila çoi në përfundimin e luftës dhe arritjen e Marrëveshjes së Dejtonit më 1995⁴⁷.

NATO e nisi fushatën ajrore me qëllim që të parandalonte një katastrofë humanitare-vrasjen dhe dëbimin e shqiptarëve të Kosovës-si dhe të ruante sigurinë rajonale duke i imponuar Beogradit planin e paqes për Kosovën në Rambuje. Megjithatë, efekti imediat i sulmeve ajrore ishte i kundërt; ato përshpejtuan operacionet e spastrimit etnik nga forcat serbe, rezultati i së cilave ishte largimi dhe deportimi i rreth 1 milionë shqiptarëve të Kosovës për në Shqipëri, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në Malin e Zi dhe në shumë shtete evropiane. Depërtimi i refugjatëve dhe dyndja e tyre shtojë nga ana e saj edhe rrezikun e mundshëm të destabilizimit social të vendeve pritëse, fakt ky që e shtyu NATO-n të angazhonte burimet e saja për operacionet humanitare⁴⁸.

Fillimi i bombardimeve të NATO-s, si dhe lufta çlirimtare që bënë UÇK-ja, ndikuan që Serbia e përballur me humbjen e luftës, të fillojë aksione ndëshkuese ndaj popullsisë civile duke masakruar dhe me qindra civilë, fëmijë, gra dhe pleq dhe duke ushtruar një gjenocid të paparë që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Më të filluar të bombardimeve të NATO-s, Serbia filloi implementimin e planit të përgatitur më parë në qarqet e saj kuazishkencore për spastrimin etnik në Kosovë, një prej krimeve më të lemerishme kundër njerëzimit që janë kryer gjatë këtij shekulli, i krahasueshëm për nga natyra, edhe pse jo nga numri, me Holokaustin e hebrenjve të realizuar nga Hitleri.

⁴⁷ Shih më shumë: Gordon N. Bardos, "Balkan History, Madeleine's War, and NATO's Kosovo", *Journal of the North American Society for Serbian Studies* 15(1): 77-102, 200, fq.96-100.

⁴⁸ Gabriel Partos, "Kosova-mënyra të reja për të ndalur në konflikt tëvjetër", botuar në librin *Lufta kundër luftës*, Tiranë, 2001, fq.102.

Në anën tjetër, udhëheqja e komanduar nga Milosheviçi e nisi luftën me shpresën se uniteti i 19 vendeve anëtare të NATO-s do të cenohej seriozisht po të zmadhoheshin humbjet e NATO-s dhe bombardimi të shkaktonte një numër të madh të viktimave civile. Megjithëse uniteti i NATO-s kaloi një provë të vështirë dhe nuk pati për pasojë ndalimin e as uljen e intensitetit të goditjeve ajrore. Përkundrazi, NATO-ja filloi dislokimin e forcave tokësore në rajon para se Beogradi të pranonte një marrëveshje; dhe kjo bëri që konflikti të zgjatë 11 javë, duke shkatërruar një pjesë të caqeve ushtarake dhe civile të Serbisë në Kosovë dhe Serbi dhe duke pasur për pasojë një numër të madh të viktimave civile.

Sulmet e NATO-s kishin një motiv të lartë moral. Ky motiv bazohej në moslejimin e spastrimit etnik në Evropë në prag të shekullit njëzet e një si dhe ndaljen e një katastrofe të thellë humanitare. NATO-ja u vu në mbrojtje të parimeve të drejtave të njeriut, të cilat kanë përparësi edhe në raport me sovranitetin e shteteve. Pikërisht kjo e bën të ligjshëm sulmin e saj ndaj Federatës Jugosllave, qoftë edhe pa mandatin e OKB-së⁴⁹.

Me gjithë legjitimitetin e aksionit të NATO-s kundër Serbisë, ky aksion vu përballë kritikave nga drejtimet e ndryshme. Disa thanë se NATO-ja nuk duhej të vepronte si xhandar ndërkombëtar, duke ndërhyrë pa mandatin e qartë të Kombeve të Bashkuara kundër një shteti sovran. Në anën tjetër, një numër i madh i ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare kanë mbrojtur legalitetin e ndërhyrjes, me qëllim parandalimi të katastrofës humanitare dhe shpëtimit të jetës së njerëzve. Baza juridike sipas këtyre ekspertëve është përcaktuar në Kaptinën VII të Kartës së OKB-së. Pas rënies së komunizmit në Evropë është mjaft i përhapur koncepti se një nga funksionet parësore të shteteve është mbrojtja-dhe jo persekutimi i qytetarëve dhe i çdo njeriu që jeton brenda kufijve të tyre. Kjo doktrinë e re është në pajtim me tendencën e krijimit të rendit të ri ndërkombëtar dhe me teorinë e sovranitetit të kufizuar shtetëror që filloi të promovohet me konfliktin në Kosovë dhe që mund të jetë një preventivë për konfliktet e tjera në baza etnike.

Krahas bombardimeve të NATO-s, UÇK-ja arriti t'u kundërvihet sulmeve serbe dhe sadopak të mbrojë popullsinë civile që kishte ngelur në Kosovë. Për më tepër, UÇK-ja i shkaktoi mjaft humbje armikut dhe e ndihmuar nga sulmet ajrore të NATO-s fitoi shumë beteja dhe çliroi

⁴⁹ Shih më shumë: Gordon N. Bardos, "Balkan History, Madeleine's War, and NATO's Kosovo", *Journal of the North American Society for Serbian Studies* 15(1): 77-102, 200, fq.96-100.

disa territore. Megjithatë, forcat serbe vranë dhe masakruan më shumë se 10.000 civilë shqiptarë, dogjën më tepër se 100.000 shtëpi, shkatërruan dhe plaçkitën pasurinë e shqiptarëve dhe morën si pengje dhe robër të luftës një numër të madh të shqiptarëve, për fatin e së cilëve as sot e kësaj dite nuk dihet asgjë. E ballafaquar me sulmet ajrore të NATO-s dhe luftën çlirimtare të UÇK-së, Serbia ndërmori represaliet më brutale ndaj popullatës civile shqiptare me ç' rast shkeli në mënyrë flagrante Konventat e Gjenevës, të cilat përcaktojnë të drejtën e luftës.

E ballafaquar me humbje e sigurt të luftës, Serbia pranoi kapitullimin e saj dhe nënshkroi Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake të ashtuquajturën Marrëveshje e Kumanovës, e cila përcaktonte detajet teknike dhe ushtarake të tërheqjes së forcave policore dhe ushtarake të Serbisë nga Kosova dhe vendosjen e forcës së sigurimit ndërkombëtar (KFOR) në Kosovë.

Administrimi ndërkombëtar i Kosovës (1999-2008)

Pas vitit 1999 në Kosovë u vendos administrimi ndërkombëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), si një mision i posaçëm pas dështimit të Marrëveshjes së Rambujesë. Ky administrim ishte një model i veçantë i krijuar vetëm për Kosovë dhe i njohur si Misioni i Kombeve të Bashkuara për Kosovë (United Nations Mission in Kosovo-UNMIK). Ky Mision madje krahasohet dhe është pak a shumë i ngjashëm me atë të Timorit Lindor (1999-2002), Afganistanit i vendosur në vitin 2002 apo edhe Kamboxhias i vendosur gjatë viteve 1992-1993⁵⁰. Po ashtu ky administrim ndërkombëtar ishte vendosur pas fushatës së bombardimeve të NATOS-s, Konferencës së Rambujesë, si dhe rezistencës së armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës⁵¹.

Pas përpjekjeve për arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë, bashkësia ndërkombëtare për të shmangur një katastrofë të përmasave çfarë kishte ndodhur në Bosnjë dhe Hercegovinë, vendosën një administrim ndërkombëtar në Kosovë, i cili kishte për qëllim trasimin e rrugës së Kosovës drejt statusit final dhe shpalljes së pavarësisë, e cila u arrit tek pas 8 viteve të plota nën administrimin ndërkombëtar.

⁵⁰ Simon Chesterman, "Justice Under International Administration: Kosovo, East Timor and Afghanistan", International Peace Academy, shtator 2002, fq.3.

⁵¹ Eric Herring "From Rambouillet to the Kosovo Accords: NATO's War against Serbia and Its Aftermath", University of Bristol, 2012, fq.225-232.

Mandati i misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK) është bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si dhe ishte shoqëruar me marrëveshjen e Kumanovës që legjitimoi hyrjen e trupave të NATO-s në Kosovë, si dhe largimin e trupave dhe administratës serbe nga Kosova. Rasti i Kosovës dhe administrimi i tillë ndërkombëtar cilësohej si një formë e protektoratit joklasik apo formë e veçantë e mbikëqyrjes së një shteti nga një organizatë ndërkombëtare apo nga shumë shtete⁵².

Me të drejtë periudha prej vitit 1999-2008⁵³ në Kosovë mund të cilësohet si periudhë tranzicionale (kalimtare) si në aspektin e shtet-ndërtimit ashtu edhe atë të krijimit të së drejtës. Gjatë kësaj periudhe kalimtare në Kosovë ishte krijuar një rend juridik i përkohshëm i cili do të vlente deri në zgjidhjen e statusit përfundimtar dhe shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Periudha transitore në Kosovë mund të ndahet në tri faza kryesore:

1. Faza e parë dhe administrimi i Kosovës në mënyrë të plotë nga UNMIK-u⁵⁴ 1999-2001;
2. Faza e dytë dhe krijimi i institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ), 2001-2005;
3. Faza e tretë dhe përgatitja për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës 2005-2008; kjo fazë njihet edhe si faza e negociatave për statusin final të Kosovës.

Shpallja e koordinuar e pavarësisë

Pas përfundimit të procesit negociator në Vjenë, në mungesë të konsensusit të palëve negociuese, përkatësisht destrucionit të sërishëm serb, ish-presidenti finlandez dhe udhëheqësi i negociatave Marti Ahtisari, i dërgoi së bashku me pakon e zgjidhjeve të Planit Gjithëpërfshirës rekomandimin që Kosovës t'i jepet pavarësia e mbikëqyrur⁵⁵. Ky rekomandim iu dërgua Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Ban Ki Mun,

⁵² "The New Kosovo Protectorate", ICG Balkans Report N°69, 20 June 1999 fq.5-6.

⁵³ Oliver Jens Schmitt "Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike", botimet Koha, Prishtinë, Nëntor 2012, fq.265-266.

⁵⁴ Jürgen Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling ëith Uncertainty", Max Planck UNYB 9 (2005), fq.255-256.

⁵⁵ Pavarësia e mbikëqyrur nënkupton që sipas Pakos së Ahtisarit Kosova edhe pse do të shpallte pavarësinë e saj, shumë segmente të shtetit do të mbikëqyrreshin nga një misioni i ri ndërkombëtar i ri-disenjuar. Udhëheqës i këtij misioni siç e kemi dhënë edhe më sipër ishte Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN-ICO), i cili kishte edhe disa kompetenca ekzekutive mbikëqyrëse sipas pakos së Ahtisarit.

por për shkak të bllokimit nga Rusia dhe Kina, ky raport asnjëherë jo vetëm që nuk u miratua, por as që u diskutua në OKB. OKB-ja e cila si autore e Rezolutës 1244 nuk arriti të përmbyllë misionin e vet me miratimin e Rezolutës tjetër me të cilën do të pranonte rekomandimin e zotri Ahtisarit për pavarësinë e mbikëqyrur⁵⁶.

Edhe pse një epilog i këtyllë ishte i pritshëm nëse merret parasysh heterogjeniteti i OKB-së dhe paaftësia e saj për të zgjidhur çështjen e Kosovës, pa dyshim se kjo ndikoi në procesin e njohjes së pavarësisë së Kosovës.

Pas dështimit të OKB-së për të pranuar rekomandimin për pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës, Institucionet e Kosovës të porsadalë nga zgjedhjet nacionale të muajit nëntor të vitit 2007, filluan përgatitjet për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Në këtë aspekt Qeveria e Kosovës, përkatësisht Kryeministri i atëhershëm Thaçi kishte rolin kyç në koordinimin e shpalljes së pavarësisë së bashku me SHBA-në, shtetet e Bashkimit Evropian. Së këndejmi procesi i shpalljes së pavarësisë në tërësi ishte një proces i koordinuar me faktorët ndërkombëtarë të lartpërmendur⁵⁷ që transmetonte të drejtën e kahmotshme të popullit të Kosovës për vetëvendosje⁵⁸.

Megjithëse në disa raste procesi dhe deklarata e pavarësisë së Kosovës është konsideruar si një akt i njëanshëm, ajo ka qenë dhe mbetet më shumë se kaq një proces i koordinuar sesa një proces i njëanshëm⁵⁹. Krahas arritjes së pëlqimit ndërkombëtar për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, disa ditë para këtij momenti historik, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë që përgatisnin edhe Kushtetutën ishin përfshirë në shkrimin (përpilimin) e Deklaratës së Pavarësisë⁶⁰. Kjo Deklaratë u

Koncepti i pavarësisë së mbikëqyrur në Kosovë ishte asisoj që në institucionet e Kosovës siç janë sistemi i drejtësisë, Gjykata Kushtetuese apo institucionet e pavarura të kishte një prezencë ndërkombëtare për një kohë të caktuar. Kjo mbikëqyrje përfundoi zyrtarisht në vitin 2012.

⁵⁶ Shih më shumë: Ugo Caruso “*Kosovo declaration of Independence and the International Community -an assessment by the Kosovo Monitoring Task Force*” JEMIE 7 (2008) 2, 2008 by European Centre for Minority Issues, fq.2-6.

⁵⁷ Ibid, fq.7.

⁵⁸ Daniel Fierstein “*Kosovo’s Declaration of Independence: An incident analysis of legality, policy and future implications*”, Boston University International Law Journal, [Vol. 26:417 2008], fq.425-429.

⁵⁹ Alexander Orakhelashvili, “*Statehood, Recognition and the United Nations System: A Unilateral Declaration of Independence in Kosovo*” Max Planck Yearbook of United Nations Law, Volume 12, 2008, p. 1-44, 2008, fq.1-2.

⁶⁰ Nga dhjetori i vitit 2007 procesi i hartimit të Kushtetutës ishte pthujtë në fund. Disa nga anëtarët kyq të grupit për hartimin e kushtetutës ishin të kyqur

hartua në një konfidencë të plotë dhe deri në momentin e fundit u harmonizua me faktorët ndërkombëtarë që ishin kyç në këtë proces. Për të shprehur karakterin historik, Deklarata e Pavarësisë sipas modelit amerikan, u shkrua me dorë në papirus nga piktori Shyqri Nimani dhe kopja origjinale e saj u soll në Kuvend në momentin e shpalljes së pavarësisë.

Përfundimisht, më 17 Shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi **Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës**⁶¹. Në një mbledhje solemne, në pasditën e së dielës, në një atmosferë festive dhe krenarie kombëtare, Kryeministri i atëhershëm i Qeverisë së Kosovës zotëri Hashim Thaçi lexoi Deklaratën e Pavarësisë⁶² duke cituar këto fjalë historike: *Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisari dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.*

Pas leximit të Deklaratës së Pavarësisë ajo në një ceremoni historike dhe solemne u nënshkrua nga të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës sipas praktikës së Kuvendit të Filadelfisë në SHBA më 4 Korrik 1776, kur u miratua Deklarata e Pavarësisë së këtij shteti.

Ditën e shpalljes së pavarësisë u miratuan edhe simbolet e tjera të shtetit të ri, Flamuri dhe Stema, kurse në Prishtinë nën petkun festiv të shtetit të ri (*"New Born"*) u bë një kremtim madhështor, kurse në tërë Kosovën sikur edhe në të gjitha qytetet e botës ku jetojnë shqiptarët, u kremtua në mënyrë madhështore dhe dinjitoze shpallja e pavarësisë.

Menjëherë një ditë pas shpalljes, Republikës së Kosovës i erdhën njohjet e para nga ShBA-ja, Anglia, Franca, Gjermania dhe shtetet e tjera që padyshim rritën kremten dhe madhështinë e shpalljes së pavarësisë.

drejtëpërdrejtë edhe në hartimin e tekstit të deklaratës së pavarësisë e cila u shpall me 17 shkurt 2008.

⁶¹ Për Deklaratën votuan njëzëri 109 deputetë të pranishëm (shqiptarë dhe shumica e deputetëve të komuniteteve jo serbe). Mbledhjen e bojkotuan 10 deputë serbë dhe një deputet goran.

⁶² Ugo Caruso *"Kosovo declaration of Independence and the International Community -an assessment by the Kosovo Monitoring Task Force"* JEMIE 7 (2008) 2, 2008 by European Centre for Minority Issues, fq.19-20.

Dhënia e mendimit nga ana e GjND-së për Deklaratën e Pavarësisë

Më 22 Korrik 2010 Gjykata vendosi që shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare⁶³. Kryetari i GjND-së, gjykatësi Hisashi Owada, tha se e drejta ndërkombëtare nuk përmbante “asnjë ndalesë për shpalljen e pavarësisë”. Gjykata po ashtu tha se përderisa shpallja e pavarësisë nuk ka qenë e paligjshme⁶⁴, çështja e njohjeve ishte politike⁶⁵.

Gjykata theksoi se Deklarata e Pavarësisë nuk ishte bërë nga Kuvendi i Kosovës, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, apo ndonjë trup tjetër publik. Fjalët *Kuvendi i Kosovës* në variantet e gjuhës angleze dhe frënge ishin bërë për shkak të përkthimit jo të drejtë dhe nuk ishin të pranishme në tekstin origjinal në gjuhën shqipe, kështu që, autorët, që e kishin quajtur veten “*përfaqësuesit e popullit të Kosovës*” nuk ishin të limituar nga Korniza Kushtetuese e krijuar nga Kombet e Bashkuara që kishte rezervuar çështjet ndërkombëtare të Kosovës vetëm në kompetencë të përfaqësuesit të KB-së⁶⁶.

Mendimi këshillues i Gjykatës u pa si vendim që kishte krijuar precedent të mundshëm që do të kishte implikime të mëdha për lëvizjet separatiste në botë, si dhe për bisedimet e Serbisë për anëtarësimin në BE. Gjithashtu u pa edhe si mundësi që do të çonte në njohjen e pavarësisë së Kosovës nga më shumë vende⁶⁷.

Paragrafi përfundimtar i mendimit këshillues (paragrafi 123), i cili është pjesë operative e vendimit (dispozitiv) përmban tri regjistrimet e votimit: ai shpallte se Gjykata në mënyrë unanime kishte gjetur se kishte juridiksion t’i përgjigjej kërkesës së Asamblesë së Përgjithshme për një mendim këshillues duke qenë se për rastin në fjalë Gjykata

⁶³ [Http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&k=21&case=141&code=-kos&p3=1](http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&k=21&case=141&code=-kos&p3=1), qasur së fundmi me 20.07.2017.

⁶⁴ Samuel Ethan Meller, “*The Kosovo case: An argument for a remedial declaration of independence*” Ga.J.Int’l & Comp. L, Vol. 40:8 2012], fq.856-857

⁶⁵ [Http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&k=21&case=141&code=-kos&p3=1](http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&k=21&case=141&code=-kos&p3=1), qasur së fundmi me 20.07.2017.

⁶⁶ International Court of Justice Reports of Judgments, “*Advisory opinions and orders accordance with international law of the unilateral declaration of independence in respect of Kosovo*” Advisory opinion of 22 July 2010, i qasshëm në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf>, qasur së fundmi me 21.07.2017.

⁶⁷ Ibid.

e pranonte se ajo kishte të drejtë të vendoste për atë kërkesë. Gjykata vendosi me nëntë vota për dhe pesë kundër për të pranuar kërkesën për dhënien e mendimit këshillues⁶⁸.

Një çështje e cila është me rëndësi të përmendet në vendimin e GJND-së është se përmes këtij vendimi GJND-ja i ka njohur popullit të Kosovës pushtetin kushtetutëbërës. Përmes frazës “..ne udhëheqësit e popullit tonë..”, përfaqësuesit e Republikës së Kosovës kanë potencuar se atë që po bëjmë ne, përkatësisht shpalljen e pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe miratimin e kushtetutës së saj, e bëjmë në emër të popullit, i cili ka “pushtet kushtetutëbërës”. Në këtë vendim të GJND-së për pavarësinë e Kosovës, përcaktohet qartazi se shpallja e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, ka qenë rezultat i ushtrimit të vullnetit (pushtetit) kushtetutëbërës të përfaqësuesve të zgjedhur të popullit të Kosovës. Sipas këtij vendimi ky ushtrim i vullnetit (pushtetit) kushtetutëbërës ka ndodhur jashtë rendit të atëhershëm juridik të krijuar nga UNMIK-u në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të 10 qershorit 1999⁶⁹. Një gjë e tillë është sqaruar edhe në pjesën e parë, mirëpo në këtë pjesë po përsëritet për hir të lidhjes së çështjes së cilës i referohemi në këtë rast, pra vendimit të GJND-së për pavarësisë e Kosovës.

Përfundimi

Pavarësia e Kosovës dhe e drejta e saj për vetëvendosje ishte në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe proceset e krijimit të rendit të ri ndërkombëtar. E drejta e vetëvendosjes paraqet shtyllë të demokracisë dhe të lirisë së individit dhe popujve. E drejta e vetëvendosjes si e drejtë universale është përcaktuar në nenin 1 të Kartës së OKB-së ku përcaktohet misioni i saj që të zhvillojë relacione miqësore midis kombeve, bazuar në respektimin e parimeve të të drejtave të barabarta dhe të vetëvendosjes së popujve dhe të ndërmarrë masa të tjera adekuate për ta forcuar paqen universale. Koncepti modern i vetëvendosjes është i përcaktuar në mënyrë të qëndrueshme në praktikën anti-kolonialiste të Kombeve të Bashkuara. Karta e Kombeve të Bashkuara, duke shpallur synimet themelore të sistemit të kujdestarisë për të përfshirë promovimin e zhvillimit përparimtar të banorëve të territoreve në

⁶⁸ Ibid.

⁶⁹ <http://zeri.info/zerat/60075/marreveshja-ia-njeh-pushtetin-kushtetuteberes-asociacionit/>, qasur së fundi më 22.08.2017.

kujdestari drejt vetëvendosjes ose pavarësisë sido që të jetë e përshtatshme për rrethanat e veçanta në të cilat ndodhet secili territor dhe njerëzit e tij dhe dëshirat e shprehura lirisht të njerëzve që kanë të bëjnë me to⁷⁰.

Parimi i vetëvendosjes u afirmua edhe me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Dhënien e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve të Kolonizuar, të aprovuar në vitin 1960. Në nenin 2 të kësaj Deklarate përcaktohet se të gjithë popujt kanë të drejtën për vetëvendosje; sipas kësaj të drejte, ata lirisht përcaktojnë statusin e tyre politik dhe lirisht realizojnë zhvillimin e vet ekonomik, social e kulturor. Afirmimin dhe njohjen tjetër ndërkombëtare, e drejta e vetëvendosjes e ka gjetur edhe në dy konventat e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Kulturore e Sociale, të miratuara në vitin 1966. Në nenin 1 të këtyre konventave përcaktohen këto elemente të së drejtës për vetëvendosje: Të gjithë popujt e kanë të drejtën për vetëvendosje, sipas kësaj të drejte ata lirisht përcaktojnë statusin e tyre politik dhe lirisht mund të realizojnë zhvillimin e vet ekonomik, social dhe kulturor; për mirëqenien e tyre popujt lirisht mund të disponojnë pasuritë dhe burimet natyrore, pa paragjykim për ndonjë obligim që del nga bashkëpunimi ekonomik ndërkombëtar, bazuar në parimin e përfitimit të ndërsjellë dhe të drejtën ndërkombëtare. Shtetet nënshkruese të Konventës, përfshirë edhe ata që kanë përgjegjësi për administrimin e trojeve që nuk vetëqeverisen, do të promovojnë të drejtën për vetëvendosje dhe do ta respektojnë atë të drejtë në përputhje me pikat e OKB-së.

Afirmimi i mëtejshëm i së drejtës së vetëvendosjes është bërë në Deklaratën e parimeve të së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me marrëdhëniet miqësore midis shteteve, të miratuar më 1970. Në këtë Deklaratë është ritheksuar obligimi i çdo shteti që të respektojë të drejtën për vetëvendosje në përputhje me dispozitat e Kartës së OKB-së. Rëndësia e kësaj preambule, shihet nga preambula e saj ku thuhet ‘të bindur se parimi i të drejtave të barabarta dhe i vetëvendosjes së popujve përmban një kontribut të rëndësishëm për të drejtën bashkëkohore ndërkombëtare, aplikimi i efektshëm i tij ka rëndësi kruciale në promovimin e marrëdhënieve miqësore midis shteteve, të bazuara në parimin e barazisë sovrane.

⁷⁰ Karta e Kombeve të Bashkuara, neni 76, paragrafi.b.

Mbështetur në aktet e lartpërmendura ndërkombëtare, e drejta e vetëvendosjes u është njohur shumë popujve të shtypur (edhe jashtë kontesteve të dekolonizimit), si në rastin e Bangladeshit, te Biafrës, të Eritresë, të Kuebekut, të Tajvanit, të Somalisë, të Timorit Lindor, të Palestinës, të Polisarios etj. Në historinë më të re politike shumë shtete të Evropës Juglindore implementuan të drejtën e tyre për vetëvendosje. Në këtë kuadër populli gjerman e ka realizuar të drejtën e tij për vetëvendosje më 1990, kur populli i Gjermanisë Lindore dhe asaj Perëndimore vendosi të ribashkohet duke rrëzuar Murin e Berlinit. Në të njëjtën kohë, deklaratimet e tyre për pavarësi u shprehen edhe nga ish-republikat e Bashkimit Sovjetik gjatë viteve 1989 dhe 1991. Ishin të parat republikat baltike, ato që realizuan vetëvendosjen duke restauruar pavarësinë e tyre. Një proces të njëjtë e ka kaluar edhe ish-Çekosllovakia, nga e cila në mënyrë paqësore dolën dy shtete të pavarura: Çekia dhe Sllovakia. Së fundi, pas shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave, gjashte njësitë federale të saj implementuan pavarësinë e tyre përmes vetëvendosjes dhe luftërave për pavarësi.

Duke u nisur nga baza legale ndërkombëtare, Kosova paraqet rast tipik të vetëvendosjes. Vetëvendosja është një e drejtë legjitime e Kosovës dhe ka mbështetje në qenien socio-politike të Kosovës. Kosova është aneksuar dhunshëm nga Serbia që nga viti 1918. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët e Kosovës i janë bashkëngjitur luftës antifashiste vetëm me premtimin e çlirimit kombëtar dhe realizimit të së drejtës për vetëvendosje. Ata artikuluan vullnetin e tyre burimor përmes Rezolutës së Bujanit, e cila i garantonte Kosovës të drejtën e vetëvendosjes, përfshirë këtu edhe të drejtën e bashkimit me shtetin amë, Shqipërinë. Mirëpo, ky vullnet burimor u shtyp dhe me 1945, Kosova i aneksohet Serbisë brenda Jugosllavisë Federale. Pas shpërbërjes së Federatës Jugosllave, edhe Kosova sikur edhe njësitë e tjera federale deklarojë vullnetin e saj për pavarësi nëpërmjet referendumit të vitit 1991. Ky përcaktim doli nga e drejta për vetëvendosje e popullit të Kosovës në rrethanat i zhbërjes së ish-Jugosllavisë. Vullnetin dhe përcaktimin e tij të fuqishëm për pavarësi dhe vetëvendosje, populli shqiptar e konfirmojë edhe përmes luftës çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe mijëra viktimave, të cilat ranë për idealin e pavarësisë dhe lirisë së Kosovës

Paskal Milo

FATI HISTORIK I VENDIMEVE TË KONFERENCËS SË AMBASADORËVE NË LONDËR PËR KOMBIN SHQIPTAR

Abstrakt

Konferenca e Ambasadorëve në Londër e vitit 1913 është një ngjarje komplekse në historinë e kombit shqiptar. Vendimet e saj që sollën në jetë një shtet të pavarur shqiptar ishte një ngjarje sa historike, aq edhe progresive. Por Shqipëria e pavarur lindi si një krijesë e gjymtuar që mbijetoi përmes sfidave të panumërta në rrugën e saj të shtetformimit. Kosova dhe territoret e tjera shqiptare që iu bashkëngjitën me dhunë mbretërive fqinje nga Fuqitë e Mëdha të kohës nga vendimet e Konferencës së Londrës përjetuan kalvarin ekzistencial të shekullit XX.

100 vjet më vonë nga kjo Konferencë ka një kthesë cilësore në fatet historike të kombit shqiptar. Çlirimi i Kosovës në vitin 1999 dhe pavarësia e saj në vitin 2008 ishte arritja më e madhe pas pavarësisë së Shqipërisë dhe goditja më e rëndë që iu dha vendimeve të Konferencës së Londrës. Por procesi i korrigjimit të vendimeve të saj nuk ka mbaruar. Uniteti i kombit shqiptar nuk është arritur. Shqiptarët vazhdojnë të jetojnë të shpërndarë në gjashtë shtete të rajonit. Tendencat pozitive në zhvillimet mbarë shqiptare po kërcënohen nga faktorë rajonalë e fuqi të huaja. Rikujtimi i vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër është një moment reflektimi në një kohë kur konjunkturat gjeopolitike nuk janë kaq optimiste për një paqe e siguri rajonale e ndërkombëtare të qëndrueshme.

Fjalët çelës: Konferenca e Ambasadorëve, shqiptarët, Fuqitë e Mëdha, fati historik.

Në historinë e kombit shqiptar ka disa ngjarje që për nga rrjedhjat kanë lënë vulën e tyre në ecurinë e zhvillimeve të mëtejshme të tij. Nuk është fjala për kthesat apo përmbysjet e brendshme politike e sociale por për ndërhyrjen e faktorëve ndërkombëtarë në fatet e tij historike. Që në agimin e ngjizjes së kombit shqiptar Fuqitë e Mëdha europiane, të njohura ndryshe si “*Koncerti European*” nuk u treguan dashamirëse për arsye e faktorë të ndryshëm e, në radhë të parë, për shkak të vonesës në shtetformimin e tij. Në aktin e parë ndërkombëtar të kohëve moderne të lidhur me çështjen shqiptare siç ishte Kongresi i Berlinit i vitit 1878, ato i trajtuan territoret e banuara nga shqiptarët si plaçkë tregu në kombinacionet gjeopolitike të kohës. Deri në ato vite shqiptarët të ndodhur nën Perandorinë Osmane kishin bërë pak për të

tërhequr vëmendjen ose për të zgjuar interesin e Fuqive të Mëdha europiane ose të paktën të njëjës prej tyre.

Në momentin kur shqiptarët filluan të lëvizin në kërkim të autonomisë përmes kryengritjeve të armatosura e në rrethanat e një konjunkturë të re europiane, ata u bënë objekt interesimi nga Fuqitë e Mëdha, veçanërisht nga dy prej tyre, Austro-Hungaria dhe Italia. Ka ndodhur shpesh edhe në historinë e kombeve të tjera që në momente vendimtare kthesash historike të ketë pasur përputhje interesash e veprime të përbashkëta midis faktorëve të brendshëm dhe atyre ndërkombëtarë. Pjesërisht kjo ndodhi edhe në Shqipëri në vitin 1912 kur kryengritja antiosmane e shqiptarëve arriti kulmin e saj. Pavarësia e Shqipërisë më 28 Nëntor 1912 ishte produkt i kësaj kryengritjeje, por edhe i mbështetjes italo-austro-hungareze. Ndodhi ajo që themeluesi i shtetit të pavarur kombëtar shqiptar, Ismail Qemali, do t'i pohonte pak më vonë Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, se *“Shqipëria është pjella juaj, unë kam pretendimin që, keq ose mirë, të jem mamia e kësaj pjelle”*.¹

Pavarësia e Shqipërisë ishte një proces i komplikuar, sepse jo të gjitha Fuqitë e Mëdha e para së gjithash Rusia ishin në favor të saj. Konferenca e Ambasadorëve të vendeve të “Koncertit European” e thirrur në Londër (17 dhjetor 1912-11 gusht 1913) u bë arenë e debateve të zgjatura e të ashpra midis Fuqive për statusin dhe kufijtë e Shqipërisë. Vendimet e kësaj Konference sollën në jetë një shtet shqiptar të cunguar të pavarur që ishte gjithsesi një ngjarje historike progresive për kohën e për shqiptarët. Por në të njëjtën kohë ishte një padrejtësi e madhe, sepse la jashtë shtetit të ri të pavarur gati gjysmën e territoreve të banuara historikisht nga shqiptarët, Kosovën e krahina të tjera të gjera shqipfolëse. Fuqitë e Mëdha bënë një pazar të shëmtuar për të përmbushur pretendimet e monarkive klienteliste ndaj territoreve shqiptare. Ishin të ndërjegjshëm për gjykimin që i bënë trungut shqiptar e për të justifikuar atë e paraqitën si kurban për paqen europiane. Avokatinë e këtij vendimi e bëri të nesërmen e përfundimit të Konferencës së Ambasadorëve kryetari i saj dhe ministri i Jashtëm britanik, Eduard Grey, në Dhomën e Komuneve kur deklaroi: *“Unë e di fare mirë se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të japë shkas për kritika të forta nga kushdo që njeh vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë rajonale. Duhet të mos harrohet se gjatë përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje të tillë, qëllimi kryesor ka qënë që*

¹ Haus-Hof und States Archiv, Politisches Archiv.Allbanien.Wien (HHStA PA A) 1912-1918.Vj:24-41-4108) 1913.

*të ruhej marrëveshja midis vetë Fuqive të Mëdha dhe, në qoftë se, vendimi për Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë ai e ka bërë punën më të rëndësishme në dobi të paqes në Europë”.*²

Shqiptarët ishin të pafuqishëm nga çdo pikëpamje për t’i kundërshtuar vendimet e kësaj Konference. Ata iu gëzuan shpalljes së pavarësisë për një pjesë të territoreve të tyre, kundërshtuan dhe u revoltuan kundër përfshirjes së Kosovës nën Serbinë, por edhe shpresuan se e ardhmja do t’u rezervonte një fat më të mirë. Këtë ndjesi e shpreh fare mirë Ismail Qemali në kujtimet e tij kur shkruan: “...kur po e shihnim të ardhmen e atdheut tonë të rilindur aq të errët, po na ngushëllonin duke na thënë se duhet të flijoheshim për interesin e përgjithshëm të Europës. I nënshtruar këtij vendimi, por jo i dëshpëruar, u ktheva në Shqipëri, duke më mbajtur të gjallë shpresa se rrethana më të favorshme, në një kohë tjetër, në të ardhmen, do t’i jepnin mundësi Shqipërisë të realizonte aspiratat e saj të ligjshme.”²

Konferenca e Ambasadorëve me vendimet e saj copëzoi tërësinë territoriale të banuar nga shqiptarët, por nuk e shmangu konfliktin evropian që erdhi një vit pas përfundimit të saj. Shqipëria ishte një kafshatë fare e vogël që të mund të evitonte përplasjen e madhe mes Fuqive. Ato mes tyre kishin për të larë llogari të vjetra të akumuluar ndërr vite që fryma dhe politika e kompromisit të “Koncertit Evropian” nuk i mbyllte më. Politika e ekuilibrit e Kongresit të Vjenës kishte marrë fund. Duhej vetëm një shkak, sado i vogël që zgjarri të ndizej. Dhe ai u gjend në Ballkan, në Sarajevë ku dora e zezë e nacionalizmit serb i mori jetën princit trashëgimtar të Austro-Hungarisë.

Eduard Grey dhe kolegët e tij evropianë, të ndarë në dy kampe kundërshtare i zhbënë vendimet dhe firmat që kishin hedhur në Konferencën e Ambasadorëve për Shqipërinë. Disa prej Fuqive të Mëdha, Italia, Austro-Hungaria e Franca futën trupat e tyre ushtarake në Shqipëri dhe e kthyen atë në një shesh betejash mes tyre. Në vijim të luftës e për të forcuar aleancën, janë përsëri katër Fuqitë e Mëdha, të Antantës, ish-firmëtarë të Konferencës së parë të Ambasadorëve në Londër që po në kryeqytetin britanik më 26 prill 1915 projektuan copëtimin e dytë të Shqipërisë, shumë herë më të rëndë e më dramatik se i pari.³

Përfundimi i Luftës së Parë Botërore dhe rrjedhojat e saj nuk ndryshuan asgjë në mentalitetin antishqiptar të Fuqive të Mëdha evropiane. Ato e vendosën projektin e Konferencës së Londrës të prillit

² Paskal Milo. Politika e jashtme e Shqipërisë. I. Botimet Toena. Tiranë, 2013, f. 132.

³ Ismail Qemali. Kujtime. Botimet Toena. Tiranë, 2009, f. 424.

1915 në dosjet e tyre shqiptare kur shkuan në Konferencën e Paqes në Paris më 1919-1920. Mbi këtë bazë për gati një vit u hartuan projekte të tjera copëtuese të Shqipërisë midis vendeve fqinje për të arritur kulmin në Memorandumin famëkeq anglo-franko-italian të 14 janarit 1920 që e ndante Shqipërinë mes Italisë, Jugosllavisë e Greqisë.⁵

Ky projekt asgjësues i pavarësisë shqiptare përmbyste edhe atë vendim pozitiv të 29 korrikut 1913 të Konferencës së parë të Ambasadorëve në Londër. Shqiptarët përjetuan orët e tyre më dramatike për mbijetesë kombëtare. Reagimi i tyre ishte i menjëhershëm dhe kompakt brenda dhe jashtë Shqipërisë. Në ndërgjegjen shqiptare Londra u bë sinonimi i rrezikut kombëtar dhe i antishqiptarizmit, jo thjesht si kryeqyteti britanik, por si simbol i koncentrimit të së keqes europiane ndaj Shqipërisë. Në ato ditë janari 1920 kjo e keqe u përmbloodh në tre emra: David Lloid Xhorxh, kryeministër i Britanisë së Madhe, Zhorzh Klemanso, kryeministër i Francës dhe Francesco Nitti, kryeministër i Italisë. Rreth tyre vërtiteshin kryeministrat e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene e të Greqisë për të rrëmbyer copat e premtuara të territoreve shqiptare.⁴

Delegacioni shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris që e përjetoi nga afër dramën e përpjekjeve për copëtim reagoi brenda atyre mundësive që kishte, u dërgoi letra Lloid Xhorxhit, Klemansoit e Nittit për të ndalur atentatin ndaj pavarësisë shqiptare.⁵ Në njërën prej tyre, më 15 janar 1920 shkruhej se *“Shqipëria e krijuar më 1913 si shtet i pavarur, neutral e i garantuar, ka një të drejtë të fituar dhe nuk mund të shikojë pavarësinë dhe integritetin e saj të shkatërruar... Ndërhyrja në çështjet shqiptare e fqinjëve të interesuar do të cenojë pavarësinë e saj dhe kjo nuk do të mungojë të provokojë turbullira në Ballkan”*.⁶

Rezistenca shqiptare nuk mbeti vetëm në fushën diplomatike. Një lëvizje kombëtare shpërtheu në Shqipëri në mbrojtje të pavarësisë e të integritetit të saj territorial. Përfaqësuesit më në zë të saj brenda vendit në dhjetëditëshin e fundit të janarit 1920 u mblodhën në Kongresin Kombëtar të Lushnjës dhe morën vendime shumë të rëndësishme për

⁴ Международные отношения в эпоху империализма (МОЕИ). Документы из архивов царского и временного правительства 1878-1917. Гг. Серия III 1914-1917, Гг Москва 1935. Серия III. Док. нр. 417.24/11 март 1915. с. 3-6.

⁵ Dokuments on British, Foreign Policy (DBFP) 1919-1939. First Series. Vol II, Dok. Nr.70. Appendix A. p, 865.

⁶ Arkiv i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme (AMEPJ). Viti 1920. Dosja nr. 34. fl. 33-34.

ringritjen e institucioneve qendrore të shtetit shqiptar. Kongresi i Lushnjës ripohoi pavarësinë e Shqipërisë dhe integritetin e saj territorial, si dhe shprehu vullnetin unanim të popullit shqiptar në mbrojtje të tyre. Ai iu drejtua Konferencës së Paqes në Paris me një protestë të ashpër kundër vendimit anglo-franko-italian të 14 janarit për copëtimin e Shqipërisë që dënonte “një shtet neutral të njohur si një ndër kombet më të vjetra në Europë” dhe kërkoi një pavarësi të plotë me kufijtë etnografikë e natyralë duke korigjuar edhe padrejtësitë e bëra nga Kongresi i Berlinit dhe Konferenca e Ambasadorëve e Londrës e vitit 1913. Kongresi vendosi të mos pranonte asnjë mandat ose protektorat të huaj dhe shprehu vullnetin se “shqiptarët janë gati të bëjnë çdo sakrificë deri në derdhjen e pikës së fundit të gjakut të tyre, kundër vendimit që mund të çojë në rrezik pavarësinë dhe integritetin territorial të tyre”.⁷

Kongresi i Lushnjës dhe delegacioni shqiptar në Paris në kushtet kur Fuqitë europiane siç shkruante Edith Durham u “ndodhën në pikën e kryerjes së një krimi ndërkombëtar e të vjedhjes së pavarësisë të një vëndi të vogël që ata ia kishin dhënë më parë”, iu drejtuan për ndihmë Shteteve të Bashkuara dhe Presidentit Uillson.⁸

Fuqitë Aleate Europiane e kishin informuar Departamentin e Shtetit dhe Presidentin Uillson për memorandumun e tyre të 14 janarit. Synimi ishte t’i vendosnin Shtetet e Bashkuara para faktit të kryer dhe të merrnin pëlqimin e tyre duke shfrytëzuar sëmundjen e Presidentit Uillson dhe opozitën e fortë republikane në Senatin amerikan. Në Uashington e kuptuan lojën, u ndjenë të fyer që synonin t’i anashkalonin dhe e gjithë çështja përveç anës parimore u kthye edhe në një përplasje prestigji. Uillsoni i kishte marrë kërkesat shqiptare për mbrojtje të cilat përputheshin edhe me programin e tij. Ato u përdorën si argumente për të hedhur poshtë memorandumun europian. Më 10 shkurt 1920 ai u shkruajti europianëve se memorandumun i 14 janarit “e ndan popullin shqiptar midis tri fuqive të huaja pavarësisht nga protestat e tij të fuqishme”.⁹ Më 25 shkurt në përgjigje të një memorandumun tjetër franko-britanik u përsëriti të njëjtat argumente për çështjen shqiptare. Kur europianët këmbëngulën përsëri, Uillsoni në 6 mars 1920 dha përgjigjen përfundimtare: “çështjet shqiptare nuk duhet të futen në diskutimin që propozohet midis Italisë e Jugosllavisë” dhe se ai “nuk do ta miratonte

⁷ AMEPJ. Viti 1920. Dosja Nr. 34, fl. 285.

⁸ National Archives and Records Administration (NARA). Record Grup 59. Department of State. Political Affairs. Albania. Decimal file, 1910-1939. M. 1211. Roll 3.

⁹ La question Adriatique. Recueil de documents officiels. Paris 1920, p. 123-129.

asnjë plan që do t'i jepte Jugosllavisë një kompensim territorial në pjesën veriore të Shqipërisë në vend të diçkaje që mund t'i shkëputej gje-tiu".¹⁰

Projektvendimet e Fuqive të Mëdha për copëtimin e Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris në vitet 1919-1920 nëse do të viheshin në jetë do të ishin më fatale për kombin shqiptar se vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër të vitit 1913. Fuqitë e Mëdha në Londër në 1913 sakrifikuan gati gjysmën e territoreve shqiptare, në vitet 1919-1920 mbi bazën edhe të traktatit të fshehtë të Londrës të vitit 1915 ato e zhbënin në thelb shtetin shqiptar, sovranitetin dhe tërësinë e tij territoriale dhe e bënë Shqipërinë një protektorat italian. Nëse kjo nuk ndodhi e gjithë merita u shkon Shteteve të Bashkuara dhe Presidentit Uillson. Në rrethanat e Konferencës së Paqes në Paris ato luajtën në një farë mënyre rolin që Austro-Hungaria dhe Italia morën përsipër në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913. Këto dy Fuqi të fundit u investuan shumë në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Shtetet e Bashkuara në Paris u angazhuan për mbijetesën e tij, madje edhe kundër tre Fuqive të Mëdha të vitit 1913, Italisë, Francës e Britanisë që kishin nënshkruar vendimet e Konferencës së Londrës, por që në janar 1920 ishin autorët e memorandumit për copëtimin e Shqipërisë. Ka një dallim thelbësor në arsyet e motivet e qëndrimeve të Austro-Hungarisë e të Italisë në Konferencën e Londrës të vitit 1913 me pozitën që morën Shtetet e Bashkuara në Konferencën e Paqes më 1920. Dy Fuqitë e para mbështetën pavarësinë e Shqipërisë për interesat e tyre gjeopolitike në Adriatik e në Ballkan si një pengesë kundër daljes së Serbisë në brigjet e Adriatikut Lindor. Shtetet e Bashkuara në vitin 1920 nuk kishin synime të tilla. Presidenti Uillson përputhi në këtë rast parimësinë e doktrinës së tij të vetëvendosjes së kombeve me një vendim politik që u tërhiqte vëmendjen Fuqive europiane se Shtetet e Bashkuara këtej e tutje nuk do të rrinin indiferent ndaj çështjeve dhe sfidave europiane.

Përkohësisht nuk ndodhi kështu. Administrata republikane që erdhi në Shtëpinë e Bardhë u rikthye politikës izolacioniste. Senati amerikan i kontrolluar nga republikanët kishte vendosur që Shtetet e Bashkuara të mos bënin pjesë në Lidhjen e Kombeve. Shqipëria u pranua në këtë organizatë falë edhe mbështetjes së Britanisë së Madhe e pas saj edhe Fuqive të tjera europiane. Mungesa e Shteteve të Bashkuara e privoi Shqipërinë nga mbrojtja në Lidhjen e Kombeve për çështjet kapitale të sovranitetit e tërësisë territoriale të saj që do të rishfaqeshin që në

¹⁰ La question Adriatique. Recueil de documents officiels... p. 123-129.

fillim të anëtarësimit të saj. Fuqitë e Mëdha europiane ndonëse e mbështetën pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve nuk kishin hequr dorë nga projektet e paternalizmit ndaj saj. Në rrethanat e reja kur u krijua Lidhja e Kombeve dhe kur Shtetet e Bashkuara ishin tërhequr relativisht nga çështjet europiane, Fuqitë e Mëdha europiane iu përshtatën konjunkturave të krijuara. Në adresë të Shqipërisë, tashmë anëtare e Lidhjes së Kombeve nuk mund të zbatoheshin politikat e mëparshme radikale të copëtimit të saj dhe të ushtrimit të protektoratit klasik mbi të. U përpunua gradualisht në trekëndëshin Romë-Londër-Paris një formulë e re që edhe do të njihte sovranitetin e tërësinë territoriale të Shqipërisë me disa korrigjime, por edhe do t'i jepte Italisë fqinje të drejtën hipotetike të kujdestarisë ndaj saj në emër të sigurisë së interesave strategjike.

Qeveria shqiptare dhe delegacioni i saj në Lidhjen e Kombeve deri në qershor 1921 nuk ishte në dijeni të këtij projekti të fshehtë anglo-franko-italian. Beogradi dhe Athina që vazhdonin t'i mbanin të ngritura pretendimet e tyre për territoret shqiptare e kapën momentin dhe intensifikuan përpjekjet diplomatike në kancelaritë e Fuqive të Mëdha, por edhe ndërhyrjet e provokimet e dhunshme në kufijtë shqiptarë e në brendësi të tyre. Konferenca e re e Ambasadorëve që po përgatitej ushqe shpresat e tyre për rigjallërimin e projekteve të vjetra për copëtimin e Shqipërisë.

Anëtarësimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve *de jure* ishte pengesë për cenimin e sovranitetit e të tërësisë territoriale të saj. Statuti dhe parimet mbi të cilat ishte ngritur Lidhja e Kombeve shkonin ndesh me çdo synim të kësaj natyre dhe çdo veprim në kundërshtim me to e komprometonte rëndë organizatën ndërkombëtare të sapokrijuar. Për të shmangur çdo veprim që penalizonte Lidhjen e Kombeve dhe për të pasur procesin nën kontrollin e plotë të tyre, Fuqitë e Mëdha thirrën Konferencën e Ambasadorëve. Këtë e bënë edhe për të treguar se çështja shqiptare ishte e mbartur nga Konferenca e Paqes e Parisit dhe i takonte Konferencës së Ambasadorëve si instrument i saj që t'i jepte zgjidhje.

Konferenca e Ambasadorëve u mbledh në Paris në dhjetëditëshin e parë të nëntorit 1921. Ajo mori një *Vendim* dhe nënshkroi një *Deklaratë* për Shqipërinë. Vendimi ripohoi faktin e njohur të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të vitit 1913 se Shqipëria njihej si shtet

sovran dhe i pavarur.¹¹ Pavarësisht se nuk solli ndonjë element të ri, rikonfirmimi i sovranitetit dhe i pavarësisë së Shqipërisë në rrethanat e asaj kohe ishte i rëndësishëm dhe pozitiv. Vendimi kishte edhe një pjesë të dytë që kishte të bënte me disa korrigjime të kufirit verior e verilindor në favor të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene që cenoi integritetin territorial të Shqipërisë.

Deklarata që miratoi Konferenca ishte e një natyre të veçantë e kontradiktore. Nga njëra anë pohonte njohjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe të integritetit, si dhe paprekshmërinë e kufijve të saj, duke i quajtur madje një çështje me rëndësi ndërkombëtare, nga ana tjetër i njëhte Italisë të drejtën që të ndërhynte me mandatin e Këshillit të Lidhjes së Kombeve për të rimëkëmbur kufijtë e saj në rastin kur ato mund të cenoheshin. Ndërhyrja italiane do të bëhej me argumentin se çdo cenim i kufijve dhe i pavarësisë së Shqipërisë “*mund të përbënte një kërcënim për sigurinë strategjike të Italisë*”.¹²

Konferenca e Ambasadorëve në Paris në thelbin e vetë u qëndroi besnike Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të vitit 1913 me një ndryshim të vogël në dëm të Shqipërisë për çështjen e kufijve. Të dy konferencat ndonëse njohën pavarësinë e kufizuan sovranitetin e saj, njëra përmes Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK) dhe tjetra përmes njohjes të Italisë të interesave strategjike në Shqipëri.

Konferenca e Ambasadorëve do të vazhdojë të merret me Shqipërinë gjatë gjysmës së parë të viteve 20, kryesisht me çështjen e kufijve të saj. Ajo u bë një instrument në duart e Fuqive të Mëdha europiane duke cenuar më tej integritetin territorial të Shqipërisë në çështjen e Vermoshit e të Manastirit të Shën Naumit. Pas vitit 1925 nuk pati konferenca ambasadorësh që të merreshin posaçërisht me çështjen shqiptare. Por vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të vitit 1913 për Shqipërinë ishin rrënjësor në politikën europiane dhe u bënë vijë zyrtare e qeverive të Fuqive evropiane, por edhe e vendeve fqinje. Copëtimi i mëtejshëm i territoreve shqiptare dhe kantonizimi i influencave të huaja në Shqipëri mbeti pjesë e agjendave diplomatike italiane, jugosllave e greke edhe gjatë viteve 30 të shekullit të kaluar dhe u reflektuan edhe në marrëveshje të fshehta mes qeverive të shteteve fqinje.

¹¹ Archives du Ministère des Affaires Etrangères. Archives Diplomatique (AMAE) Europe, 1918-1929. Albanie, vol. 18, p. 180; AMEPJ. Viti 1921. Dosja Nr. 44, fl. 364-365.

¹² AMAE...p. 181; AMEPJ...fl. 358.

Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore solli rrjedhoja dramatike për shumë popuj mes të cilëve edhe për shqiptarët. Shqipëria ishte ndër viktimat e para të pushtimit fashist. Italia dikur në konferencat ambasadoriale të Londrës të vitit 1913 e të Parisit 1921, zyrtarisht ishte shpallur një nga garantët e pavarësisë shqiptare. Pas Konferencës së Ambasadorëve në Paris në nëntor 1921 ajo filloi të ndërtojë politikën e “sigurisë strategjike” në Shqipëri që pati si përfundim 7 prillin 1939. Dy garantët e tjerë të pavarësisë e të sovranitetit të Shqipërisë në këtë Konferencë, Britania e Madhe e Franca mbajtën heshtje ose bënë deklaratat diplomatike hipokrite dhe memece ndaj pushtimit të saj.

Fryma antishqiptare e Konferencës së Ambasadorëve e vitit 1913 u reflektua përgjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Përsëri në qendër të projekteve copëtuese të Shqipërisë që u hartuan qëndronte Britania e Madhe për shkak të rolit që ajo kishte luajtur në të shkuarën, por edhe për faktin se fuqia tjetër europiane, Franca që në qershor 1940 ishte pushtuar nga Gjermania naziste. Ajo refuzoi që Shqipëria të pranohej në Kombet e Bashkuara dhe që mbreti Zog të krijonte në Londër një qeveri shqiptare në emigracion. Qeveria britanike (Foreign Offis) në korrik të vitit 1941 qëndrimin e saj e shprehte fare qartë: “*ne kurrë nuk e kemi mbështetur kauzën e pavarësisë shqiptare dhe jemi ndofta më pak të dispozuar ta bëjmë këtë tani...*”.¹³ Më 15 janar 1942 me nxitjen e Londrës midis dy qeverive, greke e jugosllave në emigracion u nënshkrua Pakti i Bashkimit ku Shqipërisë i rezervohej si “*zgjdhje*” pjesëmarrja në Federatën Ballkanike pasi të ishin plotësuar pretendimet greke dhe jugosllave në adresë të saj.¹⁴ Qëndrimi më i plotë zyrtar britanik ndaj pavarësisë shqiptare dhe integritetit territorial të Shqipërisë në vitet e Luftës së Dytë Botërore u shpreh në Deklaratën e posaçme që Sekretari i Jashtëm britanik Iden (Anthony Eden) bëri në dhjetor 1942 në emër të qeverisë: “*Ajo dëshiron ta shohë Shqipërinë të lirë nga zgjedha italiane dhe pavarësinë e saj të rivendosur... Qeveria e Madhërisë së Tij e shikon çështjen e kufijve të shtetit shqiptar pas lufte si një çështje e cila do të shqyrtohet në Konferencën e Paqes*”.¹⁵ Deklarata e dy Fuqive të tjera të Mëdha Antifashiste, Shteteve të Bashkuara e Bashkimit Sovjetik të bëra në të njëjtën kohë shprehën mbështetje të plotë për pavarësinë dhe sovranitetin e Shqipërisë pas Luftës.

¹³ Public Record Office PRO, Foreign Offis (FO) PRO-FO 371/ 29715.

¹⁴ PRO-FO 371/33113.

¹⁵ Parliamentary Debates: Official Report: House of Commons, Fifth Series, Volume 385, col. 2114-2115.

Ndërtimi i Europës së pasluftës u bë objekt diskutimi e vendimesh të Fuqive të Mëdha Antifashiste sidomos në dy konferencat e tyre në Teheran (nëntor-dhjetor 1943) dhe në Jaltë (shkurt 1945). Për Ballkanin u morën disa vendime që penalizuan Bullgarinë e Rumaninë për bashkëpunimin e tyre me Boshtin fashist. Jugosllavia u njoh në kufijtë e vjetër të monarkisë, por edhe përfitoi disa territore fqinje si trofe luftime. Ato u legjitimuan në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1946. Përmbysja e madhe që solli Lufta e Dytë Botërore, ishte rasti që të viheshin në vend padrejtësitë historike që i ishin bërë çështjes shqiptare, të revizionoheshin vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të vitit 1913. Aleatët i njihnin këto padrejtësi dhe në arkivat britanike e amerikane të kësaj kohe ndodhen mjaft raporte e studime të ekspertëve me propozime interesante për të zgjidhur ose korrigjuar një pjesë të tyre. Por këto studime mbetën pjesë të dosjeve të mbyllura diplomatike. Konjunktura ndërkombëtare në përfundim të Luftës nuk e favorizonte hapjen e dosjes shqiptare. Përkundrazi, Shqipëria me sponsorizimin britanik u rrezikua të humbiste edhe jugun e saj.

Periodha e Luftës së Ftohtë e ngriu hartën politike të Ballkanit në blloqe antagonistë ose “asnjëse”. Të dy superfuqitë e kohës, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik në rivalitet e në konflikte të ashpra për sfera influence në rajone të ndryshme të botës, nuk investuan në Ballkan për të prishur ekuilibrat e krijuara gjeopolitike. Për to Konferenca e Ambasadorëve e Londrës e vitit 1913 mbeti një relike historike. Ruajtjes së status-quo-së në Europë, rrjedhimisht edhe në Ballkan i shërbeu edhe Konferenca për Sigurinë e Bashkëpunimin në Europë (KSBE), Karta e së cilës u nënshkrua nga të gjitha vendet europiane me përjashtim të Shqipërisë në Helsinki në korrik 1975. Ajo i angazhonte vendet nënshkruese që të mos kërkonin ndryshimin e kufijve me dhunë mes shteteve dhe çështjet e minoriteteve atje ku ato ekzistonin të trajtoheshin si çështje të lirisë e të të drejtave të njeriut. Në atë kohë pati edhe komente për arsyet se përse Shqipëria nuk mori pjesë në Konferencën e Helsinkit dhe nuk e nënshkroi Kartën e saj. Në mes tyre edhe ai se Tirana zyrtare nuk pajtohej me kufijtë që i ishin imponuar Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës e vitit 1913 dhe se ajo linte të hapur çështjen e rishikimit të kufijve të saj me vendet fqinje në të ardhmen. Nuk ka prova të dokumentuara se shteti shqiptar kishte një qasje të tillë ndaj Konferencës së Helsinkit. Mospjesëmarrja e Shqipërisë në këtë Konferencë më tepër është shpjeguar me frikën e regjimit komunist për të zbatuar detyrimet e Kartës së Helsinkit në lidhje me liritë e të drejtat e njeriut në vend.

Në fakt, Enver Hoxha gjatë viteve '70 të shekullit të kaluar duke përfitur edhe nga përmirësimi relativ i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, ndoqi një politikë nacionaliste inkurajuese ndaj shqiptarëve në Jugosllavi e ndaj atyre në Kosovë në veçanti. Ai lehtësoi kontaktet njerëzore ndërshqiptare, nxiti marrëdhëniet ekonomike dhe shkëmbimet tregtare, kulturore, arsimore e shkencore. Një marrëdhënie e tillë që erdhi duke u forcuar derisa që gjallë udhëheqësi jugosllav, Josif Broz Tito, i kaloi kufijtë legalë nga ana e Tiranës zyrtare. Ajo organizoi e financoi ndër vite grupe ilegale nacionaliste-komuniste shqiptare në emigracion në veprimtarinë e të cilave bashkimi i Kosovës me Shqipërinë ishte një kërkesë kryesore e tyre. Regjimi komunist shqiptar shkoi në ekstrem në përgatitjet e tij për të zhbërë vendimet e Konferencës së Londrës në rastin kur do të shfaqeshin mundësitë e rrethanat. Se sa realiste ishte, mbetet për t'u gjykuar, por në vitin 1979 Këshilli i Lartë i Mbrojtjes i Shqipërisë me në krye Enver Hoxhën miratoi në sekret të plotë planin e sulmit ushtarak në Kosovë për bashkimin e saj me Shqipërinë.

Vitet '80 të shekullit të kaluar shënojnë një progres cilësor në përpjekjet shqiptare për të korigjuar vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913. Shqiptarët e Kosovës u ngritën në revolta për vetëqeverisje kombëtare në kuadër të Federatës, u gjakosën me makinën e dhunës federale dhe pak më vonë me regjimin e egër të shovinizmit serb në pushtet, atë të Slobodan Milosheviçit. Në këto beteja u përgatitën luftëtarët e ardhshëm të pavarësisë së Kosovës dhe që aty filloi ndërtimi i organizuar i platformës kombëtare për të varrosur vendimet e Konferencës së Londrës.

Rënia e komunizmit në Europë shënoi një përmbysje të madhe gjeostrategjike me rrjedhoja të mëdha në të gjithë botën e veçanërisht në ish-vendet komuniste, në Bashkimin Sovjetik e në vendet e Europës Lindore. Regjimet komuniste në Ballkan, në Rumani, Bullgari e Shqipëri u shpërbënë njëri pas tjetrit, dhe këto vende u futën në rrugën e ndërtimit të shoqërive demokratike e të ekonomisë së tregut. Republika Federative e Jugosllavisë e përjetoi rënien e komunizmit në mënyrë dramatike, më rëndë e me rrjedhoja shumëdimensionale. Arsyeja kryesore ishte se dështimi i sistemit jugosllav "të vetadministrimit socialist" u shoqërua me një krizë të thellë nacionale që çoi në dezintegrimin e Federatës e në shpërthimin e luftërave ndëretnike. Si rrjedhojë e tyre, filloi të shembet sistemi i vjetër i Versajës, produkt i të cilit kishte qenë Jugosllavia e në vend të saj të lindnin shtetet kombëtare të Sllovenisë,

Kroacisë, Maqedonisë së Veriut e të Bosnjë-Hercegovinës. Konferenca ndërkombëtare e Londrës e vitit 1992 i njohu këto ndryshime.

Shqiptarët e Kosovës e të viseve të tjera të Jugosllavisë tashmë të rrënuar mbetën jetimë e pa përkrahje, nuk u ftuan në Konferencën e Londrës me të njëjtin status e me të drejtën e fjalës si të tjerët. Fantazma e Londrës e vitit 1913 u shfaq përsëri në korridoret e Konferencës së Londrës të vitit 1992, këtë herë jo në nivel ambasadorial, por në një rrafsh më të lartë politik. Kjo ndodhi për dy arsye: e para se vetë shqiptarët duke qenë në pozita inferiore organizimi kombëtar në raport me sllovenët, kroatët, boshnjakët e maqedonasit që kishin republikat e tyre brenda Federatës, nuk arritën të demonstrojnë fuqi ushtarake e ta kërkonin shkëputjen përmes kryengritjes. Ata ndodheshin nën diktatin e kontrollin e Serbisë së Milosheviçit. Arsyeja e dytë kryesore ishte se shqiptarët e Kosovës e të ish-Jugosllavisë nuk patën përkrahje të kauzës së tyre kombëtare, asnjë Fuqi të Madhe të kohës, të cilat e shikonin atë vetëm si një çështje të lirisë e të të drejtave të njeriut, madje edhe brenda Republikës së Serbisë. Rrënjët e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të vitit 1913 ishin shumë të thella në ndërgjegjen politike europiane dhe askush nuk merrte mundimin dhe angazhimin për t'i shkukur ato nga trupi i Ballkanit si fuçi baruti. Mungonte ende kuptimi për potencialin shpërthyes të shqiptarëve, por edhe interesat e drejtpërdrejta të aktorëve të mëdhenj ndërkombëtarë rreth tij.

Shqiptarët e Kosovës më shumë edhe ata të viseve të tjera më pak e kuptuan e u ndërgjegjësuan plotësisht se që të fitohej beteja me padrejtësinë e madhe historike të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të vitit 1913 e për rrjedhojë edhe për t'u çliruar nga sundimi i Serbisë, duhej të sigurohej mbështetje ndërkombëtare. Këtë mision e mori përsipër Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kryetari i saj Ibrahim Rugova që në disa vite e ndërkombëtarizuan çështjen e Kosovës, e bënë pjesë të agjendave të diplomacisë e të forumeve ndërkombëtare. Kontaktet e tyre të vazhdueshme me qendrat e politikës botërore, me Shtetet e Bashkuara e vende të Bashkimit Europian duke afishuar një lëvizje paqësore për liri e pavarësi, kontribuan në sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar, në qasjen graduale të tyre të kuptimit të thelbit dhe të rrënjëve historike të çështjes shqiptare.

Përfundimi i luftës në Bosnjë-Hercegovinë në vitin 1995 e nxori Kosovën në krye të punëve të pazgjidhura në Ballkan. Por fryma e Marrëveshjes së Dejtonit aq sa e dobishme ishte për të mbyllur konfliktin e përgjakshëm të Bosnjë-Hercegovinës përkohësisht, po kaq edhe iluzore u bë se me kompromise me regjimin e Milosheviçit mund të

stabilizohej Ballkani. Kosova u dëmtua nga Marrëveshja e Dejtonit, sepse Perëndimi besoi se mund të arrihej një zgjidhje me shqiptarët brenda Serbisë me rikthimin e disa të drejtave e lirive të mohuara. Milosheviçi e keqpërdori kërkesën përëndimore për një zgjerim të të drejtave për shqiptarët. Ai bëri të kundërtën, rriti presionin e kontrollin policor dhe shtoi dhunën për ta eliminuar problemin shqiptar me çdo kusht e me çdo çmim. Shqiptarët u ndodhën përsëri në një moment kulmor të sfidës historike të mbijetesës si komb. Viti 1997-1998 shënoi kalimin nga Lëvizja paqësore për pavarësi në kryengritje të armatosur për çlirim kombëtar.

Ky ndryshim cilësor u diktua nga zhvillimet e brendshme në Kosovë e nga rrethanat ndërkombëtare. Lëvizja paqësore e kishte kryer misionin e saj historik, kishte ndërgjegjësuar e përgatitur ndër vite popullin e Kosovës për rezistencë të organizuar dhe e kishte bërë të njohur atë në arenën ndërkombëtare. Në një farë mënyre nëse do të mund të bëhej një krahasim Lëvizja paqësore e ngjante Rilindjes Kombëtare që parapërgatiti kombin shqiptar në kërkim të autonomisë e të pavarësisë. Pavarësia e Shqipërisë erdhi si rrjedhojë e kryengritjeve antiosmane të viteve 1910-1912 dhe ishte realizimi i pjesshëm i programit kombëtar. Në fundin e shekullit kishte ardhur koha që të përmbushej pjesa tjetër e programit kombëtar, liria e pavarësia e Kosovës përmes rezistencës së armatosur. Atë rol që luajtën kryengritjet antiosmane në fillim të shekullit, në fund të tij e mori përsipër lëvizja e armatosur e shqiptarëve të Kosovës që morri emrin e UÇK.

Ashtu sikurse pavarësinë e Shqipërisë e ndihmuan faktorët dhe rrethanat ndërkombëtare të kohës, mbështetja e Austro-Hungarisë dhe e Italisë, luftën e shqiptarëve të Kosovës për liri, emancipim kombëtar e pavarësi e ndihmuan Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-ja. Për herë të parë pas afro 90 vjetësh shqiptarëve iu gjendën në krah aleatë përëndimorë. Pavarësia e Shqipërisë u shpall njëkohësisht edhe si akt çlirimi kombëtar, por njohja e saj ndërkombëtare u bë pas disa muajsh në Konferencën e Ambasadorëve në Londër me vendimin e 29 korrikut 1913. Çlirimi i Kosovës dhe pavarësia e saj nuk ishin një akt i vetëm. Midis tyre pati një distancë kohore prej 9 vjetësh.

Pavarësia e Kosovës i dha një goditje gati asgjësuese Konferencës së Ambasadorëve të Londrës dhe gjithë sistemit antishqiptar që u ngrit mbi bazën e vendimeve të saj. Po a mund të quhet plotësisht e çmontuar kjo Konferencë në përmbajtjen e saj 100 vjet pas organizimit të saj? Kjo mbetet objekt diskutimi, nisur sidomos nga ideja e bashkimit kombëtar.

Marenglen Verli

INTERESAT E FUQIVE EVROPIANE DHE PERCEPTIMI I TYRE PËR SHQIPTARËT – PRELUDI I VENDIMEVE TË KONFERENCËS SË LONDRËS

Abstrakt

Fuqitë Evropiane, në mos më herët, treguan interes të veçantë dhe i njohën mirë shqiptarët gjatë shek. XV, përkatësisht në vitet e qëndresës së pashembullt nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër invazionit osman. Më pas, deri në gjysmën e dytë të shek. XVII kur u fuqizuan dy pashallëqet e mëdha shqiptare me qendra në Shkodër e Janinë, interesi i Evropës për shqiptarët dhe njohuritë e saj për ta u zbehën. Natyrisht stratotët shqiptarë, ndër luftëtarët më të guximshëm të shek. XV-XVI, ishin të kërkuar për shërbimet e tyre në Evropë, por pjesa e islamizuar e popullsisë shqiptare njihej më tepër përmes personaliteteve që patën poste drejtuese në administratën dhe ushtrinë osmane.

Në shek. XIX, kur Perandoria Osmane ishte kthyer në “të sëmurën e Bosforit”, shqiptarët për shkak të propagandës denigruese të monarkive të reja ballkanase, por edhe për shkak të propagandës së qarqeve drejtuese të Stambollit, në sytë e evropianëve ishin “të egrit” e Evropës, pa aftësi shtetformuese dhe kundër reformave, që duhet së paku të modernizonin Perandorinë. Njëherësh, myslimanët shqiptarë llogariteshin dora e osmanëve në Ballkan për të bërë “zap” popujt e krishterë të gadishullit.

Përçarjet fetare e krahinore të shqiptarëve, orientimi i tyre pro dhe kundër sulltanit e xhonturqëve, kërkesat e tyre, të ndikuara nga gjendja sociale, niveli arsimor e kulturor, shpesh pa përmbajtje të mirëfilltë kombëtare dhe të meta të tjera të shqiptarëve të hiperbolizuara nga një shumnjë propagandistike nacionale e fetare rajonale, që synonte të parapërgatiste aneksimin e viseve shqiptare, luajtën rol në opinionin që u krijua te Fuqitë e Mëdha për kombin shqiptar.

Natyrisht, më tepër se perceptimi për shqiptarët që kishin Fuqitë e Mëdha dhe, gjithashtu më tepër se interesat e fqinjëve, në politikën e lartë evropiane përcaktuese ishin vetë interesat e gjashtë Fuqive. Dueti Austro-Hungari – Itali, kishte politikën strategjike rajonale më të favorshme për interesat e kombit shqiptar. Veçanërisht për Vjenën një komb shqiptar i emancipuar dhe një shtet shqiptar solid në bregun e Adriatikut, llogaritej një bastion me vlera jetike, për t’u mbrojtur nga ekspansioni i Ruisë.

Në një konglomerat interesash të kundërta dhe opinionesh përgjithësisht negative për shqiptarët, pas shpartallimit të Perandorisë Osmane në vitin 1912, Fuqitë e Mëdha, pas shumë përplasjeve midis tyre, me konsensus miratuan krijimin e shtetit shqiptar, veçse të përgjysmuar si popullsi e territore.

Vendimet e Konferencës së Londrës do të ishin kështu fryt i interesave të ndryshme të Fuqive Evropiane, mpleksur me perceptimin e tyre për shqiptarët.

Fjalët çelës: Fuqitë e Mëdha, Konferenca e Londrës, Perandoria Osmane, çështja shqiptare.

Fuqitë evropiane, në mos më herët, treguan interes të veçantë për arbërit/shqiptarët dhe i njohën mirë ata gjatë shek. XV, përkatësisht në vitet e qëndresës së pashembullt nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër invazionit osman. Natyrisht ishte fjala për Evropën Perëndimore Qendrore, sepse Rusia e Pjetrit I në Evropën Lindore do të lindte pas 3 shekujve. Asokohe arbërit dhe prijësi i tyre i shquar perceptoheshin si barrierë për qytetërimin evropian dhe fenë e krishterë përballë pushtuesve aziatikë dhe ekspansionit jo vetëm politik e ushtarak lindor osman, por edhe avancimit të islamizmit drejt Evropës. Kaq shumë u vlerësua qëndresa antiosmane e arbërve sa për suksesin e saj u interesuan posaçërisht Mbretëria e Hungarisë, Republika e Venedikut, Papati- Vatikani Dukati i Milanos, Mbretëria e Napolit, Ragusa, etj., të cilat ishin të rrezikuarat e para nëse thyhej qëndresa e arbërve.

Arbrit – shqiptarët, edhe pse të reduktuar në numër e të rrënuar ekonomikisht, do të ishin pjesë e planeve dhe kombinacioneve antiosmane gjatë shekullit XIV deri në fillim të shek. XVII, madje trojet e tyre qenë qëndër për kuvendet që pretendonin me ndihmën e Evropës të realizonin çlirimin e Ballkanit prej pushtuesve osmanë.

Më pas deri në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, kur u fuqizuan dy pashallëqet e mëdha shqiptare me qëndër në Shkodër e Janinë, interesi i Evropës për shqiptarët u zbeh dhe njohuritë për ta ishin më të pakta. Pasi kishin shkëlqyer si stratotë (mercenarë), luftëtarë të dorës së parë në shërbim të shteteve të ndryshme evropiane të kohës, veçanërisht Francës, Spanjës, Venedikut etj., duke arritur të komandojnë ushtritë më në zë të kohës (si himarjotin Maurik Bua, kryekomandant shumëvjeçar i ushtrive të Republikës së Venedikut, në fillim të shekullit XVI), shqiptarët gjithnjë të pakët në numër dhe progresivisht të islamizuar, nuk ishin më “aleatët” e dikurshëm të Evropës. Tashmë vezirë e pashallarë shqiptarë myslimanë, pjesë e elitës politike të Perandorisë Osmane, u prinin armatave osmane drejt Evropës Qendrore, deri në rrethimin e Vjenës (1683-14 korrik/ 31 gusht) nga Kara Mustafa Pasha, pengonin Rusinë që po ngrihej si perandori të dilte në Detin e Zi dhe luanin role me rëndësi në pushtimin dhe qeverisjen e territoreve të Azisë dhe Afrikës, nga Jemeni e Persia deri në Gjibraltar. Pjesëmarrja e shqiptarëve në kryengritjet antiosmane në Ballkan gjatë luftës Austro-Osmane, sikurse ndodhi nën drejtimin e Pjetër Bogdanit, që rezultuan të shtypura me terror e të pasuara nga shpërngulje masive të popullsisë edhe pse ato kryengritje nuk patën sukses, u regjistruan në memorien e kancelarive evropiane të kohës.

Në shekullin XVIII, fillimi i rënies së dukshme të Perandorisë Osmane dhe forcimi i pashallëqeve të fuqishme gjysmautonome të Shkodrës dhe Janinës i bënë përsëri të njohur shqiptarët. Edhe pse në shumicë myslimane, popullsia në shumicë shqiptare e këtyre pashallëqeve llogaritej nga Franca, Anglia e Rusia si potencial që mund të ndikonte në zhvillimet politike ushtarake në Ballkan.

Por pikërisht në fillim të shekullit XIX, qëndrimi i Fuqive të Mëdha ndaj Perandorisë Osmane dhe kombit shqiptar, përkatësisht elitës së tij politike e ekonomike, filloi të diferencohet dukshëm.

Lëvizjet nacionale, krijimi i shteteve të para autonome e të pavarura në Ballkan (Greqia dhe Serbia), aspiratat e tyre për konsolidimi e zgjerim territorial, të mbështetura nga njëra apo tjetra Fuqi e Madhe, e kthyen gradualisht Ballkanin në “Fuçi Baruti”

Shqiptarët, të përçarë në aspektin fetar e krahinor, u ndodhën me këtë rast midis dy zjarreve. Nga njëra anë Perandoria Osmane (në elitën e së cilës ishin integruar e bënë pjesë shumë personalitete me origjinë shqiptare), organizoi politikën e pengimit të zhvillimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, kurse nga ana tjetër fqinjët veriorë e jugorë, të cilët tashmë kishin shtetet e tyre nacionale dhe aleatët e tyre të mëdhenj, i shtuan përpjekjet që kombi shqiptar dhe trojet e tij të shërbenin si material mbushës për konstruksionet e reja shtetërore ballkanike.

Në shekullin XIX, kur disa Fuqi të Mëdha përpiqeshin të mbanin gjallë “të sëmurin e Bosforit”, kurse Rusia kërkonte ta shkatërronte për të rritur influencën në Ballkan, e për të marrë ngushticat e Bosforit dhe Dardaneleve, shqiptarët, për shkak të politikës denigruese të monarkive të reja ballkanase, por edhe për shkak të propagandës së qarqeve drejtuese të Stambollit, në sytë e evropianëve shikoheshin si të “egrit” e Evropës, pa aftësi shtetformuese dhe kundër reformave (p.sh. Reformave të Tanzimatit), që duhet sadopak të modernizonin Perandorinë. Njëherësh, myslimanët shqiptarë llogariteshin dora e osmanëve në Ballkan për të bërë “zap” popujt e krishterë të gadishullit.

Konsulli i Austro-Hungarisë, Lipih në vitin 1877 në një raport të gjatë e shumë të argumentuar, dërguar Vjenës, njoftonte se ndryshimet në organizimin e kufijve midis njësive të Perandorisë, të bëra nga veziri i madh reformator Mithat Pasha, kishin pikërisht një synim të tillë.

Njëherësh Lipih llogariste forcën ushtarake të shqiptarëve edhe për interesat e Perandorisë Habsburge. Sipas tij 120 000 shqiptarë katolikë në Shqipërinë e Veriut dhe në pjesën e Rrafshit të Dukagjinit midis Prizrenit dhe Pejës, mund të nxirrnin në rast lute afro 20 000 luftëtarë.

Lipihu kishte besim se në rast përplasje midis Perandorisë Osmane dhe Perandorisë Rus, ose të Perandorisë Osmane me monarkitë e vogla ballkanike dhe, veçanërisht, të përfshirjes në konflikt edhe të Austro-Hungarezëve, shqiptarët myslimanë gjithashtu do të rreshtoheshin në krahun e duhur.

Me sa duket në Vjenë, edhe pse për momentin, sikurse në Berlin, Paris, Londër e Romë, ishin për t'i zgjatur jetën Perandorisë Osmane, ekzistonin kalkulime edhe për një opsion tjetër, kur Austro-Hungaria do të zgjerohej drejt Jugut të Ballkanit për të zotëruar si një trevë jetike Bregun Lindor të Adriatikut.

Lufta ruso-turke e viteve 1877-1878, shpartallimi i Perandorisë Osmane, zhvillimet që pasuan Traktatin e Shën Stefanit dhe Kongresin e Berlinit, përkatësisht humbja e disa territoreve osmane në Ballkan, ndër të cilat Sanxhaku i Nishit e vise të tjera shqiptare dhe historia e marrëdhënieve shqiptaro-ballkanase e shqiptaro-turke gjatë viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), sollën një vështrim të ri të faktorit ndërkombëtar për shqiptarët. Këta u faktorizuan, por përçarjet fetare e krahinore, orientimi i tyre pro e kundër politikës së Portës së Lartë, kërkesat e tyre të ndikuara nga gjendja ekonomike e sociale, niveli arsimor e kulturor, shpesh pa përmbajtje të mirëfilltë kombëtare dhe të meta të tjera të shqiptarëve, të hiperbolizuara nga një propagandë denigruese masive nacionale e fetare rajonale, që synonte të parapërgatiste aneksimin e viseve shqiptare, luajtën pa dyshim rol në opinionin që u krijua te Fuqitë e Mëdha për kombin shqiptar.

Duke pasur opinion të ngjashëm, të krijuar gjatë gjithë shekullit XIX, pak të influencuar pozitivisht nga lëvizja e dobët kombëtare shqiptare, e cila edhe pse me disa ideologë e veprimtarë të fuqishëm si vëllezërit frashëri, Pashko Vasa, Ismail Qemali, etj., nuk kishte mundur të bënte për vete shtresa të gjera të popullsisë, Fuqitë e Mëdha përcaktuese në politikën e tyre patën interesat e tyre gjeopolitike në rajon.

Natyrisht më tepër se perceptimi për shqiptarët që kishin gjashtë Fuqitë e Mëdha dhe, gjithashtu, më tepër se interesat e fqinjëve, në politikën e lartë evropiane përcaktuese ishin interesat e tyre. Dueti Austro-Hungari-Itali, kishte politikën strategjike rajonale më të favorshme për interesat e kombit shqiptar. Veçanërisht për Vjenën një komb shqiptar i emancipuar dhe një shtet shqiptar solid në bregun e Adriatikut, llogaritej më shumë se kurrë më parë si një bastion me vlera jetike, për t'u mbrojtur nga ekspansioni i Rusisë.

Austro-Hungaria e dekadave të fundit të shekullit XIX dhe dekadës së parë të shekullit XX, nuk ishte më Austria e gjysmës së parë të

shekullit XIX, kur i printe koncernit evropian nën drejtimin e kancelarit të hekurt, princit Meternik. Principatat gjermane dhe italiane të bashkuara në shtete me pretendime i kishin prerë krahët Austro-Hungarisë në vitet '60-'70 në kufijtë veriorë dhe perëndimorë. Rusia nuk ishte kafshatë për Austro-Hungarinë në krahun lindor. Prandaj viset shqiptare dhe kombi shqiptar kishte rëndësi të veçantë për Vjenën. Investimet e Perandorisë Habsburgase për inteligjencën shqiptare, për arsimin dhe kulturën shqiptare, ishin pikërisht në kuadër të gjallërimit sasior dhe cilësor të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që gjithashtu nuk kishte shumë për të zgjedhur që të arrinte të krijonte shtetin kombëtar autonom e më pas të pavarur. Në këtë rrugë, por pa konsekuencën e Vjenës, eci edhe Roma. Për Gjermaninë, aleate me Austro-Hungarinë gjatë krijimit të Blloqeve të Fuqive të Mëdha, çështja shqiptare shikohej pa pasion, kurse për Francën e sidomos për Rusinë, në Ballkan bëhej mirë kur dobësohej Austro-Hungaria dhe fitonte terren politika pansllaviste. Pozitë të veçantë mbante Britania e Madhe, që ekuilibrin me rajonin e Mesdheut e shihte si mundësi për të vijuar të ishte mbretëreshë e deteve dhe e tregtisë botërore.

Në këtë konglomerat interesash të kundërta dhe opinionesh përgjithësisht negative për shqiptarët, pas shpartallimit të Perandorisë Osmane në vitin 1912, Fuqitë e Mëdha, pas shumë përplasjesh midis tyre, me konsensus, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, miratuan krijimin e shtetit shqiptar, veçse të përgjysmuar si popullsi e territore.

Vendimet e Konferencës së Londrës do të ishin kështu fryt i interesave të ndryshme të Fuqive Evropiane, mpleksur me perceptimin e tyre për shqiptarët.

Këta do të paguanin "haraçin" për integrimin politik, veçanërisht të elitës, por edhe për konvertimin fetar, gjithashtu për politikën e Portës së Lartë që të mos kishin arsimin e kulturën e tyre kombëtare, të mos njiheshin e trajtoheshin si komb brenda Perandorisë Osmane, për rënien pre e propagandës shtetërore osmane, për të shërbyer për interesat e saj në rastin e përbaljes midis Perandorisë dhe Fuqive të Mëdha evropiane, sikurse ndodhi kur agravoit çështja e Bosnjës (aneksimi i Bosnjës nga Austro-Hungaria). Zhvillimet në Konferencën e Londrës për statusin dhe kufijtë e shtetit të ri shqiptar, lënia jashtë këtyre kufijve e Kosovës edhe në hartën më të favorshme të paraqitur nga Austro-Hungaria, ishin dëshmi për këtë.

Shteti i ri shqiptar humbi shumëçka, por iu njoh pavarësia. Mbetej që më një realpolitikë të mirëzbatuar të ecej përpara drejt konsolidimit dhe prosperitetit. Madje Lufta Botërore do të inspironte rifillimin (në

një luftë titanike) të përpjekjeve për të ringjallur Shqipërinë (duke kërkuar një aleat të ri të madh). Fatmirësisht kjo u arrit falë angazhimit maksimal të shqiptarëve për shkak të kontradiktave të fuqive rajonal e Fuqive të Mëdha, për shkak se asnjëra nga fuqitë rajonale fqinje nuk kishte prioritet të politikës përfitimin territorial në Shqipëri dhe për shkak të pozicioneve të SHBA-së dhe më pas Britanisë së Madhe, që favorizuan përpjekjet shqiptare për të rilindur shtetin e tyre.

Bibliografia

1. Arkivi i Institutit të Historisë (AIH), Fondi Arkivi i Vjenës vitet 1877-1914.
2. Alfred Rapport, *Rrjedha e punvet në Shqipni*, “Mbrothësia”, Tiranë 1928.
3. Arben Puto, *Shqipëria Politike (1912-1939)*, Tiranë TOENA, 2009.
4. Arben Puto, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha, 1912-1914, “8 Nëntori”, Tiranë 1978.
5. Armend Mehmeti, *Diplomacia e Britanisë së Madhe mbi marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave (1919-1939)*, Instituti i Historisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, “Kristalina -KH”, Tiranë 2019.
6. Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, (1912-1918), vëllimi II, botim nga Arben Puto, “8 Nëntori”, Tiranë 1978.
7. *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadoëve në Londër, 1912-1913*, përgatitur nga Muhamet Shatri, Instituti i Historisë i QSA, TOENA, Tiranë 2012.
8. *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqipëtarët (tetor-dhjetor 1913)*, vëllimi I, TOENA 2012.
9. Georges Castellan, *Historia e Ballkanit (shekulli XIV-XX)*, Tiranë 1991.
10. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëllimi I, Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimet TOENA, Tiranë 2002.
11. Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 1878-1881*, Tiranë 1997.
12. Ksenofon Krisafi, Çështja shqiptare në Kongresin e Berlinit, *Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*, vëll. I, Tiranë 1979.
13. *Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*, vëll. I, Tiranë 1979, vëll. II, Tiranë 1980.
14. *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920 (Dokumente)*, Përgatitur për botim nga Muin Çami, etj, Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave, Tiranë 1975.
15. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) në dokumentet angleze*, Përgatitur nga Skënder Rizaj, Prishtinë 1978.
16. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) në dokumentet osmane*, Përgatitur nga Iljaz Rexha, Prishtinë 1978.
17. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) në dokumentet osmane*, Përgatitur nga Kristaq Prifti, Tiranë 1978.

18. Marenglen Verli, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze*, Botimet “Klean”, Tiranë 2014.
19. Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, Tiranë 1995.
20. Muin Çami & Marenglen Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes (1919-1920)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Kristalina -KH”, Tiranë 2015.
21. *100 vjet pavarësi* (Aktet e Konferencës shkencore ndërkombëtare), vëllimi I, II, Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Botimet Albanologjike, Tiranë 2014.
22. Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, vëllimi I, (1912-1939), Tiranë, TOENA, 2013.
23. *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1876-1878)*, dokumente franceze, përgatitur nga Ligor Mile, vëll I, Tiranë 1978.
24. *Vilhelm, princ i Shqipërisë, princ i Vidit, Promemorie mbi Shqipërinë*, Skanderbeg Books, Tiranë 2010.
25. Xheladin Shala, *Shqipëria në Konferencën e Ambasadorëve 1912-1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017.
26. Zekria Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*, Prishtinë 1979.

Ibrahim Gashi

NDIKIMET E KONSTELACIONIT NË RAPORTET E FUQIVE TË MËDHA NË EPILOGUN E KONFERENCËS SË AMBASADORËVE NË LONDËR 1912-1913

Abstrakt

Një kaptinë tejet e rëndësishme në krizën ballkanike të viteve 1912-1913 përbën çështja e pozicionimit të Fuqive të Mëdha karshi pavarësisë shqiptare. Tratativat diplomatike dhe debatet e gjata në Konferencën e Ambasadorëve në Londër për muaj me radhë e kishin ngritur çështjen shqiptare në një çështje të dorës së parë, duke sinjalizuar të gjithë aktorët ballkanikë se ajo nuk mund të mënjanohej tërësisht.

Konstelacioni ndërkombëtar i krijuar nga pozicionimet e Fuqive të Mëdha në kuadër të dy aleancave të mëdha politike dhe ushtarake tashmë të konsoliduara reflektuan në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë edhe në qëndrimet e tyre në rrjedhën dhe vendimet e Konferencës. Aleatët ballkanikë dhe mbështetësit e tyre nga radhët e Fuqive të Mëdha (Rusia dhe Franca) kishin pranuar të njihnin krijimin e një shteti autonom shqiptar në një territor të ngushtë, fare të papërfillshëm, për ta privuar kështu atë nga mundësitë që të mbijetonte ekonomikisht dhe politikisht. Nga ana tjetër, Fuqitë e Trepalëshit, sidomos Austro-Hungaria dhe Italia, kishin treguar “interesim” të veçantë për konsolidimin e shtetit shqiptar, me rastin e caktimit të kufijve të tij me fqinjët ballkanikë. Në një situatë të tillë ndërkombëtare edhe zgjidhjet e ofruara në Konferencën e Ambasadorëve në Londër shprehin qartë këtë konstelacion dhe rivalitetin ndërmjet fuqive të mëdha.

Fjalët çelës: konferenca, fuqitë e mëdha, marrëveshje, debate, etj.

Për të kuptuar konstelacionin ndërkombëtar në fund të shekullit XIX dhe XX pra për të kuptuar pozicionet e gjashtë fuqive të mëdha të kohës në raportet midis tyre dhe rrjedhimisht edhe në raport me krizat dhe konfliktet e tjera rajonale duhet para së gjithash të analizohen burimet diplomatike të kohës të përmbledhura në dhjetëra vëllime të proviniencës arkivore britanike, gjermane, franceze dhe austro-hungareze, si dhe të një literaturë kompetente e mbeshtetur në burime multiprovinciale.

Studiuesi dhe historiani i njohur i shekullit të kaluar, Luigi Albertini, në studimin e tij trevëlimesh (rreth 1700 f) “The origine of the war

of 1914”¹ të botuar në vitin 1952, duke shfrytëzuar një dokumentacion primar të vjelë para L.II.B pra, para se ta asgjësonte, lufta dhe në mbështetje të intervistave me disa nga protagonistët e kohës na sjell një tablo të shkëlqyer të marrëdhënieve ndërkombëtare të fundshekullit XIX dhe fillim shekullit XX, duke identifikuar rivalitetin anglo-gjerman, si njërin nga shkaktarët e parë që çoi në luftën e madhe dhe menjëherë pas tij duke renditur “interesimet” e mbretërisë dualiste austro-hungareze dhe asaj cariste ruse për dominim në Turqinë evropiane, përkatësisht në Ballkan.

Kriza e brendshme politike që kishte përfshirë P.O në fillim të shekullit XX., krahas kujdestarisë austro-ruse për të participuar në “zgjidhjen” e çështjes lindore krijuan mjaftueshëm rrethanat për një shpërthim të armatosur. Kur themi këtë kemi parasysh aktin e aneksimit të BeH nga ana e A-H dhe aktivitetin diplomatik të Rusisë cariste për krijimin e aleancës ballkanike. Të dy këto ngjarje krahas kryengritjeve shqiptare, me theks kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912 krijuan perspektivën e një përplasjeje të armatosur midis aleatëve ballkanikë dhe P.O.

Realiteti i krijuar pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, në një kohë kur pjesa më e madhe e territorit të shtetit të saposhpallur ndodhej në duar të ushtrive serbe, malazeze dhe greke, rrjedhimisht prodhonte implikime serioze në marrëdhëniet ndërmjet Fuqive të Mëdha dhe vendeve të Aleancës Ballkanike. Dy faktorë të rinj dukeshin shumë inkonsistent njëri ndaj tjetrit. Dalja e Serbisë në Adriatik dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë e mohonin apriori njëra-tjetrën. Serbia ishte e vetëdijshme për këtë, andaj dhe shumë zëshëm kishte reagu kundër krijimit të shtetit të pavarur shqiptar. Kryeministri i Serbisë, Nikolla Pashiqi kishte deklaruar lidhur me këtë në parlament: *”Serbia nuk mund të gëzohet për formimin e Shqipërisë, sepse ky është grushti më i rëndë kundër sllavëve dhe Aleancës Ballkanike që ndër morën austro-gjermanët...”*²

Çështja e daljes së Serbisë në Adriatik po i sfidonte seriozisht relacionet ndërmjet Fuqive të Trepalëshit dhe të Antantës. Deri në këtë

¹ Lee, D. E. (1954). *Western Continental Europe: ALBERTINI, LUIGI. The Origins of the War of 1914. Vol. II: The Crisis of July 1914 from the Sarajevo Outrage to the Austro-Hungarian General Mobilization.* Translated and edited by Isabella M. Massey. Pp. xvi, 727. New York: Oxford University Press, 1953. \$11.00. *THE ANNALS of the American Academy of Political and Social Science*, 293(1), 204-205. <https://doi.org/10.1177/000271625429300172>

² Xheladin Shala, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Serbe 1912-1918*, Prishtinë, 1990, f. 102;

fazë të rrjedhës së luftës mund të thuhet se vetëm Austro-Hungaria dhe Rusia kishin qenë të involvuara indirekt. Përparimet e shpejta të ushtrive ballkanike nga gjysma e dytë e nëntorit, në drejtim të Stambollit dhe të Adriatikut, u shkaktuan shqetësim edhe fuqive të tjera. Aleancat e krijuara kohë më parë tani po hynin në një fazë të testimit serioz.

Austro-Hungaria, duke dyshuar në sinqeritetin e plotë të Italisë dhe deri diku edhe në forcën e saj, i kishte kthyer shikimet nga aleati kryesor -Gjermania. Vizita e princit trashëgimtar Franc Ferdinandit dhe e shefit të Shtatmadhorisë së forcave të armatosura austro-hungareze gjeneralit Shemua, më 23 nëntor në Berlin, erdhi në një kohë kur çështja e daljes së Serbisë në Adriatik ishte aktualizuar maksimalisht. Vizita në fjalë motivohej edhe nga shqetësimet e Vjenës lidhur me masat përforcuese ruse të ndërmarra ato ditë në kufirin me Austrinë në Galici. Me të arritur në Berlin Shemua pati takim me homologun e tij Moltken, në Springe. Nga dëshmitë që ka lënë Shemua mësojmë mbi përmbajtjen e këtij takimi: *“Biseda jonë e rikonfirmoi marrëveshjen e majit të këtij viti dhe gjithashtu rezultoi me kompletimin e një marrëveshjeje të plotë në përputhje me situatën e përgjithshme. Moltke aprovoi në tërësi vlerësimet e situatës dhe shqetësimet tona lidhur me Rusinë dhe Serbinë, duke shtuar se gjermanët do të ndërmarrin masa shtesë të përforcimit të kufirit gjermano rus, duke angazhuar edhe formacionet rezervë. Ai e rikonfirmoi pohimin e thënë disa herë se Austria mund të llogariste në mbështetjen e sigurt të Gjermanisë në rast të një sulmi nga ana e Ruisë, sepse kjo do të rrezikonte edhe interesat e Gjermanisë. Por në të njëjtën kohë ai prezantoi edhe tërë kompleksitetin e situatës në rast të një aksioni të tillë. Mobilizimi i ushtrisë gjermane mund të çonte në mobilizimin e ushtrisë franceze. Dy ushtritë e mobilizuara karshi njëra-tjetrës mund të rrëshqisnin drejt konfliktit.... Moltke deshi të dinte se a do të angazhonte Austria ndonjë pjesë të trupave të saj në mbrojtjen e kufirit me Italinë, dhe ai u ndje i lehtësuar kur i pohova se nuk do të kishte nevojë për një gjë të tillë...”*³ Edhe takimi që F. Ferdinandi kishte pasur me Kaiserin kishte kaluar në këtë frymë dhe po atë ditë pas mbarimit të takimit F.Ferdinandi e kishte angazhuar ambasadorin e tij në Berlin të njoftonte Vjenën për suksesin e plotë të vizitës dhe mbështetjen e marrë nga Gjermania. Për më tepër delegacioni austriak me shumë pompozitet dhe eufori e përcolli këtë lajm, dhe kjo bëri që nga tërë konfidencialiteti i bisedimeve të rridhte shumëçka në shtypin austriak. *“Neue Freie Presse”* kishte publikuar me pompozitet mbështetjen e pa rezervë që F.

³ Ernest Helmreich, *The diplomacy of the Balkan Wars 1912-1913*, London 1938, f. 239;

Ferdinandi kishte marrë nga kryeministri Bethman Hollëeg. ⁴Dy ditë më vonë shtypi gjerman, (*Norddeutsche Allgemeine Zeitung*) e botonte deklaratën e Kiderlenit në të cilën akuzohej shtypi i Vjenës se në mënyrë të pakontrolluar po kontribuon në tensionimin e situatës. Ai në këtë deklaratë e bëri të: "... të njohur faktin se të gjitha çështjet do të trajtohen nga fuqitë bashkërisht dhe assesi nga ndonjëra në mënyrë të njëanshme".⁵

Edhe brenda anëtarëve të Antantës pikërisht në këtë kohë po zhvilloheshin tratativa të dendura diplomatike për të rikonfirmuar obligimet ndërbllokiste në rrethanat e krijuara. Dalja e Serbisë në Adriatik dhe zhurma e madhe që vinte lidhur me këtë nga Austro-Hungaria nxiti reagimet e diplomacisë ruse. Rusia, sikurse Austro-Hungaria, kishte marrë rolin e iniciatorit brenda Antantës për forcimin e kursit antiaustro-gjerman. Franca pas fitoreve të përmendura të aleatëve ballkanikë po shprehte interesimet e para të saj lidhur me luftën. Siç bën të ditur Izvol-ski, ambasadori rus në Paris, Franca përpara këtyre zhvillimeve të fundit në Ballkan kishte mbajtur një kurs strikt në politikën e saj ballkanike dhe ndaj obligimeve brenda Aleancës. ⁶Në një fjalim të Poencare's të këtyre ditëve të mbajtur në Nant do të promovohet kursi i ri i politikës franceze karshi aleatëve ballkanikë dhe solidarizimi i saj me Rusinë lidhur me ngjarjet në Ballkan. "Sot, do të shkruajë Izvol-ski, të gjitha gazetat e Parisit pa përjashtim e kanë mbështetur ngrohtësisht fjalimin e Poincare-s. Në të gjitha shkrimet poentohet pjesa e fjalimit ku ministri i Jashtëm francez flet për të drejtën e shteteve ballkanike për të ruajtur frytet e sukseseve të arritura...."⁷

Në rrethana të afrimit të Austro-Hungarisë dhe Gjermanisë, Rusia nuk ndjehej plotësisht e qetë. Rrjedhimisht, Sazanovi u interesua maksimalisht për të qartësuar pozicionin e Anglisë karshi zhvillimeve dramatike në Ballkan. Diplomacia britanike nga ana e saj gjatë tërë kohës ishte shprehur e gatshme se do të ruante relacionet e mira ndëraleate me Rusinë, por pa dhënë asnjë premtim konkret. Insistimet e vazhdueshme të Sazanovit Greyi i kishte zbrapsur me sukses, duke përsëritur se: "...në

⁴ Neue Freie Presse, Nov. 23, 1912;

⁵ Helmreich, *The diplomacy...*, 244;

⁶ Poencare në një vizitë që i bëri Peterburgut i kishte thënë, pos tjerash, Sazanovit: "mos llogaritni në ndihmën tonë ushtarake në Ballkan, bile edhe atëherë nëse iu sulmon Austro-Hungaria. ne do të kryejmë obligimet tona nga Aleanca, por nuk do t'i tejkalojmë ato." shih: Raymond Poincaré, *Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës: (1912-1913)*, Logos-A, 2006, f. 231;

⁷ *Ibid*,232;

rastin e një konflikti austro-serb, përpjekjet e Anglisë do të jenë pjesë e përpjekjeve të fuqive të tjera”.⁸ Me gjithë mosprononcimin e qartë ndaj luftës eventuale, Anglia megjithatë nuk ishte aq indiferente ndaj zhvillimeve në Ballkan. Për më tepër mbështetja që Berlioni i kishte deklaruar politikës luftënxitëse të Vjenës në Ballkan ishte rrethanë tepër shqetësuese për Londrën. Së këndejmi, me miratimin e Grey-it gjenerali Wilson, shefi i shtatmadhorisë së forcave angleze, i bëri një vizitë të fshehtë Francës më 26 nëntor, me qëllim që të mësonte se çfarë masash do të ndërmerreshin në rast të një konflikti franko-gjerman, ku Belgjika sigurisht se do të mbante qëndrim armiqësor. Të dyja palët do t’i kush-tonin më shumë angazhimin pranë qeverisë së Brukselit.⁹

Shqetësimeve serioze që shkaktoi dalja e Serbisë në Adriatik, siç kemi përmendur më lart iu shtua edhe një faktor i ri në zhvillimet ballkanike. Fjala është për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912.

Koncerti i Fuqive të Mëdha, përballë këtyre zhvillimeve më të reja në Ballkan, u ndodh përpara domosdoshmërisë së ndërmarrjes së vendimeve konkrete për të parandaluar shndërrimin e luftës ballkanike në një luftë botërore.

Ideja e thirrjes së një konference ndërkombëtare për Ballkanin, në nivel ambasadorësh, erdhi nga Franca. Mirëpo, vendi i mbajtjes nuk do të ishte Parisi (siç kishte propozuar diplomacia ruse), por Londra, si një vend “neutral”.¹⁰

Pesë Fuqitë e Mëdha të Evropës përfaqësoheshin në Konferencë nga ambasadorët e tyre të akredituar në Londër: konti Mensdorf (Austro-Hungaria), princi Lihnovski (Gjermaninë), markezi Imperiali (Italinë), Pol Kambon (Francën) dhe konti Bekendorf (Rusinë). Me pëlqimin e të gjithëve, ministri i Jashtëm i Anglisë, Sir Eduard Grey, do të udhëhiqte punën e Konferencës, në cilësinë e kryetarit të përhershëm të Konferencës.¹¹

Konferenca i filloi punimet më 17 dhjetor 1912 dhe që në mbledhjen e parë u bë e qartë se çështja kryesore me të cilën do të merrej ajo

⁸ British Documents on the Origins of the War 1898-1914, vol. IX, London 1934; Vol. IX, 202;

⁹ Helmreich, *The Diplomacy...*, 234;

¹⁰ Arben Puto, *Pavarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*, Tiranë, 1978, f. 148;

¹¹ Ibid; Branko Babiq, *Politika Crne Gore u novo oslobodjenim krajevima 1912-1914*, Cetinje, Titograd, 1984, 42;

ishte çështja shqiptare, pas tërheqjes së ushtrive osmane dhe depërtimit të ushtrive ballkanike.

Kur bëjmë fjalë për rendin e ditës së Konferencës vërejmë se varësisht prej pikave konsensusi ndërkombëtar ishte i ndryshëm.

Lidhur me çështjen e statusit të ardhshëm të Shqipërisë, në të vërtetë, me fizionominë e saj politike, siç duket ekzistonte gatishmëria e të gjithë pjesëmarrësve që të krijohej “një Shqipëri autonome”, “nën sovranitetin ose suzeranitetin e sulltanit”, e cila do të ishte “neutrale” dhe “nën garancinë dhe kontrollin ekskluziv të gjashtë Fuqive të Mëdha”.¹²

Çështja e dytë që ishte shtruar lidhur me Shqipërinë po ashtu u ab-solvua që në mbledhjet e para. Pra, ndihma ndërkombëtare për rregullimin e brendshëm të Shqipërisë iu besua, nga pjesëmarrësit e Konferencës, me konsensus, Austro-Hungarisë dhe Italisë, si lëshim për “interesat e tyre të posaçme” në Shqipëri. Këto dy shtete u ngarkuan që në një nga mbledhjet e ardhshme të paraqitnin një projekt të detajuar për organizimin e shtetit shqiptar të përbërë kryesisht nga forcat e brendshme të tij.¹³

Çështja më qenësore për Shqipërinë pa dyshim ishte çështja e lidhur me kufijtë e ardhshëm të saj. Këtu Fuqitë e Mëdha do t’u nën-shtrohen presioneve të njëra-tjetrës dhe të aleatëve ballkanikë nga terreni. Pikëpamjet e tyre në këtë pikë ishin shumë heterogjene dhe kontra-diktore dhe sillëshin nga ideja e krijimit të një Shqipërie sipas propo-zimeve ruso-franceze me një territor fare të papërfillshëm, e paaftë eko-nomikisht dhe politikisht për të mbijetuar dhe një Shqipërie me më pak territor të cunguar, deri diku reale, që propozonte Austro-Hungaria dhe aleatët e saj.

Në mbledhjen e parë (17 dhjetor 1912) pjesëmarrësit e Konferen-cës lidhur me çështjen e kufijve morën vetëm vendime të përgjithshme. Ambasadorët fillimisht i fokusuan diskutimet e tyre vetëm në caktimin në parim të kufirit verior me Malin e Zi dhe të kufirit jugor me Greqinë, në mënyrë që të sigurohej mundësia të ratifikoheshin kufijtë e këtyre dy shteteve. Përveç kësaj, mbledhja e parë u mjaftua vetëm që t’i jepeshin garanci Austro-Hungarisë kundër një daljeje territoriale të Serbisë në bregdetin shqiptar.¹⁴

¹² Arben Puto, *Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare II*, Tiranë 1987, f. 190; Gazmend Rizaj, *Çështja e Daljes së Serbisë në Adriatik përmes bregdetit shqiptar dhe caktimit të kufirit veri-lindor të Shqipërisë 1912-1913*, (tezë e doktoraturës në dorëshkrim) Prishtinë 1995, f. 105;

¹³ *Historia e Shqipërisë II*, f. 142-143;

¹⁴ Arben Puto, *Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare II*, Tiranë 1987, 188-190;

Mbledhja e parë përfundoi me një pajtueshmëri në parim për zgjidhjen e problemeve të shtuara. Kjo i dha mundësi kryetarit të Konferencës, Lordit Eduard Grey, të jepte komunikatën e parë për shtyp me këtë formulim: “Ambasadorët u rekomanduan qeverive të tyre njohjen në parim mbi autonominë e Shqipërisë dhe propozimet për një dalje tregtare të Serbisë në Adriatik. Të gjashtë Fuqitë u pajtuan në parim me këto dy pika.¹⁵” Ky “unitet” fillestar i Fuqive të Mëdha, do të jetë farë i përkohshëm. Çështjet e shtruara për diskutim, veçanërisht çështja e lidhur më caktimin e kufirit verior dhe verilindor të Shqipërisë do të shkaktojë debate të gjata, polarizime, projekte dhe kundërprojekte, të cilat do ta mbajnë për katër muaj me radhë popullin shqiptar në ankth dhe presion të paparë.

Në fund të dhjetorit 1912, Konferencës iu dorëzuan tri propozim-projekte (projekt-harta) të Shqipërisë: Propozim-projekti Austro-Hungarez,¹⁶ Propozim-projekti ruso-frëng,¹⁷ Projekt-propozimi serbo-malazez.¹⁸ Edhe Qeveria e Përkohshme e Vlorës kishte hartuar një propozim të vetin të kufijve, i cili do t'i dorëzohej në formë memorandumit Eduard Greyt më 2 janar 1913.

Ne funksion të temës bosht të Konferencës së sotme do të analizojmë vetëm atë se cili ishte ndikimi që pati pozicionimi i Fuqive të

¹⁵ Public Record Office-Foreign Office (PRO-FO), 424/236,4032, dok.nr. 398, Informatë e Eduard Greyt për F.Cartwright-in, 18.12.1912, (nëpërmes G.Rizaj, Çështja...,107);

¹⁶ Ky projekt, që iu dorëzua Konferencës më 20 dhjetor, parashihte që kufiri i Shqipërisë të shkonte nga ngushtica e Bunës, përgjatë vijës së kufirit malazez, duke e kaluar nga jugu Plavën dhe Gucinë; pastaj shkonte nga Peja, Gjakova dhe Prizreni në jug sipas vijës bjeshkore dhe ndërmjet liqenit të Ohrit dhe të Prespës. Sipas Berchtoldit, ky do të ishte programi maksimalist i Vjenës. Peja, Prizreni dhe Ohri do të shërbenin më tepër si objekt kompensimi. Edhe plani italian e skiconte ngjashëm kufirin e ardhshëm të Shqipërisë, veçse Shkodrën e parashihte t'i ngelej Malit të Zi. shih: Mihajlo Vojvodiq, *Skadarska Kriza 1913 Godine*, Beograd 1970, 37-38;

¹⁷ Sipas këtij propozimprojekti, i cili i arriti Konferencës nga përfaqësuesi i Rusisë Bekendorfi më 21 dhjetor 1912, Shkodra, Peja, Gjakova dhe Prizreni parashiheshin jashtë Shqipërisë, përkatësisht propozohej që kufiri verior të jetë Drini e në lindje Drini i Zi. Vija jugore e këtij projekti ia linte Greqisë Korçën, Delvinën, Sarandën dhe Butrintin, shih: HHStA PA, nr. 5013, dt. 21.12.1912; *British Documents ...IX*, Nr.325; G.Rizaj, *Çështja...*, 111; Dilo, *Çështja shqiptare...*, 242-243; Vojvodiq, *Skadarska...*, 137; Shala, *Marrëdhëniet...*, 37-38;

¹⁸ Projekti serbo-malazez parashihte një Shqipëri të tkurrur territorialisht në maksimum. Sipas udhëzimeve të Pashiqit, ambasadori serb duhej të kërkonte për kufi verior të Shqipërisë lumin Mat dhe vetëm nën presionin e madh në fund mund të lëshonte pe deri në lumin Drin., shih: Dimitrije Djordjevic, *Izlazak Srbije na more i konferencija ambasadora u Londonu 1912*, Beograd 1956, 140;

Madhe në kuadër të aleancave që u takonin në çështjen e caktimit të kufijve të shtetit shqiptar që po diskutohej në Konferencë.

Çështja e harmonizimit të projekteve të dorëzuara në Konferencë paraqiste detyrën më të vështirë me të cilën do të merreshin për muaj me radhë diplomatët e Fuqive të Mëdha të mbledhur në Londër. Ndër çështjet me delikate pa dyshim doli çështja e Shkodrës. Veçanërisht Rusia dhe Austro-Hungaria kishin pikëpamje skajshmërisht të kundërta lidhur me këtë çështje. E para, duke e abstraktuar tërësisht kriterin etnik, faktin se Shkodra akoma nuk ishte pushtuar nga malazezët dhe qëndresën e madhe që atje po e bënin jo turqit, por shqiptarët, e kërkonte me ngulm që ajo t'i takonte Malit të Zi.¹⁹ Austro-Hungaria, nga ana e saj, kishte ngritur disa argumente shumë të fuqishme kundër tezës ruse. Realiteti etnik, historik, kulturor dhe religjioz i qytetit me rrethinat e tij, nuk korrespondonin me Malin e Zi, por me Shqipërinë.²⁰

Në këtë diversitet pikëpamjesh lidhur me përkatësinë e qytetit të Shkodrës në të ardhmen fjalën vendimtare do ta kenë Fuqitë e tjera të Mëdha. Rusia besonte se do ta kishte mbështetjen e sigurt të aleatëve të saj,²¹ mbase edhe të Italisë,²² nga blloku i Trepalëshit.

Debatet e gjata për caktimin e kufirit verilindor të Shqipërisë po shpërfaqnin kompleksitetin e kësaj ndërmarrjeje në rrethana kur propozimi që vinte nga ambasadori austro-hungarez refuzohej apriori nga ambasadori rus, dhe ky refuzim mbështetej herë direkt e herë indirekt nga aleatët francezë dhe britanikë. Kur jemi te Britania duhet nënvizuar se ministri E. Grey bëri përqapje të pareshtura diplomatike pranë Romës dhe Berlinit që të ndikonte tek aleatet e Vjenës për të kërkuar lëshime të reja. Fillimisht Grey provoi ta bindte Romën për çështjen e Shkodrës.

¹⁹ *Österreich – Ungarns Aussenpolitik, (Ö-UA) V, Nr. 5127;*

²⁰ *Ibid;*

²¹ Mundësia e realizimit të planit rus, përveç të tjerash, varej drejtpërdrejt nga dy faktorë: 1. Mbështetja franceze dhe angleze dhe 2. Kompromisi i Fuqive të Antantës lidhur me këtë çështje, në mbështetje të planit rus, shih: *Diplomatski Arhiv Sekretariata Inostranih poslova (DASIP), Politicko Odelenje (PO), fas. II, doc. 3, pov. br. 4752, izvestaj iz Beca pasicu, 17.12.1912;* (përmes Mihailo Vojvodic, *Skadarska kriza 1913 godine*, Beograd, 1970, 42);

²² Rusia, siç bën të njohur Grey, e kishte lutur atë që të ndërhyjë pranë qeverisë italiane, që kjo e fundit të influenconte Vjenën për të hequr dorë nga Shkodra. Grey, ç'është e vërteta, e kishte bërë këtë. Në një takim që kishte pasur me ambasadorin italian në Londër kishte kërkuar nga ai që t'ia përcillte San Gjulianos propozimin e tij. San Gjuliano nga ana e tij në këtë çështje ishte treguar paksa i përmbajtur. Në fakt, ai i kishte kërkuar Greyit që për këtë duhej t'i linte pak më shumë kohë në dispozicion për disa arsye:

Në një telegram që Lordi E. Grey, i dërgonte ambasadorit të tij në Romë për bisedën që kishte pasur me ambasadorin italian në Londër nga i cili kishte mësuar se Italia ndodhej në një pozitë delikate sa i përket Shkodrës, e para sepse ishin marrëveshjet me Austro-Hungarinë për politika të përbashkëta lidhur në Çështjet e Adriatikut dhe e dyta Italia nuk kishte asnjë dilemë se Shkodra është shqiptare. Ndaj *“ne propozojmë shprehej ambasadori italian në Londër Imperiali se çështja e Shkodrës duhej të shtyhej derisa të bëhet e qartë zgjidhja e çështjeve të tjera.”*²³

Në ditët në vijim zgjidhja nuk po dukej në horizont. Shpresa e fundit për zgjidhje, nga të gjitha analizat mund të vinte vetëm nga Londra dhe Berlini. Vetëm këto dy fuqi nëse do ta relativizonin mbështetjen e tyre të pakusht ndaj aleatëve të tyre, Ruisë përkatësisht A-H do të mund t'i lëvizte ato nga pozicionet e ngurta. E vërteta është se edhe Britania edhe Gjermania nuk ishin të interesuara që situata të zgjaste pafundësisht, sepse ajo mund të prodhonte zgjatje të konfliktit dhe mundësi reale të përfshirjes në luftë edhe të Austro-Hungarisë e rrjedhimisht edhe të Ruisë për të ndihmuar palët eksponente.

Iniciativa për të lëvizur në këtë drejtim erdhi nga Grey. Ai i propozoi Berlinit që të ushtronte presion ndaj Vjenës, që ajo të bënte edhe ndonjë lëshim tjetër përveç Prizrenit dhe Pejës, nëse dëshironte që çështja e Shkodrës të merrte rrugën e zgjidhjes.²⁴

Një dritë në fund të tunelit filloi të dukej kur Rusia dha sinjale që mund të kërkonte një kompensim të ri për të lëvizur nga pozicioni i saj i ngurtë për Shkodën. Në mbledhjen e 6 shkurtit ambasadorët, sidomos kryesuesi i Konferencës, E. Grey, u përshkua nga një ndjenë e re e shpresës se, pas sinjaleve që vinin nga pala ruse për lëshimin e mundshëm të Shkodrës, zgjidhja e caktimit të kufirit verilindor të Shqipërisë po dukej në horizont. Lihnovski, në takimin që pati me Greyn, pas “lëshimit” rus, ofroi koncesione plotësuese që Vjena ishte e gatshme t'i bënte në ato momente: Ato ishin: Fisi i Kastratit i mbetet Shqipërisë, mirëpo disa fise në veri mund t'i lihen Malit të Zi; Gjakova i mbetet Shqipërisë, por kufiri mund të lakohet për aq sa disa manastire t'i lihen Serbisë; Dibra i mbetet Shqipërisë, por disa territore afër liqenit të Ohrit do të mund t'i jepeshin Serbisë.²⁵

²³ PRO. FO, 371, Turkie, 1757, Telegram i Ser. Eduard Grey tek Ser. R. Rodd, 1 Janar 2013, nr. 1.

²⁴ Ibid; IX, Nr. 520;

²⁵ G. Rizaj, *Çështja...*, 127;

Se propozimet e ofruara nga pala austro-hungareze ishin të pamjaftueshme, ambasadorët u bindën shpejt. Pas 4 ditësh (10 shkurt 1912) pala ruse doli me kundërpropozimet e saj, sipas të cilave Rusia dakordohej për lënien e qytetit të Shkodrës në Shqipëri, me kusht që Malit të Zi t'i jepeshin liqeni i Shkodrës bashkë me bregun e majtë të Bunës dhe Taraboshi,²⁶ ndërsa Serbisë t'i jepej, përveç Pejës e Prizrenit, edhe Gjakova dhe Dibra, madje edhe krahina e Lumës.²⁷ Në këto momente zgjidhja po dukej edhe më tej e pamundur. Tani presioni i nikopirit filloi të drejtohej nga aleatet e A-H për ta bindur atë që të lëshonte Shkodrën. Qeveritë aleate të Berlinit dhe të Romës ushtruan presion ndaj Vjenës që të shpejtonte në gjetjen e një zgjidhjeje sa më parë që të ishte e mundur, sepse Shkodra çdo moment mund të binte në duart e malazezëve. Sidomos kërcënuese ishte vërejtja e 18 shkurtit që Roma i drejtonte Vjenës: “*se Italia nuk do të merrte pjesë në ndonjë ekspeditë ushtarake që do të kishte për qëllim marrjen e Shkodrës nga malazezët*”²⁸. Në mbledhjet që Konferenca mbajti në fund të shkurtit dhe në pjesën e parë të marsit, debatet hynë në një fazë kritike, ku të dy palët dukeshin shumë të vendosura që çështja e Gjakovës të zgjidhej në favor të tyre. Nga ana tjetër edhe çështja e Shkodrës nuk ishte definuar akoma. Situata siç është e njohur agravoj edhe me tepër. Malazezët e pushtuan Shkodrën. Demarshi i fuqive të mëdha për heqje dhe largim të trupave serbo-malazeze nuk dha efekte. Në këto rrethana Fuqitë e Mëdha të shqetësuara vendosën të japin epilog çështjeve të hapura.

Koncesioni i fundit i ofruar nga Vjena e lëvizi mekanizmin vep-ruer të Konferencës drejt një konsensusi përfundimtar lidhur me caktimin e kufirit verior dhe verilindor të Shqipërisë. Në mbledhjen e 22 marsit 1913, pasi u komunikua propozimi i fundit austro-hungarez, Konferenca mori këto vendime:

- Që Shkodra të mbetet në kuadrin e Shqipërisë;
- Që Gjakova të lihet jashtë Shqipërisë;
- Që Fuqitë e Mëdha të marrin hapa konkretë në Beograd dhe në Cetinë, për heqjen e rrethimit të Shkodrës, pushimin e veprimeve luftarake në të gjitha territoret shqiptare dhe evakuimin e plotë të ushtrive të tyre nga këto territore.²⁹

²⁶ Ibid;

²⁷ Ö-UA, V, nr. 5797,5801;

²⁸ Ibid, V, nr.5859;

²⁹ Puto, Çështja..., 229-230;

Si përfundim, duke analizuar përmbajtjen e debateve të gjata lidhur me caktimin e kufirit verior dhe verilindor të Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër është e lehtë të kuptohet se qëndrimet e fuqive më të interesuara për këtë temë, pra të A-H dhe të Ruisë ndikoheshin qartësisht madje mbaheshin peng nga konstelacioni i pozicionimeve të fuqive të tjera në kuadër të dy aleancave respektive tashmë të krijuara. Edhe arritja e zgjidhjes finale, siç shihet ishte fryt i një kompromisi midis dy aleancave vetëm për të evituar përballjen midis tyre.

Arben Cici

SHQIPTARËT, NGA SHKËPUTJA PREJ SOVRANITETIT TË SULLTANIT DREJT COPËTIMIT ETNIKO-TERRITORIAL, BRENDA TREKËNDËSHIT ROMË-LONDËR-VJENË

Abstrakt

Nën tryshinë e pasojave të paparashikuara të Luftës së Parë Ballkanike (LPB), gjashtë Fuqitë e Mëdha, u mbledhën në St James's Palace, në Londër më 17 dhjetor 1912, vetëm pak ditë pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912.

Përballë faktit të dekompozimit të pakontrolluar të Perandorisë Osmane dhe humbjes së territorit të saj ballkanik, ambasadorët e Konferencës së Londrës lëvizën në qëndrimet e tyre sa i takon fatit të shqiptarëve, nga qasja e përbashkët e njohjes së një Shqipërie autonome nën sovranitetin e sulltanit drejt vendimit përfundimtar të një Shqipërie të pavarur, me neutralitet të garantuar nga gjashtë Fuqitë e Mëdha. Ky vendim që përbëhet prej njëmbëdhjetë nenesh, u mor më 29 Korrik 1913, pas pesëdhjetë e katër takimesh që u shoqëruan me debate dhe përplasje të forta të interesave të drejtpërdrejta dhe të aleatëve të tyre ballkanikë.

Austro-Hungaria, Italia dhe Britania, mbas saj Rusia, nuk morën në konsideratë as kriterin historik, as kriterin gjuhësor, as kriterin etnik dhe etniko-kulturor, por vendosën të copëtonin arbitrarisht dhe padrejtësisht trojet shqiptare dhe shqiptarët, duke lënë jashtë Shqipërisë më shumë se gjysmën e territorit të banuar prej shqiptarëve, madje territorin më urban, më të begatë dhe me më shumë infrastrukturë e zhvillim.

Fjalët çelës: Pavarësia e Shqipërisë, padrejtësi historike, kriter etnik, kriter gjuhësor, Lufta e Parë Ballkanike, Austro-Hungaria, Italia, Britania e Madhe.

Konferenca e Ambasadorëve ose Konferenca e Paqes, hapi siparin në Londër më 17 dhjetor të vitit 1912.

Vetëm dy muaj pas fillimit të Luftës së Parë Ballkanike (8 tetor 1912) dhe pak ditë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë (28 Nëntor 1912) gjashtë Fuqitë e Mëdha (Britania e Madhe, Austro-Hungaria, Gjermania, Italia, Franca dhe Rusia) u mbledhën në St James's Palace, në Londër, për të vendosur për të ardhmen politike dhe ndarjen territoriale të Perandorisë Osmane dhe për t'u kujdesur veçanërisht për ekuilibrat e brishtë të forcës në kontinentin evropian.

Fillimi i Luftës së Parë Ballkanike duket se lëkund status quo-në e interesave të Fuqive të Mëdha në Ballkan dhe njëkohësisht krijoi frikën, deri në bindje, se fillimi i një lufte evropiane ishte shumë afër.

Ndaj do të duhej të gjendej një zgjidhje e pranueshme nga të gjithë aktorët e mëdhenj, në mënyrë që zjarri i luftës të mos cenonte as interesat e tyre në Ballkan e as të prekte drejtpërdrejt kryeqytetet dhe kancelaritë e tyre.

Përballë faktit të dekompozimit të pakontrolluar të Perandorisë Osmane dhe humbjes së territorit të saj ballkanik, e lindjes së shteteve të reja autonome, por sidomos lakmisë, gjithnjë në rritje, për territore, të fuqive ballkanike, fqinje me Perandorinë Osmane, ambasadorët e Konferencës së Londrës diskutuan gjatë dhe vendosën edhe për fatet e Shqipërisë së re dhe të shqiptarëve në të ardhmen e tyre post-osmane.

Përfaqësuesit e gjashtë Fuqive të Mëdha lëvizën në qëndrimet e tyre, sa i takon fatit të shqiptarëve, nga qasja e përbashkët e njohjes së një Shqipërie autonome, nën sovranitetin e sulltanit, drejt vendimit përfundimtar të një Shqipërie të pavarur, me neutralitet të garantuar nga gjashtë Fuqitë e Mëdha.

Vendimi përfundimtar që u mor mbi statusin e Shqipërisë, më 29 Korrik 1913, përbëhet prej njëmbëdhjetë nenesh dhe u deshën pesëdhjetë e katër takime, të shoqëruara me diskutime të gjata, debate të zjarrra dhe përplasje të forta, herë të hapura dhe herë të fshehta, të interesave të drejtpërdrejta të vendeve pjesëmarrëse dhe të aleatëve të tyre ballkanikë.

Fuqitë pjesëmarrëse në Konferencë ishin të ndara qartë në dy blloqe: Austro-Hungaria, Italia dhe Gjermania ose Aleancës së Treshes do të përballëshin me Antantën, përfaqësuesit e Ruisë, Francës dhe Britaninë e Madhe, e cila u përpoq të dukej asnjënjë, për shkak edhe të faktit të fuqisë organizatore të Konferencës dhe të karakterit të interesave në Ballkan në përgjithësi, si dhe qëndrimit ndaj çështjes shqiptare në veçanti,

Nisur nga dinamika e ngjarjeve, Austro-Hungaria, e cila ishte fuqia më e afërt gjeografikisht me hapësirën ku zhvillohej Lufta Ballkanike, dhe jo vetëm, mbetej fuqia më e interesuar për organizimin e kësaj Konference. Statu-quo-ja e fuqisë strategjike dhe interesave të saj ekonomikë cenoheshin drejtpërdrejt nga zgjerimi i pakontrolluar i shteteve të Aleancës Ballkanike. Prova e zjarrit dhe e forcës mbetej çështja shqiptare ose çështja e shtetit shqiptar. Në parim të gjitha fuqitë ishin

për lindjen e një Shqipërie, por ndryshimet ishin thellësisht të dallueshme, sa i takon mënyrës, formës politiko-administrative, varësisë apo paanësisë, parimeve të ndërtimit të këtij shteti të ri dhe të territorit e sovranitetit politik: parimeve historike, etnike, gjuhësore, ekonomike, fetare, ato të organizimit administrativ brenda Perandorisë Osmane, etj.

Nga ana tjetër zhvillimet në terren mes palëve ndërluftuese e bënin edhe më të ashpër përplasjen dhe më të paparashikueshëm përfundimin me sukses të Konferencës e vendimin e saj, dhe për pasojë edhe fatin dhe të ardhmen e Evropës.

Fatkeqësisht vendimi përfundimtar për krijimin e Shqipërisë dhe përcaktimin e kufijve të saj nuk mori në konsideratë asnjë nga parimet e drejta dhe të qëndrueshme, si dhe kriteret realiste apo përvojën historike për ekzistencën e një shteti të sapoformuar. Çështja shqiptare u kthye në një fushëbetejë ku blloqet dhe më pas shtetet e aleancat e tyre derdhën energjitë, fuqitë, peshën, aftësitë dhe gjithë angazhimin për të arritur ambiciet dhe qëllimet e tyre.

Konferenca e Ambasadorëve në Londër, e cila nisi nxituar dhe pa një platformë të përgatitur paraprakisht pati mbi tryezë dy qëndrime të kristalizuara dhe të kërkuara me forcë nga diplomacia austro-hungareze dhe interesat e Aleancës së Treshes:

1. Njohja e ekzistencës së Shqipërisë, pavarësisht statusit politik dhe
2. Vendet ballkanike fituese të luftës me Perandorinë Osmane të shpërbleheshin me territore, jo sipas kërkesave dhe oreksit të tyre, të cilat shkonin kundër pozitave dhe interesave të fuqive të mëdha, veçanërisht të Aleancës së Treshes.

Vjena dhe Roma dhe më pak Berlini nuk dëshironin që shtrirja e shteteve sllave të Ballkanit të cenonte interesat e tyre. Ata ishin të qartë se vetëm në këtë mënyrë do të mund të pengonin forcimin e ndikimit rus në Ballkan dhe më pas në Adriatik. Krijimi i shteti shqiptar ishte mburoja kryesore ndaj oreksit gjithnjë në rritje të vendeve sllave dhe Rusisë, në Ballkan dhe drejt Adriatikut. Në parim, një zgjerim të ndikimit rus në Ballkan nuk e kishte për zemër as Londra e as Parisi të cilët, me shumë diplomaci, kërkonin që edhe Austro-Hungaria të mos ishte përfituesja e madhe e shpërbërjes së Perandorisë Osmane.

Vjena ishte e detyruar të ndante Adriatikon vetëm me Romën dhe jo me një shtet tjetër ballkanik, i cili duke kontrolluar ngushticën e Otrantos do të vështirësonte kalimin e anijeve ushtarake dhe tregtare. Nëse Serbia do të kishte dalje direkte në Adriatik dhe Mali i Zi do të

mbante pushtimet në tokat shqiptare atëherë ndërtimi i një baze ushtarake detare ruse do të ishte pothuajse i paevitueshëm.¹

Ndaj edhe Britania e Madhe, e cila ishte shumë e interesuar për suksesin e Konferencës dhe baraspeshën e interesave të Fuqive të Mëdha, mbështeti krijimin e një Shqipërie, që u përshtatej interesave të saj në këtë pjesë të Evropës me gjithë zgjerimin dhe forcimin e pakontrolluar të fuqive të tjera evropiane dhe ballkanike.

Porë nga ky këndvështrim, aksi Londër-Vjenë-Romë përbënte një garanci për të ardhmen e shqiptarëve dhe vendimet që Konferenca do të merrte si për formën institucionale dhe organizative të Shqipërisë së ardhme ashtu edhe për përcaktimin e drejtë të kufijve të saj shtetërorë. Fatkeqësisht ky aks, ndonëse kishte edhe Berlinin mbështetës dhe më afër me qëndrime, u thye dhe u ndryshua mjaftueshmërisht përballë fuqive të tjera, kryesisht Moskës dhe Parisit, të cilat ia arritën qëllimit të siguronin një shtrirje të hegjemonisë serbe, e për pasojë ruse, afër Adriatikut, duke përfshirë padrejtësisht brenda kufijve të Malit të Zi, të Serbisë dhe Greqisë² tokat shqiptare, historikisht, natyralisht, etnikisht, gjuhësisht të banuara prej shqiptarëve.

Por, në fillim të këtij procesi, pavarësimi i plotë politik nga Perandoria Osmane nuk u pranua si opsioni më i mirë. Trashëgimia e gjatë osmane dhe pranimi në masë i fesë islame, sipas Ruisë, “ishte edhe në interes të vendeve evropiane, por edhe të vetë shqiptarëve që të ruanin lidhjet me Perandorinë Osmane, e cila kishte ndikuar dhe ndryshuar edhe mentalitetin e tyre si popull”.³ Nisur nga situata në terren dhe

¹ Nicola Guy, *Lindja e Shqipërisë. Nacionalizmi Etik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*, Tiranë, Pegi 2012, f. 57.

² Krijimi i Shqipërisë, deklaronte Pašići, përbën një rrezik të madh, jo vetëm për serbët, por edhe për krejt Lidhjen Ballkanike", dhe se ajo "do t'i nxjerrë shumë ngatërresa Serbisë dhe Europës". Ministère des Affaires Etrangères, Archives Diplomatiques, Paris, Politique Etrangère (më tej: PE), Turquie, Guerres Balkaniques, vol. 251 (XXIII), f. 24. Raport i ambasadës franceze nga Londra dërguar në Paris, 24 dhjetor 1912.

³ Ambasadori i Ruisë, A. Benckendorff, u pozicionua kundër synimit, që Sulltanit t'i merrej pushteti suprem në Shqipëri dhe mendonte se kjo qenkej e padrejtë, ngaqë pjesa dërrmuese e popullsisë qenkan muhamedanë. Shkaku i vërtetë i refuzimit të pavarësisë së plotë të Shqipërisë nga ana e Ruisë ishte që një Shqipëri autonome, pasi të ishin larguar turqit nga territoret e fundit të okupuara në Ballkan, do të ishte ndarë përfundimisht ndërmjet shteteve sllave të Ballkanit. Rusia besonte që përmes kësaj të realizonte pretendimet e saja të politikës së Fuqive të Mëdha. Për këtë Arben Puto: Çështja shqiptare në kohën e luftërave ballkanike dhe gjatë Luftës së Parë Botërore, f. 20, në: Çështja shqiptare në aktet

pashmangshmëria e largimit të Perandorisë Osmane nga Ballkani, një Shqipëri e mbetur nën autoritetin e Sulltanit ishte një pre e gatshme për t'u ndarë sërish, më vonë, mes shteteve të Aleancës Ballkanike.

Duket se ky qëndrim i shkonte për shtat strategjisë serbe për asimilimin e plotë dhe me të gjitha mënyrat, të kombit shqiptar.⁴

Ky qëndrim gjeti mbështetjen edhe të përfaqësuesit francez i cili argumentonte se meqë vetë shqiptarët kishin luajtur një rol të rëndësishëm dhe për një kohë të gjatë në organizimin shtetëror dhe administrativ të traditës osmane në Shqipëri, në të mirë të tyre do të duhet të mbetej e të vazhdohej kjo traditë.

Ndaj në seancën e saj të parë, Konferenca e Ambasadorëve, më 17 dhjetor 1912, mori dy vendime:

1. I pari që Shqipëria të ishte autonome nën sovranitetin ose suzerenitetin e Sulltanit dhe nën garancinë e kontrollin ekskluziv të gjash-të Fuqive të Mëdha⁵, duke ngarkuar Austro-Hungarinë dhe Italinë t'u propozonin Fuqive të Mëdha projektin për organizimin e shtetit autonom shqiptar.

Ky formulim nuk e njëjtte statusin e Shqipërisë së pavarur, të shpallur nga kuvendi i Vlorës dhe cenonte aspiratat e shqiptarëve për një shtet plotësisht të pavarur dhe sovran.

Nga ana tjetër, në planin dhe vizionin afatshkurtër njohja e ekzistencës së saj dhe mbijetesa e Shqipërisë ishte imperative, pa marrë parasysh si do të bëhej kjo. Ky hap do të ishte preludi i zgjidhjes së largimit të ushtrive pushtuese nga pjesa më e madhe e territorit dhe një hap i rëndësishëm drejt normalizimit shtetëror, politik dhe administrativ të saj.

ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, v. II, Tiranë, 1987; Thoma Murzaku: Politika Ballkanike e Rusisë dhe çështja shqiptare, Tiranë, 1999.

⁴ Sipas Michael W. Weithmann: Balkan-Chronik: 2000 Jahre zëischen Orient und Okzident [Kronika e Ballkanit: 2000 vjet mes Lindjes dhe Perëndimit], Grac etj. 1995, në kapitullin III, Die Balkankriege 1912-1913 / Albanien, der-vorläufig-letzte Balkanstaat, f. 321-323 Ai përshkruan politikën e ndjekur hapur dhe deklaruar publikisht nga kryeministri serb Nikola Pašić në kohën e luftërave ballkanike më 1913: Pašić iu përgjigj pyetjes se çfarë do të duhej të ndodhte me miliona shqiptarë: "Do t'i serbizojmë dhe në qoftë se nuk pranojnë që të serbizohen, ne do t'i dëbojmë dhe, në qoftë se nuk pranojnë që të dëbohen, ne do t'i vrasim."

⁵ Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (Përmbledhje dokumentash)*, vëll.II, Tiranë, 8 Nëntori, 1987, dok.nr.1, f.187-190. Vendimi mbi autonominë e Shqipërisë, Londër, 17 dhjetor 1912.

Në dobi të Shqipërisë dhe të mundësisë së kapërcimit të krizës dhe anarkisë politike në të cilën ajo ndodhej ishte theksimi i garancive dhe i kontrollit ekskluziv të gjashtë Fuqive të Mëdha ndaj saj. Kjo ishte shumë e rëndësishme për Qeverinë e Vlorës, sepse vetëm nëpërmjet mbështetjes së Fuqive të Mëdha, ajo mund të rifitonte shtrirjen territoriale të qeverisë dhe qeverisjes së vendit. Vetëm angazhimi i drejtpërdrejtë i Fuqive të Mëdha do të mundësonte largimin e ushtrive pushuese jashtë vijave të kufirit që Konferenca do të caktonte më vonë si kufijtë e Shqipërisë, duke lënë padrejtësisht jashtë pjesë të rëndësishme të trungut natyral kombëtar, etnik, historik, gjuhësor, ekonomik, etno-kulturor shqiptar.

2. I dyti ishte vendimi në parim që Shqipëria autonome të kufizohej në veri me Malin e Zi e në jug me Greqinë.

Nëpërmjet këtij vendimi, (duke caktuar fqinjin verior Malin e Zi), Konferenca i preu Serbisë rrugën për të dalë në Adriatik dhe furinë për të aneksuar territore të veriut të Shqipërisë.

Roli i Austro-Hungarisë ishte vendimtar, sepse kështu përjash-tohej mundësia e daljes të Serbisë në det, që mund të ndodhte vetëm nëpërmjet aneksimit të pjesës veriore të Shqipërisë. Ky vendim nënkuptonte kështu largimin e ushtrisë së saj pushtuese nga Durrësi e Shëngjini⁶ dhe pretendimet e saj mbi faktin e kryer.

Si kompensim, Serbisë iu njoh e drejta ekonomike të një daljeje tregtare në det nëpërmjet një skele shqiptare të lirë dhe asnjëse. Ajo do të arrihej me anën e një hekurudhe ndërkombëtare, nën kontrollin europian dhe nën mbikëqyrjen e një force të posaçme ndërkombëtare, me liri tranziti për gjithë mallrat, përfshirë edhe municionet e luftës.

Italia ishte gjithashtu fuqia e dytë, drejtpërdrejt e interesuar ndaj çështjes shqiptare. Në vijimësi, falë përpjekjeve të saj për t'u shtrirë drejt Ballkanit, ajo ishte partnerja e dytë tregtare në trojet shqiptare,

⁶ Rëndësia e Shkodrës dhe arsytet se pse ajo duhej të përfshihej brenda kufijve të shtetit shqiptar, është shprehur me tre pika kryesore të hartuara nga vetë Ministri i Jashtëm, Konti Bertold: 1-Shkodra është qendra e protektoratit tonë katolik në Veri të Shqipërisë dhe si e tillë është e rëndësishme për të mbetur në Shqipëri. 2-Në opinionin e ekspertëve, një Shqipëri mbijetuese është e pakonceptueshme pa Shkodrën dhe rrethinat e saj. 3- Nëse Shkodra nuk do të përfshihet në Shqipëri, fiset shqiptare që e kanë qendrën e tyre rreth Shkodrës do të humbasin lidhjet e tyre me Shqipërinë. Këto fise do të jenë, kundër dëshirës së tyre, të asimiluara në Malin e Zi, që është i kundërt nga pikëpamja etnike dhe fetare nga Shqipëria. Hall Richard Cooper (1974), *Austro-Hungary and the northern Albanian frontier 1912-1913*, Ohio: Ohio State University, f. 38-39

madje me investime falë misioneve katolike në fushën e arsimit. Ajo nuk do të pranonte kurrsesi që një fuqi tjetër, përfshirë Austro-Hungarinë, të zotëronte plotësisht bregdetin shqiptar dhe më pas Ballkanin osman, siç quhej prej tyre. Në mendësinë e diplomacisë së Romës trashëguar nën qasjen “quinta sponda”⁷, domosdoshmërisht Shqipëria mbetej përparësi komunikuese dhe lidhëse me “detet levantine” dhe një rifitim i ligjshëm i hegjemonisë që Venediku dikur kishte gëzuar në rajon.⁸ Italia do të mbetej një përkrahëse dhe mbështetëse e jashtëzakonshme për ndërtimin e hekurudhave që do të lidhnin bregdetin shqiptar me brendësinë e Ballkanit dhe detin Egje. Kjo mendësi nuk ndryshoi,⁹ madje pas Konferencës së Londrës dhe ngjarjeve në terren Italia doli jashtë skemës së ndarjes së përcaktuar nga kjo Konferencë dhe nga të tjerat që pasuan, me gatishmërinë për të copëtuar Shqipërinë midis fqinjëve të saj.¹⁰

Megjithatë, duke parë balancën e forcave brenda Konferencës dhe njëkohësisht zhvillimet e rrezikshme të shtrirjes së ndikimit rus drejt Adriatikut, diplomacia italiane do të preferonte një aleancë dhe një marrëveshje me Vjenën, për këtë çështje që sa vinte bëhej edhe më e mprehtë dhe më e ndërlikuar, si brenda ashtu edhe jashtë Konferencës.

Ky bashkëpunim lehtësohej nga marrëveshja e arritur midis tyre për Shqipërinë në vitin 1901, e cila ishte ripohuar dhe freskuar më tej në vitet 1909 dhe 1912-11, duke parandaluar mundësinë e krijimit të një kufiri bregdetar në zotërim të fuqive të tjera ballkanike.

Pra, sipas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër nga 18 dhjetorit 1912 Shqipëria do të kishte autonomi nën sovranitetin ose suzeranitetin e Sulltanit dhe e mbikëqyrur nga ndërkombëtarët, me shpresën se kishte kapërcyer rrezikun e zhdukjes si shtet, për të sfiduar më tej çështjen e përcaktimit të kufijve të saj administrativë.

Diplomacia austro-hungareze dhe italiane, të ngarkuar për projektin e organizimit të shtetit autonom shqiptar, i prezantuan Konferencës së Ambasadorëve, më 8 maj 1913, projektin e një shteti shqiptar plotësisht të pavarur. Ky projekt ndryshonte kryekëput nga vendimi i

⁷ Pio Biondoliti, *Albania, Quinta Sponda d'Italia*, C.E.T.I.M. Milano –Milanino, 1939.

⁸ Eugenio Barbarich, *Albania* (Monografia antropogeografica), ROMA, Enrico Voghera, Editore, 1905, f. 177-194).

⁹ P.Pastorelli, *L'Albania nella politica estera italiana 1914-1920*, Napoli, 1970, f. 94-95.

¹⁰ Arben Cici, *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920-1934*, UET Press, Tiranë, 2013.

¹¹ Beqir Meta, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2023, f. 150.

Konferencës të datës 18 dhjetor dhe shoqërohej me argumente të qëndrueshme që buronin sa nga zhvillimet në terren ashtu edhe konjunkturën brenda Konferencës, përfshirë raportet brenda Aleancës së Treshes. Vazhdimi i Luftërave Ballkanike kishte tkurrur pjesën evropiane të Perandorinë Osmane duke e larguar kufirin e saj shumë larg kufijve të mundshëm të Shqipërisë. Forcat greke kishin marrë Janinën dhe ato malazeze Shkodrën. Për pasojë sovraniteti osman mbi Shqipërinë do të ishte vetëm një akt në letër¹², aspak i dobishëm, edhe për vetë Perandorinë Osmane, e cila kishte qenë mbështetëse e vendimit të 17 dhjetorit 1912. Nuk do të kishte asnjë mundësi praktike të respektohej e drejta ndërkombëtare në dobi të neutralitetit brenda varësisë së Perandorisë Osmane. Do të ishte e pamundur për popullsinë myslimane shqiptare të qëndronte neutrale, në rastin e një konflikti të armatosur të pushtetit qendror osman dhe natyrisht do të ndikonte dhe raportet e saj me popullsinë e krishterë shqiptare, e cila do të ishte më e prirur, në këto rrethana, t'i qëndronte dhe të respektohej neutralitetin e vendosur nga Fuqitë e Mëdha.¹³ Për më tepër, edhe elementët patriotë shqiptarë, sidomos të krishterët, ishin kundër ruajtjes së sovranitetit osman, sado relativ të dukej ai, edhe nga frika se bashkatdhetarët e tyre myslimanë do të përfitonin, ashtu si edhe më parë, pozita më të privilegjuara dhe përfitime të padrejta prej pushtetit qendror osman.

Ndaj Vjena dhe Roma e vlerësuan se sundimi osman në Shqipëri nuk mund të mbahej më dhe nuk ishte më në interesin e tyre që të mbështesnin vazhdimësinë e sovranitetit të sulltanit mbi Shqipërinë.

Pavarësia e Shqipërisë, megjithatë, mbetej e kushtëzuar nga shumë kufizime e garanci që mbronin interesat e Fuqive të Mëdha duke u vënë nën kontrollin shumëvjeçar të tyre. Nën presionin e Britanisë së Madhe dhe të Francës, edhe Rusia e pranoi këtë projekt dhe më 20 maj 1913, Konferenca arriti në parim marrëveshjen për pavarësinë e Shqipërisë.

Traktati i Paqes i 30 majit 1913 ndërmjet aleatëve ballkanikë dhe Perandorisë Osmane, i imponuar nga Fuqitë e Mëdha, veçanërisht falë presionit të qeverisë britanike, detyroi edhe Perandorinë Osmane të hiqte zyrtarisht dorë nga të drejtat e saj në Shqipëri dhe t'u njihte Fuqive të Mëdha të drejtën për të zgjidhur çështjen e kufijve të Shqipërisë dhe të çdo çështjeje tjetër që kishte të bënte me të. Porta e Lartë, deri në këtë

¹² Haus, Hof und Staatsarchiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien (më tej: HHSStA.PA.A.) në AIH, Vj. 24-13 1315. Raport mbi çështjen e administrimit të ardhshëm të Shqipërisë.

¹³ Po aty, Vj.24-13-1320. Telegram i Berchtold-it për Mensdorff në Londër, Vjenë, 7 maj 1913.

kohë, e kishte kundërshtuar shkëputjen përfundimtare të Shqipërisë, duke propozuar varësinë e saj nga Perandoria Osmane, me në krye një princ nga familja perandorake.

Ky vendim i dytë rreth statusit të Shqipërisë, shënonte një hap përpara, sepse ai u pranua si nga Perandoria Osmane ashtu edhe nga aleatët ballkanikë që vazhdonin të kishin pretendime ndaj Shqipërisë si kundrejt statusit ashtu edhe kufijve të saj.

Edhe projekti i ri, i mesit të korrikut 1913, i Austro-Hungarisë dhe Italisë për pavarësinë e plotë të Shqipërisë i cili parashikonte edhe mandatin e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK) u kundërshtua me qëllim që t'i jepnin fuqi sa më maksimale mandatit të tij në Shqipëri dhe të ngushtonin, sa më shumë, kompetencat e administratës së re shqiptare. Vetëm falë një kompromisi mbi këtë çështje të rëndësishme dhe reciprokisht lëshimeve mes dy blloqeve, Konferenca e Ambasadorëve do të merrte vendimin final për Shqipërinë, më 29 korrik 1913, lidhur me statusin e Shqipërisë, thelbi i të cilit qëndronte në dy paragrafët e parë:

Shqipëria formohej si principatë autonome, sovrane dhe e trashëgueshme, nën garancinë e gjashtë Fuqive të Mëdha; çdo lidhje suzereniteti midis Perandorisë Osmane dhe Shqipërisë përjashtohej.

Shqipëria shpallej vend asnjane, kontrolli i administratës civile dhe financiare i besohej një Komisioni Ndërkombëtar të Kontrollit, i përbërë nga delegatët e gjashtë Fuqive të Mëdha dhe nga një delegat i Shqipërisë. Ky Komision do të kishte një mandat 10-vjeçar dhe mund të përsëritej në rast nevoje.

Sipas pikës shtatë, princi do të emërohej brenda një afati prej gjashtë muajsh. Funkionimi i autoriteteve vendase ekzistuese dhe i xhandarmërisë, që do të organizohej nga oficerë suedezë, do të ishte nën kontrollin e Komisionit Ndërkombëtar, derisa të emërohej princi dhe të formohej një qeveri kombëtare definitive¹⁴

Ky vendim përbënte aktin themelor ndërkombëtar lidhur me njohjen dhe sanksionimin e pavarësisë së Shqipërisë dhe organizimin e shtetit të pavarur shqiptar.

Ky vendimi, megjithëse nuk pasqyronte aspiratat e plota të shqiptarëve u përgjigjej rrethanave të krijimit dhe funksionimit të shtetit të ri

¹⁴ Robert Elsie, *The London Conference and the Albanian Question (1912-1914)*, 2012, f. 13.

shqiptar. Procesi i arritjes së këtij vendimi dhe zhvillimet brenda Konferencës provuan se Fuqitë e Mëdha, në fund të fundit, u përpoqën të mbronin maksimalisht dhe shumë ngushtë interesat e tyre në Shqipëri dhe në Ballkan. Ecuria e punës dhe aktivitetit të mëvonshëm të përfaqësuesve të tyre në KNK, do të cenonte rëndë, si interesat e shtetit të ri shqiptar, ashtu edhe vetë procesin e ndërtimit dhe konsolidimit të tij. Mandati i KNK-së i dha de facto atij një pushtet sovran dhe të plotë me më tepër kompetenca sesa komisionet e tjera ndërkombëtare që ishin krijuar për të administruar territore të ndryshme.

Edhe seancat e pas datës 29 Korrik 1913, kur kjo Konferencë vendosi ndryshimin e organizimit të shtetit shqiptar, duke e shpallur Shqipërinë principatë autonome, sovrane dhe të trashëgueshme, nën garancinë e gjashtë Fuqive të Mëdha pa asnjë lidhje suzereniteti me Perandorinë Osmane, do të ishin po aq të nxehta dhe konfliktuale sa edhe ngjarjet në terrenin e Luftës së Parë Ballkanike e mandej të Dytës, e cila nuk vonoi aspak të ndodhte.¹⁵

Përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha, Sir Edward Grey (Britania e Madhe), Konti Mensdorff (Austro-Hungari), Konti Benkendorff (Rusi), Prici Lichnowsky (Gjermani), Markezi Imperiali (Itali) dhe z. Paul Cambon e kthyen tryezën e Konferencës së Londrës në një kabinet gjeografie ku interesat dhe ambiciet shpaloseshin, përplaseshin, ndërthureshin e mbivendoseshin, pa asnjë parim ku copëza hartash dhe shënimesh, apo telegramesh nga kryeqytetet e tyre e lajme nga ngjarje e ndodhi të terrenit të luftës, tensiononin e helmonin ajrin e Konferencës dhe në të njëjtën kohë shtonin zellin dhe oreksin e tyre për të gëlltitur copëza territori për interesat e tyre ose për aleatët që qëndronin mbas tyre, nëpër korridore ose në terren.

Edhe Qeveria e Vlorës i paraqiti Konferencës së Ambasadorëve në Londër një Memorandum ku shtroheshin kërkesat e ligjshme të Shqipërisë e shqiptarëve, veçanërisht lidhur me kufijtë e ardhshëm të saj. Kufijtë e përcaktuar dhe të kërkuar nga referendumi niseshin nga kufijtë

¹⁵ Për shkak të mosdakordësisë mes Serbisë dhe Bullgarisë rreth territoreve të zaptuara në Maqedoni, Bullgaria e sulmoi Serbinë në qershor 1913, duke filluar kështu Luftën e Dytë Ballkanike (29 qershor – 18 gusht 1913). Ndaj, zhvillimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër do të bëheshin edhe më të komplikuar. Në këtë konflikt Greqia u vendos në anën e Serbisë dhe pak pas kësaj aleatët arritën ta zbrapsin armatën bullgare nga Maqedonia. Pas kësaj mes Malit të Zi dhe Serbisë shpërtheu një konflikt i ri rreth territoreve të zaptuara, këtë herë në Kosovë, që u ndal me një marrëveshje mes Serbisë dhe Malit të Zi nga nëntori 1913. N. Malcolm: Kosovo a short History, Londër 1998, f. 257.

e atëhershëm të Malit të Zi dhe përfshinin, bashkë me rrethet përkatëse, Pejën, Mitrovicën, Prishtinën, Preshevën, Kumanovën, Shkupin, Tetovën, Gostivarin, Dibërën, Manastirin, Kosturin, Mecovën dhe Janinën. Në jug do të mbaheshin kufijtë ekzistues me Turqinë deri në Prevezë. Nisur nga vendimi i datës 17 dhjetor, dhe jo vetëm, Memorandumi përfundonte duke hedhur poshtë tezën e aleatëve ballkanikë se Shqipëria ishte e lidhur me Turqinë dhe, për pasojë, trojet shqiptare do të shërbenin si “kompensim territorial” për aleatët që fituan në luftë. Theksohej edhe fakti se kryengritjet e vazhdueshme shqiptare kundër sundimit turk ishin një kontribut i rëndësishëm në çështjen e përbashkët të popujve të Ballkanit. Kombi shqiptar nuk mund të vuante fatin e sundimit turk në Ballkan, mbyllej Memorandumi.¹⁶

Pavarësisht se në fillim të Konferencës u deklarua formalisht se në zgjidhjen e problemeve të Ballkanit dhe të Shqipërisë do të ndiqej parimi etnik dhe historiko-gjuhësor, si parimi që do të krijonte një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme, në praktikë, me vendimin e saj të 29 Korrikut të vitit 1913, Konferenca e Londrës qartësisht nuk kishte marrë në konsideratë asnjë nga parimet për të krijuar një rajon të ekuilibruar, të paqtë dhe të qetë, madje nëpërkëmbi hapur të vërtetat dhe parimet etnike, historike, gjuhësore dhe aspiratat e kërkesat e vazhdueshme të popullit shqiptar për të jetuar i bashkuar dhe në paqe.¹⁷

¹⁶ Dokumenti më i rëndësishëm i diplomacisë së brishtë shqiptare ka qenë “Memorandumi” i datës 3 janar 1913. Asokohe, pavarësisht se Shqipëria nuk kishte ende shërbim diplomatik të rregullt, Ismail Qemali caktoi si ambasador “shëtitës” Rasip (Rasip) Dinon për në Austri, Itali dhe deri në Londër. Për në Londër, me porosi të Ismail Qemalit, ai mori me vete, nga Italia dhe Franca ku ata jetonin, Mehmed Konicën, Filip Nogën dhe Sotir Kolean. Kjo mërgatë përpiloi dhe i dorëzoi sir Edward Grey-t, Kryetarit të Konferencës së Ambasadorëve, memorandumun e Qeverisë Shqiptare, dokumentin e parë diplomatik. Ky memorandum i kushtojë kryesisht çështjes së caktimit të kufijve, duke paraqitur dhe duke argumentuar pikëpamjet dhe qëndrimin e shtetit shqiptar. Më 25 janar 1913, diplomatët shqiptarë i dorëzuan Konferencës një memorandum të dytë. Në këtë memorandum të dytë kërkohej, zbatim i kriterit etnik, ku cilësohej më dukshëm si një kusht për sigurimin e paqes dhe të stabilitetit në Ballkan. Në formulimin e kërkesave të dy memorandumëve, rëndësi të veçantë ka pasur “tradita” e 4 vilajeteve shqiptare, që kishte qenë motiv i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

¹⁷ Më 26 mars 1913 të deleguarit e qeverisë së përkohshme shqiptare shkuan në Ministrinë e Jashtme Britanike, për t’i shprehur pikëpamjet e tyre rreth përcaktimit të kufijve. Ata ankoheshin se çështja shqiptare ishte rregulluar pa marrjen në konsideratë të shqiptarëve dhe që kufijtë ishin përcaktuar vetëm për të shmanhur një thyerje mes Austro-Hungarisë dhe Rusisë. Të deleguarit e përfunduan me atë që nuk dëshironin drejtësi të plotë apo favorizime, por luteshin vetëm për “pak drejtësi”, për të shmangur katastrofa të mëtejme për Shqipërinë. Krah. R. R. Kritt:

Ata e komprometuan parimin etnik duke ia nënshtruar atë tërësisht ambicieve dhe interesave të tyre politike. E respektuan këtë parim vetëm në ato raste kur ai përputhej dhe u vlente interesave të tyre strategjike. Edhe Austro-Hungaria që fillimisht kërkoi respektin e këtij parimi në procesin e caktimit të kufijve të shtetit të ri shqiptar, e kërkoi këtë sipas rrethanave dhe situatave, e natyrisht të kompromiseve përgjatë zhvillimit të Konferencës.¹⁸ Pavarësisht nga kjo, Vjena mbeti, deri në fund, avokati më i interesuar dhe më këmbëngulës në favor dhe shumë më afër interesave të shqiptarëve dhe Shqipërisë.

Ambasadori, Mensdorff, paraqiti pëlqimin e qeverisë së tij se "ato pjesë që janë të banuara vetëm nga shqiptarët duhet t'i përkasin Shqipërisë" mirëpo, siç njoftonte ai Vjenën, "mendimi i gjithë kolegëve është se nuk mund të shkojnë përpara me konsiderata etnografike".¹⁹

Vetë përfaqësuesi i Britanisë së Madhe Sir Edward Grey dhe drejuesi i Konferencës së Londrës ka pranuar se aspektet etnike nuk luajtën asnjë rol gjatë përcaktimit të kufijve.²⁰

Vjena do të dëshironte që shteti i ri shqiptar të ishte element i ekuilibrit të ri në Ballkan, ndaj duket se, duke parë edhe raportin e forcave brenda dhe jashtë Konferencës, edhe ajo nuk ishte për një zbatim absolut e pikë për pikë të parimit etnik. Përvoja e formimit të monarkisë së dyfishtë brenda së cilës gëlonte një konglomerat popujsh e kombesh, të cilëve u mohohesh parimi i kombësisë e shtynte atë të mos ishte luftëtare e paepur e këtij parimi. Madje sipas profesorit Beqir Meta, qeveria në Vjenë duhet të merrte parasysh si ndjenjat austriake, ashtu edhe hungareze: të parët ishin në favor të pajtimit ndërsa të dytët për një zgjidhje me forcë të problemit sllav.²¹

Vjena, duke pasur rezerva të përkrahja italiane dhe mbështetja e Gjermanisë nuk dëshironte të gjendej e vetme përballë Moskës dhe

Die Londoner Botschafterkonferenz 1912–1913, Dissertation an der Universität Wien [Konferenca e Ambasadorëve në Londër 1912–1913, disertacion pranë Universitetit të Vjenës], Vjenë 1960, f. 205.

¹⁸ Beqir Meta, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2023, f. 147.

¹⁹ Arben Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha...*, f.50-51, Citohet një raport i Mensdorff-it nga Londra drejtuar Vjenës, 18 dhjetor 1912.

²⁰ Krah. R. R. Kritt: *Die Londoner Botschafterkonferenz 1912–1913*, Dissertation an der Universität Wien [Konferenca e Ambasadorëve në Londër 1912–1913, disertacion pranë Universitetit të Vjenës], Vjenë 1960, f. 205.

²¹ Beqir Meta, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2023, f. 149.

Francës, u përpoq të luante lojën e saj fillimisht brenda “Koncertit Evropian” përballë kërcënimit të Aleancës Ballkanike.

Idetë e veta për caktimin e kufijve Austro-Hungaria i konkretizoi në një projekt-hartë të Shqipërisë, që ia paraqiti Konferencës më 20 dhjetor 1912,²² me kërkesën e kësaj të fundit për ta pasur si bazë për diskutim. Ky projekt nuk i përmbahej tërësisht parimit etnik në konfigurimin e shtetit shqiptar, pasi linte jashtë mjaft territore të rëndësishme shqiptare, por ishte projekti më i favorshëm për shqiptarët, në raport me projektet dhe synimet e Fuqive të tjera të Mëdha. Për më tepër, edhe për këtë kufi të propozuar, austro-hungarezët ishin të detyruar dhe të përgatitur të bënin lëshime. Diplomatat austro-hungarezë nuk e fshihnin këtë qëllim. Sipas tyre, kjo shtrirje "e zgjeruar" e hapësirës së shtetit të ri shqiptar do të krijonte një hapësirë të mjaftueshme për kompromiset e mundshme gjatë negociatave të ardhshme.

Konferenca e Londrës nuk e pranoi si bazë për zgjidhjen e çështjes së kufijve të Shqipërisë edhe parimin pjesërisht etnik dhe trajtimin e paplotë të këtij parimi që ajo mori nga varianti i Kontit Mensdorff. Ai u ballafaqua me një projekt-hartë të dytë nga ana e Ruisë e cila parashikonte një cungim të madh të tokave të Shqipërisë.

Projekti austro-hungarez ndeshi në kundërshtimin e fortë të Ruisë e Francës, të përkrahur edhe nga Britania e Madhe. Madje edhe përfaqësuesi i Romës dhe i Berlinit shprehën rezerva ndaj tij, madje ushtruan presion kundrejt ambasadorit austriak që të mos ngulte këmbë për përfshirjen brenda shtetit shqiptar të Shkodrës, Pejës, Prizrenit etj.²³

²² Vija kufitare në veri të vendit "kalonte përgjatë Bunës, duke ndjekur drejtimin e vjetër të kufirit të Malit të Zi me Turqinë, deri afër Rzhanicës. Prej këtej vazhdonte në trajtë gjysmërrethi dhe, duke kaluar në jug të Gucisë e të Plavës, merrte drejtimin për në afërsitë e Pejës, të Gjakovës e të Prizrenit që përfshiheshin në Shqipëri. Nga Prizreni kufiri zbriste në jug dhe mbërrinte në malet midis liqenit të Ohrit e liqenit të Pespës, duke përfshirë qytetet e Dibrës e të Ohrit brenda tokave shqiptare. Më tej, drejt jugut e juglindjes, kufiri linte Korçën e Janinën në anën e Shqipërisë dhe, në fund, ndiqte rrjedhën e lumit Kalamas për të dalë në detin Jon, në jug të ishullit të Korfuzit". A. Puto, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha..., f. 167; Ksenofon Krisafi, "Çështja e kufijve të Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës (1912-1913)" në Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shekullit XX, Konferencë shkencore me rastin e 90-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (27 nëntor 2007), përgatiti për botim dhe redaktor shkencor Marenglen Verli, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë, Tirane: Klean, 2007, f. 28.

²³ A. Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha...*, f. 56-57. Njoftime të Mensdorff-it nga Londra të datave 20 dhe 21 dhjetor 1912; Romeo Gurakuqi, *Shqipëria: 1911-1914*, Tirane: UET Press, 2012, f. 485. Autori i

Diskutimet morën pamjen e një ballafaqimi të drejtpërdrejtë ndërmjet përfaqësuesve të Austro-Hungarisë dhe të Rusisë e të të tjerëve nga pas, për çdo qytet a krahinë shqiptare të Veriut.

Roma, që do të ishte më e prekura e dytë nga drejtimi që do të merrte çështja shqiptare, zgjodhi pozicionin asnjanes dhe krahas Vjenës, sa kohë që kjo e fundit nuk kishte gjasa të përfitonte avantazhin e rrezikshëm të zotërimit të bregdetit shqiptar. Asnjanesia dhe aleanca mes Vjenës dhe Romës për të ruajtur kontrollin reciprok në këtë moment, u përshtatej të dy palëve. Mbështetja e krijimit të shtetit autonom ose të pavarur shqiptar, ishte mundësia e vetme për të mbajtur në ekuilibër këtë realitet të mpërtë dhe të papajtueshëm.²⁴ Kështu, Romës i mbetej të bashkëpunonte me Vjenën për krijimin e një Shqipërie të pavarur, e cila mund të parandalonte që ky bregdet të bëhej sllav ose grek.

Edhe Gjermania, e cila ishte fillimisht kundër organizimit të një konference nga Fuqitë e Mëdha për problemet në Ballkan dhe të ardhmen e Perandorisë Osmane,²⁵ mbështeste dy aleatët e saj dhe donte të minimizonte divergjencat italo-austriake, me qëllim që Aleanca e Trefishtë të mbetej e paprekur.²⁶ Madje Ministri i Jashtëm gjerman Kinderlen-Wëchter (Kinderlen Veshter) u propozoi Fuqive të Mëdha që, nëpërmjet një programi të përbashkët veprimi, të ndërhynin mes palëve kundërshtare duke nënvizuar që platforma e përbashkët e këtij aksioni politik, duhej të ishte pavarësia e Shqipërisë,²⁷ dhe Serbisë mund t'i jepej e drejta e ndërtimit të një linje hekurudhore, me një port në detin Adriatik, por të mos i njihej marrja e asnjë pjese nga territori shqiptar.²⁸

Ecuria e punimeve në Konferencë tregoi se Austro-Hungaria e kishte Gjermaninë një aleat të paqëndrueshëm sa i përket mbështetjes në lidhje me çështjen shqiptare. Kjo edhe për shkak të konjunkturave dhe

referohet The National Archives, London (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/1757, doc. no. 666. R. Rod për E. Grey-n, Romë, 5 janar 1913 dhe E. Grey për R. Rod, 7 janar 1913.

²⁴ Henry N. Brailsford, *Macedonia, its Races and their Future*, London: 1906, f. 282-284.

²⁵ Kjo trajtohet nga Antonello Biagini, *Historia e Shqipërisë nga zanafilla deri në ditët tona*, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 1998, f. 106-121.

²⁶ Beqir Meta, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2023, f. 150

²⁷ Hanns Christian Lëhr, *Die Gröndung Albaniens. Wilhelm zu Wied und die Balkan Diplomatie der Gröemächte 1912-1914*, Frankfurt am main: 2010, f. 39.

²⁸ Po aty, f. 40.

krizave të brendshme në Gjermani²⁹ por sidomos për faktin se Berlina nuk kishte interesa të drejtpërdrejta në Shqipëri dhe se Ministria e Jashtme e Gjermanisë mendonte se vendi i saj nuk duhej të hynte në një konflikt ushtarak me Rusinë për hir të Austro-Hungarisë. Prandaj, në situatën e acaruar politike dhe ushtarake ndërmjet Austro-Hungarisë, nga njëra anë dhe Serbisë e Rusisë, nga ana tjetër, Berlina ndërhyri, duke zbutur dhe moderuar pozicionin e Austro-Hungarisë. Në momente të tjera kyçe, kur u rrezikua interesi themelor i Austro-Hungarisë, si në rastin e krizës së Shkodrës, ajo i dha Vjenës përkohësisht përkrahjen dhe garancitë e nevojshme politike dhe ushtarake.³⁰ Kjo ndërhyrje pati një ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e kufijve të Shqipërisë.

Përballë bllokut josolid të Aleancës së Trefishtë, Rusia dhe më e moderuar Franca, në vazhdimësi do të mbronte interesat dhe pretendimet e popujve sllavë, veçanërisht Malit të Zi dhe Serbisë në Ballkan, duke i shërbyer rritjes së fuqisë së saj politike e ushtarake dhe minimizimit të fuqisë së rivales së saj, Perandorisë Austro-Hungareze dhe sigurisht, edhe gjithë Bllokut Gjermanik. Në Konferencën e Ambasadorëve ajo u përpoq maksimalisht të mbështeste pretendimet serbe dhe malazeze, duke këmbëngulur që shtetet ballkanike, të cilat kishin fituar luftën, duhej të mbanin territoret e pushtuara, dhe ky parim duhej të mbizotëronte mbi përkatësinë kombëtare të popullsisë. Qëllimi i qëndrimit të saj gjatë Konferencës ishte një avancim i dukshëm i projektit pansllavist.

Momenti më i rëndësishëm ishte diskutimi i çështjes së kufijve ku Moska, e mbështetur edhe nga Franca, paraqiti projektin e saj, i cili ishte krejtësisht ndryshe nga projekti austro-hungarez. Territori shqiptar tkurrej dhe zvogëlohej maksimalisht, në dobi të Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë. Kufiri shqiptar konfigurohej në hartën ruse me shtrirjen që nisej afër derdhjes së Drinit në detin Adriatik dhe vazhdonte më tej, duke ia lënë Shkodrën dhe gjithë trevën veriore Malit të Zi, për të ndjekur rrjedhën e Drinit të Bardhë dhe, pasi linte jashtë gjithë tokat shqiptare të vilajetit të Kosovës e pothuajse gjithë vilajetin e Manastirit,

²⁹ Në Gjermani, ekzistonin mendime të ndryshme sa i takon politikës që duhej të ndiqej ndaj Shqipërisë. Beqir Meta, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2023, f. 152. Sipas H. Ch. Löhr, *Die Gründung Albaniens...*, f. 41.

³⁰ Rüdiger Schiel, *Skutari 1913/14 - eine frühe "Joint" oder eine "Combined Operation"?* në Bernhard Chiari & Gerhard P. Groß, *Am Rande Europas? Der Balkan-Raum und Bevölkerung ale Wirkungsfelder militärischer Gewalt*, München: 2009, f. 89-105.

zbriste në liqenin e Ohrit. Pastaj, gati në vijë të drejtë, vazhdonte në jug, kthehej drejt perëndimit dhe dilte në detin Jon, te Kepi i Qefalisë, duke lënë jashtë Shqipërisë Korçën, Delvinën, Sarandën e gjithë Çamërinë.³¹

Përcaktimi i kufijve veriorë e verilindorë të Shqipërisë krijoi, jo vetëm përplasje mes dy blloqeve, por edhe krisje brenda Aleancës së Trefishtë. Ambasadorët e Austro-Hungarisë e të Rusisë u grindën për çdo qytet a krahinë shqiptare të Veriut, duke ngadalësuar ritmin e zhvillimit të Konferencës e për pasojë vendimin e saj. Kërkesa e Vjenës për t'ia lënë Shkodrën Shqipërisë ndeshi në kundërshtimin e ashpër të Moskës, të përkrahur nga Parisi, nga Anglia dhe, në një farë mënyre, edhe nga Roma, kundërshti ndaj së cilës përfaqësuesi i Austro-Hungarisë kërcënoi se do të largohej nga Konferenca e Londrës. Vetëm falë moderimit të sforcuar të Italisë, duke ndryshuar qëndrim dhe duke i dalë në krah Austro-Hungarisë, Rusia me mbështetjen e Londrës hodhi në tryezë kartat e kompromisit. Ajo pajtohej me idenë që Shkodra të lihej brenda Shqipërisë, por kërkonte t'i jepeshin Malit të Zi gjithë liqeni i Shkodrës e Mali i Taraboshit, kurse Serbisë Gjakova, Dibra e Luma. Kundërshtimi i përbashkët nga Aleanca e Trefishtë bëri që Konferenca e Ambasadorëve të mbetet në një pikë të vdekur për gati një muaj. Për më se një muaj bisedimet u zhvilluan jashtë Konferencës, por gjithmonë me ndërmjetësinë e ministrit e Jashtëm anglez.

Por si Vjena, ashtu edhe Roma i njihnin shumë mirë mundësitë dhe kufijtë e presionit rus, ashtu edhe peshën e tij në kontekstin evropian të kohës. Britania e Madhe ishte e interesuar në suksesin e Konferencës në përgjithësi. Ajo nuk kishte lidhje preferenciale dhe aleanca që përfshinin ndarjen e interesave në këtë pjesë të Evropës, por natyrshëm nuk dëshironte rivale e konkurrencte për dalje në dete të reja dhe porte ushtarake në jugun e Evropës. Këmbëngulja e Rusisë për të arritur patjetër daljen në Adriatik po mbante peng ecurinë e Konferencës, duke provokuar deri edhe dështimin e saj nga një anë, por edhe duke forcuar aleancën mes Austro-Hungarisë dhe Italisë,³² nga ana tjetër. Këto zhvillime të reja do të ndikonin dhe vështirësonin më shumë arritjen e objektivave afatgjatë rusë.

Ndonëse Vjena kishte deklaruar në fillim se asnjë qytet me shumicë shqiptare nuk do të shpëtohet nga shteti shqiptar, sepse ato ishin pjesë e interesave të tyre afatgjatë, ajo u tërhoq duke lëshuar Fushën e

³¹ A. Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha...*, f. 171; K. Krisafi, "Çështja e kufijve...", f. 128-129.

³² Nicola Guy, *Lindja e Shqipërisë. Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*, Tiranë: Pegi, 2012, f. 60-61

Kosovës, Deçanin, Pejën, Dibrën dhe Prizrenin, falë edhe trysnisë së Italisë dhe Gjermanisë.³³

Ndërkohë që situata në terren u komplikua e përkeqësua edhe më tej, sepse Perandoria Osmane u largua nga Konferenca e Paqes si pasojë e kërkesave të tepruara të aleatëve ballkanikë, duke rinisur më 3 shkurt 1913 luftën kundër tyre dhe duke prishur armëpushimin e arritur më 3 dhjetor 1912. Perandoria Osmane, ndryshe nga sa priste, e humbi dhe këtë fazë të Luftës Ballkanike dhe më 16 prill u detyrua të nënshkruante një armëpushim të ri.

Vendimi i Fuqive të Mëdha për shkëputjen e Kosovës ishte, në fakt, ligjërimi i asaj se çfarë kishte ndodhur në terren. Trupat serbe, të cilat e kishin pushtuar atë, ndodheshin në mesin e fushatës së tyre propagandistike dhe ushtarake, për të shkuar më tej, drejt Adriatikut. “Vetë shqiptarët ishin me origjinë serbe, por ishin konvertuar më vonë në myslimanë për të siguruar mbështetjen osmane”³⁴ ishte platforma e fushatës serbe për të ligjëruar pushtimin e Kosovës³⁵. Gjatë muajit mars Serbia, Mali i Zi dhe Greqia i intensifikuan veprimet ushtarake në thellësi

³³ Dokumente britanike për çështjen shqiptare..., përg. M. Shatri, f. 214 (dok. 127); f. 215 (dok. 128); f. 225 (dok. 137); 226 (dok. 138); E. Grey për F. Cartwright, 7 janar 1913; F. Cartwright për E. Grey-n, Vjenë, 8 janar 1913; E. Grey për E. Goschen, 17 janar 1913; E. Grey për Buchanan (Bjukkwen), 6 shkurt 1913; A. Puto, Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha..., f.195-196.

³⁴ A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, dok. nr. 9, f. 225-226. Raport i P. Cambon mbi propozimet për caktimin e kufirit të Shqipërisë në veri dhe në lindje, 6 shkurt 1913.

³⁵ Më 21 mars 1913, Mensdorff-i lëshoi Gjakovën në këmbim të Shkodrës, megjithëse nënvizoi me forcë se Gjakova ishte një qytet shqiptar katolik, si dhe qendra më e rëndësishme e nacionalizmit shqiptar në Shqipërinë e Veriut. Vjena kërkoi me forcë zbrazjen e menjëhershme të territoreve shqiptare nga ushtria serbe e malazeze dhe marrjen e masave për mbrojtjen e popullsisë shqiptare në territoret që do t'i lëshoheshin Serbisë e Malit të Zi. Ky lëshim u kushtzua me: dhënien e garancive nga Fuqitë se kufiri verior e verilindor i Shqipërisë do të vendosej në përputhje me vijën austriake (duke përfshirë propozimin austro-hungarez lidhur me Bunën e liqenin e Shkodrës); me pushimin e menjëhershëm të veprimeve ushtarake dhe me zbrazjen e shpejtë nga ana e Serbisë dhe Malit të Zi të territoreve të caktuara Shqipërisë, e cila do të kërkohej e sigurohej nga ana e përfaqësuesve të gjashtë Fuqive të Mëdha. Dokumente britanike për çështjen shqiptare..., përg. M.Shatri, f. 358. E Grey për Buchanan, 22 mars 1913.

Më 22 mars u miratuan të tjera cenime territoriale në favor të fqinjëve veriorë. Serbisë iu kalua edhe Rrafshi i Dukagjinit, si dhe territore shqiptare në Maqedoninë Perëndimore. Ky vendim është interpretuar se u miratua nën presionin e Rusisë, për të kompensuar Serbinë për privimin e saj nga dalja në Adriatik. V. Kondis, Greqia dhe Shqipëria në shekullin XX..., f.57

të tokave shqiptare. Forcat serbe së bashku me ato malazeze, intensifikuan sulmin për marrjen e Shkodrës, ndërsa grekët arritën deri në afërsi të Beratit.³⁶

Marrëveshja e 22 marsit 1913, e cila linte jashtë Shqipërisë gjysmën e trojeve të saj të natyrshme, nuk u zbatua. U desh sërish angazhimi i Fuqive të Mëdha, për një periudhë gati gjashtëjavore që Mbreti Nikolla, i mbështetur edhe nga qëndrimi i Ruisë, të tërhiqej nga rrethimi i Shkodrës që e kishte pushtuar më 23 prill, sipas edhe marrëveshjes me Esat Pashë Toptanin. Kompromisi u arrit me nënshkrimin e një marrëveshjeje të re, më 9 maj 1913, falë së cilës u hoq rrethimi i Shkodrës dhe e ribashkoi atë me Shqipërinë. Kjo krizë e fundit e Konferencës së Londrës lidhur me përcaktimin e kufijve veriorë dhe verilindorë të Shqipërisë u zgjidh mbi parimin e “shkopit dhe karotës”. Fuqitë e Mëdha, krahas kërcënimit për ndërhyrje ushtarake ndërkombëtare, i prematuan Malit të Zi edhe një ndihmë financiare 37 në një kohë të afërt. Konferenca vendosi që kufiri verior të përcaktohej në terren nga një komision, i përbërë nga ekspertë, njohës të Ballkanit.

Në fakt, zhvillimet e brendshme në Shqipëri nuk e favorizonin diskutimin e çështjes shqiptare në Londër dhe as ndihmonin mbështetjen e Vjenës dhe qëndrimet e saj dashamirëse në favor të kësaj çështjeje. Gjatë kohës së zhvillimit të Konferencës, në Shqipëri deri në vitin 1913, u formuan katër qeveri: Qeveria provizore e Vlorës, nën Ismail Qemalin; Qeveria e Shqipërisë së Mesme me seli në Durrës, e udhëhequr nga Esad pashë Toptani; Qeveria e tretë, ajo e Ded Çokut në Lezhë dhe e katërta, ishte Qeveria e Prenk Bib Dodës, e vetëshpallur në Mirditë. Vendi paraqiste një tablo të vajtueshme të përçarjeve e ndasive politike. Këto rrethana të brendshme në Shqipëri, nuk e lehtësuan pozicionin e ministrit të Jashtëm austro-hungarez Berchtold, për të mbrojtur integritetin e plotë të Shqipërisë.

Me debate të ashpra u shoqëruan edhe negociatat e përcaktimit të kufirit jugor të Shqipërisë. Aleancat brenda konferencës u pozicionuan dukshëm përballë, me qasjet dhe interesat shumë larg njëra tjetrës. Për këtë çështje, Aleanca e Trefishtë tregoi më shumë kompaktësi dhe vendosmëri në qëndrim se sa kishte ndodhur me kufijtë veriorë dhe verilindorë. Aleanca Tripalëshe kryesohej nga përfaqësuesi italian, Imperiali, i cili kryesonte me këmbëngulje ruajtjen e interesave strategjike dhe

³⁶ HHSStA.PA.A. në AIH, Vj. 23-23-2396. Telegram nga Kotorri e Tivari për në Vjenë, 3 prill 1913.

³⁷ Beqir Meta, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2023, f. 161

ekonomike italiane mbi këtë pjesë të rajoni dhe shtetin shqiptar. Interesat e Romës dhe Vjenës përputheshin sa i takon kësaj pjese të kufirit. Ato nuk donin daljen në Adriatikun shqiptar të asnjë faktori të tretë, qoftë edhe një fuqi e vogël siç ishte Greqia. 38 Pasi mori premtimin e kolegut të tij nga Vjena, për mbështetjen e interesave shqiptare në suazën e barazisë së interesave të shteteve të tyre në këtë pjesë të Ballkanit, ambasadori italian Imperiali paraqiti një projekt, që përshkohej nga dy qëndrime. Në njërën anë, ishte këmbëngulja e Vjenës për t'ia lënë Korçën Shqipërisë, kurse në anën tjetër propozimi insistues i Romës për të mos ia dhënë Greqisë gjithë bregdetin përballë Korfuzit, sepse, siç thuhej në një dokument të Këshillit të Ministrave të Italisë, të 11 prillit 1913, "Kanali i Korfuzit tërësisht në duart e Greqisë, do ta zhvlerësonte Vlorën".³⁹

Për arsye, jo vetëm taktike, por edhe strategjike Ambasadori Beckendorf i dha përfaqësuesit francez Cambon-i (Kambon) rolin drejtues në mbrojtjen e pretendimeve greke. Rusia kishte shumë më pak interes dhe vëmendje ndaj grekëve joslavë dhe nuk dëshironte të përballlej drejtpërdrejt sërish me Italinë të cilën dëshironte, për pasojë ta largonte nga aleanca me Fuqitë Gjermanike. Franca, nga ana tjetër, kishte lidhje trashëgimie, financiare dhe interesa specifike në Greqi. Vendosija e saj në ballë të përplasjes do të mund të kundërbalancoje përpjekjet e Berlinit për të shfrytëzuar në interesin e vet origjinën gjermane të Mbretit Konstandin të Greqisë.

Cambon-i synonte t'i linte Greqisë zotërimin e dy krahëve të Kanalit të Korfuzit dhe kontrollin mbi këtë ngushticë, ndaj propozoi që Korça, Gjirokastra dhe zona bregdetare, deri në veri të Kepit të Qefalisë, t'i jepeshin Greqisë. Në harmoni dhe në vijim të qëndrimit francez ndaj statusit të Shqipërisë⁴⁰, Cambon-i nënvizonte se popullsia ortodokse duhej të bashkohej me Greqinë, pasi ajo nuk duhej të lihej brenda një shteti me shumicë myslimane. Argumentet e tij të karakterit etnik, fetar dhe romantik ndaj Korçës si një qendër intelektuale greke, se njerëzit e arsimuar të kësaj zone ishin me simpati greke, ashtu edhe ndaj Gjirokastrës, nuk ishin bindës mjaftueshëm, për të shndërruar këtë qytet shqiptar në qytet grek dhe për të arritur synimet e Greqisë dhe interesat

³⁸ A.Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha...*, f. 227-228.

³⁹ A.Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, vëll. II, f.75.

⁴⁰ Edith P. Stickney, *Southern Albania or Northern Epirus in European International Affairs (1912-1913)*, Stanford" 1926, f. 35 (botimi shqip: Shqipëria Jugore ose Epiri i Veriut në çështjet europiane ndërkombëtare (1912-1913), Prishtinë: KOHA, 1998, f. 50).

e saj strategjike. Për zyrtarët grekë e rëndësishme ishte të mundësonin lehtësisht komunikimin midis zonës së Epirit të Jugut dhe të Maqedonisë, duke shmangur malet e Pindit, nëpërmjet ndërtimit të një rruge që do të kalonte përmes Korçës. Duke zotëruar qytetin e Gjirokastrës, Athina do të vendoste kontrollin mbi rrugën Janinë-Vlorë dhe kontrollin e plotë të Kanalit të Korfuzit.

Përkatësia e qartë shqiptare e Korçës dhe ekzistenca e saj, si qendër e rëndësishme e kulturës dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të njohura nga të gjithë, nuk patën ndonjë ndikim thelbësor në vendimmarrjen e Konferencës. Përfshirja e Korçës brenda shtetit shqiptar, si pikë kufitare fundore midis Serbisë dhe Greqisë dhe asnjënjësia e Kanalit të Korfuzit ishin përparësi për Austro-Hungarinë. Ajo e shikonte këtë kufi shumë të vlefshëm, sepse rriste edhe më tepër varësinë ekonomike të Serbisë dhe përforconte politikën austriake për të penguar daljen e saj në Adriatik, duke i dhënë shtetit shqiptar një shtrirje edhe më të madhe.

Qëndrimet e vendosura italiane dhe austriake ndaj kufirit jugor të Shqipërisë, pavarësisht nuancave të veçanta, ishin të palëkundura edhe pas më shumë se dy muaj bisedimesh brenda Konferencës.⁴¹ Ato deklaroi se Korça në lindje dhe Kepi i Stillos në jugperëndim, përbënin “shtyllat e Herkulit” për Shqipërinë dhe e bënë të qartë se nuk do të pranoni asnjë koncesion në këtë drejtim.⁴²

Lufta e Dytë Ballkanike, që përfundoi me disfatën e Bullgarisë, inkurajoi dhe nxiti veprimet aneksuese të fuqive ballkanike fituese ndaj trojeve shqiptare, duke komprometuar edhe vetë zhvillimet e Konferencës së Londrës dhe zhvlerësuar vendimet e saj.

Londra, nga ana e saj, kërkonte të përdorte vendimet e Konferencës në një plan më të gjerë strategjik dhe rajonal, duke kapërcyer kufijtë e Ballkanit. Grey propozoi planin e vet me pesë pika më 1 gusht 1913. Ai përfshinte ngritjen e një komisioni ndërkombëtar për përcaktimin e kufijve shqiptaro-grek, me idenë që Korça, Kepi i Stillos dhe Sazani t'i mbeteshin Shqipërisë.⁴³ Të konsideruara si kompensim, Greqisë do t'i jepeshin ishujt e Egjeut, të cilët, që pas Luftës Italo-Turke,

⁴¹ Giannini, A. (1940). *L'Albania dall'indipendenza all'unione con l'Italia (1913-1939)*, Milano: Istituto per gli Studi di Politica Internazionale, f. 11-12.

⁴² *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III (Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912- 7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 26.

⁴³ A.Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, vëll. II, dok. nr. 40, f. 282. Procesverbal mbi kufirin jugor të Shqipërisë dhe çështjen e ishujve, Londër, 1 gusht 1913.

ishin pushtuar nga Italia. Grey synonte të eliminonte kontrollin italian mbi ishujt e Egjeut, duke e konsideruar si kërcënim ndaj interesave dhe fuqisë ushtarako-detare britanike në Mesdheun Lindor, në Dardanelet dhe për pasojë në kanalin e Suezit.

Pavarësisht nga kundërshtitë e fuqishme të ambasadorit Imperiali ndaj propozimit britanik për ishujt e Egjeut, veçanërisht në seancat e datave 5 dhe 8 gusht 1913,⁴⁴ përfundimisht, më datën 11 gusht 1913 u arrit marrëveshja, në themel të të cilës ishte plani prej pesë pikash i ambasadorit britanik për ngritjen e një komisioni që do të caktonte në terren kufirin shqiptar, mbështetur në vendimin se Korça, Kepi i Stillos dhe bregdeti jugor i liqenit të Ohrit duhej të konfirmoheshin si pjesë e Shqipërisë.

Në ndryshim nga kufiri verior dhe verilindor, Komisioni i Caktimit të Kufijve Jugorë, teorikisht, do të kishte më shumë hapësirë për të caktuar kufirin mbi baza etnike, sepse në Konferencë ishin përcaktuar kufijtë e një numri më të vogël zonash të debatueshme dhe Fuqitë e Mëdha do ta kishin më të lehtë për t'i kërkuar Athinës zbrazjen e Shqipërisë Jugore.

Më konkretisht, marrëveshja përfundimtare për kufirin shqiptarogrek, e datës 11 gusht 1913, përmblihte:

"Krahina bregdetare deri në Ftelia, duke përfshirë edhe ishullin e Sazanit, krahina në veri të vijës greke si dhe kazaja e vjetër osmane e Korçës, me bregun jugor të liqenit të Ohrit, që shtrihet prej fshatit Lin deri në Manastirin e Shën Naumit, ishin pjesë përbërëse e Shqipërisë".⁴⁵

Përcaktimi në mënyrë arbitrare, qëllimisht sipërfaqësore dhe krejtësisht të padrejtë i statusit të Shqipërisë dhe kufijve të saj nuk i dha zgjidhjen e duhur, si në planin kombëtar ashtu edhe në atë rajonal, çështjes shqiptare. Konferenca e Londrës përfundoi bisedimet diplomatike duke i lënë shqiptarët të ndarë e të copëtuar, Shqipërinë të çapitur, të paorganizuar dhe të varfër e në mëshirën e furtunave dhe luftërave e orekseve të fuqive pushtuese. Copat e Shqipërisë u përdorën si mall kleringu me fqinjët, duke lënë brenda saj afërsisht vetëm gjysmën e trojeve dhe të popullsisë shqiptare. Krahinat më të begata, trevat bujqësore dhe pjellore e me nëntokë shumë të pasur (Kosova në veri, Çamëria në jug), u lanë jashtë kufijve të Shqipërisë nga Konferenca e Londrës.

⁴⁴ Po aty, dok.nr. 41, f. 283-286. Procesverbal mbi kufirin jugor të Shqipërisë dhe çështjen e ishujve, Londër, 5 gusht 1913.

⁴⁵ Panagiotis N. Pipinelis, *Europe and the Albanian Question*, Argonaut, Inc. Chicago: 1963, f. 55.

Vetë Edward Grey, duke folur për caktimin e kufijve të Shqipërisë nga Konferenca e Londrës, deklaronte më 12 gusht në Dhomën e Komuneve: “Unë e di fare mirë se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo (zgjidhje), në shumë pika, do të japë shkas për kritika të mëdha, nga kushdo që e njih vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë lokale. Duhet të mos harrohet se gjatë përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje të tillë, qëllimi kryesor ka qenë që të ruhet marrëveshja ndërmjet vetë Fuqive të Mëdha dhe, në qoftë se vendimi për Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë ai e ka bërë punën më të rëndësishme, në të mirë të paqes së Evropës.

Ngjarjet e mëvonshme në Ballkan dhe Evropë, provuan krejt të kundërtën. Ndryshimet dhe përmbysjet e domosdoshme të pas viteve 90 në Evropë, në ish-Jugosllavi, por veçanërisht zhvillimet e fundit në Kosovë janë prova më e pakundërshtueshme se paqja e pretenduar e Konferencës së Paqes të vitit 1913 ishte një paqe e rreme, e padrejtë, e paqëndrueshme dhe jo afatgjatë. Historia mbetet dëshmitari i pakundërshtueshëm, ashtu si edhe dëshmitarët e gjallë:

“Kjo ishte një kurdisje e shteteve fqinje përmes Fuqive të Mëdha, në krye me Rusinë. Një lojë më e ndyrë e tradhtisë kurrë nuk është lozur, përderisa Kosova dhe trojet e tjera lindore u morën me tradhti”, e përshkruan këtë padrejtësi mikeshja e madhe e popullit shqiptar, miss Edith Durham⁴⁶.

⁴⁶ Edith Durham, *Bregna e Ballkanit*, Shtëpia Botuese 8 Nëntori, Tiranë, 1990, f. 407.

Arbër Hadri

POLITIKA E SHBA-së NDAJ FORMËSIMIT TË SHTETIT SHQIPTAR: NGA KONFERENCA E LONDRËS DERI TE NJOHJA (1912-1922)

Abstrakt

Politika amerikane ndaj formësimit të shtetit shqiptar ka qenë e një rëndësie të veçantë dhe në etapa përkatëse ishte përcaktuese për fatin e mbijetimit të tij.

Në periudhën dhjetëvjeçare të marrëdhënieve shqiptaro-amerikane (1912-1922), nga shpallja e pavarësisë e deri me njohjen zyrtare të saj, politika e jashtme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka pësuar lëkundje lidhur me rolin e saj në arenën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në këtë kuadër, nga një politikë izolacioniste që e ka karakterizuar Shqipërinë deri në Luftën e Parë Botërore, përfshirja e saj në këtë luftë ndryshoi këtë kurs dhe mori rolin prijës me Presidentin Villson në krijimin e paqes dhe idesë së Ligës së Kombeve.

Përfshirja amerikane në zgjidhjen e çështjes shqiptare përkon me këtë kallëp të rolit të saj në marrëdhëniet ndërkombëtare. Qëndrimi i politikës së ShBA-së ndaj çështjes shqiptare karakterizohet nga tri etapa të rëndësishme të krijimit të politikës së jashtme amerikane kundruall saj: I. Periudha para fillimit të Konferencës së Paqes, që shquhet nga qëndrimet ende të padefinuara të administratës amerikane ndaj çështjes shqiptare, por më pas me parime të përgjithshme ndërkombëtare të vendosura me fillimin e luftës; II. Etapa e mbrojtjes së qenies së shtetit shqiptar nga ana e Presidentit Villson dhe e delegacionit negociator të ShBA-së gjatë gjithë punimeve të Konferencës së Paqes dhe të Konferencës së Ambasadorëve e deri në përfundim të mandatit presidencial të Villsonit dhe III. Periudha pasvillsoniane, me ripozicionimin e stepur të politikës së administratës së re amerikane dhe hezitimit fillestar të saj për njohjen e shtetit shqiptar.

Duke marrë parasysh se procesi i formësimit të shtetit shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare ka filluar me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, Konferencën e Londrës dhe më pas ka vazhduar deri me pranimin në Ligën e Kombeve dhe me që çështja e ekzistencës së saj është vënë në pikëpyetje me rastin e krijimit të rendit të ri botëror në Konferencën e Paqes, këtë periudhë kohore 1912-1920, duhet ta shohim si të pandarë në kontekstin e sendërtimit të shtetit shqiptar të pranuar ndërkombëtarisht. Në këtë kuadër roli amerikan në periudhën 1919-1920 ka qenë vendimtar për mbijetimin e shtetit shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare, ka parandaluar ndarjen treshas të Shqipërisë nga vendet fqinje dhe ka qenë e vetmja Fuqi e Madhe që ka përkrahur në formë të palëkundur të drejtën e popullit shqiptar për vetëvendosje dhe për krijimin e shtetit të Shqipërisë.

Fjalët çelës: Politika amerikane, çështja shqiptare, Presidenti Villson, shteti shqiptar

Politika amerikane ndaj formësimit të shtetit shqiptar ka qenë e një rëndësie të veçantë dhe në etapa përkatëse ka qenë përcaktuese për fatin e mbijetimit të tij.

Në periudhën dhjetëvjeçare të marrëdhënieve shqiptaro-amerikane (1912-1922), nga shpallja e pavarësisë e deri me njohjen zyrtare të saj, politika e jashtme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka pësuar lëkundje sa i përket rolit të saj në arenën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në këtë kuadër, nga një politikë izolacioniste që e ka karakterizuar Shqipërinë deri në Luftën e Parë Botërore, përfshirja e saj në këtë luftë ndryshoi këtë kurs dhe mori rolin prijës me Presidentin Villson në krijimin e paqes dhe idesë së Ligës së Kombeve.

Përfshirja amerikane në zgjidhjen e çështjes shqiptare përkon me këtë kornizë të rolit të saj në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Duke marrë parasysh se procesi i formësimit të shtetit shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare ka filluar me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, Konferencën e Londrës dhe më pas ka vazhduar deri me pranimin në Ligën e Kombeve dhe meqë çështja e ekzistencës së saj është vënë në pikëpyetje me rastin e krijimit të rendit të ri botëror në Konferencën e Paqes, këtë periudhë kohore 1912-1920 duhet ta shohim si të pandarë në kontekstin e sendërtimit të shtetit shqiptar të pranuar ndërkombëtarisht. Në këtë kuadër trajtimi i rolit amerikan në këtë periudhë është me rëndësi të veçantë.

Qëndrimi i politikës së ShBA-së ndaj çështjes shqiptare karakterizohet nga tri etapa të rëndësishme: I. Periudha para fillimit të Konferencës së Paqes, që shquhet nga qëndrimet ende të padefinuara të administratës amerikane ndaj çështjes shqiptare, por më pas me parime të përgjithshme ndërkombëtare të vendosura me fillimin e luftës; II. Etapa e mbrojtjes së qenies së shtetit shqiptar nga ana e Presidentit Villson dhe e delegacionit negociator të ShBA-së gjatë gjithë punimeve të Konferencës së Paqes dhe të Konferencës së Ambasadorëve dhe III. Periudha pasvillsoniane, me ripozicionimin e stepur të politikës së administratës së re amerikane dhe hezitimit fillestar të saj për njohjen e shtetit shqiptar.¹

Çështja shqiptare para dhe gjatë Luftës së Parë Botërore ishte në një pozitë të papërbalueshme si në aspektin e brendshëm, ashtu edhe në konstelacionin ndërkombëtar. Me gjithë faktin që në Konferencën e

¹ Arbër Hadri, *Presidenti Villson dhe çështja shqiptare: Politika e SHBA-së në Konferencën e Paqes në Paris 1919-1920* (Prishtinë: Instituti i Historisë Ali Hadri, 2012), p. 57.

Londrës u parashtruan konditat e procesit të themelimit të shtetit shqiptar, fillimi i Luftës së Parë Botërore e ndaloi këtë ecuri, territoret e tij u okupuan dhe çështja e shtetit shqiptar u bë pjesë përbërëse e fatit të krijimit të rendit të ri botëror dhe qëndrimit të Fuqive të Mëdha ndaj konfigurimit të shteteve e territoreve, që ishin përfshirë në këtë luftë. Kjo pozitë e palakmueshme shtroi përpara kombit shqiptar çështjen e ripërtëritjes së pavarësisë politike dhe mbrojtjes së sovranitetit shtetëror. Një ndër çështjet më akute, që rëndonin mbi çështjen shqiptare, çështja e Kosovës dhe e popullatës së trojeve të tjera etnike të mbetura jashtë territorit administrativ të Shqipërisë londineze fatkeqësisht u anashkaluan për shkak të përpjekjes së mbrojtjes së vetë territorit të ngushtë të caktuar në Konferencën Ndërkombëtare të Londrës.²

Pjesa më e madhe e territorit të saj ishte nën kontrollin e huaj, shteti shqiptar nuk kishte marrë pjesë aktivisht në radhët e aleatëve në Luftën e Parë Botërore, e më këtë edhe pozicioni i tij në arenën ndërkombëtare linte shumë për të dëshiruar. Shqipëria gjendej nën okupimin e zonave ushtarake të huaja; Të trupave pushtuese italiane, franceze, greke e serbe, ndërsa Kosova, Maqedonia Perëndimore dhe viset e tjera të banuara me shqiptarë u vunë sërish nën okupimin e dhunshëm serb. Një ndër faktorët që rezultuan këtë pozitë të çështjes shqiptare në filllet e Konferencës ishte edhe fakti që shteti shqiptar ende nuk kishte pasur kohë të konsolidohej në formën e duhur për të rezultuar stabilitet politik dhe forcë ushtarake, ngase stuhia e rrjedhës së Luftës së Parë Botërore e kishte përfshirë pa kontroll. Zgjidhja e çështjes shqiptare përcaktohej nga një tërësi elementesh prej të cilave më me peshë ishin faktorët e raportit të forcës, që ishte në dëm të saj, si dhe përcaktimi dhe njohja e parimit të fituesit në luftë kundrejt parimit të vetëvendosjes së popujve.³

Kjo pozitë e palakmueshme shtroi përpara kombit shqiptar çështjen e ripërtëritjes së pavarësisë politike dhe mbrojtjes së sovranitetit shtetëror. Një ndër çështjet më akute që rëndonin mbi çështjen shqiptare, çështja e Kosovës dhe e popullatës së trojeve të tjera etnike të mbetura jashtë territorit administrativ të Shqipërisë, fatkeqësisht kishte mbetur pezull nga pamundësia e veprimit dhe e gjendjes në të cilën gjendej Shqipëria. Kjo gjendje u reflektua edhe gjatë punimeve të Konferencës dhe dha rezultat negativ në këtë kontekst.

² Po aty, p. 50-56.

³ Po aty.

Ekuilibri i mëparshëm i forcave në rrafshin ndërkombëtar, në kuadër të së cilës kishte përfituar dhe nga mund të përfitonte çështja shqiptare, kishte ndryshuar tërësisht në dëm të saj. Fundi i Luftës së Parë Botërore rezultoi me thyerjen fuqive të bllokut qendror dhe shpërbërjen e Perandorisë Austro-Hungareze, kundërshtare e ekspansionit serb në Ballkan. Tri vendet fqinje Italia, Serbia-Mali Zi dhe Greqia renditeshin ndër fituesit e luftës dhe kërkonin territore të reja shqiptare, përpos atyre të aneksuara më parë. Italia, si nënshkruese e Traktatit të Fshehtë të Londrës të prillit 1915, kishte synim të përfitonte sa më shumë, duke veçuar pjesët që i përshtaten asaj dhe duke anashkaluar ato që nuk i hynin në interes, duke formuar kështu një kundërthënie ndërkombëtare, në vorbullën e së cilës hyri edhe çështja shqiptare. Ndërsa Shqipëria, që kërkonte rishikimin e padrejtësive, ishte një vend që kishte mbetur asnjans gjatë Luftës Botërore. Ajo zyrtarisht nuk u bashkua me asnjërin prej të dy blloqeve ndërluftuese. Për të plotësuar këtë pasqyrë të zymtë, nga të katër fuqitë kryesore fituese të luftës ShBA-ja, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Italia, vetëm kjo e fundit ishte e interesuar të përkrahte kërkesat territoriale shqiptare, pjesërisht dhe në mënyrë të tërthortë vetëm atëherë nëse shërbenin për interesat e saj ndaj rivalitetit me shtetin në formim e sipër të Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene. Në këtë kuadër vetë ekzistenca e shtetit të Shqipërisë ishte vënë në rrezik nga interesat e shteteve fqinje dhe të Fuqive të Mëdha.⁴

Përpjekjet e shqiptarëve për përfaqësim dhe zgjidhje të drejtë e të denjë të çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes vinin nga të gjitha anët e botës duke përfshirë mërgatën në Evropë dhe ShBA-në. Kështu, disa elemente të veprimtarisë së mërgatës shqiptare të cilat janë shënuar në mënyrë më domethënëse në Departamentin e Shtetit Amerikan dhe qëndrimin e ShBA-së kundruall çështjes shqiptare në prag të Konferencës së Paqes mund ta rikonstruojmë nëpërmjet korrespondencës diplomatike ndërmjet ShBA-së dhe Mbretërisë së Bashkuar, respektivisht sekretarit të Shtetit Robert Lansing dhe ambasadorit Britanik Barklay. Në këtë korrespondencë pasqyrohet qasja e përgjithshme, që strukturat e larta politike të të dyja palëve ende nuk e kishin përcaktuar qartë qëndrimin në vija të trasha lidhur me çështjen shqiptare dhe Shqipërinë në veçanti. Në këtë kuadër, Sekretari i Shtetit, Robert Lansing, duke e sqa-

⁴ Muin Çami “Shqiptarët për problemin e Kosovës në mbarim të Luftës së I Botërore”, J. Bajraktari, *Çështja e Kosovës - Një problem historik dhe aktual: (Simpozium i mbajtur në Tiranë më 15-16 prill 1993)* (Prishtinë: Instituti i Historisë, 1996), p. 138.

ruar qëndrimin lidhur me letrën paraprake të qeverisë britanike sa i përket synimit të shqiptarëve në Bernë të Zvicrës që t'i bëjnë kërkesë qeverisë italiane për lejimin e menjëhershëm të tyre për t'i vënë nën një administrim të vetëm të gjitha pjesët e çliruara të Shqipërisë. Sekretari i Shtetit konfirmon sugjerimin e Qeverisë së Britanisë se asnjë veprim i natyrës paragjyquese nuk duhet ndërmarrë dhe se qëndrimi i tyre ishte se asgjë nuk duhet të bëhet për ta paragjykuar shqyrtimin e çështjes shqiptare nga Konferenca e Paqes, duke dhënë përgjigje se Qeveria e ShBA-së nuk parashikon kurrfarë veprimi lidhur me Shqipërinë në Konferencën e Paqes.⁵ Kjo qasje e strukturave të larta, me gjithë analizat e thukëta të "Inkuajarit" dhe memorandumet e ndryshme të mërgatës shqiptare, ishte ende në veprim meqë Konferenca e Paqes Botërore ishte në prag të fillimit dhe ishin në diskutim pothuajse të gjitha çështjet politike dhe ekonomike të botës, dhe ato ishin enorme në numër, kështu që çështjes shqiptare dhe çështjeve të tjera të Ballkanit nuk iu dha edhe aq rëndësi në këtë stad të veprimit politik.⁶

Politika amerikane ndaj çështjes shqiptare bazohet në qëndrimin e përgjithshëm që ShBA-ja kishte ndaj rrjedhave politike botërore dhe inkuadrimit më aktiv të saj në politikën globale. Kështu, dalja nga izolimi politik i ShBA-së me hyrjen në Luftën e Parë Botërore, inkuadrimi në hartimin e programit të Paqes Botërore dhe si lider i sajimit të rendit të ri botëror, duke përfshirë këtu rajonin e Ballkanit si tërësi, ndryshuan edhe interesin për këtë pjesë të botës.⁷

Fundi i izolacionizmit – fillimi i progresizmit në politikën e jashtme amerikane

Duke marrë parasysh izolimin politik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës përgjatë gati tërë historisë më të hershme të saj, ajo para shekullit njëzet kishte rol dytësor në planet për rendin e ri botëror dhe tek me fillimin e luftës më 1914 dhe involvimit më serioz të Amerikës në proceset botërore, në rrjedhat ndërkombëtare filloi të dalë në pah edhe angazhimi më domethënës i saj. Ky interes ishte i bazuar në idenë

⁵ United States Department of State, *Papers Relating to the Foreign Relations of the United States: The Paris Peace Conference, 1919*, Department of State Publication, v. 2 (Washington: U.S. Government Printing Office, 1942), Doc. 875.00/35 - No. 315, p. 373.

⁶ Po aty.

⁷ Hadri, *Presidenti Villson dhe çështja shqiptare*, p. 58.

e formimit të organizatës *Liga për Zbatimin e Paqes*, detyra e së cilës do të ishte krijimi i një organi të përbashkët ndërkombëtar, i përbërë nga shtetet sovraane, të cilat do t'u nënshtroheshin ligjeve ndërkombëtare dhe do të kishin mundësi të aplikojnë sanksione ekonomike dhe ushtarake ndaj çdo shteti, i cili do të refuzonte të bënte ujdi në mënyrë paqësore.⁸

Për gati dy vjet, që nga shpërthimi i luftës në Evropë në gusht të vitit 1914, Presidenti Vudro Villson pareshtur eksploroj rrugë të ndryshme, me qëllim të ndërprerjes së konfliktit botëror. Ndonëse ende neutrale, qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës shfaqte interes të theksuar në konfliktin evropian dhe në rrugët e zgjidhjes së tij. Fjalimet e tij të shpeshta publike joshën vëmendjen e pandërprerë për marrëveshjen eventuale të luftës. Këto fjalime të hershme reflektuan brengosjen e thellë të Presidentit Villson mbi ecurinë e luftës, mirëpo në këtë kohë brengosja u shpreh vetëm në kushtet e përgjithshme. Megjithatë, në maj të vitit 1916 një shkëputje e rëndësishme nga frazat e mëparshme të shoqërisë paqësore u bë e evidente. Tani e tutje në vend të apeleve të turbullta të vetëdijes njerëzore, Presidenti Villson filloi të apelojë për një organizatë botërore e cila do të ishte e aftë që të mirëmbajë paqen ndërkombëtare aq të dëshiruar.⁹

Me këtë u bë burrshtetasi i parë që bëri një thirrje të tillë. Ai po ashtu promovoi idenë e anëtarësimit të Amerikës në Lidhje, mirëpo nuk bëri propozime të caktuara mbi organizimin e saj, duke lënë të kuptohet se hyrja në detaje në këtë stad kohor do të provokonte kontradikta ndërkombëtare dhe do të mund të merrte pamjen e një organizate që është vetëm një aleancë ushtarake kundër Gjermanisë.¹⁰

Rolin amerikan në rritje mbi çështjet botërore e përcaktuan disa faktorë të rëndësishëm sikurse: rritja e shpejtë e fuqisë së saj dhe shembja graduale e sistemit ndërkombëtar me qendër Evropën. Villsoni e

⁸ K.A. Clements, *The Presidency of Woodrow Wilson*, American Presidency Series (University Press of Kansas, 1992), p. 174.

⁹ Fjalimet e Villsonit në vitin 1916 mbi paqen ishin: Fjalimi në Aetolian Hall, Nju Jork, më 27 janar 1916; Fjalimi në Arlington, Virgjinia më 30 maj Fjalimi në Detroit, Miçigan, më 10 korrik; Fjalimi në Shadov Llovn, Nju Jork, më 2 shtator. Publikuar në: Wilson, Woodrow., Baker, Ray Stannard., Dodd, William Edward., Leach, Howard Seavoy. *The Public Papers of Woodrow Wilson: The new democracy; presidential messages, addresses, and other papers (1913-1917)*. United Kingdom: Harper and Brothers, 1926, p. 2, 1, 7, 194, 231, 287.

¹⁰ Warren F. Kuehl, *Seeking World Order: The United States and International Organization to 1920* (Vanderbilt University Press, Nashville -Tennesy, 1969), p. 224-226.

justifikonte rolin botëror të Amerikës dhe tendencat e saj për daljen nga izolacionizmi me misionin e saj shpëtimtar. Amerika kishte një detyrim jo për ekuilibrin e forcës, por për përhapjen e parimeve të saj në gjithë botën. Gjatë administratës së Villsonit, Amerika doli si një lojtar kryesor në çështjet botërore, duke shpallur parime, të cilat, megjithëse pasqyronin aksiomat e mendimit amerikan, shënonin një kthesë revolucionare për diplomatët e Botës së Vjetër. Sipas këtyre parimeve, paqja varret nga përhapja e demokracisë, shtetet duhet të gjykohen me të njëjtat kritere morale si dhe individët dhe interesat kombëtare varen nga pranimi i një sistemi ndërkombëtar të së drejtës.¹¹

Opinionin publik në ShBA gjatë luftës në Evropë mbronte pikëpamjen se Amerika duhet ta ruajë pozicionimin e saj të neutralitetit ndaj ngjarjeve në Evropë, ngase ajo ishte “tejmase krenare që të luftojë”. Përgjatë vitit 1916, Presidenti Villson nëpërmjet emisarit të tij të posaçëm kolonel Edvard Hausit, bëri përpjekje të vazhdueshme që të sjellë në tryezën e bisedimeve palët ndërluftuese nën kushtet që i konsideronte si të drejta për të gjithë. Mirëpo, këto përpjekje ishin të paracaktuara për dështim, meqë palët ndërluftuese nuk ishin të gatshme në këtë kohë për një armëpushim pa i përmbushur secila interesat e saj vetanake. Për më shumë, kombe të ndryshme kishin lidhur një rrjet të ngatërruar të marrëveshjeve sekrete, që seriozisht i dëmtuan përpjekjet gjatë dhe pas përfundimit të luftës për një paqe të qëndrueshme. Me gjithë tensionet e kohëpaskohshme, deri në pranverën e vitit 1917 Villsoni nuk kishte synim që ta përfshinte vendin e tij në luftën e përgjithshme, e po ashtu nuk kishte as entuziazëm në radhët e popullsisë amerikane që të inkua-drohej në luftë.¹²

Mobilizimi dhe hyrja në luftë e Flotës së Shteteve të Bashkuara, flota e dytë më moderne dhe më e madhja në botë pas asaj britanike, ndryshoi balancën e fuqisë në det, në Oqeanin Atlantik dhe në Detin e Veriut, në mënyrë të pandryshueshme në favor të aleatëve. Në ndërkohë mobilizimi dha rezultat me kontingjentin e parë prej një milioni rekrutësh, duke pasuar edhe nga një milion ushtarë të tjerë, më vonë. Parashikohej që dy milionë ushtarë do të zbarkoheshin në Francë brenda vitit 1918.¹³ Inkuadrimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në luftën e përgjithshme ndryshoi thelbësisht balancën e brishtë ndërluftuese,

¹¹ Henry Kissinger, *Diplomacia* (Tiranë, 1999), p. 29, 30.

¹² J. Keegan, *The First World War*, A Borzoi Book (A. Knopf, 1999), p. 350-353.

¹³ Po aty.

duke i dhënë vulë ngjarjeve dhe rrjedhave të luftës së mëtejshme në favor të aleatëve.

Më 8 janar 1918, nëntë muaj pas hyrjes në luftë të ShBA-së, Presidenti Villson përsëriti dhe zgjeroi planin e paqes në të “*Katërbëdhjetë pikat*”, në adresimin e sesionit të përbashkët të Kongresit, parashtrori atë që ai e konsideronte si parakusht bazë të një paqeje të drejtë dhe të përhershme.¹⁴

Programi i tij përbëhej nga disa parime themelore: denoncimi i marrëveshjeve sekrete dhe publiciteti i marrëveshjeve ndërkombëtare, deteve të lira, barazisë së kushteve të tregtisë për të gjitha kombet, mbikëqyrja e armatimit, një laramani e ujdiqe gjeografike, ku do të zbatoheshin parimet e vetëvendosjes, e mbi të gjitha, themelimi i Lidhjes së Kombeve, organ që do ta zbatonte paqen.¹⁵

Qëllimi i fjalimit pjesërisht ishte në shërbim të frymëzimit të përçarjes në kuadrin e Gjermanisë dhe Perandorisë Austro-Hungareze për të ndryshuar kursin e luftës në favor të aleatëve dhe të nxisë ndërluftuesit e tjerë që të inkuadrohen në luftë, si dhe pjesërisht të marrë kontrollin ndaj procesit paqësor nga bolshevikët rusë, që negocionin me gjermanët në Brest-Litovski. Mirëpo caku kryesor ishte të spikatë të vetmen lloj paqeje që Presidenti Villson besonte se do të ishte jetëgjatë.¹⁶ Thelbi i fjalimit qëndroi i njëjtë me fjalimin e 1917-tës, mirëpo nënvizoi territoret që duhet ta kenë të drejtën e vetëvendosjes; kërkoi evakuimin e territoreve të okupuara të Belgjikës, Francës dhe të Ruisisë; po ashtu rekomandoi heqjen e barrierave ekonomike ndërmjet kombeve dhe denoncoi karakterin e marrëveshjeve të fshehta.¹⁷

Të “*Katërbëdhjetë pikat*” kanë rëndësi të veçantë për disa arsye. Para së gjithash, ato do të zbatonin shumë parime të reformave të brendshme amerikane, të njohura si “*Progresivizmi*” edhe në politikën e jashtme. Nocionet e tregtisë së lirë, marrëveshjeve të hapura, demokracisë dhe vetëvendosjes ishin versione të zakonshme të programeve të politikës së brendshme, të cilat reformatorët i kishin përkrahur për më se dy dekada. Së dyti, të “*Katërbëdhjetë pikat*” përbënin të vetmen deklaratë që ngërthente kërkesat e të gjitha palëve ndërluftuese. Kështu, ato u bënë bazë për dorëzimin gjerman dhe i vetmi kriter nëpërmjet, të cilit mund të vlerësohej traktati i paqes. Ç’është akoma më me rëndësi

¹⁴ Clements, *The Presidency of Woodrow Wilson*, p. 164.

¹⁵ Gordon Levin, *Woodrow Wilson and World Politics: America's Response to War and Revolution* (Oxford University Press, 1968), p. 50-51.

¹⁶ Clements, *The Presidency of Woodrow Wilson*, p. 164.

¹⁷ Po aty.

derisa shumë vende besonin se vetëm interesi vetanak duhej të ishte pikësnyimi kryesor i politikës së jashtme, në të “*Katërbëdhjetë pikat*” e tij Villsoni theksonte se morali dhe etika lypsej të bëheshin elementi kyç si i politikës së brendshme, ashtu edhe i politikës së jashtme të një shoqërie demokratike.¹⁸

Gadishulli ballkanik dhe çështja shqiptare, respektivisht “çështja e Adriatikut” në kuadër të së cilës trajtohej gjatë Konferencës së Paqes në të “*Katërbëdhjetë pikat*” shqyrtohet dhe ndërlihet në forma të ndryshme në pikat: I, IX, X, XI dhe XIV,¹⁹ ku theksohet se do të ketë vetëm marrëveshje²⁰ publike të paqes, pas së cilës nuk do të ketë më traktate private ndërkombëtare të asnjë lloji, duke aluduar se diplomacia duhet të veprojë përherë sheshazi dhe para opinionit publik. Nënvizohet domosdoshmëria e evakuimit dhe rikthimit të territoreve të pushtuara, vendosja e marrëdhënieve miqësore në sajë të vijave të parashtuara historikisht dhe të përkatësisë kombëtare, pavarësia dhe integriteti territorial i shteteve ballkanike, si dhe akordimi i daljes së Serbisë në det, duke aluduar në aspektin ekonomik të transportit të mallrave nëpërmjet ndërtimit të një hekurudhe deri në një port të përshtatshëm. Në këtë kontekst mundësia e realizimit të interesave ekonomike të Serbisë trajtohen në kuadër të qarkullimit të lirë të mallrave deri në det, bazuar në dokumentet e “*Komisionit përgatitor amerikan - Inkuajari*” trajtohet fillimisht në këtë etapë, nëpërmjet portit të Selanikut, gjersa më pas në propozimet e mëvonshme gjatë procesit negociator në Konferencën e Paqes në Paris përfshihet si mundësi edhe porti i Durrësit.²¹ Në lidhje me fatin e popujve nën sundimin e Austro-Hungarisë, meqë në këtë stad kohor ende nuk shihej në horizont shkatërrimi i tërësishëm i Perandorisë, sugjerohej dhënia e lirisë së zhvillimit autonom të tyre. E në lidhje me këtë nuk parashikohej etniteti i pavarur politik i sllavëve të jugut, por ky problem shikohej nën prizmin e autonomisë së tyre në kuadër të Perandorisë.²² Në pikën e katërbëdhjetë nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme parashikohej të themelohej një asociacion i kombeve me qëllim që të sigurohen garanci të ndërsjella për politikën e pavarësisë dhe

¹⁸ Woodrow Wilson ed Arthur Link, *The Papers of Woodrow Wilson*, vol. 45, 68 vols. (Princeton: Princeton University Press, 1984), 535-540.

¹⁹ “*Katërbëdhjetë Pikat*”, po aty.

²⁰ Kjo pikë gjatë punimeve të Konferencës së Paqes në Paris ishte gurthemeli i politikës amerikane ndaj çështjes së Adriatikut dhe “*Marrëveshjes së Londrës*”.

²¹ Lawrence Gelfand, “*The Inquiry*” – *American Preparations for Peace, 1917-1919* (New Haven and London: Yale University Press, 1963), p. 142-153.

²² Woodrow Wilson ed Arthur Link, *The Papers of Woodrow Wilson*, vol. 45, 68 vols. (Princeton: Princeton University Press, 1984), 535-540.

të integritetit territorial njësoj si për shtetet e mëdha, ashtu edhe për shtetet të vogla.²³

“Komisioni Përgatitor Amerikan - Inkuajari” dhe çështja shqiptare

Politika e jashtme e ShBA-së në këtë periudhë ishte në stadin e krijimit të një pasqyre të përgjithshme për rrjedhat ndërkombëtare dhe përcaktimin e interesit amerikan. Për këtë qëllim presidenti amerikan Vudro Villson menjëherë pas hyrjes në luftë formoi “Komisionin Përgatitor Amerikan”, po ashtu i njohur edhe si “Inkuajari”,²⁴ nga dijetarë të dalluar, me qëllim të hulumtimit dhe shqyrtimit të çështjeve që do të trajtoheshin në Konferencën Paqësore. “Inkuajari” kishte detyrë përpilimin e rekomandimeve në interesin kombëtar për delegacionin e ardhshëm amerikan, “Komisionit Amerikan për Negocimin e Paqes”, që do angazhohej si trup negociues pas përfundimit të luftës.²⁵ Komisioni funksionoi jashtë kornizave të Departamentit të Shtetit dhe ishte i lidhur drejtpërdrejt nëpërmjet Hausit me Presidentin Villson.²⁶

Sa i përket qasjes ndaj Ballkanit në këtë stad kohor, para Konferencës së Paqes, ilustrimi më i mirë për mosinteresimin e ShBA-së ishte fakti se ajo kishte vetëm një përfaqësues politik për Rumaninë, Bullgarinë dhe Serbinë me seli në Bukuresht. Duke përgatitur materialin sugjerues për Ballkanin, Villiam Bullard, admiral amerikan në një letër ankohet se nuk i është dhënë më shumë hapësirë Ballkanit dhe Turqisë, duke spikatur se ajo ishte nyja e problemit dhe se Amerika duhet të jetë e informuar mirë për këtë çështje nëse dëshiron të ndikojë në proceset e paqes.²⁷

ShBA-ja në Ballkan dhe në ujërat e Adriatikut ishin të angazhuara më tepër moralisht sesa ushtarakisht, duke përfshirë këtu edhe bombardimin e Durrësit më 2 tetor 1918. Bllokadën e bregdetit shqiptar nga ana e italianëve në fund të majit të vitit 1915 Departamenti i Shtetit nuk

²³ “Katërmbëdhjetë Pikat”, po aty.

²⁴ “Wilson to House, September 2 1917”, Woodrow Wilson ed Arthur Link, *The Papers of Woodrow Wilson*, vol. 44, 68 vols. (Princeton: Princeton University Press, 1984), p. 120-121.

²⁵ Gelfand, *The Inquiry*, p. X-XII.

²⁶ Po aty, p. 26.

²⁷ “Records of the American Commission to Negotiate Peace”, doc. nr. 77; cituar në Haris Silajxhiq, *Shqipëria dhe ShBA në Arkivat e Vashingtonit* (Tiranë: Dituria, 1999), p. 48.

e miratonte, ngase e konsideronte atë si një thyerje të rregullave të qarkullimit detar nga ana e Italisë dhe fakti i hyrjes së saj në luftë me Austro-Hungarinë nuk e justifikonte sipas saj marrjen e masave të tilla. Sekretari i Shtetit Robert Lansing paralajmëron seriozitetin e këtij veprimi dhe të drejtën e anijeve amerikane për të qarkulluar edhe më tutje pa asnjë pengesë.²⁸ Megjithëse qeveria italiane siguronte se bllokada nuk do t'u sjellë asnjë pengesë anijeve amerikane, anija amerikane "Albania" e ngarkuar me ushqime për popullsinë e Shqipërisë që e detyruar të largohet nga porti i Durrësit në dhjetor të vitit 1915.²⁹ Bllokada e bregdetit shqiptar shënon fillimin e marrëdhënieve të tendosura ndërmjet Italisë dhe ShBA-së, që karakterizuan aktivitetin amerikan në Adriatik. Admirali Villiam Sims konstaton se italianët nuk e shihnin me sy të mirë praninë amerikane në Adriatik.³⁰

Detyrat e parashtruara në "Komisionin Përgatitor Amerikan" lidhur me Ballkanin konsistonin në: Përpilimin e kufijve të ardhshëm, vlerësimin e fuqisë dhe dobësive të shteteve të pasigurta (duke aluduar me këtë rast në Shqipërinë), aranzhimet qeveritare dhe ekonomike, mbrojtjen e minoriteteve apo njerëzve të dobët etj.³¹

Memorandumi i "Inkuajarit" mbi çështjen e Ballkanit nënvizonte se nuk ka justifikim për zgjerimin e sovranitetit italian në rajonet e bregdetit Adriatik - Dalmacisë, meqë rrezikohej ekspansioni italian në Ballkan.³²

Presidenti Villson mbështeste pikëpamjet e përgjithshme të zhvilluara në memorandumin e "Inkuajarit". Ai ishte mjaft i matur që të mos ketë gisht në shumë çështje specifike në memorandum të sugjeruara nga Komisioni, duke preferuar që të mbajë diskutimet e tij lidhur me synimet e luftës dhe paqes në një nivel më të përgjithshëm. Kështu, nëse bëhet një krahasim ndërmjet pikës XI të programit të Presidentit

²⁸ United States Department of State, *Papers Relating to the Foreign Relations of the United States: The Paris Peace Conference, 1915*, Department of State Publication, v. 2 (U.S. Government Printing Office, 1942), supplement part II: neutral right, p. 72.

²⁹ Haris Silajxhiq, *Shqipëria dhe SHBA në Arkivat e Vashingtonit* (Tiranë: Dituria, 1999), p. 52.

³⁰ "Papers of William Sims", letër e Simsit dërguar Bensonit, më 15.12.1918; Po aty.

³¹ United States Department of State, *Papers Relating to the Foreign Relations of the United States: The Paris Peace Conference, 1919*, Department of State Publication, v. 1 (Washington: U.S. Government Printing Office, 1942), p. 19.

³² "Memorandum", Baker, Ray Stannard. *Woodrow Wilson and World Settlement: Written from His Unpublished and Personal Material* (United States: P. Smith, 1960), p. 3, 35.

Villson, që kishte të bënte me Ballkanin dhe memorandumit të “*Inkuajarit*” do të nxjerrim një konkludim të tillë. Villsoni nënvizonte problemet e përgjithshme, mirëpo gjuha e tij ishte konkrete. Të gjitha territoret e okupuara do të duhej të evakuheshin dhe ripërtërihen marrëdhëniet ndërmjet shteteve ballkanike të cilat duhet të vendosen nën prizmin e “*negociatave miqësore në sajë të vijave të vendosura historikisht dhe të përkatësisë kombëtare; duhet po ashtu të sigurohen garanci ndërkom-bëtare të pavarësisë politike dhe ekonomike, si dhe të ruhet integriteti territorial i disa shteteve ballkanase*”.³³

Lidhur me çështjen shqiptare në veçanti, qëndrimi i personelit të “*Inkuajarit*”, i shprehur në memorandumet dhe draftrekomandimet e 22 dhjetorit të vitit 1917, 2 janarit 1918 dhe 21 janar 1919, për shkak të mosnjohjes së çështjes shqiptare dhe të Ballkanit, në përgjithësi, ishin në diskrepancë me realitetin në terren dhe ishte më specifik, duke hedhur poshtë vendimet e Marrëveshjes së Bukureshtit. Serbia do të duhej, sipas mendimit të personelit të sektorit ballkanas, të ketë qasje në det nëpërmjet portit të Selanikut, si zgjedhje më e mirë. Sa i përket Maqedonisë, ardhmëria e saj do të duhej të vendoset më vonë, pasi të përfundojnë studimet shtesë. Çështja e Shqipërisë vështrohej nën prizmin “*pothuajse me siguri, si entitet politik i padëshiruar*”.³⁴ Në memorandumin e Komisionit Përgatitor, faktorët ekonomikë lidhur me çështjet ballkanike ngadhënjyen ndaj rëndësisë së përkatësisë etnike. Që këtej, në përcaktimin e kufijve territorialë të Ballkanit, sipas “*Inkuajarit*”, faktorët ekonomikë kishin primat.³⁵

Influenca e propozimeve të “*Inkuajarit*”, në marrëveshjet përfundimtare paqësore sa i përket gadishullit ballkanik ishte e limituar dhe kishte vetëm rezultate fillestare në adaptimin e disa koncepcioneve në të “*Katërmbëdhjetë pikat*”.

Rekomandimet e “*Inkuajarit*” nuk kishin forcën e trasimit të politikës amerikane në Konferencën e Paqes në Paris, mirëpo kufizoheshin në domenin e informimit, rekomandimit. Në rastin e Ballkanit këto koncepcione nuk ishin të mbështetura në forcën e argumentit dhe nuk ishin të përpiluara nga ekspertë të mirëfilltë të çështjeve ballkanike. Në këtë kuadër programi i Komisionit Përgatitor lidhur me Evropën u realizua vetëm pjesërisht.

³³ Gelfand, *The Inquiry*, p. 144-145.

³⁴ Inquiry Doc. 887, p. 50-51; Po aty.

³⁵ Po aty.

Pjesa e programit për Ballkanin në krahasim me pjesët e tjera përjetoj ndryshim rrënjësor gjatë procesit të negocimit dhe shërbeu vetëm si “*tekst informativ*” dhe nuk e determinoi politikën amerikane në Konferencën e Paqes në Paris, meqë autoritetin e krijimit të qëndrimeve politike e kishin negociatorët e plotfuqishëm, si dhe vetë Presidenti Villson si bartësi kryesor i kësaj politike. Strukturimi, organizimi dhe konceptimi i politikës së jashtme amerikane ishte nën vështirimin dhe në duart e Presidentit Villson, shprehi e pandryshueshme e të cilit ishte edhe marrja e pavarur e vendimeve pavarësisht nga sugjerimet dhe këshillat e personelit përkatës.³⁶

Çështja e shtetit shqiptar përballë politikave të Fuqive të Mëdha dhe qëndrimi amerikan

Formësimi i qëndrimeve të politikës amerikane ndaj çështjes shqiptare dhe të Adriatikut, pjesë e së cilës ishte gjatë sesioneve të punimeve të Konferencës, mund të përmbledhet në katër shtylla kryesore: Formësimi i qëndrimeve për zgjidhjen e çështjes shqiptare dhe të Adriatikut; marrëveshja provizore për çështjen e Adriatikut “Memorandumi i 9 dhjetorit 1919”; përpjekja për zhvleftësimin e “Memorandumit të 9 dhjetorit” nga ana e tri Fuqive të Mëdha dhe mbrojtja amerikane e qenies së shtetit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve deri më pranimin në Ligën e Kombeve.

Në periudhën e parë, me gjithë përpjekjen që në përfundim të negociatave për atë që njihet si “Marrëveshja e Versajës” që të arrihet një zgjidhje edhe për çështjen e Adriatikut, në kuadër të së cilës ishte edhe çështja shqiptare, nuk u arrit të ketë një pajtueshmëri të Fuqive të Mëdha për përcaktimin e konditave të pranueshme për të gjitha palët. Mbrojtja e “*Programit të paqes*” të prezantuar nga Presidenti Villson dhe ndalja e ekspansionit italian në Adriatik, respektivisht qëndrimeve për çështjen e Adriatikut dhe asaj shqiptare e karakterizuan politikën amerikane në këtë periudhë. Pikërisht në këtë kohë vendimtare për qenien e çështjes shqiptare, qëndrimi i ShBA-së dhe i Presidentit Villson në prag të Konferencës e gjatë gjithë punimeve të saj ishte e vetmja përkrahje që çështja shqiptare gjeti për mbijetimin e saj historik. Përkrahja ishte e shumënduarshme, në filllet e Konferencës ishte refuzimi i njohjes së Marrëveshjes famëkeqe të Londrës për ndarjen treshes të

³⁶ Arthur Walworth, *Wilson and His Peacemakers: American Diplomacy at the Paris Peace Conference, 1919* (New York: Norton, 1985.), p. 7-11.

Shqipërisë, pjesë e së cilës nuk ishte ShBA-ja dhe e cila nuk reflektonte në Programin e 14 pikave të proklamuar për Paqe Botërore nga ana e Presidentit Villson. Kjo marrëveshje shkelte edhe parimin bazë të vetëvendosjes së popujve, pa marrë parasysh madhësinë e numrin e tyre, që ishte pjesë e programit.³⁷

Parimi i vetëvendosjes, pavarësisë dhe disponimit me hapësirën e natyrshme për funksionim e shteteve të reja të dala pas luftës, sikurse me rastin e çështjes së Adriatikut, respektivisht shtetit të ri të Jugosllavisë, bregdetit të saj dhe të mbrojtjes së pavarësisë së Shqipërisë, ishin një ndër parimet kryesore që Presidenti Villson nguli këmbë që në punimet e para të Konferencës. Kjo qasje u përforcua edhe më tej, meqë këto shtete ishin pre e mëtimeve territoriale strategjike të Italisë dhe politika amerikane ishte e vendosur që me çdo kusht ta parandalonte penetrimin dhe ndryshimin e balancës politike në Adriatik dhe në Gadi-shullin Ballkanik. Ky qëndrim i Komisionit Amerikan për Negocimin e Paqes ishte konstant që në fillet e punimeve të Konferencës dhe deri në përmbylljen e saj.³⁸

Muaji shkurt ishte një ndër muajt kryesorë për trajtimin e çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes. Kjo meqë u themelua dhe u mbajtën punimet e “Komisionit për Marrëdhëniet Greko-Shqiptare”, u dëgjuan kërkesat e delegacionit shqiptar dhe atij grek, u përcaktuan drejtimit kryesore për zgjidhjen e çështjes shqiptare, por edhe filloi të kuptohet elementi shumëdimensional i çështjes shqiptare, duke përfshirë këtu edhe ndërlidhjen me çështjen e Adriatikut, e cila gjatë muajve në vijim të Konferencës së Paqes shërbeu si mburojë për çështjen shqiptare.³⁹

Menjëherë pas paraqitjes së delegacionit grek, Llojd Xhorxh kërkoi leje për të bërë një propozim. Deklarata e Venizellos kishte nxitur shumë pyetje, statistikore e gjeografike; për këtë shkak ai propozoi që të ndiqet e njëjta rrugë që është ndjekur në rastin e Rumanisë. Me fjalë të tjera, që të caktohen ekspertë për t’i bashkërenduar të gjitha faktet dhe më pas, Konferenca do të vendoste për politikën pasi të jenë pranuar raportet e ekspertëve. U ra dakord që çështjet e ngritura në deklaratën e Venizellos në lidhje me interesat territoriale të Greqisë në vendosjen e paqes, do t’i referohen për shqyrtim në rastin e parë të mundshëm Komisionit të Ekspertëve, të përbërë nga dy përfaqësues nga secili prej shteteve vijuese: ShBA-së, Mbretërisë së Bashkuar, Francës

³⁷ Hadri, *Presidenti Villson dhe çështja shqiptare*, p. 77-78.

³⁸ Po aty.

³⁹ Po aty, p. 82-98.

dhe Italisë. Do të ishte detyrë e këtij Komisioni që t'i kufizonte çështjet që kërkojnë zgjidhje brenda kufijve më të ngushtë të mundshëm dhe të bëjnë rekomandime për zgjidhje të drejta. Komisioni u autorizua t'i konsultojë përfaqësuesit e popujve në fjalë.⁴⁰

Kërkesat shqiptare i kaluan për shqyrtim këtij Komisioni për çështjet greke, e në të cilin merrnin pjesë përfaqësuesit e ShBA-së, Mbretërisë së Bashkuar, Francës dhe Italisë. Në fillim të marsit ky Komision i paraqiti këshillit raportin e tij. Lidhur me kufirin shqiptaro-grek pikëpamja e katër fuqive nuk ishte e njëjtë. Ndërsa Italia ishte për ruajtjen e kufijve të 1913-tës, në viset e jugut përfaqësuesit francezë dhe anglezë duke synuar që pozitat e rëndësishme strategjike të bregdetit shqiptar që kontrollonin kanalin e Korfuzit dhe rrugën Sarandë-Janinë Korçë-Follorinë, të mos mbeteshin në kufijtë e një Shqipërie nën varësinë e Italisë, propozonin që Korça dhe Gjirokastra t'i jepeshin Greqisë. Në këtë qëndrim të tyre shprehej edhe synimi i qeverisë së Parisit për të ngushtuar zgjerimin e Italisë në Ballkan dhe qëllimi i qeverisë Britanike për ta lidhur Greqinë pas vete, në mënyrë që ta bënte një vegël në mbrojtjen e interesave britanike në Ballkan dhe veçanërisht në Lindjen e Afërme. Përfaqësuesit e ShBA-së, të cilët mbajtjen e Vlorës nga ana e Italisë e quanin të mjaftueshme për "sigurimin" e appetiteve italiane në Adriatikun Jugor, dolën me propozimin që krahina e Gjirokastrës deri në bregdet, krahinë e cila lidhej me kanalin e Korfuzit, t'i jepej Greqisë, ndërsa Korça të mbetej në kufijtë e Shqipërisë.⁴¹

Të gjitha këto rrethana negative çuan në atë që dëgjimi i delegacionit shqiptar më 24 shkurt 1919 në Këshillin e të Dhjetëve të ishte thjesht formal dhe të mbetej pa asnjë jehonë. Për pasojë pas dëgjimit të këtij delegacioni, Këshilli i të Dhjetëve nuk ngriti asnjë komision të posaçëm për shqyrtimin e kërkesave territoriale shqiptare, sikurse kishite vepruar për rastet analoge të vendeve të tjera, si për Greqinë në fillim të shkurtit.⁴²

⁴⁰ United States Department of State, *Papers Relating to the Foreign Relations of the United States: The Paris Peace Conference, 1919*, Department of State Publication, v. 3 (Washington: U.S. Government Printing Office, 1943), Doc. 180.03101/29, p. 868-875.

⁴¹ Po aty.

⁴² Muin Çami "Shqiptarët për problemin e Kosovës në mbarim të Luftës së I Botërore", J. Bajraktari, *Çështja e Kosovës - Një problem historik dhe aktual: (Simpozium i mbajtur në Tiranë më 15-16 prill 1993)* (Prishtinë: Instituti i Historisë, 1996), p. 139.

Faza e përpjekjes për gjetjen e një zgjidhjeje për çështjen shqiptare dhe atë të Adriatikut kulmon me arritjen e një marrëveshjeje të Katërshes së Madhe të mpiksur në “Memorandumin e 9 dhjetorit 1919”. Kjo marrëveshje nënkuptonte një zgjidhje të ekuilibruar pa fitues dominant. Politika amerikane karakterizohet me mbrojtjen e çështjes shqiptare, respektivisht të shtetit të Shqipërisë ndaj tendencave të shpërbërjes dhe ndarjes territoriale të tij nga ana e shteteve fqinje, me gjithë faktin se në këtë marrëveshje mandati ndaj Shqipërisë iu dha Italisë. Nga kjo mburojë natyrale e krijuar nga raporti i forcave ndërkombëtare në trajtimin e çështjes së Adriatikut, Shqipëria përfitoi dhe arriti që në saje të qëndrimeve të politikës amerikane të mbijetojë dhe të sendërtojë të drejtën e shtetit.

Nyja e mospajtimeve dhe pozicionimeve të Fuqive të Mëdha rreth çështjes së Adriatikut filloi të zërthehet në fillim të dhjetorit, që dha rezultat edhe me marrëveshjen e parë dhe të vetme ndërmjet ShBA-së, Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar lidhur me këtë çështje më 9 dhjetor 1919, e njohur edhe si “*Memorandumi i 9 dhjetorit*”.

Memorandumi u nënshkrua nga ana e Klemensoas, Krovit dhe Polllkut, përfaqësuesit të plotfuqishëm amerikan në fund të mbledhjes së Këshillit të Lartë më 9 dhjetor 1919.⁴³

Italisë iu dha kontrolli i plotë detar i Adriatikut nëpërmjet tre çelësive të Adriatikut: Pulës, Vlorës dhe një baze të ishullit qendror, mirëpo edhe këto nuk ishin të mjaftueshme që ta shuajnë apetitin e saj dhe me këtë rast u shtua koncesioni ndaj Luginës në Albona, në ishujt Lussin, kushteve të shtetit të lirë Fiume dhe gjetkë. Në këtë kontekst u përmbush nga Fuqitë e Mëdha nëpërmjet këtij memorandumit edhe kërkesa e Italisë për një mandat italian ndaj Shqipërinë.⁴⁴

Kushtet që u vënë për pranimin e këtij mandati ndaj Shqipërisë ishin si vijon:

1. Shqipëria njihej si një shtet i pavarur brenda kufijve të përcaktuar në Konferencën e Londrës të vitit 1913 sa u përket kufijve verilindorë, mirëpo me mundësi që shteti i ardhshëm shqiptar të negociojë korrigjimet e rajonit me shtetin serbo-kroato-sllloven, që mund të jenë në përputhje me kërkesat lokale etnografike dhe ekonomike;

⁴³ Hadri, *Presidenti Villson dhe çështja shqiptare*, p. 153 - 159.

⁴⁴ G.M. Hitchcock, United States President (1913-1921 : Wilson), and United States Congress Senate, *The Adriatic Question*, Document (United States. Congress (66th, 2nd Session : 1919-1920). Senate)) (U.S. Government Printing Office, 1920), p. 5-8.

2. Qeveria serbo-kroato-slllovene do të kishte të drejtën të ndërtojë dhe të operojë hekurudhat nëpër Shqipërinë e Veriut në veri të paraleles 41, shkallë 15;

3. Të drejtën për të kontrolluar zhvillimin e lumit Buna do t'i jepej Këshillit të Lidhjes së Kombeve me kompetencë për t'ia deleguar punën ose Italisë, ose shtetit serbo-kroato-sllloven (në kondita që Mali i Zi të ishte pjesë e shtetit SKS);

4. Krijimi i një komisioni i përbërë nga një përfaqësues i qeverisë italiane, një përfaqësues i Lidhjes së Kombeve dhe një përfaqësues i shtetit shqiptar, i cili do të caktohej nga fuqitë kryesore aleate dhe të asociuara për qëllime të përpunimit të (a) kushteve të mandatit që do t'i besohej Italisë mbi Shqipërinë dhe (b) organizimit të shtetit të ardhshëm të Shqipërisë. Vendimi përfundimtar për kushtet e mandatit dhe organizimit do të merrej nga Këshilli i Lidhjes, me shumicë votash;

5. Ky Komision do të mbikëqyrte edhe liritë e besimit; lirinë e plotë në arsim dhe çështje gjuhësore të të gjithë banorëve të shtetit shqiptar; parandalimin e shfrytëzimit të vendit dhe kolonizimit të tij në një mënyrë që mund të ishte kundër interesave të banorëve vendës; përmirësimin e sistemit ekzistues të pronësisë mbi tokat; krijimin eventual të xhandarmërisë (oficerët e lartë të së cilës mund të jenë shtetas të pushtetit të detyrueshëm) për një periudhë dyvjeçare nga mandatori.⁴⁵

Me gjithë faktin se Shqipëria njihej si shtet i pavarur, mandatin në administrimin e tij, nën ombrellën e Lidhjes së Kombeve, do ta kishte Italia. Kufijtë e Shqipërisë në pjesën jugore mbeteshin të kontestuar, duke iu hapur shtegu provizor Greqisë që të okupojë territorin në përfundim dhe në jug të vijës së demarkacionit, një hap i cili nëse do të jetësohej do të bëhej i pakontestueshëm më vonë. Qyteti i Vlorës së bashku me brendësinë e saj për “shkaqe të mbrojtjes dhe zhvillim ekonomik” në suazat e sovranitetit të plotë i besohej Italisë. Forma e mandatit ishte hartuar në atë mënyrë që të tentojë ta parandalojë në afat të gjatë eksploatimin e vendit dhe kolonizimin e tij. Edhe pse mandati nuk ishte në favor të shqiptarëve, këto restriksione i dedikohen delegacionit amerikan, i cili kishte merita edhe për insistimin në mbrojtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, e vetmja fuqi përkrahëse e këtij opinioni dhe oponent i Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar.⁴⁶

Memorandumi i 9 dhjetorit, ndonëse pretendonte të ishte bazë asnjënjë dhe pikë kompromisi ndërmjet antagonizmave italo-jugosllavë,

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty.

nuk arriti t'i kënaqë orekset e pangopshme të të dyja palëve, të cilat edhe u distancuan nga ai. Për më shumë, ky memorandum nuk ishte në pajtueshmëri me aspiratat e drejta të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi të plotë politike në tërësinë territoriale të pranuar ndërkombëtarisht në Konferencën e Londrës dhe me sovranitet territorial të mëvetësishëm. I jepej mandati një fuqie fqinje - Italisë, me pretendime të mëdha territoriale e ekonomike në gadishullin ballkanik dhe e cilësuar si skajshmërisht e paanshme që të udhëhiqte një projekt të tillë. Pjesa e kufirit me Greqinë nuk përcaktohej, ndaj lihej mundësia për ndryshime jo të drejta e të favorshme për Shqipërinë.⁴⁷

Megjithëkëtë, “*Memorandumi i 9 dhjetorit 1919*” ishte një hap shumë me rëndësi për rrjedhën pasuese të çështjes shqiptare në kontekstin pozitiv, meqë ishte një qëndrim i aprovuar i të tri fuqive kryesore ShBA-së, Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës, që Shqipëria të njihej si shtet i pavarur dhe ishte një gurthemel të cilin ShBA-ja në krye me Presidentin Villson nuk do të lejonin të ndryshohej me çdo kusht gjatë gjithë relacioneve të mëtutjeshme të Konferencës së Paqes dhe të Ambasadorëve.⁴⁸

Në anën tjetër, me qëllim të minimimit të “*Memorandumit të 9 dhjetorit*”, delegacioni italian lansoi pikat e “kompromisit”, vija të cilat ajo do të ishte në gjendje t'i pranonte. Propozimet italiane kishin për qëllim përçapjen e qëndrimeve të Fuqive të Mëdha dhe riorientimin e zgjidhjes së çështjes së Adriatikut në favor të saj.⁴⁹

Tentimi i zhvleftësimit të “*Memorandumit të 9 dhjetorit*” nga ana e tri Fuqive të Mëdha: Francës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Italisë dhe anashkalimin e tërësishëm të ShBA-së në këtë proces, shënoi një kapitull të veçantë në odisejadën e një kompromisi për çështjen shqiptare dhe të Adriatikut. Qëllimi primar i kasasj qasjeje ishte rikthimi në shqyrtim i çështjes së Adriatikut dhe çështjes së ekzistimit të shtetit shqiptar, si dhe akomodimi i interesave të Italisë në dëm të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë. Në bazë të qëllimeve të kësaj përpjekjeje, që është e njohur me projektpropozimin e 9 dhe 14 janarit 1920 të këtyre tri Fuqive të Mëdha, Shqipëria ndahej në tresh dhe “*Marrëveshja e fshehtë e Londrës*” vihej në funksion.

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ “F. S. Nitti to Lloyd George”, January 6 1920; Po aty.

Në momentet kur mund të mendohej se vështirësitë kryesore lidhur me harmonizimin e qëndrimeve mbi çështjen e Adriatikut ndërmjet Fuqive të Mëdha me “*Memorandumin e 9 dhjetorit*” ishin kapërcyer, hendeku përsëri u hap me përvetësimin nga ana e Mbretërisë së Bashkuar të alternativave italiane për zgjidhjen e çështjes së Adriatikut, të cilat u mbështetën edhe nga Franca.

Ky tentim i ndryshimit klandestin të një marrëveshje paraprake me ShBA-në – “*Memorandumit të përbashkët të 9 dhjetorit*”, nëpërmjet projekt-propozimeve të 9 dhe 14 janarit 1920 të sponsorizuara nga Mbretëria e Bashkuara dhe Franca, ishin thyerje e zotimeve dhe e marrëveshjes së përbashkëta të Fuqive të Mëdha. Këto propozime përmbanin në vete thelbin e “*Marrëveshjes së fshehtë të Londrës*” për ndarjen treshes të Shqipërisë, e cila ishte refuzuar kategorikisht nga Presidenti Villson, nga mundësia e përfshirjes së saj në çfarëdo forme në zgjidhjen e çështjes së Adriatikut. Ky qëndrim ishte pjesë e refuzimit të marrëveshjeve të fshehta në kuadër të programit paqësor të shpalosur nga Presidenti Villson. Në këtë prizëm, Presidenti Villson nën asnjë rrethanë nuk iu nënshtrua kësaj qasjeje të Fuqive të tjera të Mëdha, meqë me këtë rast do të ndryshonin në tërësi parimet e mbrojtura nga politika amerikane në Konferencën e Paqes. Për më shumë, Presidenti Villson mbronte pikëpamjen se asnjë territor i Shqipërisë nuk mund të jepet në favor të Jugosllavisë, si pjesë e kompensimit territorial në një vend tjetër për zgjidhjen e çështjes së Adriatikut, duke aluduar në shkëmbime terriroresh të mundshme ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë.⁵⁰

Politika amerikane, e mpiksuar në qëndrimet e prera të Presidentit Villson, ishte e vendosur se nuk do të ketë anashkalim të saj nga zgjidhja e këtyre çështjeve, nuk mund të ketë ritrajtim të këtyre çështjeve duke u bazuar në kritere joparimore dhe të papranueshme për palët e përfshira në terren, si dhe nuk pranohet në asnjë mënyrë nga ana e ShBA-së çfarëdo marrëveshje e fshehtë ndërkombëtare, duke aluduar në atë të Londrës, në të cilën nuk ka qenë e përfshirë Amerika. Ky dimension i qëndrimit amerikan mbrojti qenien e ekzistimit të shtetit të Shqipërisë.⁵¹

⁵⁰ G.M. Hitchcock, United States President (1913-1921 : Wilson), and United States Congress Senate, *The Adriatic Question*, Document (United States. Congress (66th, 2nd Session : 1919-1920). Senate)) (U.S. Government Printing Office, 1920), p. 18-26; “Documents on British Foreign Policy”, IV, p. 237; 738-744; 786-789.

⁵¹ Hadri, *Presidenti Villson dhe çështja shqiptare*, p. 160-175.

Të dyja propozimet, ai i 9 dhe 14 janarit, ishin devijim i qëndrimeve të mëparshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës, si dhe anashkalonin rezultatet e negociatave të mëparshme dhe qëndrimin e Presidentit Villson për çështjen e Adriatikut.

Presidenti Villsoni, për më shumë, përdor edhe letrën e kërce-nimit se do të tërhiqte Marrëveshjen e Versajës nga Senati nëse kryeministrat e Britanisë dhe të Francës nuk do të hiqnin dorë nga zgjidhja që kishin propozuar së bashku me Italinë, duke anashkaluar në tërësi Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ultimatumi konsistonte në kthimin e memorandumit të përbashkët amerikano-britanico-francez të 9 dhjetorit, si e vetmja zgjidhje e miratuar nga ana e Fuqive të Mëdha për çështjen e Adriatikut.⁵²

Përgjigjja e Presidentit Villson ndaj propozimeve britanico-franceze dhe ndaj sugjerimeve të personelit të tij për çështjen e Adriatikut ishte mosluhatja dhe insistimi në vijën e përcaktuar më parë nga ana e tij gjatë procesit të negocimit dhe se qëndrimi përfundimtar i qeverisë amerikane është përfshirë në notën e përbashkët të 9 dhjetorit, drejtuar qeverisë italiane, të nënshkruar nga Pollku, Krovi dhe Klemensoa.⁵³

Qëndrimet e Presidentit Villson ishin se çështja e Adriatikut nuk mund të zgjidhet në dëm të një pale të tjetër, duke aluduar në jugosllavët, të cilët ishin shtyrë me forcë drejt pranimit të planit rezervë të 20 janarit vetëm pse kishin disa kundërshtime lidhur me memorandumin e 9 dhjetorit. Mirëpo Villsoni nuk pretendonte që do të kundërshtonte një marrëveshje të përbashkët të pranueshme për Italinë dhe Jugosllavinë, me kusht që një ujdje e tillë nuk do të bazohej në ndonjë kompensim gjetiu në llogari të nacionalitetit të një fuqie të tretë.⁵⁴

Kjo çështje e një ujdje që do të ishte në kurriz të një pale të tretë është e drejtuar kah çështja e mosndarjes së shtetit të Shqipërisë, çka edhe e vërteton nënvizimi i Presidentit Villson që copëtimi tresh i Shqipërisë në propozimin britanico-francez mund të jetë i pranueshëm për qeverinë jugosllave, mirëpo “*Presidenti Villson i kundërvihet fuqishëm çdo padrejtësie ndaj popullit shqiptar për përfitime të Jugosllavisë, për*

⁵² Woodrow Wilson ed Arthur Link, *The Papers of Woodrow Wilson*, vol. 64, 68 vols. (Princeton: Princeton University Press, 1991), p. VIII.

⁵³ “Edith Bolling Galt Wilson to Robert Lansing – The White House, 27 January 1920”, Woodrow Wilson ed Arthur Link, *The Papers of Woodrow Wilson*, vol. 64, 68 vols. (Princeton: Princeton University Press, 1991), p. 335-337.

⁵⁴ “Frank Lyon Polk to H.C. Wallace, Doc. nr. 401, February 24 1920”, Woodrow Wilson ed Arthur Link, *The Papers of Woodrow Wilson*, vol. 64, 68 vols. (Princeton: Princeton University Press, 1991), p. 459-463.

aq sa është edhe në kundërshtim me dëmtimin e popullit jugosllav për përfitime të Italisë”. Ai spikat që diferencat ndërmjet popullatës me besim të krishterë dhe mysliman do të theksoheshin më tepër nëse këto dy seksione do të viheshin nën kontrollin e kombeve me gjuhë dhe qeverisje të ndryshme, si dhe me fuqi të ndryshme ekonomike. Për më tepër, një pjesë do të administrohej nga qeveria italiane që është e përfaqësuar në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, ndërsa pjesa tjetër nga qeveria jugosllave që nuk ka një përfaqësim të tillë. Kësisoj ndryshimi apo heqja e një mandati të tillë në një të ardhme do të ishte pothuajse e pamundshme.⁵⁵

Sa i përket Marrëveshjes së Londrës, Presidenti Villson e riafirmoi vijën e përcaktuar më parë nga ai se çështja e Adriatikut nuk mund të lidhet dhe të jetë peng i kësaj marrëveshjeje, duke e argumentuar me faktet e parashtruara më parë nga ai, sikurse shpërbërja e Austro-Hungarisë, karakteri i fshehtë i marrëveshjes, si dhe kundërshtimi i tij ndaj principeve të pranuar unanimisht si baza të ndërtimit të paqes.⁵⁶

Problemi i Marrëveshjes së Londrës ishte njëra ndër çështjet më akute që trajtoheshin në Konferencë. Ky ishte problem i cili në vorbullën e saj tërhiqte edhe një mori çështjesh të tjera të rëndësishme. Ishte pikërisht çështja e Adriatikut dhe ajo shqiptare që varej nga pranimi apo refuzimi i saj. Politika amerikane hidhte poshtë decidivisht çdo lloj marrëveshjeje të fshehtë dhe të bazuar në kurriz të vendeve të tjera. Kjo ishte në kundërshtim me të “*Katërmëdhjetë pikat*”, nuk ishte në vazhden e vijës politike të përcaktuar nga Villsoni dhe thyente skajshmërisht parimet e vetëvendosjes së popujve. Delegacioni amerikan tentonte në çdo mënyrë ta minonte këtë marrëveshje të fshehtë.⁵⁷

Si rezultat i këmbënguljes së patundshme të Presidentit Villson për gjetjen e një zgjidhjeje të drejtë dhe bazuar në principet e nënvizuara në politikën e tij, u arrit që ujdia për çështjen e Adriatikut, respektivisht mbi atë shqiptare të shtyhet për një kohë më të përshtatshme, e që do të respektonte konceptet politike të tri Fuqive të Mëdha. Një politikë e tillë amerikane mundësoi pengimin e fuqive evropiane që të legalizojnë ndonjëherë nga zgjidhjet e paraqitura, nga të cilat asnjëra nuk ishte në dobi të Shqipërisë. Punimet e Konferencës së Paqes u përmbyllën dhe arritja e një zgjidhjeje të kënaqshme për çështjen shqiptare dhe të

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Hadri, *Presidenti Villson dhe çështja shqiptare*, p. 177-185.

Adriatikut u përcaktua të merret në Konferencën e ardhshme të Ambasadorëve.⁵⁸

Periudha e mbrojtjes amerikane të qenies së shtetit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve deri me pranimin në Ligën e Kombeve fillon me përfundimin e punimeve të Konferencës së Paqes në Paris më 21 shkurt 1920 dhe përfshin fillimin e punimeve të Konferencës së Ambasadorëve, e deri me pranimin e Shqipërisë në Ligën e Kombeve dhe nga ana e ShBA-së. Kjo etapë karakterizohet me ngritjen e faktorit të brendshëm shqiptar, me fillimin e konsolidimit të brendshëm të tij në vazhden e ripërtëritjes së shtetit shqiptar, si dhe me mbrojtjen amerikane të shtetësisë së Shqipërisë.

Shqiptarët, të zhgënjyer nga lëkundjet e diplomacisë evropiane dhe planeve të saj për një copëtim të mëtutjeshëm, gjallërojnë jetën e tyre politike dhe në janar të vitit 1920 organizojnë Kongresin historik të Lushnjës. Kongresi i Lushnjës u përball me riafirmimin e pavarësisë, konfirmimin e sovranitetit të brendshëm dhe të jashtëm të vendit, si dhe me përcaktimin e parimeve kushtetuese të tij. Konsolidimi i Shtetit të Shqipërisë, në fazën vijuese, ishte një ndër shtyllat kryesore të riafirmimit të çështjes shqiptare në sferën e konstelacioneve ndërkombëtare.⁵⁹

Në kontekstin e përçarjeve të Fuqive të Mëdha lidhur me çështjen shqiptare dhe të Adriatikut, qëndrimi i politikës amerikane dhe i Presidentit Villson në përgjigjen e tij më 2 mars 1920 drejtuar Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar, ishte vetëmohues duke ritheksuar qëndrimin që *“ai pranonte një marrëveshje ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë, por vetëm me kusht që kjo të mos prekë interesat territoriale apo interesat e tjera të kombeve të treta”*, duke aluduar në Shqipërinë. Më pas delegacioni amerikan thekson qëndrimin e Presidentit Villson që *“çështja shqiptare nuk duhej të përfshihej në diskutimet e përbashkëta të Italisë dhe Jugosllavisë dhe Presidenti Villson vuri në pah që ai në asnjë mënyrë nuk do të pranojë asnjë plan që i jep Jugosllavisë pjesë të rajonit verior të Shqipërisë si kompensime territoriale, të cilat asaj i privohen diku tjetër”*.⁶⁰

Rezultat i fillimit të konsolidimit të politikës së brendshme shtetërore ishte ndryshimi i kursit në marrëdhëniet e jashtme, që morën një drejtim pozitiv për Qeverinë e Tiranës. Një zhvillim me rëndësi ishte

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ “Frank Lyon Polk with Enclosure, March 2 1920”, Woodrow Wilson, ed Arthur Link, *The Papers of Woodrow Wilson*, vol. 65, 68 vols. (Princeton: Princeton University Press, 1992), p. 38.

marrëveshja shqiptaro-greke e 18 maj 1920, respektivisht “*Protokolli i Kapshticës*”. Kjo marrëveshje ishte e kufizuar dhe trajtonte çështjen e ruajtjes së gjendjes ekzistuese në zonën kufitare, duke theksuar se trupat greke pas largimit të trupave franceze nuk do të avanconin në thellësi të territorit shqiptar. Mirëpo, Shqipëria ndodhej gjithnjë përpara rrezikut immanent të humbjes së pavarësisë dhe cungimit të territorit. Vlora u bë simboli i rezistencës, çlirimi i saj u bë objektivi kryesor i lëvizjes që rezultoi me kurorëzimin e tërheqjes së trupave italiane nga territori i Shqipërisë, që ndryshoi rrënjësisht edhe rrjedhën e politikës së jashtme ndaj saj. Me gjithë konsolidimin e pjesshëm të shtetit shqiptar, në fund të vitit 1920 ende mbeteshin pa u zgjidhur çështjet bosht, - ajo e njohjes ndërkombëtare të shtetit të pavarur dhe sovran të Shqipërisë dhe mbrojtja e kufijve të përcaktuar me marrëveshjen ndërkombëtare të vitit 1913.⁶¹

Pas tërheqjes së trupave italiane nga Vlora dhe të trupave franceze nga Korça, Qeveria e Shqipërisë e ushtronte pushtetin e saj në pjesën më të madhe të territorit brenda kufijve të saj shtetërorë. Mirëpo, po ashtu ajo ballafaqohej me okupimin e territoreve të saj në jug nga ato greke dhe në veri nuk reshtnin inkursionet e ushtrisë jugosllave. Çështja e territoreve të tjera të populluara nga shqiptarët, jashtë kufijve të përcaktuar nga viti 1913, për shkak të pozitës së palakmueshme të Shqipërisë, e cila ende nuk kishte forcë të ushtronte tërësisht sovranitetin territorial në hapësirën e saj, si dhe për shkak të konstelacioneve ndërkombëtare jo të favorshme, mbetej pezull dhe pa trajtim të duhur. Në këto kondita shtrohej si një çështje e ngutshme ripohimi i statusit të Shqipërisë si shtet i pavarur dhe sovran, akt me të cilin qeveria e Shqipërisë do të të përfshihej në arenën e marrëdhënieve ndërkombëtare.⁶²

Përkrahja e Presidentit të ShBA-së, Vudro Villson, për pavarësinë e Shqipërisë edhe një herë u përforcua me qëndrimin që ai mbante me kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar Llojd Xhorxh. Kështu në përgjigjen e tij drejtuar Kryeministrit Xhorxh, më 3 nëntor 1920, Presidenti Villson thekson që ai beson në një zgjidhje të drejtë dhe konstruktive të çështjes së Shqipërisë dhe të çështjes së Adriatikut. Lidhur me Shqipërinë, Presidenti Villson rithekson që ky problem ka pasur qasje jo të duhur, duke e lidhur me përcaktimin e kufijve të Shqipërisë sipas aspiratave të Jugosllavisë dhe Greqisë, pa marrë parasysh në masë të duhur

⁶¹ Hadri, *Presidenti Villson dhe çështja shqiptare*, p.189-198.

⁶² Po aty.

aspiratat dhe të drejtat e vetë popullit shqiptar. Po ashtu, Presidenti Villson rithekson që tani “*qëllimi primar është t’u nënshtrohem aspiratave të drejta të popullit shqiptar për një zgjidhje përfundimtare të kësaj çështjeje*”.⁶³

Pranimi i Shqipërisë nga Lidhja e Kombeve më 17 dhjetor 1920, me ç’rast u ripohua statusi i saj si shtet i pavarur me njohjen kolektive ndërkombëtare, ishte me rëndësi vendimtare, meqë konfirmohej njohja ndërkombëtare e shtetit shqiptar.⁶⁴

Me gjithë faktin se periudha pasvillsoniane cilësohet me rripozicionimin e stepur të politikës së administratës së re amerikane dhe hezitimimin fillestar për pranimin e shtetit shqiptar, në përfundim të këtij procesi interesat potenciale që Shqipërinë e cilësonin me rëndësi në rrafshin e eksploatimit të resurseve natyrore ekonomike, ndikuan që Qeveria e ShBA-së më 28.8.1922 të njohë “*de jure*” Qeverinë e Shqipërisë, të themelojë marrëdhënie diplomatike, akt me të cilin përmbillet një kaptinë me rëndësi në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane.⁶⁵

Mund të përfundojmë se në kuadër të përcaktimit të rendit të ri botëror pas Luftës së Parë Botërore qëndrimi i ShBA-së ka qenë vendimtar për mbijetimin e shtetit shqiptar. Kjo politikë ka parandaluar shuarjen e shtetit shqiptar, ndarjen treshas të Shqipërisë e popullit të saj dhe dhënien e territoreve të saj vendeve fqinje. Në këtë kuadër ShBA-ja ka qenë e vetmja Fuqi e Madhe që ka përkrahur në formë të palëkundër të drejtën e popullit shqiptar për vetëvendosje dhe për sendërtimin e shtetit të Shqipërisë.

⁶³ Woodrow Wilson, ed Arthur Link, *The Papers of Woodrow Wilson*, vol. 66, 68 vols. (Princeton: Princeton University Press, 1992), p. 307-308.

⁶⁴ *Historia e popullit shqiptar*, grup autorësh, vol. III (Tirana: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007), p. 171.

⁶⁵ Departamenti i Shtetit, Doc. 875.01/233.a. Bllejkut, më 25.7.1922 gjithashtu iu dha urdhër që deri në vendosjen e marrëdhënieve të rregullta diplomatike të qëndronte në Shqipëri në rangun e të dërguarit me punë.

KONFERENCA E AMBASADORËVE NË
LONDËR DHE SHQIPTARËT

Konferencë shkencore
13 tetor 2023

2024

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Bahri Koskoviku

Redaktor teknik:
ASHAK

Madhësia: 14 tabakë shtypi
Tirazhi: 300 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

94(496.5).085.11(062)
930.22(=18:420)”2023“(062)

Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe shqiptarët : konferencë shkencore 13 tetor 2023 = The Conference of Ambassadors in London and the Albanians : Scientific Conference 13 October 2023 / përgatitur nga Frashër Demaj. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2024. - 221 f. ; 24 cm.

Teksti në gjuhën shqipe

1. Demaj, Frashër

ISBN 978-9951-26-091-6